

NË KËTË NUMËR FESTIV TË GAZETËS "EPOKA E RE" MUND TË LEXONI SHKRIME TË LLOJLLOJSHME NGA POLITIKA, EKONOMIA, KULTURA, MUZIKA, SPORTI DHE KOLUMNË

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7963  
31 dhjetor 2024 dhe  
1, 2 e 3 janar 2025



**BEHXHET SHALA**  
vjen me një  
shkrim ekskluziv:  
Vitin që iku e  
pamë, për 2025-n  
ta dëgjojmë Baba  
Vangën!



**EDITA TAHIRI:**  
Ballkani  
Perëndimor në  
mes të Perëndimit  
dhe Rusisë:  
Koha të vendosen  
kufijtë  
gjeopolitikë



**IBRAHIM GASHI:**  
Fqinjësia e  
kontestuar dhe  
inkursionet  
terroriste të  
Serbisë ndaj  
Kosovë gjatë  
vitit 2024

## 2025-a, BETEJA FINALE E STRATEGJËVE TË LIRISË

Lexoni ngjarjet më të veçanta që kanë ndodhur në Kosovë dhe botë gjatë vitit 2024. Shkrime edhe për diplomacinë e Kosovës gjatë vitit 2024 dhe bredhjet e liderëve institucionalë pa asnjë rezultat në politikën e jashtme.

Po në këtë numër festiv mund të lexoni dy shkrime për çlirimtarët në Hagë, për proceset gjyqësore gjatë vitit 2024 dhe padrejtësitë ndaj tyre për më shumë se katër vjet. Dhe një shkrim nga LULZIM ETEMAJ: "Kambanat e alarmit të Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit".

### GËZUAR 2025!



**MILAZIM KRASNIQI:** Si ta ribëjmë kombin në realitetet e reja



**BURIM RAMADANI:** Viti 2025: stabilizim, transparencë, zhvillim



**VALON MURTEZAJ:** 2024-a, vit me zhvillime të rëndësishme në politikën e jashtme globale



**FERAT SHALA:** Viti i ri, vit më i mirë sepse Kosova meriton më mirë



**SAFET GËRXHALIU:** Dështimi i thellë në diplomaci, sanksionet e BE-së, mungesa e stabilitetit politik dhe dështimi ekonomik janë realiteti i Kosovës 2024

"EPOKA E RE" TË GJITHË QYTETARËVE UA URON VITIN E RI 2025!



**Kolegji  
BIZNESI**  
www.kolegjbiznesi.com  
info@kolegjbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**AWR ABRBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de



# Ngjarjet kryesore që karakterizuan shqiptarët në vitin 2024

**EPOKA E RE** Përgatiti: Lirim GECI

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Viti që po lëmë pas është karakterizuar me ngjarje të shumta të shqiptarët. Në Kosovë, krahas liberalizimit të vizave, kanë ndodhur shumë zhvillime, duke përfshirë ndalimin e dinarit serb, sulmin terrorist në "Ibër-Lepenc", shpalljen e datës së zgjedhjeve, aktivizimin e organeve të drejtësisë në raport me dyshimet për korrupsionin qeveritar. Kurse në Shqipëri, krahas hapjes së kapitullit të parë për anëtarësim në BE, ka ndodhur edhe arrestimi i ish-presidentit Ilir Meta. Edhe në Maqedoninë e Veriut ka pasur zhvillime të shumta, ku ndër to kanë qenë zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare dhe debati i ashpër për Ligjin për Gjuhët, ku përfshihet edhe ajo shqipe, i cili ka përfunduar në Kushtetuese.

## Qytetarët e Kosovës udhëtojnë pa viza

Qytetarët e Kosovës nga 1 janari i vitit 2024 kanë filluar të udhëtojnë pa viza në shtetet e zonës Schengen. Liberalizimi i

vizave u mundëson qytetarëve të Kosovës, që kanë pasaporta biometrike, të qëndrojnë deri në 90 ditë brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga 27 shtetet anëtare të zonës Schengen. Por, pavarësisht se Spanja është pjesë e Schengenit, kosovarët nuk do të mund të udhëtojnë në këtë shtet, pasi Madridi zyrtar nuk e njeh pavarësinë e Kosovës e as pasaportat e saj.



## Ndalohe dinari serb në Kosovë

Banka Qendrore e Kosovës (BQK) ka miratuar rregulloren për operacionet për paratë e gatshme, e cila thotë se monedha e vetme që lejohet për kryerjen e transaksioneve të pagesave me para të gatshme në Kosovë është euro, duke ndaluar përdorimin e dinarit. Ky vendim ka ngjallur reagime të shumta

nga bashkësia ndërkombëtare dhe Serbia.



## Haradinaj dhe Limaj bashkojnë forcat

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Socialdemokrate kanë nënshkruar marrëveshje koalicioni për zgjedhjet parlamentare. Kjo marrëveshje është nënshkruar nga Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj. Haradinaj ka theksuar se ata janë bashkuar për arsyen se nuk duan t'i lënë qytetarët e Kosovës pa kujdes pasi, sipas tij, ata janë të "luftuar" nga qeveria Kurti. Ndërsa Fatmir Limaj ka thënë se koalicioni parazgjedhor me AAK-në është lajm i mirë për politikën në Kosovë dhe gjithë qytetarët.



## Konfiskohet pasuria e Radoiqit në Kosovë

Autoritetet në Kosovë kanë konfiskuar dhe sekuestruar pasuri të Millan Radoiqit, ish-nënkryetarit të Listës Serbe, i cili mori përgjegjësinë për sulmin ndaj policisë së Kosovës në Banjskë shtatorin e vitit të kaluar. Më 4 prill, në një aksion në veriun e Kosovës, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara konfiskoi dy prona të paluajtshme në Mitrovicën e Veriut dhe një në komunën e Zubin Potokut, të cilat janë të lidhura me sulmin e një grupi të armatosur serbësh në Banjskë.

## Shqipëria hap kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në BE

Shqipëria ka hapur kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën e përbashkët për medie me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szijjarto, në Luksemburg, e ka vlerësuar historik nisjen e këtij procesi. Rama ka thënë se shqiptarët nuk mund të kenë një plan B kur vjen fjala për liritë individuale, sundimin e ligjit dhe demokracinë funksionale.

## Ngrehet aktakuzë ndaj 45 personave për sulmin në Banjskë, në mesin e tyre edhe Radoiqi

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë ndaj 45 personave, në mesin e tyre edhe Millan Radoiqi, për sulmin e armatosur në Banjskë. Të përfshirët, sipas prokurorit të rastit, Naim Abazi, kanë pasur role të ndryshme brenda grupit të tyre kriminal, "duke filluar nga



organizimi dhe drejtimi i aktiviteteve terroriste deri te financimi dhe shpëlarja e parave”.

### Kosova përfiton nga ShBA-ja mbi 34 milionë dollarë

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nëpërmjet USAID-it kanë ndihmuar Kosovën edhe me mbi 34 milionë dollarë. Marrëveshja është nënshkruar në mes të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani dhe përfaqësueses së USAID-it, Mary Elieen Devitt. Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier ka thënë se përkushtimi i ShBA-së ndaj popullit të Kosovës është po aq i fortë dhe i hekurt si gjithmonë. Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se janë duke u përballur me disa sfida me qeverinë e Kurtit që, sipas tij, kanë ndikuar në cilësinë e partneritetit ShBA - Kosovë.

### Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku lirohen nga akuzat për krime lufte

Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin lirues ndaj ish-komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Sylejman Selimi dhe ish-pjesëtarit të UÇK-së, Jahir Demaku, të cilët akuzoheshin për krime lufte kundër popullatës civile.

Trupi gjyqësor ka vlerësuar se dëshmia e dëshmitarit "A" si e vetme ka qenë e mangët për ta arritur standardin e të provuarit për krimet e luftës dhe vendimi është i bazuar në standardet vendore.



### Kosova ka 1.5 milion banorë

Kosova i ka 1 586 659 banorë të regjistruar, sipas raportit përfundimtar të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për regjistrimin e popullsisë për vitin 2024. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të ASK-së, Avni Kastrati, ka thënë se kjo agjenci ka bërë vlerësimin për komunat me shumicë serbe në veri të vendit, ku kryesisht është bojkotuar procesi. Ai ka thënë se ASK-ja vlerëson se Kosova ka një popullsi të përgjithshme rezidente prej 1 602 515. Numri i saktë i banorëve në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës nuk është i njohur, megjithatë gjatë procesit të fundit të votimit atje në prill, të drejtë vote kishin 46 556 qytetarë, këtu përfshihen edhe vendet ku jeton komuniteti shqiptar. Më 6 prill kishte filluar regjistrimi i popullsisë, ndërsa



## Bedri Hamza, kandidat i PDK-së për kryeministër të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka dominuar Bedri Hamzën kandidat të PDK-së për kryeministër të Kosovës.

“Si një personalitet i dëshmuar, Bedriu është përgjigjja jonë ndaj thirrjeve të qytetarëve për jetë, mirëqenie dhe të ardhme më

të mirë e më të sigurt!”, ka thënë Krasniqi të mërkurën në një konferencë të përbashkët për medie me Bedri Hamzën.

rezultatet përfundimtare janë shpallur më 20 dhjetor.



### Prokuroria e fton për intervistim ministren Hajdari, e dyshuar për keqpërdorim të detyrës

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ftuar për intervistë ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Kosovës (MINT), Rozeta Hajdari, e cila dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me rezervat shtetërore. Megjithatë, Prokuroria ka thënë se Hajdari e ka mbrojtur veten në heshtje në paraqitjen e saj si e pandehur para prokurorëve. “Mirëpo, e njëjta sot nuk është deklaruar dhe, siç e parasheh Kodi i Procedurës Penale, ka shfrytëzuar të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje”, ka njoftuar prokuroria.

### Dështon iniciativa për shkarkimin e kryetarëve në veri të Kosovës

Ka dështuar procesi i votimit për shkarkim ose jo të kryetarëve shqiptarë në katër komunat në veri të Kosovës. Serbët lokalë, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok, ndonëse kanë marrë pjesë në peticionin për shkarkim të kryetarëve, më vonë e kanë bojkotuar procesin, sikurse ka bërë thirrje Lista Serbe. Kjo parti, më e madhja e serbëve në Kosovë, e cila gëzon

mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka thënë se ka vendosur ta bojkotojë procesin për shkak të listave të vjetërsuara të votuesve dhe duke pretenduar se procedurat e planifikuara janë “të pamundura” dhe se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, “ka bërë gjithçka që votimet të dështojnë”. Si pasojë e dështimit të procesit të 21 prillit, kryetarët shqiptarë e kanë siguruar edhe një vit në krye të komunave, pasi një proces i njëjtë nuk do të mund të zhvillohet në 12 muajt e ardhshëm.



### Hapet baza e NATO-s në Kuçovë

Në Kuçovë të Shqipërisë është përfunduar baza ajrore taktike e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), e para bazë e aleancës në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në ceremoninë inauguruese morën pjesë përfaqësues të NATO-s, ministri i Mbrojtjes i Turqisë dhe ai i Italisë, përfaqësues të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe ata të institucioneve të Shqipërisë dhe të Kosovës. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka theksuar se kjo bazë është një element tjetër i sigurisë për rajonin e Ballkanit Perëndimor.

### PDK-ja i jep fund bashkëpunimit me LDK-në në Prishtinë

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i ka dhënë fund

koalicionit qeverisës me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) në komunën e Prishtinës. Vendimi ka ardhur menjëherë pas mbledhjes së Kuvendit Komunal kur PDK-ja kishte mundësuar kuorumin dhe votuar “pro” shfuqizimit të vendimit për shkëmbimin e disa pronave komunale në Badoc. Kjo lëvizje e PDK-së kishte ardhur pak ditë pasi kryetari Përparim Rama kishte liruar nga detyra nënkryetaren Donjeta Sahatçiu si dhe drejtorin për Shërbime Publike, Ilirik Musliu, që të dy nga radhët e PDK-së.

### Kurti “lëshon bajrakun”, urdhëron kalimin e pronave Manastirit të Deçanit

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka lëshuar ‘bajrakun’ në lidhje me pronat për Manastirin e Deçanit. Ai ka thënë se qeveria e tij i ka kërkuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës ta zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të vitit 2016 për tokën e Manastirit të Deçanit. Kurti ka thënë se ndonëse Qeverisë së Kosovës nuk i pëlqen vendimi, të cilin e ka cilësuar “të çuditshëm” e “të padrejtë”, ajo nuk ka mjete ligjore dhe juridike për ta anuluar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Ky vendim i Kurtit ka nxitur reagime të shumta në vend, pasi që përgjatë gjithë së kaluarës së tij politike, Kurti dhe partia që udhëheq kanë qenë kundër zbatimit të një vendimi të tillë.

### Dejona Mihali intervistohet nga Prokuroria Speciale

Dejona Mihali, koordinatoreja e fuqishme e Komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje, është intervistuar nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Në një

njoftim Prokuroria Speciale ka bërë me dije se Mihali është intervistuar në cilësinë e dëshmitares për disa çështje penale që po hetohen nga kjo prokurori. Pas përfundimit të intervistimit, Mihali u është përgjigjur shkurt pyetjeve të gazetarëve. “Jam intervistuar për zbardhjen e së vërtetës...”, ka thënë ajo, e cila nga gazetaret është pyetur edhe për mesazhet e saj me ish-kryeshefin e KEK-ut, Nagip Krasniqi, por nuk ka dhënë përgjigje. “Gjithë të mirat! Mirupafshim! Punë të mbarë!”, ka thënë Mihali.

### Shqiptarët e Luginës protestojnë për “identitet dhe dinjitet”

Shqiptarët e Luginës së Preshevës kanë protestuar në Bujanoc, ku kanë akuzuar Serbinë për shkeljen sistematike të të drejtave të tyre. Deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka akuzuar qeverinë serbe për mohimin e të drejtave të shqiptarëve. Ai ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare t'i bëjë trysni Serbisë për ndaljen e diskriminimit ndaj shqiptarëve në Luginë. Këtë protestë e ka mbështetur edhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, duke u zotuar se të drejtat e shqiptarëve në Luginë do t'i ngrehin në nivelet më të larta ndërkombëtare.



### Takohen Kurti dhe Krasniqi, flasin për zgjedhjet

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, kanë zhvilluar një takim të përbashkët në të cilin kanë folur për zhvillimet e përgjithshme në vend, duke mos përjashtuar as shkuarjen në zgjedhje të parakohshme. Për këtë të fundit, Kurti ka thënë se ka shprehur interesim për të diskutuar me PDK-në, LDK-në dhe AAK-në. Ndërkaq, Krasniqi ka thënë se PDK-ja është e gatshme për një pajtim me të gjitha partitë parlamentare për ta caktuar datën e zgjedhjeve të reja. Kjo iniciativë nuk është përkratur nga LDK-ja dhe AAK-ja.

### Osmani shpall 9 shkurtin datë të zgjedhjeve

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka caktuar 9 shkurtin e vitit 2025 datën kur do të mbahen zgjedhjet e rregullta parlamentare në Kosovë. Në



deketin e nënshkruar nga Osmani thuhet se caktimi i datës së zgjedhjeve u bë pas konsultimeve me partitë politike dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta parlamentare që do të organizohen në Kosovë që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

### Kosova humbet rastin historik për t'u anëtarësuar në KiE

Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE) nuk e ka përfshirë në agjendë çështjen e anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Mospërfshirja në agjendë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk e ka plotësuar kushtin për dërgimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese. Kryesuesja e deritanishme e Komitetit të Ministrave të KiE-së, Dominique Hasler, ka bërë me dije se ky komitet është duke e shqyrtuar opsionin se si ta procedojë pranimin e Kosovës në këtë organizatë. Derisa opozita e ka fajësuar pushtetin për këtë dështim, presidentja Osmani ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në KiE është vetëm çështje kohe, ndërsa kryediplomatja Gërvalla ka thënë se ky proces nuk mund të ndalet.

### Kurti ftohet për intervistim nga Prokuroria Speciale, por nuk shkon

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është ftuar nga Prokuroria Speciale për të dëshmuar lidhur me rezervat shtetërore. Ai herën e parë nuk është paraqitur në prokurori me arsyetimin se është jashtë vendit në një vizitë zyrtare. Ai as herën e dytë nuk është paraqitur para prokurorisë, por ka thënë se është i gatshëm ta japë dëshminë në zyrën e tij.



### Talat Xhaferi bëhet kryeministri i parë shqiptar në Maqedoni

Talat Xhaferi është votuar si kryeministri i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut. Ai është bërë kryeministër me 65 vota për, tri kundër dhe asnjë abstenim nga 111 deputetë sa ishin në sallë. Betimi i tij është bërë para deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut pas dorëheqjes së qeverisë së kaluar që udhëhiqej nga Dimitar Kovačevski.

## Vdes shkrimtari më i madh shqiptar, Ismail Kadare

Shkrimtari më i madh shqiptar Ismail Kadare ka ndërruar jetë në moshën 88-vjeçare. Ai ka lindur në Gjirokastrë, më 28 janar të vitit 1936. Ishte akademik, politikan, ish-deputet i Kuvendit Popullor (1970-'82), zëvendëskryetar i Frontit Demokratik dhe një ndër shkrimtarët më të mëdhenj bashkëkohorë. Kadare është shquar kryesisht për prozë, por kontributi i tij ishte shtrirë edhe në dramaturgjë, poezi dhe përkthime. Ka nisur të shkruajë kur ishte ende i ri, fillimisht poezi, me të cilat ishte bërë i njohur, e më pas edhe prozë, duke u bërë prozatori kryesor shqiptar. Veprat e tij janë përkthyer në rreth 45 gjuhë të ndryshme, duke qenë kështu përfaqësues kryesor i letërsisë shqipe nëpër botë.



### Shefi i CIA-s viziton Kosovën

Shefi i Agjencisë Qendrore amerikane të Inteligjencës (CIA), William Burns, ka qëndruar për një vizitë në Kosovë më 22 gusht. Burns është takuar me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeministrin Albin Kurti dhe shefin e AKI-së, Petrit Ajeti. Vizita e Burns ka ndodhur në kohën kur në Kosovë flitej për hapjen e urës së Ibrit, e cila, pavarësisht prej paralajmërimeve të qeveritarëve, vazhdon të jetë e mbyllur.



### Tony Blair viziton Kosovën në 25-vjetorin e çlirimit

Ish-kryeministri britanik Tony Blair ka qëndruar në Kosovë me rastin e 25-vjetorit të çlirimit. Gjatë qëndrimit në Kosovë Blair u është drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke kujtuar, siç ka thënë, "vendimin e vështirë për të ndërmarrë veprime për ta ndaluar luftën në

Kosovë" më 1999. Në nderim të kontributit të tij për çlirimin e Kosovës në Ferizaj është ngritur një përmendore në Ferizaj.

### DASH-i thotë se në Kosovë ka korrupsion serioz qeveritar

Në Kosovë ka korrupsion serioz qeveritar. Kështu është thënë në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit të publikuar këtë të hënë më 22 prill. Në përmbledhjen e raportit janë përmendur të gjeturat kryesore dhe aty është thënë se në Kosovë ka "probleme serioze me pavarësinë e gjyqësorit", pastaj "kufizime serioze për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, duke përfshirë dhunën ose kërcënimet me dhunë ndaj gazetarëve" dhe, gjithashtu, "korrupsion serioz qeveritar".



### Ali Ahmeti fiton zgjedhjet në Maqedoni, por e humbet pushtetin

Fronti Evropian, i drejtuar nga Ali Ahmeti, ka fituar zgjedhjet parlamentare në Maqedoninë e Veriut, duke e mposhtur koalicionin VLEN. Pavarësisht kësaj, ky koalicion nuk është përfshirë në qeverinë e drejtuar nga Hristijan Mickoski. Ai në qeveri ka përfshirë koalicionin VLEN që drejtohet nga Arben Taravari. Ali Ahmeti është duke "luftuar" me pushtetin për përdorimin e Ligjit të Gjuhës Shqipe, i cili ka përfunduar në



Gjykatën Kushtetuese. Krahas zgjedhjeve parlamentare, Bujar Osmani nga Fronti Evropian ka dalë i dyti në zgjedhjet presidenciale.

### Riho Terras nga Estonia emërohet raportues për Kosovën në PE

Eurodeputeti estonez nga Partia Popullore Evropiane (PPE), Riho Terras, është emëruar raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian (PE). Për emërimin e tij në këtë pozitë janë pajtuar në grupin e PPE-së në Komisionin për Politikë të Jashtme. Riho Terras është ish-ushtarak nga Estonia, i cili ka qenë deputet edhe në përbërjen paraprake të Parlamentit Evropian.



### "Brate", Kusari-Lila e quan vëlla Simiqin, merren vesh për takim me Kurtin

Katër biseda të Mimoza Kusari-Lilës me Sllavko Simiqin kanë zbuluar përpjekjet e shesheve të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për koordinim me Listën Serbe. Bisedat në "WhatsApp" kishin dëshmuar "kapitullimin" e LV-së para Listës Serbe për kalimin e ligjeve në Kuvend dhe për çështjen e energjisë elektrike në veri. Kusari-Lila në një çast e kishte quajtur vëlla (brate) Simiqin. Ata ishin marrë vesh për caktimin e një takimi të Simiqit me kryeministrin Albin Kurti. Kusari-Lila kishte marrë ftesë për vizitë te Milan Radoičiqi në

Kopaonik, i cili është përgjegjës për sulmin në Banjskë. Mimoza Kusari-Lila ishte përpjekur të krijonte aleancë me Listën Serbe për çështje të agjendës legislative të mazhorancës.

### Osmani ia kthen Kuvendit dy ligje për rishqyrtim, përmbajtja e njërit rrezikon sigurinë kombëtare

Presidentja Vjosa Osmani ia ka kthyer për rishqyrtim Kuvendit të Kosovës Ligjin për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ligji për Këshillin e Sigurisë është kthyer për shkak se me përmbajtjen aktuale rrezikon sigurinë kombëtare dhe është në kundërshtim me Kushtetutën. Ndërkaq Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit është kthyer për shkak të dispozitave të caktuara të cilat rrezikojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë.

### Skandali me ambalazhuesit e ujit, arrestohen dy zyrtarë të MMPHI-së

Organet e rendit kanë arrestuar sekretarin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, Izedin Bytyqi dhe zyrtarin e lartë të kësaj ministrie, Naser Hafizi, të dyshuar për faljen e borxheve për ambalazhuesit e ujit. Bytyqi është liruar nga paraburgimi, por jo edhe Hafizi.



### Ministria e drejtuar nga Peci ndan grante për vëllanë dhe dajën e Pacollit të LV-së

Sekretari i përgjithshëm i Forumit të Rinisë së LDK-së, Egzon Pacolli, kishte njoftuar se Blerim Pacolli, vëllai i deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka fituar grant 100 mijë eurosh nga Ministria e Bujqësisë që drejtohet nga ministri Faton Peci. Sipas dokumenteve të publikuara nga ana e tij, del se ministria e Faton Peci i ka dhënë grant 100 mijë euro edhe dajës së Fitore Pacollit, Sylejman Islamit. Pas raportimeve në medie, Ministria e Bujqësisë ka marrë vendim që t'i pezullojë këto grante. Kujtojmë se Pacolli është kryetare e Komisionit për Bujqësi në Kuvend.

### Artan Grubi futet në listën e zezë të ShBA-së

Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) ka njoftuar se i ka futur në listën e zezë të Shteteve të



# Sulm terrorist në kanalin e “Ibër-Lepenc”-it

Një shpërthim që ka ndodhur mbrëmjen e 29 nëntorit në fshatin Varragë të komunës së Zubin Potokut ka dëmtuar kanalin e ujit të “Ibër-

Lepenc”-it, nga i cili furnizohen me ujë nga Liqeni i Ujmanit disa qytete të vendit, si dhe Korporata Energetike e Kosovës për ftohjen e

termoelektraneve. Nga ky shpërthim nuk ka pasur viktima. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka akuzuar fqinjën

veriore të Kosovës, Serbinë, për “sulm kriminal dhe terrorist”, i cili, sipas tij, ka synuar “ta dëmtojë infrastrukturën mbase më të

rëndësishme” të vendit. Ndërkaq, përfaqësues ndërkombëtarë në Kosovë kanë dënuar fuqishëm shpërthimin në “Ibër-Lepenc”.

Bashkuara ish-zëvendëskryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Artan Grubi, si dhe gjykatësin e Gjykatës së Apelit, Enver Behxheti, për shkak të përfshirjes në “korrupsion të madh”. Në një njoftim për medie, DASH-i ka bërë me dije se Grubi dhe Behxheti “janë përfshirë në korrupsion të madh duke pranuar rryshfet për t’i minuar proceset gjyqësore të lidhura me dënimin penal të Sasho Mijalkovit, ish-drejtorit të shërbimit sekret”. Në listën e zezë janë futur edhe anëtarët e familjes së ngushtë të Grubit, i

cili ishte zëvendëskryeministër i Maqedonisë së Veriut nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integrim gjatë mandatit të kaluar 2020-2024. Pas këtij vendimi, Grubi ka dhënë dorëheqje nga të gjitha pozitat publike.

## Nënshkruhet marrëveshja me prodhuesin turk për fabrikën e municioneve në Kosovë

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka njoftuar se është nënshkruar kontrata me

prodhuesin shtetëror turk “Makine ve Kimya Endüstrisi” (MKE), për të vënë në funksion fabrikën e municioneve në Kosovë. Pas prodhimit të dy llojeve të municioneve, në fabrikë do të bëhen edhe dizajne të dronëve luftarakë. Po ashtu, përfshihet edhe trajnimi i stafit në kuadër të kontratës.

## Fjalimi i vonshëm i Osmanit në Kuvend: Vënia në rrezik e aleancave apo luajtja bixhoz me to e cenon mbrojtjen e Kosovës

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në fjalimin vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ka bërë thirrje për ruajtjen e marrëdhënieve me vendet aleate, duke thënë se cenimi i raporteve me këto vende e cenon Kosovën. Ajo e cilësoi të pabalancuar dialogun me Serbinë dhe kërkoi trysni ndërkombëtare ndaj Serbisë për respektimin e të drejtave të shqiptarëve atje. Duke folur të enjten në një seancë

parlamentare të bojkotuar nga dy prej tri subjekteve më të mëdha opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, presidentja e vendit tha se “aleanca e Kosovës me vendet e tjera është më e madhe dhe më e rëndësishme se cilido prej nesh si politikan”. Ajo bëri thirrje që Kosova t’i ruajë aleancat e saj. “Aleancat janë këtu për të na mbrojtur, prandaj vënia në rrezik e tyre, luajtja bixhoz me to, apo cenimi i tyre, e cenon vetë mbrojtjen e republikës sonë”, ka thënë ajo.

## Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë, seancë të përbashkët parlamentare

Kuvendi i Kosovës dhe ai i Shqipërisë kanë mbajtur të premtën një seancë të përbashkët parlamentare në Prishtinë, në të cilën janë zotuar, përmes një deklaratë, se do ta ndihmojnë njëra-tjetrën në arenën ndërkombëtare dhe do ta thellojnë bashkëpunimin mes vete. Gjatë seancës, e cila ka zgjatur tri orë, liderët e të dyja vendeve kanë mbajtur fjalime para





deputetëve të pranishëm nga të dyja vende, ku kanë ofruar mbështetjen e ndërsjellë dhe kanë lartësuar lidhjet historike në mes të dy vendeve. Deklarata e tyre e përbashkët, e cila është lexuar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka theksuar se qëllimi i mbledhjes ishte që Kosova dhe Shqipëria ta bashkërendonin “agjendën kombëtare” për arritjen e synimeve të përbashkëta strategjike.

### Shqipëria mbyll “TikTok”-un

Qeveria e Shqipërisë ka marrë vendim për ndalimin e “TikTok”-ut për 1 vit. Kryeministri Edi Rama ka thënë se vendimi është marrë pas 1 300 takimeve të organizuara në të gjithë territorin e Shqipërisë nga Ministria e Arsimit pas vrasjes së 14-vjeçarit pranë shkollës “Fan Noli”. Ai ka thënë se 90 për qind e prindërve janë shprehur në favor të mbylljes së “TikTok”-ut.

### Arrestohet ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

Kryetari i Partisë së Lirisë në Shqipëri, Ilir Meta, është arrestuar me urdhër të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) më 21 tetor. Meta ndodhet në paraburgim ndonëse disa herë ka kërkuar të lirohet nga kjo masë. Meta kishte shërbyer në pozitën e presidentit të Shqipërisë nga viti 2017 deri më 2022. Përveç që ka mbajtur pozitën e presidentit, Meta kishte qenë edhe kryeministër, kryetar Kuvendi dhe ministër i Jashtëm.



### Djali i Jakup Krasniqit i bashkohet PDK-së, garon për deputet në zgjedhjet e 9 shkurtit

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka mirëpritur të mërkurën në parti djalin e Jakup Krasniqit, Altinin, i cili do të jetë kandidat për deputet në listën e PDK-së në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Krasniqi është shprehur i lumtur që PDK-së po i bashkohet një zë i ri, por që është i rrënjësuar thellë në trashëgiminë e shërbimit, sakrificës dhe përkushtimit të palëkundur ndaj vendit. Ndërsa Altin Krasniqi është shprehur se duke qenë djali i një personaliteti si Jakup Krasniqi që ia kushtoi jetën lirisë dhe pavarësisë së Kosovës, ka

vendosur të marrë përgjegjësi për të punuar për të ardhmen e Kosovës.

### Begaj shpall 11 majin datë të zgjedhjeve në Shqipëri

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka shpallur datën 11 maj të vitit 2025 për mbajtjen e zgjedhjeve të reja parlamentare. Zyra e Presidencës shqiptare ka sqaruar për mediet se kreu i shtetit shqiptar vendosi ta respektojë kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për caktimin e datës së zgjedhjeve. “Shkaku themelor për caktimin e datës 11 maj 2025 si datë për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve qëndron në nevojën e shprehur nga KQZ-ja për ta shfrytëzuar të gjithë kohën në dispozicion për përgatitjen e infrastrukturës ligjore dhe organizative, që të bëhet i mundur votimi i suksesshëm dhe rezultativ i shqiptarëve nga jashtë vendit”, ka njoftuar Presidencën shqiptare.

### Kosova avancohet në Asambenë Parlamentare të NATO-s

Asambleja Parlamentare e Aleancës Veriatlantike - NATO ka avancuar statusin e Republikës së Kosovës nga vëzhguese parlamentare në anëtare të



### Osmani takohet me Trumpin

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është takuar me presidentin e zgjedhur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump. Takimi i tyre është zhvilluar në kuadër të ceremonisë së rihapjes së katedrales “Notre-Dame” në Paris. “Me presidentin Trump, në ceremoninë e rihapjes së



## Ambasadori Hovenier përfundon mandatin: Po largohem si një mik i fortë i Kosovës

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Kosovë (ShBA), Jeffrey Hovenier, ka përfunduar zyrtarisht mandatin e tij trevjeçar si përfaqësues i Amerikës në vendin tonë. Pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, Hovenieri ka theksuar simbolikën e përmblyjes së misionit të tij me të njëjtin akt

që e kishte nisur me vendosjen e një kurore lulesh të shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova.

Hovenieri ka thënë se që kur ka nisur punën në fund të viteve '90 nuk ka asnjë dyshim për përparimin dhe për kapacitetin e njerëzve të Kosovës për qëndrueshmërinë e tyre për ta

realizuar vizionin e tyre për një shtet sovran, të pavarur, demokratik, shumetnik, të begatë dhe të suksesshëm. Ai ka thënë se po largohet nga kjo detyrë si mik i fortë i Kosovës. “Do të largohem si një mik edhe më i fortë i Kosovës sesa isha kur mbërrita”, ka thënë ambasadori Hovenier.

asociuar të saj. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, ka mirëpritur një vendim të tillë.

Në një reagim në rrjetet sociale, Maqedonci ka thënë se avancimi i Kuvendit të Kosovës nga vëzhgues parlamentar në anëtar të asociuar është një hap i madh për sigurinë.

### Garë e ashpër për zgjedhjet e 9 shkurtit

Partitë politike kanë filluar fushatën elektorale për zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025. Ato tashmë kanë paraqitur listat e kandidatëve për deputetë. Lëvizja Vetëvendosje në këto zgjedhje kandidon me Albin Kurtin për kryeministër, PDK-ja me Bedri Hamzën, LDK-ja me Lumir Abdixhikun dhe koalicioni AAK-Nisma me Ramush Haradinajn.

### Konfirmohet rasti i parë me Linë e Majmunëve në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë të Publike i Kosovës ka bërë me dije se gjatë ditës së djeshme në Laboratorin e Mikrobiologjisë përmes metodës RT-PCR është konfirmuar një rast i importuar të Mpox, i njohur më parë si Lia e Majmunëve. “Rasti i gjinisë mashkullore (30 vjeç), shtetas i Republikës së Kosovës, është shtrirë në Klinikën Infektive/QKUK me datë 24.12.2024, pas kthimit nga një shtet i Afrikës Perëndimore, me simptoma si temperaturë, ethe, ndryshime në lëkurë, në fytyrë, në duar dhe kuarje”, ka njoftuar IKShPK-ja.



### LV-së i largohen tre deputetë dhe i bashkohet një këngëtare

Gjatë vitit 2024 nga grupi parlamentar i Lëvizja Vetëvendosjes janë larguar deputetët Eman Rrahmani, Visar Korenica, Drita Millaku. Rrahmani dhe Korenica garojnë në zgjedhje në “Listën për Familjen”, ndërsa Millaku i është bashkuar LDK-së. Krahas kësaj, Vetëvendosjes i është bashkuar këngëtarja Edona Llalloshi, por njëri nga themeluesit e kësaj lëvizje, Liburn Aliu, është lënë jashtë listës zgjedhore për zgjedhjet e 9 shkurtit.



ÇFARË KA NDODHUR NË GJYKATËN SPECIALE NË VITIN 2024?

# 2025-a, BETEJA FINALE E LIDERËVE TË UÇK-së ME PADREJTËSINË SPECIALE

Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, pritet të përfundojë në vitin 2025. Por viti që po lëmë pas është karakterizuar me zhvillime të shumta në Gjykatën Speciale në Hagë. Krahas arrestimeve, dënimit të Pjetër Shalës dhe aktakuzës së re ndaj Thaçit, në Hagë janë zhvilluar debate të ashpra në mes të mbrojtjes së liderëve të UÇK-së dhe prokurorëve. Po ashtu, janë larguar avokatët kryesorë të Thaçit dhe Veselit për çfarë janë akuzuar institucionet e Kosovës për mungesë të mbështetjes financiare. Gjithashtu, liderët e UÇK-së kanë kërkuar nga trupi gjyqësor të mos ia mbajë anën prokurorisë, por të jetë i paanshëm

ta paraqitur rastin e mbrojtjes. Ai ka thënë se nuk planifikon të thërrasë më shumë se 10 dëshmitarë.

Fillimisht Prokuroria e Hagës kishte bërë me dije se synon të ketë 312 dëshmitarë. Megjithatë, një pjesë të tyre u janë pranuar dëshmitë me shkrim e disa janë larguar tërësisht. Megjithatë, sipas prokurorisë, numri i dëshmitarëve do të ulet edhe më tutje, në mënyrë që në prill të përfundojë rasti i Prokurorisë së Specializuar e të fillojnë dëshmitarët e mbrojtjes. Prokuroria e Hagës tash ka larguar nga lista e dëshmitarëve edhe disa persona.

## Thaçi dhe Veseli mbesin pa avokatët kryesorë

Avokatët kryesorë të mbrojtjes së Hashim Thaçit, pranë Gjykatës Speciale në Hagë, Gregory Kehoe, Joe Reeder, "Greenberg Legal Associates" dhe anëtarët e kësaj kompanie, kanë kërkuar të tërhiqen nga procesi gjyqësor. Në kërkesën e tyre ndaj Speciales është përmendur moskryerja e obligimeve ndaj tyre. Ndërkaq Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ka realizuar me kohë të gjitha

pagesat dhe obligimet për mbrojtjen e Hashim Thaçit, duke iu referuar marrëveshjes që kanë vetëm me avokatin mbrojtës të Hashim Thaçit, Luka Misesiq. Vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi, duke e falënderuar avokatin Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm, ka sqaruar se kontrata me kompaninë ligjore "Greenberg Legal Associates" nuk është vazhduar për shkak të vështirësive financiare. Tani avokati kryesor i Thaçit është Luka Misesiq.

Edhe avokati Ben Emmerson është larguar nga ekipi mbrojtës i Kadri Veselit në Hagë. Gjykata Speciale ka miratuar kërkesën e avokatit Emmerson për tërheqje nga ekipi mbrojtës i Veselit. Sipas Gjykatës Speciale, kjo nuk do të shkaktojë vonesa në procesin gjyqësor. Pas largimit të Emmersonit, avokat kryesor i Kadri Veselit është caktuar të jetë Rodney Dixon. Ai ka një karrierë të spikatur në fushën e të drejtës ndërkombëtare publike dhe penale, si dhe të drejtave të njeriut, duke përfaqësuar qeveri, politikanë të shquar dhe individë në raste të ndërlikuara globale. Ndër rastet më të spikatura ku Dixon i ka qenë i angazhuar,

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, DHJETOR/JANAR - Beteja juridike për mbrojtjen e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Gjykatën Speciale ka vazhduar edhe gjatë vitit që po lëmë pas. Gjatë vitit 2024 kanë ndodhur përplasje të ashpra në mes të mbrojtjes së liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit me prokurorët e Speciales dhe me disa nga dëshmitarët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), të cilat janë demouluar nga avokatët e katërshes së UÇK-së. Krahas

kësaj, së paku deklarativisht është thënë se gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë është duke shkuar drejt fundit. Zyra e Prokurorit të Specializuar deri më 15 prill të vitit 2025 do ta përfundojë paraqitjen e dëshmitarëve në këtë proces gjyqësor maratonik.

Prokurori Matt Hawling ka bërë me dije se kanë planifikuar të ftojnë edhe disa dëshmitarë në sallën e gjyqimit, megjithatë mund të largohen edhe disa të tjerë. Ai është shprehur se mund ta përfundojë rastin e tyre deri në prill 2025, ashtu siç u është përcaktuar nga trupi gjyqësor. Ndërsa kryegjyqtari Charles Smith ka pasur kritika që nuk po

ka dëshmitarë rezervë për ta vazhduar sa më shpejt përfundimin e dëshmitëve. Ai ka thënë se nuk e kanë ndër mend ta zgjasin afatin për paraqitjen e rastit të ZPS-së. Ligjërisht, pas paraqitjes së rastit nga ZPS-ja, avokatët kanë të drejtë ta kërkojnë hedhjen e aktakuzës. Ndërsa avokatët e liderëve të UÇK-së kanë bërë me dije se synojnë ta shfrytëzojnë këtë mundësi, megjithatë afati është i shkurtër. "Do të kërkojmë të paktën 1 muaj kohë për ta bërë kërkesën tonë", ka thënë avokati i Jakup Krasniqit. Kurse avokati i Hashim Thaçit, Luka Misesiq, ka bërë me dije se do t'i duhen gjashtë javë për t'u përgatitur për



përfshihen përfaqësimi i Qeverisë së Afganistanit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, mbrojtja e viktimave ujqore në rastin e gjenocidit të supozuar nga autoritetet kineze dhe përfaqësimi i "AlJazeera"-s në rastin e vrasjes së gazetares Shireen Abu Akleh.

Largimi i avokatëve të Thaçit dhe Veselit është përcjellë me reagime të mëdha në Kosovë, duke akuzuar institucionet e Kosovës për mospërkrahjen e liderëve të UÇK-së që ndodhen në Hagë që nga nëntori i vitit 2020.



### Mbrojtja e liderëve të UÇK-së kërkon ndryshimin e udhëzimit: Po rrezikohet mbrojtja

Duke iu referuar procesit gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë dhe vështirësive për mbulimin e shpenzimeve për ekipet mbrojtëse, avokatët e katër liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, në emër të katërshes çlirimtare i kanë bërë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë që të ndryshohet dhe plotësohet Udhëzimi Administrativ nr. 08/2022, i cili parasheh tarifa të reja për avokatët dhe shpenzimet e tjera për mbrojtjen juridike të akuzuarve në proceset gjyqësore pranë Gjykatës Speciale.

Kërkesa e liderëve të UÇK-së për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ, të cilin e ka siguruar "Epoka e re", ishte bërë më 24 prill të vitit 2023. Sipas kësaj kërkesë, udhëzimi aktual administrativ është duke paraqitur vështirësi për mbrojtje adekuate sa iu përket të akuzuarve të cilët po mbahen në paraburgim nga Gjykata Speciale. Sipas kësaj kërkesë, Udhëzimi Administrativ nuk pasqyron gjendjen faktike për mbrojtje efektive të liderëve të UÇK-së.

Më tutje, në këtë kërkesë është përmendur rasti i ish-presidentit Hashim Thaçi, i cili, sipas avokatëve, përmbush të gjitha kriteret për mbështetje institucionale.

Në këtë kërkesë janë bërë edhe disa krahasime me rastet e mëhershme që kanë ndodhur në Tribunalin e Hagës. Në krahasim me rastet e tjera është përmendur numri i dëshmitarëve të prokurorisë, i cili kalon mbi 300 dëshmitarë. Në këtë kërkesë është elaboruar edhe afati kohor kur ka ndodhur lufta në Kosovë dhe puna që është duke bërë mbrojtja e katër liderëve të UÇK-së. Në fund të kësaj kërkesë, ata kanë rikujtuar se Republika e Kosovës ka miratuar ligjin që garanton mbrojtje juridike adekuate dhe mbulon shpenzime për tarifat e

avokatëve dhe shpenzimet e tjera për personat e akuzuar në proceset gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.



### Ekipi mbrojtës i Thaçit, letër Konjufcës, Kurtit dhe Haxhiut: Urgjente dhe e domosdoshme mbështetja financiare shtesë

Ekipi mbrojtës i ish-presidentit Hashim Thaçi, nëpërmjet një letre drejtuar kryeparlamentarit Glauk Konjufca, kryeministrit Albin Kurti dhe ministres Albulena Haxhiu, ka kërkuar mbështetje financiare shtesë për mbrojtjen e Thaçit. Bordi i Fondacionit "Përkrahje për mbrojtjen juridike të Hashim Thaçit", ka bërë me dije se në mungesë të mjeteve financiare, ish-presidentit i është larguar një prej avokatëve kryesorë, "por edhe aktualisht avokati kryesor i angazhuar ka paralajmëruar se do të mund të largohet në periudhën e ardhshme, respektivisht nga fundi i këtij muaji". Në këtë drejtim, mbrojtja e Thaçit ka vlerësuar se ndarja e mjeteve financiare të kërkuara, i shërben drejtësisë dhe mbrojtjes së kauzës së drejtë të luftës së UÇK-së. Më herët avokatët e liderëve të UÇK-së ishin ankuar për mungesë të fondeve adekuate nga shteti. Luka Misesiq, avokat i Hashim Thaçit, Ben Emmerson, si avokat i Kadri Veselit, David Young, avokat i Rexhep Selimit dhe Alegendra Venkateswari, avokate e Jakup Krasniqit kishin nënshkruar një letër më 24 prill 2023, me anë të së cilës shprehnin shqetësimin se pagesat e bëra nga shteti nuk i reflektonin kostot e ekipeve të avokatëve.



### Krërët e UÇK-së i shkruajnë letër trupit gjyqësor, u kërkojnë ta ruajnë paanshmërinë

Liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, kanë kërkuar nga trupi gjyqësor në Gjykatën Speciale, që ta ruajë paanshmërinë dhe të mos mbajë anën e Prokurorisë. Përmes një letre drejtuar trupit gjyqësor, ata kanë thënë se janë

shkelur të drejtat e të akuzuarve për gjykim të paanshëm dhe tribunal të pavarur. Në kërkesën e publikuar në faqen zyrtare të Speciales, avokatët e Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit kanë kërkuar nga gjyqtarët që mos t'ia mbajnë anën Prokurorisë Speciale, por të jenë të paanshëm në zbardhjen e së vërtetës.

Sipas letrës 10-faqëshe të avokatit Luka Misesiq, Rodney Dixon, Geoffrey Roberts dhe Venkateshëari Alegandra, në hyrje është thënë se: "Është thelbësore që trupi gjyqësor jo vetëm që duhet të ushtrojë funksionet e tij në mënyrë të paanshme por, po ashtu, duhet ta sigurojë edhe shfaqjen e paanshmërisë. Marrja në pyetje nga gjyqtarët po çon përpara çështjen e Prokurorisë ose një çështje gjyqësore të ngjashme me të, duke marrë rolin që normalisht do të luante Prokuroria dhe duke dështuar në sqarimin ose eksplorimin e ndonjë informacioni shfaqësues. Prandaj, mbrojtja e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit kërkon nga trupi gjyqësor që të ndërmarrë hapa për ta siguruar pamjen e paanshëm dhe për t'i kufizuar paragjykimet ndaj mbrojtjes gjatë marrjes në pyetje gjyqësore".

Mbrojtja e katërshes së UÇK-së ka shprehur shqetësimet e mëhershme të shpalosura para trupit gjyqësor për këtë çështje. Sipas tyre, dokumentet që janë pranuar si prova gjatë dëshmive të dëshmitarëve të Prokurorisë, tregojnë se në këtë çështje ka mungesë të paanshmërisë.


Një çështje tjetër që katërshja ka përmendur në letrën drejtuar Speciales, është thënë se në shumë raste, gjyqtarët kanë bërë më shumë pyetje se vetë mbrojtja. Avokatët kanë vlerësuar se koha që u kushtohet pyetjeve gjyqësore është shumë e konsiderueshme dhe po ndikon në zhvillimin e shpejtë të këtyre procedimeve.

Mbrojtja e katërshes ka vlerësuar se në bazë të kohës që janë parashtruar pyetjet për dëshmitarët, del se gjyqtarët e kësaj gjykate po ia mbajnë anën Prokurorisë së Specializuar. Avokatët në letrën e tyre kanë shkruar se të akuzuarit kërkojnë nga paneli t'i marrë parasysh kritikën e tyre dhe të marrë masa që secili anëtar i panelit të veprojë jo vetëm në mënyrë të paanshme, por të përpiqet ta krijojë pamjen e paanshmërisë gjatë parashtrimit të pyetjeve drejtuar dëshmitarëve.

### Mbrojtja e liderëve të UÇK-së demoloji dëshmitarët e ZPS-së

Në vitin 2024 kanë dështuar shumë dëshmitarë të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS). Gjatë dëshmive të tyre ata janë demoluar nga avokatët e liderëve të UÇK-së. Krahas këtyre dëshmive e kemi veçuar ish-oficerin e NATO-s, Steve Russell, i cili për dytë ditë me radhë në Hagë ka dështuar në

rastin e liderëve të UÇK-së. Ai në cilësinë e dëshmitarit të ZPS-së është ballafaquar me fakte nga mbrojtja e katërshes së UÇK-së, veçmas nga ajo e Thaçit. I zënë ngushtë lidhur me dëshminë me shkrim, Russell është lëshuar në interpretime koti dhe bajate, pasi mbrojtja e Hashim Thaçit me zë dhe figurë e ka zënë në rrenë dëshmitarin e ZPS-së, i cili kishte ofruar dëshmi të paqena nga ato që i kishte thënë Thaçi pas luftës në Gjilan. Dëshmitë e paraqitura nga mbrojtja e Thaçit janë pranuar nga trupi gjyqësor. Po ashtu, në Hagë kanë dështuar edhe disa nga ish-eporët e lartë të UÇK-së, Sokol Bashota, Halil Çadraku etj., të cilët kanë mbrojtur të vërtetën e luftës çlirimtare.



### Pjetër Shala dënohet me 18 vjet burgim nga Specialja

Pjetër Shala, ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), është dënuar të me 18 vjet burgim kinse për krime lufte nga trupi gjyqësor i Gjykatës Speciale. Ai është shpallur fajtor për ndalim arbitrar dhe torturë kundër së paku 18 personave dhe në pikën e vrasjes së paligjshme kundër një personi, më ose rreth datës 5 qershor 1999, në fabrikën e metalit në Kukës të Shqipërisë. Gjykata ka thënë se akuzat e trajtimit mizor është mbuluar tërësisht nga ajo e torturës dhe nuk është shqyrtuar më tej nga Gjykata. Sipas gjykatës, viktimat kanë qenë kryesisht shqiptarë të Kosovës, të cilat kanë pësuar dëme nga shqiptarët të tjerë të Kosovës. Prokuroria ka kërkuar dënim prej 28 vjetësh për Shalën. Pjetër Shala, shtetas belg, i njohur me nofkën "Ujku", është deklaruar më parë i pafajshëm për të gjitha akuzat.



### Specialja vazhdon gjahun ndaj UÇK-së, ngre aktakuzë të re kundër Thaçit dhe ndaj katër të tjerëve

Gjykata Speciale në Hagë ka konfirmuar një aktakuzë të re

kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe kundër katër personave të tjerë për vepra penale që lidhen me "pretendime për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e krimeve të luftës Thaçi dhe të tjerët".

Në një njoftim për medie nga Dhomat e Specializuara të Kosovës është thënë se aktakuza është konfirmuar kundër Hashim Thaçit, ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, dhe Fadil Fazliut. Smakaj, Fazliu dhe Kilaj janë arrestuar më 5 dhjetor në Kosovë dhe janë dërguar në ndërtesën e paraburgimit të Dhomat e Specializuara në Hagë një ditë më vonë.



### Haxhi Shala, Sabit Jonuzi dhe Ismet Bahtijari pranojnë fajësinë para gjykatës në Hagë

Ish-pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Haxhi Shala dhe Sabit Januzi, janë deklaruar fajtorë para Gjykatës Speciale në Hagë për akuzën e frikësimit të dëshmitarit dhe pengimit të drejtësisë. Të dy e kanë bërë këtë deklaram më 18 dhjetor në kuadër të një marrëveshjeje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë e Specializuar, ku Shala është pajtuar edhe për një dënim me burgim deri në tri vjet, ndërsa Jonuzi është pajtuar me një dënim prej 24 deri në 30 muaj burgim. Ata kanë thënë se kanë pranuar marrëveshjet pa ndonjë detyrim dhe me vullnet të lirë si dhe që nuk do t'i apelojnë vendimet e dënimeve të tyre nëse ato do të jenë sipas marrëveshjes apo më të ulëta.

Në anën tjetër, edhe Ismet Bahtijari ka arritur një marrëveshje të ngjashme për pranimin e fajësisë. Çfarë akuzash kanë pranuar Shala dhe Jonuzi? Në dy marrëveshjet e fajësisë është theksuar se në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023, Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin kanë kontaktuar një dëshmitar.

Më tutje është thënë se dëshmitarit i janë bërë vizita në shtëpinë e tij dhe i janë ofruar përfitime në këmbim të tërheqjes së dëshmisë së tij. Sipas Prokurorisë, vepra në grup është kryer nën direktivën e Shalës. Deri më tani nuk është bërë publike se për cilin dëshmitar bëhet fjalë, apo në cilin rast ka dështuar ai. Dhomat e Specializuara të Kosovës deri më tani kanë shpallur dy aktgjykime për pengim në administrim të drejtësisë.





## Thaçi në Speciale: S'jam në garë elektorale, presim drejtësi dhe respektim të Kushtetutës së Kosovës

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në seancën e 8 dhjetorit nuk është deklaruar rreth aktakuzës së re të ngritur ndaj tij, kinse për ndikimin mbi dëshmitarët. Në paraqitjen e tij para trupit gjykues, Thaçi ka thënë se "krejt papritmas para 2-3 ditësh" është njoftuar për aktakuzën e re dhe nuk ka pasur kohë ta diskutojë në thelb këtë dokument me ekipin e tij mbrojtës. "Me siguri e dini, unë që katër vjet përballim me një tjetër proces gjyqësor. E di që shoqëria e Kosovës, familja ime dhe unë presim fundin e këtij procesi, presim drejtësi. Krejt papritmas para 2-3 ditësh u njoftova për akuzën e re nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. E di se Kosova është në prag të zgjedhjeve të përgjithshme, por unë nuk jam pjesë e garës elektorale, nuk paraqes rrezik për askënd. Prandaj, kërkoj edhe sot - unë respektoj dhe besoj në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës - nga të gjithë, kudo që jeni ulur, në cilëndo anë apo në çdo uniformë që jeni në këtë sallë - të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, në mbledhjen e Këshillit Drejtues, ka ngritur shqetësimin për zhvillimet e fundit në Hagë, ku Zyra e Prokurorit Special ka njoftuar se ish-presidentit Hashim Thaçi i është shtuar edhe një aktakuzë për, kinse, pengim të drejtësisë, ndërsa ai tashmë ka katër vjet që ndodhet në paraburgim. "Lufta çlirimtare e popullit tonë ishte e drejtë, fisnike dhe e rrënjësor në të drejtën universale për liri dhe dinjitet. Çdo përpjekje për t'i dhënë tjetër kahe kësaj të vërtete, rrezikon ta minojë jo vetëm legjitimitetin e drejtësisë, por edhe ta cenojë trashëgiminë e një lufte të shenjtë për liri. Ne apelojmë që Dhomat e Specializuara të veprojnë me përgjegjësi maksimale! Vendimet e tyre duhet të mbështeten vetëm në fakte dhe parime ligjore. Drejtësia nuk duhet, asnjëherë, të përdoret si mjet për ta rishkruar historinë apo për t'i kontestuar sakrificat e atyre që luftuan për lirinë e Kosovës", ka kërkuar Krasniqi.



## Veseli në Hagë: Mos të cenohet besimi i popullit të Kosovës në Gjykatën Speciale

Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka folur më 27 maj në seancën gjyqësore në Hagë. Duke u ndërlidhur me deklaratat në këtë seancë, Veseli ka kërkuar që procesi të jetë i drejtë, transparent dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. "Do të jem i shkurtër dhe i drejtpërdrejtë me ju për faktin se është në interesin publik. Çështja e parë ka të bëjë me kohëzgjatjen e këtij procesi, që nga dita e parë kur jemi futur në këtë sallë, prokuroria ka kërkuar në mënyrë transparente 545 orë. Prej ditës së parë, faktikisht, secili e kemi ditur se 545 orë me procesin që do ta zhvillojmë në këtë sallë, do të kalonin 3 vjet ose 4 vjet, edhe nëse fare asnjë pyetje nuk do të bënte as mbrojtja e as ju si trup gjykues. Nuk dua të paragjykoj, por dua të them se: besoj është në interes të publikut, jo vetëm tonin, që dikush duhet të marrë përgjegjësinë e vendimmarrjes, që ky proces para popullit të Kosovës të jetë jo vetëm fer, jo vetëm transparent, jo vetëm t'i respektojë procedurat e Kushtetutës së Kosovës, por edhe të ruajë dhe garantojë një gjykim të drejtë dhe në kohë të arsyeshme", ka thënë Veseli. Më tutje, Veseli ka kërkuar të mos cenohet besimi i qytetarëve të Kosovës në drejtësinë ndërkombëtare. "Unë si një nga të akuzuarit, i nderuar, frikësohem se

nëse nuk respektohen këto parime. Nuk ka të bëjë me fatin tonë individual, por me një mesazh që do ta dërgojmë te populli i Kosovës, i cili e ka krijuar, me vetëdije të plotë, por edhe me besim këtë gjykatë, tek ju si partnerë tanë ndërkombëtarë, dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të cenohet besimi që ka shteti ligjor dhe drejtësia ndërkombëtare", ka thënë Veseli.

Veseli ka komentuar edhe përplasjet e ashpra që janë shfaqur ndërmjet kryetarit të trupit gjykues, Charles Smith dhe avokatit të tij, Ben Emmerson. "Është edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me mua si të akuzuar dhe me avokatin tim. I nderuar, trup gjykues, po e shoh një komunikim që nuk është normal e joprofesional. Nuk po paragjykoj, por si i akuzuar kam të drejtë të jap mesazh: nuk do të doja që në gjera që janë jashtë realitetit tim të ndikohet e paragjykoj, sepse ka një mospërmbajtje në adresimet e avokatit tim", ka thënë Kadri Veseli.

Një përplasje "brutale" ka ndodhur në këtë seancë në rastin e krerëve të UÇK-së në Hagë. Avokati i Kadri Veselit është "kapur" me kryegjyqtarin Smith lidhur me faktin se gjykimi po stërzgjetet. Emmersoni ka deklaruar se më shumë pyetje për dëshmitarë kanë bërë gjyqtarët se mbrojtja e Veselit.



## Gucati dhe Haradinaj lajnë hesapet me Speciale

Dy figurat kryesore të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Guçati dhe Nasim Haradinaj, janë dënuar në vitin 2022 për pengimin e drejtësisë. Guçati dhe Haradinaj ishin dënuar me 4 vjet e 3 muaj burgim. Ata ishin liruar më 2023 me disa kushte. Në dhjetor të vitit 2024, Guçati dhe

Haradinaj kanë përfunduar të gjitha detyrimet ndaj Gjykatës Speciale. Kujtojmë se në dhjetor të vitit 2022 eprori i lartë i UÇK-së, Salih Mustafa -komandant "Cali" - ishte dënuar me 26 vjet burgim, ndërsa në vitin 2023 Gjykata e Apelit ia kishte ulur në 22 vjet burgim.





# KAMBANAT E ALARMIT TË NASIM HARADINAJT DHE HYSNI GUCATIT



Lulëzim ETEMAJ

Është folur dhe shkruar shumë për Gjykatën Speciale politike në Hagë. Por, opinionit publik i ka munguar fotografia e plotë e saj, e cila u kompletua në masë të madhe këto ditë pas vuajtjes së dënimit të padrejtë dhe fitimit të së drejtës për t'iu adresuar opinionit publik nga Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati.

- Shkelja ekstreme e të drejtave dhe lirive të njeriut, përfshirë edhe vjedhjen e parave të ushqimit nga ana e burgut;
- Fabrikimi, joshja dhe manipulimi i dëshmitarëve nga ana e Zyrës së Prokurorit të Specializuar;
- Moskryerja e obligimeve nga ana e shtetit të Kosovës;
- Garancia e ofruar nga Shqipëria, Kroacia dhe Turqia, por jo edhe nga vetë Kosova, për t'i lëshuar të mbrohen në liri drejtuesit e luftës së UÇK-së;
- Rreziku potencial, bazuar në kushtet dhe rrethanat aktuale të sigurisë brenda burgut, që Serbia të ndërmarrë veprime ekstreme ndaj krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, për ta penguar shpalljen e tyre të pafajshëm dhe humbjen e procesit gjyqësor politik.

Dëshmi për këtë rrezik

potencial është rasti i tentimit për ta marrë në pyetje Nasim Haradinajn nga "Slloveni", për të cilin autoritetet e burgut i thonë më pastaj se nuk ishin në "dijeni" se kush ishte. Këto janë pesë përshkrimet më esenciale të fotografisë së Dhomave të Specializuara, Zyrës së Prokurorit të Specializuar Politik në Hagë si dhe burgut të tyre në Scheveningen, pas intervistave që i kanë dhënë ish-të burgosurit politikë të Gjykatës Speciale, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati, për televizionet e Kosovës. Një falënderim të madh dhe admirimin tim që të dyve për kurajën qytetare si dhe angazhimin e pakompromis në shërbim të mbrojtjes së pastërtisë së luftës së UÇK-së, ligjshmërisë, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut!

Bazuar në përshkrimet e hollësishme, thellësisht argumentuese, të gjendjes nga Haradinaj dhe Gucati, është koha e fundit, që në mungesë të veprimit të Qeverisë, Kuvendit dhe Presidencës së Kosovës, për t'u organizuar institucionet e tjera, si Avokati i Popullit, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj), partitë politike, diplomatët aktualë dhe ish-diplomatët, Oda e Avokatëve të Kosovës, shteti shqiptar si dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së për t'u takuar me kryetaren e kësaj gjykate, Ekaterina Trendafilova, BE-në, Këshillin e Evropës, qeveritë e vendeve kryesore të BE-së si dhe administratën amerikane për



të siguruar një proces të drejtë, që respekton ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës dhe garanton të drejtat dhe liritë e njeriut, përfshirë sigurinë fizike në burg të krerëve të UÇK-së. Në të gjitha këto takime do të duhej të ishin të pranishëm pashmangshmërisht edhe Nasim Haradinaj dhe Hysni

Gucati, si dëshmitarë konkretë të devijimeve të kundërligjshme të Gjykatës Speciale Politike të Hagës. Po ashtu, përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare t'u paraqitet ankesa që Nasim Haradinaj tashmë ka bërë në Gjykatën e Strasburgut. Kambanat e alarmit po bien fort nga Nasim Haradinaj dhe

Hysni Gucati! Askush nuk mund të thotë nesër se nuk i dëgjuam. Të thotë që nuk ranë se nuk kishte kambana! Të thotë se nuk e kuptuam atë që po na kanoset! Që po i kanoset luftës së pastër të UÇK-së dhe krerëve të saj! Të sotmes dhe sidomos të ardhmes së shtetit të Kosovës!



# VITI I RI, VIT MË I MIRË SEPSE KOSOVA MERITON MË MIRË



## Shkruan: Ferat SHALA

Viti 2024 po mbyllet mes shumë sfidave politike e ekonomike që kaloi vendi ynë dhe me të cilat po vazhdon të përballlet edhe në kapërcyell të moteve. Ashtu sikurse në tre vjetët paraprakë, edhe ky vit u karakterizua nga stagnimi dhe prapakhimi në çdo sferë. Kosova po futet në vitin 2025 e brishtë së brendshmi dhe e dobët së jashtmi. Së brendshmi, shoqëria e Kosovës është më e përçarë se kurrë më parë. Qeveria e Kosovës i ka kanalizuar të gjitha energjitë nga lufta ndaj oponentëve politikë, nga denigrimi i partive opozitare dhe nga lufta e ulët, duke mos zgjedhur metodë e mjet ndaj gazetarëve e analistëve që demaskojnë për çdo ditë korrupsionin qeveritar. E njëjta teknikë baltosëse është përdorur jo vetëm ndaj opozitës dhe medias, por ndaj kujtdo që ka shprehur qoftë edhe mospajtimin më të vogël me qeverinë – sindikatave, mësimdhënësve, policëve, minatorëve, bujqve etj. Krejt kjo kulturë toksike e sulmeve ad hominem ndaj gjithkujt që nuk pajtohet me qeverinë, ka thelluar më shumë hendekun social, ka thyer kohezionin e brendshëm dhe ka kultivuar polarizimin që prorrë po e dëmton shoqërinë tonë. Në arenën e jashtme, Kosova po mbyll një tjetër vit e

shkapërderdhur. Kjo qeveri e ka futur vendin në qorrsovak. Kosova vazhdon të jetë nën sanksione nga ata që duhej të ishin aleatët tanë më të mëdhenj. Serbia, e cila haptazi kryen provokacione brenda kufirit të Kosovës, nuk futet në sanksione. Pra, aq shkurtpamëse ka qenë kjo qeveri dhe diplomacia e saj, saqë Serbinë agresore e ka nxjerrë në pah si viktimë, kurse Kosovën viktimë e ka bërë të duket si agresore. Nga provokimet e vazhdueshme në veri të vendit, qeveria nuk ka arritur ta korrë maksimumin diplomatik. Agresioni i shtetit serb në veri nuk është shfrytëzuar siç duhet dhe Kosova, ndonëse dukshëm ishte viktimë, dështoi ta shpërfaqte të vërtetën e asaj që po ndodh në veri. Si në çdo sferë tjetër, edhe në diplomaci ky vit ishte në vendnumëro. Ministria e Jashtme nuk ka arritur të sjellë asnjë njohje të re – jo vetëm gjatë vitit që po lëmë pas, por gjatë gjithë mandatit të saj katërvjeçar. Fatkeqësisht, dyert e mëdha të vendimmarrjes botërore, tash e katër vjet, vijojnë të jenë të mbyllura për Kosovën. Ministria e Jashtme është shndërruar në ent punësimi të militantëve e familjarëve, gjersa vizitat dhe shpenzimet e ministres kanë shkuar kryesisht për takime

partiake jashtë Kosovës dhe jo për vizita që do të sillnin njohje të reja dhe anëtarësime të reja në organizata e institucione ndërkombëtare. Qasja skandaloze, bajraktarllëqet anakronike, arroganca fëmijërore dhe mungesa e dellit patriotik i kësaj qeverie ka bërë që sot Kosova t'i ketë në nivelin më të ulët në histori raportet edhe me shtetin-vëlla të Shqipërisë, sikurse edhe me faktorin politik shqiptar në shtetet e tjera përreth. Në vend të ndërtimit të urave të komunikimit, kjo qeveri ka qenë fokusuar që të përzihet në punët e brendshme dhe në proceset zgjedhore në Shqipëri, Maqedoni e Luginë. Gjersa po i shkruaj këto rreshta, në atmosferën festive të fundit të vitit, familjet kosovare do të duhej të ishin duke u përgatitur të qetë e të lumtur për festat e fundvitit. Shumë prej tyre, fatkeqësisht, janë duke u përballur me vështirësi për shkak të ndërprerjeve kohëgjata dhe të vazhdueshme të energjisë elektrike. Shumë nga këto familje kanë hallin e fëmijëve që nuk arrijnë as t'i ngrohini pa rrymë në këto temperatura acari. Ky është vetëm një nga dështimet e kësaj qeverie. E preokupuar më shumë për pazaret me Gen-in e Beogradit me energji, partia në pushtet

ka kundërshtuar gazsjellësin amerikan, sikurse kishte kundërshtuar dikur ndërtimin e termocentralit të ri, dhe sot fajëson popullin përse ka dështuar ta furnizojë me energji elektrike. Për më tepër, ndonëse nuk kanë rrymë nga 8-10 orë, qytetarët prapëseprapë duhet të paguajnë fatyra të fryra me çmime marramendëse. Në vend se t'i japin zgjidhje këtij problemi, zyrtarët e pushtetit tallen – siç bëri kryeshefi i KOSTT-it, i cili tha se nuk paskemi rrymë për shkak të zhvillimit ekonomik!!! Ta thuash këtë në një vend si Kosova ku vetëm vitin e fundit, sipas Agjencisë së Statistikave, janë mbyllur 1500 biznese, më e pakta mund të quhet ofendim për qytetarin. Përpos problemeve energjetike e ekonomike dhe stagnimit në politikën e jashtme, Qeveria e Kosovës ka dështuar edhe në mbrojtjen e të drejtave të njeriut për krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – atyre falë të cilëve jetojmë sot të lirë – në procesin e tyre gjyqësor në Dhomat e Specializuara në Hagë. U dëshën fjalët e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ramës, për t'ua përkujtuar se është obligim të reagojnë për shkeljet që bëhen në këto procese gjyqësore që zhvillohen atje. Secili prej nesh ka besuar dhe

ende beson në pavarësinë e gjyqësorit dhe përgjithësisht në drejtësinë ndërkombëtare. Por, nuk mund të heshtim kur shkelen të drejtat themelore të të akuzuarve. Po ashtu, nuk mund të heshtim dhe mos ta themi se të gjithë ne besojmë në pafajësinë dhe luftën e drejtë të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe të gjithë të tjerëve. Ata meritojnë trajtim dinjitoz! Përgjithësisht, në çdo sferë, në çdo fushë, Kosova meriton më mirë. Meriton një qeverisje kompetente që ka qasje profesioniste dhe ekspertizë në ekonomi, me vizion të qartë kombëtar në raport me Shqipërinë e shqiptarët e rajonit dhe vizion të qartë diplomatik në raport me partnerët tonë perëndimorë. Këtë filozofi politike dhe këtë kompetencë sot e reflekton vetëm Partia Demokratike e Kosovës dhe kandidati i saj për kryeministër, Bedri Hamza. Një punëtor i palodhshëm, një ekspert i pashoq, një njeri me kulturë. Ai është përgjigja për problemet që sot ka Kosova. Ai është kryeministri i ri që Kosovën do ta kthejë në binarët e normalitetit dhe zhvillimit. Me Bedri Hamzën kryeministër, me qeverinë e re të kompetencës, viti i ri 2025 do të jetë vit më i mirë për Kosovën sepse Kosova meriton më mirë!



# FQINJËSIA E KONTESTUAR DHE INKURSIONET TERRORISTE TË SERBISË NDAJ KOSOVËS GJATË VITIT 2024



Shkruan:  
Prof. Dr. Ibrahim GASHI

Kosova si një entitet i ri shtetëror në Ballkanin Perëndimor që nga 17 shkurti 2008 ka shënuar suksese të prekshme në procesin e legjitimitimit ndërkombëtar të statusit të saj. Ajo është njohur nga 117 shtete, në mesin e tyre nga shtete shumë të fuqishme të botës, është anëtarësuar në organizata me shumë influencë në sistemin ndërkombëtar, ka nënshkruar MSA-në, dhe ndodhet në përpjekjen e saj për anëtarësim në Këshillin e Evropës, në UNESCO, në Interpol dhe në shumë mekanizma shumëpalësh. Nga ana tjetër Kosova vazhdon të jetë e sfiduar në procesin e afirmimit ndërkombëtar të shtetësisë së saj me mosnjohje nga pesë vende anëtare të BE-së (Rumania, Spanja, Greqia, Sllovakia dhe Qipro), nga dy anëtarët e përhershëm të KS të OKB-së (Kina dhe Rusia) dhe nga shteti fqinjë i Serbisë.

Mosnjohja nga pesë vendet anëtare të BE-së e ka frenuar procesin e përafimit të Kosovës për anëtarësim në strukturat e BE-së. Mosnjohja nga dy anëtarët e përhershëm të KS të OKB paralizon çfarëdo iniciative të anëtarësimit të Kosovës në OKB derisa mosnjohja nga Serbia aktualisht po i krijon Kosovës probleme më të shumta në navigimin e saj në marrëdhënie ndërkombëtare si një entitet i plotë legal.

Procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë nga të gjithë aktorët e rëndësishëm ndërkombëtarë është konsideruar si një parakusht i rëndësishëm për arritjen një sigurie dhe paqeje të qëndrueshme të rajonit. Kjo është edhe arsyeja përse menjëherë pas verdiktit të GjND-së të vitit 2010, lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, OKB-ja ka autorizuar BE-në të ndërmjetësojë dhe fasilitojë një proces dialogu midis Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve. Fillimisht dialogu duhej të përqendrohej te çështjet

teknike për të kaluar më pas te çështjet politike. Në parim palët në heshtje pranuan e pastaj edhe nënshkruan se do të bëjnë kompromise të domosdoshme që për palën e Kosovës ishte themelimi i Asociacionit të Komunave Serbe dhe për palën serbe njohja e Kosovës.

Hapat e parë të palëve drejt normalizimit ishin shumë inkurajues. Serbia me marrëveshjen e vitit 2013 pranoi shuarjen e strukturave paralele në veri dhe me të njëjtën marrëveshje pala e Kosovës mori përsipër themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe (AKS). Përpjekja e Serbisë për t'i ruajtur strukturat paralele përmes ngritjes së barrikadave gjatë vitit 2011 dhe vrasjes së policit të Kosovës Enver Zymberi duket se ishte një lojë për ta alternuar defunksionalizimin e strukturave paralele jo duke i zhdukur, por duke i legjitimuar ato. Pjesa politike e këtyre strukturave u përfshi në një parti të re politike e njohur si "Lista serbe" dhe pjesa militare u rekrutua në Policinë e Kosovës dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo në të vërtetë ishte një Fitore e Pirros për Kosovën. Kosova edhe pse e nënshkroi marrëveshjen e vitit 2013 për krijimin e AKS nuk lëvizti në drejtim të implementimit të saj. Procesi i dialogut lëvizti me ritme të ngadalshme. Palët arritën një numër marrëveshjesh për çështje teknike, por pjesa më e madhe nuk zbatohet ngaqë Serbia i kushtëzonte ato me kërkesën për themelimin e Asociacionit. Presioni ndërkombëtar mbi palën e Kosovës për themelimin e AKS-së rezultoi edhe me

marrëveshjen e vitit 2015, me të cilën Kosova përsëriti zotimin e saj për themelimin e Asociacionit, duke i lënë në kompetencë Gjykatës Kushtetuese ta analizojë kushtetutshmërinë e neneve të Statutit të draftuar të Asociacionit, e cila konstatoi një mospërputhshmëri të shumë neneve të tij me Kushtetutën e Kosovës. Rrjedhimisht rezistenca e opinionit publik dhe atij politik opozitar kundër Asociacionit e zvarriti krijimin e tij pafundësisht.

Gjatë 4-5 viteve të fundit dialogu hyri në një labirint, duke mos prodhuar pothuaj asnjë marrëveshje përveç atyre imazheve nga Brukseli të shtërngimit të duarve me ndërmjetësimin e ngarkuar nga Bashkimi Evropian, z. Lajçak dhe udhëheqësin për politikë të jashtme, z. Borell.

Në ndërkohë qeveria në terren bëri disa hapa për ta shtrirë sovranitetin dhe juridiksionin e institucioneve të Kosovës në komunat veriore i cili kishte qenë i papërfillshëm dhe fare pak funksional. Kjo solli tensione. Serbet lokalë të përfshirë në strukturat shtetërore të Kosovës filluan t'i bojkotojnë ato. Ata lanë vakante pozitat drejtuese në këto komuna. Dezertuan edhe nga strukturat e Policisë së Kosovës dhe mbi të gjitha e bojkotuan me mospjesëmarrje procesin e zgjedhjeve lokale atje. Nga ana tjetër institucionet e Kosovës nuk lejuan vakum institucional dhe as pambulueshmeri të sigurisë atje. Kjo për Beogradin ishte e papranueshme dhe ai këtë u mundua ta paraqesë në Bruksel, por edhe më gjerë si atak tek

institucionet e Kosovës kundër serbëve lokalë, duke e vënë shpeshherë palën e Kosovës në pozitë të sikletshme para partnerëve ndërkombëtarë. Kjo lojë e Serbisë bëhej edhe për marketing të brendshëm të klasës politike atje dhe të vet Vuçiqit, por edhe si një pjesë e politikës ekspansioniste të kontestimit të fqinjësisë ndaj Kosovës, duke e cilësuar Kosovën brenda orbitës së botës serbe. Kjo logjikë politike e Beogradit shkoi edhe më larg. Beogradi po punonte për rikthimin e strukturave paralele atje. Atij s'i mbeti rrugë tjetër veçse ta rikthejë gjendjen e konfliktit të ngrirë atje dhe përmes konfrontimit me forcat policore të Kosovës t'i viktimizojë disa ekstremistë për ta arritur homogjenizimin e serbëve të veriut dhe ruajtur varësinë e tyre ndaj Beogradit. Në këtë politikë të diversionit dhe të sabotazhit Beogradi u involvua thellësisht. Përfaqësuesit politikë nominalë të serbëve të veriut (Lista serbe) po punonin ngushtë me Beogradin për ta kryer një agresion ndaj shtetit të Kosovës dhe kur të ndodhë ndërhyrja e forcave të rendit të Kosovës, të ketë viktimë nga civilët serbë në mënyrë që nën kërcënimin e ushtrisë serbe të stacionuar në kufi, të provokohet një ndërmjetësim i KFOR-it për t'i larguar institucionet legale të sigurisë së Kosovës nga ajo pjesë. Sulmi terrorist i 24 shtatorit i vitit të kaluar është dëshmi e këtij skenari. Fatmirësisht sulmuesit u dekonspiruan dhe u vunë në ndjekje të forcave policore të Kosovës. Skenari i Vuçiqit si duket dështoi keq. Sulmi është duke u

hetuar nga agjenci profesioniste ndërkombëtare. Cilido që të jetë rezultati i hetimeve një gjë është e sigurt se Serbia nuk ka hequr dorë nga destruktiviteti i saj karshi Kosovës. Ajo e konteston fqinjësinë me shtetin e Kosovës. Për më shumë ajo i bën obstrukcion të hapur kësaj fqinjësie.

Me këtë sulm terrorist nuk u cenua vetëm sovraniteti territorial i Kosovës, por u rrezikua seriozisht edhe misioni ndërkombëtar i KFOR-it. Por, për fat të keq, Serbia nuk u ndëshkua për këtë agresion të hapur ndaj shtetit të Kosovës në një kohë kur siguria e saj është e garantuar nga forcat ndërkombëtare të NATO-s në Kosovë (KFOR). Këtë akt të agresionit të hapur ajo e kaloi pa ndonjë konsekuencë të madhe. Mbase për t'i ikur dialogut, përkatësisht zbatimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Ohrit, ajo ka zgjedhur rrugën e obstrukcionit dhe të provokimit të akteve diverzive dhe terroriste ndaj Kosovës.

Sulmi më i fundit në kanalën e ujësllësit nga Ujmani është inkursioni i radhës, në leximin më logjik si vazhdimësi e agresionit të 24 shtatorit, ani pse edhe për këtë rast janë duke u kryer hetime ndërkombëtar mbi motivet dhe aktorët e mundshëm.

Si përfundim trajektorja e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë nga 2008-ta e këndej nuk ka përjetuar ndonjë transformim përmbajtësor. Ka ndodhur fare pak progres në drejtim të normalizimit. Serbia ka frenuar të gjitha iniciativat për të lëvizur drejt një marrëveshje përfundimtare, e bindur se ajo do ta impononte njohjen e Kosovës. Në këtë politikë obskurantiste kundër Kosovës, Serbia ka përdorur të gjitha mjetet e mundshme, duke filluar nga propaganda, manipulimi i serbëve lokalë, bojkotimi i institucioneve, protesta dhe dhunë të hapur e deri tek aktet e agresionit terrorist kundër shtetit të Kosovës. Viti 2024 ka shënuar pikën më të ulët në marrëdhëniet midis Prishtinës dhe Beogradit. Beogradi me këtë është përcaktuar për politikën e fqinjësisë së kontestuar dhe agresivitetin e hapur kundër shtetit të Kosovës. Protestat e studentëve në Serbi kundër regjimit jodemokratik të Vuçiqit dhe zgjedhjet parlamentare në Kosovë janë zhvillime që mund të krijojnë realitete më me pak tensione gjatë vitit 2025, në Kosovë dhe në rajon.





# VITIN QË IKU E PAMË, PËR 2025-n TA DËGJOJMË BABA VANGËN!



Behxhet Sh. SHALA -  
BAJGORA

**Të papjekur, të pangirë, injorantë dhe të këqij:** Qeveria Kurti 2 erdhi me një përkrahje mbi 50 për qind, thuaja ishte votim për referendum. Opozita u shkërmoq shumë; renegatja Osmani me injoranten Gërvalla e përgjysmuan LDK-në, PDK-në mbetur pa trurin dhe shpirtin e saj, Kadri Veselin dhe Hashim Thaçin relativisht kaloi mirë. AAK-ja e ruajti mesataren e votës duke mbetur parti rajonale. Opozita ishte e nokautuar, pozita e ekzaltuar. Pozita mori aq shumë pushtet sa që nuk kishte quadro për ta mbushur të gjithë atë hapësirë prandaj, pa përfillur kritere njerëzore, politike, kombëtare, profesionale dhe morale, vendosi injorantë të pashembullt në vende dhe poste me rëndësi dhe përgjegjësi. Një analfabete e çakorduar e shndërroi diplomacinë e Kosovës në një çerthull për prostitucion diplomatik. Asnjë njohje gjatë këtij mandati, asnjë anëtarësim dhe dështim epokal për anëtarësim në Këshill të Evropës. Mashtruese e rryer, urrejtje e madhe e UÇK-së dhe të burgosurve politikë me patologji të theksuar kundër pengjeve të Hagës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Tërë kohën ka shëtitur nëpër botë, pa asnjë rezultat përveç Gani Jakupit. Peci i Albinit ka dhunuar buxhetin e Kosovës duke paguar 100.000 euro për një lopë apo një arkë me molla si dhe dardha turshi për anëtarët e LVV-së, Guxo dhe Alternativa. Çfarë rrenci, injoranti, antikombëtari dhe llaskuçi, Gima i Gushavcit është zotni për këtë mizërie njerëzore. HAJNullah Çeku është taliban i hajnisë që me poshtërsinë më të madhe ndanë qindra mijëra euro për anëtarë familje dhe bashkëpartiakë. Si ministër i kulturës është i pakulturë, arrogant dhe dinak. Llaskuc i pispillosur. Arsen Lupin, varianti i mjerë kosovar. Në një shëndetësi të sëmurë, hajnia dhe mashtrimi ka metastazuar në çdo cep të atdheut. Ministër pa dinjitet, pa kurriz dhe me shumë fytyra, Beni që mbahet për Albinit. Ministri i mbrojtjes - komandant Pasuli është shndërruar në rregëzinë të një faqeziu që një kile pasul e bleu sa një kile marihuanë. Drejtësia është d(ri)eformuar, krejt dhe drejt,

ashtu siç ishte premtuar gjatë fushatës. Kapaciteti profesional i kupolës drejtuese i MD-së është sa i një referenti juridik që e ka përfunduar shkollën e mesme mjaftueshëm në kohën e Ali Milicic të Serbisë dhe Binak Maxharrajt të Serbisë dhe Rrahman Morinës, tash patriotë të mëdhenj dhe përkrahës të KM Kurti. Xhela e ka shëtitur kaqzetën në veri (kur e kanë lejuar ndërkombëtarët) pa guxuar t'ua çajë kokën Radoiçiqit e të tjerëve siç bënte me policë shqiptarë të Kosovës. E ka deprofesionalizuar policinë duke e bërë kriter për gradim llaskucërinë dhe mungesën e kurrizit në vend të profesionalizmit. Thuaja e ka lënë pa bukë Bakinë duke folur para mediave ani pse nuk i vjen as te zogu i këmbës. Sanço Panço i Policisë. Gjatë mandatit të tij ndodhën Banjska dhe Ibër - Lepenci. Liburni, i lagur nga vërshimet e ujit, ka kohë që nuk është në LVV, merreni me mend Hysen dezertori e udhëheq ministrinë. Deri këtu ka ardhur puna. Për Rozetën është gjynah për të shpenzuar fjalë, nuk i ka mbetur miell nga rezervat as për një krelanë të grytë. Nuk ka as vaj, krip e as çaj rusi. KM Kurti ka bërë çka ka dashur, nuk ia ka ndier as për Shkup e as për Shkodër. I ndau shqiptarët në Maqedoni të Veriut duke e luftuar krahan e luftës dhe duke e ulur pazarin politik përmes Besnik Koqes dhe Arben Travarit. Në Luginë i ndau shqiptarët në rrogëtarë të Albinit dhe kundërshtarë të Albinit. Në Mal të Zi përkrahu proserbin Abazović kurse Martin Berishajn, përveç ambasador e bëri knjaz të hajnisë me rrymë. Në Shqipëri nuk i nguli dhëmbët përveç se e importoi një andarte greke, Dejana Mihalin sikur që i financon mbeturinat e Enver Hoxhës dhe neanarkistët. Opozitën në Kosovë e ka dhunuar paturpësisht sikur që ka qenë amici curie (mik i gjykatës raciste speciale në Hagë) kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe çlirimtarëve tjerë. Me Serbinë ka mbajtur takime të rregullta në dy nivele, botërisht dhe ilegalisht, sekserja mercenare Mimoza Kusari ka qenë e mandatuara për kontakte dhe takime me Radoiçiqin dhe LS-në kundër veteranëve të UÇK-së kurse Besnik Rrenci përmes takimeve me Petkoviçin ka luajtur edhe rolin e oficerit për lidhje me Aca Vuçiqin. KM Kurti ka linçuar gazetarët, shoqërinë civile, gjyqësorin, prokurorinë dhe Gjykatën Kushtetuese duke e vendosur veten mbi çdo ligj tokësor, po e harron ligjin kryesor, hyjnorin. Ka kapur çdo gjë që ka mundur ta kapë, madje edhe më shumë. Prostitucionin e ka shndërruar në art informativ në RTK, me Rilindin si makro.

Nepotizmin e ka bërë kategori kushtetuese kurse mbrojtjen e korrupsionit të kuadrove partiake dhe të pushtetit e ka bërë çështje jetese dhe mbijetese. Ta kishte mbrojtur bashkimin kombëtar siç e mbron korrupsionin, do të ishte harruar Hasan Prishtina, si tribun kombëtar. Ka denoncuar krimet kundër njerëzimit në Buça (Ukrainë) kurse nuk ka guxuar të dënojë gjenocidin në Gazë. Bashkë me paramilitarin antishqiptar, Hekuran Murati, po i bënë rrush dhe kumbulla taksat kosovare. Në vend të himnit Kombëtar, po e dëgjon "Këngën e Qiririt". I ardhur si shpresë, dritë, nur, kosovarëve ia bëri terr, ditën dhe natën. Megaloman, e ka të theksuar, si kartë identiteti ndjenjën e madhësisë. Mosrespektues, shpërfillës, keqpërdorues i besimit dhe premtimeve Vojsa Osmani, më shumë është sjell si këshilltare e Zellenskit se si presidente e Kosovës. Asgjë Kosova nuk ka fituar nga ajo, kjo i ka fituar të gjitha nga Kosova, pa i dhënë asgjë. Mjeshtrë e ndërkamcave, intrigave, konspiracioneve, si Çezare Borghia, ra në hundëlesh, në Albin Kurtin që po e dërgon në shportë, pa mundësi riciklimi. Vetëm këtë e ka merituar. Glauk Konjufca, shok i ngushtë i Mefit prandaj ma humbë çdo motiv të shkruaj për këto ameba. Vitin e kaluar askush nuk u mor me Kosovën. Ishte Ukraina prioritet, pastaj Gaza ku u bë dhe po bëhet gjenocid, Siria mori fund pasi LV-ja e Asadit iku në Rusi, Irani po rëshqet drejt humnerës, Tajvani po bëhet pjesë e menysë së Kinës etj. Kush prandaj merret me Kosovën?! As Grenellin madje nuk e tundo.

**Po në vitin 2025:** Kosova do të vihet para situatës, lëre ose merr. Hapësira manovruese do të jetë e vogël, thuaja vakum. Nuk do të ketë ofertë të mirë për Kosovën, kemi humbur shumë kohë. Në popull thuhet: "një herë vjen vera kah dera", kush mendon se vjen dy herë është budalla. Sidomos në politikë vlen ky rregull. E mira është se në Kosovë është ngjizur një Byro Kombëtare e Hetimeve, sikur në Shqipëri pas së cilës do të formohet edhe SPAK-u kosovar. Vetëm po pritët një marrëveshje politike me Serbinë. Komandant Pasuli po flet për Javellinat, KM Kurti për armatimin e ushtrisë, po ndjellë luftë të përditshme. Unë krejt shpresat i vari te luftëtarët e shquar të UÇK-së, të dëshmuar gjatë luftës, komandantët Xhela dhe Hysen Durmishi! Kosova e vitit 2025 me një qeveri të koalicionit, pa LV në qeveri dhe Albin Kurtin si KM. Ose, Kosova, si Koreja e Veriut, me qeveri njëpartiake, vetëm LV-ja, me partnerin tradicional, Listën Serbe. Në këtë rast do të jetësohen të gjitha marrëveshjet me Serbinë. Nëse del që e kam gabim për Albinin dhe ai, nëse mbetet KM i Kosovës, bën punë të mira për vendin, do të bëhem përkrahësi më i madh i tij. Zotim publik. Lexuesve, miqve, shokëve ua kam mbetur borxh dy shkrime, një për Avni Deharin e tjetrin për Xhevdet Pozharnin. Kësmet, i shkruaj edhe këto. Për vitin e ri dua t'i uroj lexuesit e mi të rregullt, ata që më kanë sharë, shpifësit e certifikuar dhe të gjithë ata që flasin shqip, frymojnë shqip, ëndërrojnë shqip, vdesin shqip, kuq e zi. Urime të sinqerta për ata që na e

sollën lirinë dhe shtetin e që janë të privuar nga liria nga një Gjykatë Speciale Raciste, me mercenarët shqipfolës që do t'i gjykojë historia. Urime për presidentin Hashim Thaçi, kryekuvendarët Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli, 10-shin e UÇK-së Rexhep Selimi, komandant Salih Mustafën dhe Pjetër Shalën. Urime juve që i dhatë kuptim dhe përmbajtje luftës për liri dhe shtet! Pa ju nuk do të kishte pavarësi. Urime veteranëve të luftës, urime familjeve të dëshmorëve të Kombit! Urime të burgosurve politikë, që janë përndjekur nga Jugosllavia, po përndiqen edhe nga antikombëtarët që janë palosur në gjirin e pushtetit! Urime në amshim për dy komandantët e shqiptarisë, atij politik, Bacë Adem Demaçi dhe atij ushtarak, legjendari Adem Jashari! Kujtim i përjetshëm për Fehën dhe Xhevën, komandant Petritin, doktorin e UÇK-së, Hafir Shalën dhe ideologun e luftës çlirimtare, Xhavit Hazirin. Një përkujtim i veçantë për njeriun e urtë dhe të mirë, patriotin e devotshëm dhe të pamposhtur, idealistin e përbetuar, politikantin model, princin shembullor dhe shokun e papërsëritshëm, Tahir Hanin nga Struga, që kaloi në amshim vitin që po lëmë pas. Më 1 janar 2025, ndonëse pa Bacën Adem, me time shoqe Faxhën, ushtarët e Bacës Adem, Shkëmbin dhe Blinin, Milen dhe Artën, sipas një rituali do ta përcjellim Koncertin e Filharmonisë së Vjenës të Vitit të Ri. Së paku kujtimet mbesin si trashëgimi, nga brezi në brez.





# BALLKANI PERËNDIMOR NË MES TË PERËNDIMIT DHE RUSISË: KOHA TË VENDOSËN KUFIJTË GJEOPOLITIKË



Shkruan: Dr. Edita TAHIRI  
*Ish-zëvendëskryeministre dhe kryengociatore*

**B**alkani Perëndimor është një term politik që përfshin gjashtë vende të Ballkanit: Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Mal i Zi, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia. Megjithatë i definuar me të drejtë se është Perëndimor, në realitet nuk është i tëri perëndimor, përveç Serbisë e cila është pro-ruse dhe një pjesë e Bosnjë-Hercegovinës njohur si “Republika Serbe” pa dëshirën e gjithë popullit të Bosnjës.

Në epokën gjeopolitike që po jetojmë, lufta gjeopolitike e Rosisë kundër Ukrainës ka ndikuar në ndarje të qartë të Ballkanit Perëndimor në linja gjeopolitike, pra sot kemi një Ballkan Perëndimor midis Perëndimit dhe Rosisë.

Pavarësisht prej kësaj ndarjeje të qartë, partnerët perëndimorë, ShBA dhe BE, po hezitojnë ta vendosin kufirin gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht të vendosin linjën e qartë të sferave të influencës midis Perëndimit dhe Rosisë apo bllokut pro-rus që po ravijëzohet gjithnjë e më shumë.

Hezitimi i Perëndimit në këtë drejtim ka lënë Ballkanin Perëndimor të jetojë midis ambivalencës dhe qartësisë, të dëmshme për paqen e brishtë të rajonit tonë ku rrezikshmëria e sigurisë është e evidente.

Pse po e them kështu dhe çfarë po mendoj me ambivalencën dhe çfarë me qartësinë në rajonin tonë? Në fakt, gjithë debati akademik dhe politik mbi Ballkanin Perëndimor është i fokusuar në sfidat e sigurisë në Evropë, por shumë më shumë në

Ballkanin Perëndimor të gjeneruara nga Rusia si dhe lufta Ukrainë-Rusi, kjo për arsye të ekzistimit të “Kalit të Trojës” të Rosisë në Ballkan, që është Serbia.

Ambivalenca ka të bëjë me paqartësinë e ardhmërinë paqësore dhe euroatlantike të Ballkanit Perëndimor, ndërkohë që qartësia është në kërcënimet e përditshme të sigurisë ndaj Ballkanit perëndimor në këtë epokë gjeopolitike.

Ambivalenca / paqartësia mbizotëron në dinamikën pozitive, sepse perspektiva për më shumë paqe, më shumë stabilitet dhe më shumë siguri duket larg, aq larg sa edhe integrimi euroatlantik i vendeve që ende nuk janë pjesë e BE-së dhe të NATO-s.

Ambivalenca e BE-së në raport me Vendet e Ballkanit Perëndimor që aspirojnë integrimin evropian fillon që nga Samiti i Selanikut 2003, kur BE dhe udhëheqja e saj siguruan se ardhmëria e vendeve të Ballkanit perëndimor është në BE. Në samite të njëpasnjëshme që nga ky i fundit më 18 dhjetor 2024 përsëriti pati sigurime në deklarata, por në vepër do të vazhdojë kjo politikë e prolonguar e dyerve të hapura në fjalë, por e mbyllur në praktikë. Një dallim qenësor që pati Deklarata e sivjetshme e Samitit BE-Ballkani Perëndimor e cila përmendi kontekstin gjeopolitikë. Pra tre vjet nga lufta në Ukrainë, BE-ja bëri ballë të përmend gjeopolitikën.

Mirëpo, BE-ja ka edhe ambivalenca të tjera në raport me shtetet pro-perëndimore dhe pro-ruse të Ballkanit Perëndimor,

kështu për shembull, BE-ja toleroi Serbinë ta ndjekë politikën edhe me Rusinë dhe me BE-në, pra të qëndrojë në dy karrige, atë të Rosisë dhe të BE-së.

Më tej, Serbia pro-ruse nuk ndoqi politiken evropiane për sanksionimin e Rosisë për pushtimin e Ukrainës, BE-ja nuk e ndëshkoi Serbinë, ndërsa shtetet pro-perëndimore që ndoqën këtë linjë nuk u shpërbyen.

Kur ishte çështja e sulmit gjeopolitik të Serbisë në Banjškë të Kosovës, BE-ja lehtësisht ndëshkoi Kosovën ndërsa nuk e ndëshkoi Serbinë, këto ndëshkime ndaj Kosovës vazhdojnë tash një vit, BE-ja përsëri lehtësisht nuk i hoqi, e pakta ka qenë që BE-ja t’i tregoj popullit të Kosovës se cilat janë arsyet që u ndëshkua Kosova. Natyrisht këtë shpjegim duhet ta bënte edhe Qeveria e Kosovës, mirëpo mos-transparenca e kësaj qeverie është e njohur që nga marrja e mandatit.

Ndërkohë ambivalenca e BE-së po vazhdon edhe në dialogun e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve fqinjësore Kosovë-Serbi, që po zgjatë më shumë se një dekadë dhe fundi nuk i shihet. Në këtë mënyrë BE-ja kërkon asociacionin nga Kosova por nuk e kërkon nga Serbia njohjen e shtetit të Kosovës.

E njëjta po ndodh edhe me qasjen e NATO-s ndaj vendeve që aspirojnë NATO-n, ndonëse NATO më herët filloi të përmend rëndësinë e qasjes gjeopolitike dhe gjeostrategjike, por nuk hapi dyert për Kosovën dhe Bosnjën që kishin kaluar luftëra e gjenocide nga Serbia e Millosheviqit.

Ndërkohë që Serbia as nuk e aspiron NATO-n, duke mbajtur anën e Rosisë haptazi.

Duke theksuar paqartësitë në qiellin e Ballkanit Perëndimor, dua të theksoj se qartësia në qiellin e rajonit tonë është negative për fat të keq, pra qartësia është në dinamikën negative për rajonin tonë duke përfshirë kërcënimet e qarta për sigurinë dhe dinamikën destabilizuese në Ballkanin Perëndimor, në veçanti ndaj Kosovës, Bosnjës dhe së fundi ndaj Malit të Zi.

E qartë është lufta invizibile gjeopolitike e Serbisë ndaj Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës e nxitur nga Rusia, që vazhdon që nga përfundimi i Luftës në Kosovë, që ishte lufta e fundit në Ballkan pas Kroacisë dhe Bosnjës. Serbia përmes ndërhyrjeve destabilizuese ndaj Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës po çon përpara agjendën e saj gjeopolitike e nacionaliste.

Edhe ma e qartë është lufta e Serbisë për krijimin e “botës serbe” përkatësisht të krijimin e “Serbisë së madhe”. Atë çfarë po bënë Rusia dëshpërimisht për rikthimin e humbjeve nga rënia e Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Ftohtë, të ngjashme po bënë Serbia dëshpërimisht për rikthimin e humbjeve nga rënia e ish-Jugosllavisë nga gërmadhat e të cilës tentoi pa sukses të krijonte “Serbinë e madhe”.

Përballë ambicieve të qarta gjeopolitike të Rosisë dhe Serbisë në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor, Perëndimi duhet t’i japë përgjigje të qartë gjeopolitike.

Ndërsa Rusia duke bombarduar Kievin dëmtoi qëllimshëm ambasadat e vendeve pro-perëndimore, Ambasadat e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, kjo ishte një mënyrë indirekte e Rosisë për të vendosur vetë kufirin gjeopolitik në Evropë.

Është gjithnjë e ma e qartë lufta e doktrinave gjeopolitike të Perëndimit dhe Rosisë, me një anë Doktrina e “Heartlandit” dhe një anë tjetër Doktrina ruse e “euro-azisë” ku Ballkani Perëndimor ka një peshë specifike.

Pra është e evidente se sfidat e sigurisë në Ballkanin Perëndimor janë ripercaktuar nga lufta në Ukrainë e cila jo vetëm ringjalli gjeopolitikën klasike por dhe e ka dëmtuar rëndë rendin ndërkombëtar të krijuar Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë kontekst, brishtësia e paqes në Ballkanin Perëndimor kërkon vendime dhe veprime gjeopolitike dhe gjeostrategjike nga ana e ShBA-së dhe NATO-s. Është koha që Perëndimi ta vendosë kufirin e vet gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor, ta mbroj dhe të krijoj kushtet për një paqe të qëndrueshme. Hap i parë është që NATO te anëtarësoj Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën, si garanci e sigurisë dhe paqes në rajonin tonë.

Është koha për vendime gjeopolitike të NATO-s për të kundërshtuar luftën gjeopolitike ruse kundër Ukrainës dhe kundër luftës invizibile gjeopolitike të Serbisë në Ballkanin Perëndimor.

Është koha të vendosen linjat e qarta të sferave të influencës në mes të Perëndimit dhe Rosisë në



# BREDHJET E LIDERËVE NËPËR BOTË PA ASNJË REZULTAT NË POLITIKËN E JASHTME

Diplomacia e Kosovës gjatë vitit 2024 nuk ka shënuar ndonjë sukses substancial në arenën ndërkombëtare. Gjatë vitit që po e lëmë pas Kosova nuk është njohur nga asnjë shtet i botës. Vizitat e shumta të liderëve institucionalë nuk kanë rezultuar produktive as në njohje të reja e as në anëtarësim në organizata të rëndësishme ndërkombëtare. Dështimi më i madh i diplomacisë së Kosovës ka qenë mosanëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës



Lirim GECI

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Diplomacia e Kosovës gjatë vitit 2024 nuk është treguar aspak e suksesshme. Përpos bredhjeve (vizitave) nëpër botë, liderët institucionalë nuk kanë treguar asnjë rezultat në raport me ndonjë njohje apo anëtarësim të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Presidentja Vjosa Osmani gjatë vitit 2024 ka zhvilluar vizita të shumta nëpër botë, duke përfshirë edhe vizitat e shpeshta në ShBA. Edhe kryeministri Albin Kurti ka realizuar vizita të shumta nëpër botë. Këto vizita më shumë kanë qenë të karakterit multilateral dhe bilateral. Po ashtu, edhe shefja e diplomacisë së Kosovës, Donika Gërvalla, ka realizuar vizita të shumta nëpër shtete të ndryshme,

por rezultatet i kanë munguar. Mossukseset e Kosovës në arenën ndërkombëtare kanë qenë të ndërlidhura me procesin e dialogut, konkretisht me zbatimin e marrëveshjeve të arritura me Serbinë. Po ashtu, veprimet e brendshme të institucioneve të Kosovës kanë ndikuar në relacionin e raporteve me shumë vende, përfshirë edhe shtetet mike, veçanërisht me ShBA-në, e cila është pasivizuar për shkak të mosmarrjes parasysh të sugjerimeve të saj në raport me disa zhvillime në veriun e Kosovës. Dështimi më spektakular i pushtetit aktual në diplomaci ka qenë mosanëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës (KIE). Republika e Kosovës më 18 maj kishte mbetur jashtë agjendës së Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (KIE) për anëtarësim në

këtë organizatë të rëndësishme ndërkombëtare. Mospërfshirja në agjendë ka ndodhur për shkak se Kosova nuk e ka plotësuar kushtin për dërgimin e draft-statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Gjykatën Kushtetuese. Në plotësimin e këtij kushti kanë insistuar Franca, Gjermania dhe Italia, ndonëse një ditë para mbajtjes së mbledhjes së Komitetit të Ministrave të KIE-së, ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, nëpërmjet një letre drejtuar Asamblesë Parlamentare të KIE-së, ishte zotuar se Qeveria e Kosovës do ta hartojë një draft-statut të Asociacionit, duke e anashkaluar atë të Bashkimit Evropian (BE). Megjithatë, vendet anëtare kanë shprehur gatishmëri që Kosova të mund të bëhet anëtare në një fazë të mëvonshme, nëse e plotëson kushtin e kërkuar nga Franca, Gjermania dhe Italia. Pas kalimit të rekomandimit për pranimin e Kosovës në Asamblesë Parlamentare të KIE-së, disa shtete kishin vendosur kusht që Kosova ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe nëse dëshiron të bëhet anëtare e organizatës me seli në Strasburg. Më 16 maj, përmes një letre dërguar Këshillit të Evropës, liderët institucionalë të Kosovës ishin zotuar se do ta hartojnë një draft-

statut për Asociacionin dhe të njëjtin do ta dërgojnë për interpretim në Gjykatën Kushtetuese deri në fund të majit. Me këtë zotim, Kosova kishte thënë se ka përbushur kushtin e vënë nga disa anëtarë të Këshillit të Evropës dhe Prishtina zyrtare pati kërkuar që të bëhet anëtare e kësaj organizate evropiane për të drejtat e njeriut. Por, Gjermania, një prej shteteve që ka vendosur kushtin për Kosovën në KIE, ka thënë se ajo konsideron si "hap konkret" vetëm kur Kosova ta dorëzojë në Gjykatën Kushtetuese draft-statutin për Asociacionin. Letra e dërguar në Këshillin e Evropës nga Donika Gërvalla, pa dijeninë e presidentes Osmani, ka qenë pikë kthese në "acarimin" e raporteve të presidentes me kryeministrin Kurti dhe kryediplomatën Gërvalla. Në fjalim vjetor të mbajtur në Kuvend, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thumbuar kryeministrin Kurti dhe ministren Gërvalla në raport me aleancat ndërkombëtare. "Aleancat janë këtu për të na mbrojtur, prandaj vënia në rrezik e tyre, luajtja bixhoz me to, apo cenimi i tyre, e cenon vetë mbrojtjen e republikës sonë", ka thënë ajo. Pas zhvillimeve në Strasburg ka reaguar ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD), Donika Gërvalla. Ajo fajëson

ndërkombëtarët për dështimin e Kosovës në KIE, duke thënë se "nuk mund të ndalet anëtarësimi i Kosovës". Lidhur me këtë dështim ka pasur reagime të mëdha në Kosovë sidomos nga partitë opozitare, por edhe nga miqtë ndërkombëtarë. Ish-emisari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i cili do të ketë pozitë të rëndësishme në administratën Trump (shef i misioneve speciale), kishte thënë se kryeministri Albin Kurti është duke e penguar Kosovën dhe se, sipas tij, qytetarët meritojnë më mirë. "Kurti po e pengon Kosovën. Është e trishtueshme. Miqtë e mi në Kosovë meritojnë më mirë. Aq shumë përparim mund të bëhet për normalizimin e marrëdhënieve nëse marrëveshjet thjesht do të zbatoheshin", kishte shkruar Grenelli në platformën "X". Krahas kësaj, diplomacia e Kosovës ka shënuar disa të arritura siç janë liberalizimi i vizave (kriteret kanë qenë të plotësuar nga BE, njohja e pasaportave nga Tajlanda, Emiratet Arabe, Tajvani dhe njohja nga dy shtete mosnjohëse, Spanja e Armenia. Po ashtu, Kosova gjatë këtij viti ka blerë edhe disa objekte për vendosjen e ambasadave siç është objekti në ShBA.





# NGJARJET MË KRYESORE NË EKONOMI GJATË VITIT 2024



**Përgatiti:**  
**Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, DHJETOR/JANAR** - Rritja ekonomike në 4.3 %, rritja e pagave në sektorin publik dhe e pensioneve, ndarja e 100 eurove për fundvit për fëmijë dhe pensionistë, peticioni i dorëzuar nga SBASHK-u për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale, mbyllja e pikave të derivateve në veri, shkarkimi i Nagip Krasniqit nga pozita e kryeshefit të KEK-ut, lansimi i projektit për investime nga mërgata, rritja e pagës minimale në 350 euro, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” në 2024 regjistroi 4 milionë pasagjerë, shpërndarja e faturave të rrymës në veri, ishin disa nga ngjarjet që e karakterizuan vitin 2024 në sektorin e ekonomisë

## Viti 2024 mbyllet me rritje ekonomike 4.3 %

Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, në konferencën e fundvitit për medie, ka thënë se viti 2024 do të mbyllet me

rritje ekonomike prej 4.3-përqindësh. Ismaili bëri me dije se, megjithëse deri në shtator ishte regjistruar një rritje prej 4.6 %, ekonomia e Kosovës pritet të mbyllet me një rritje prej 4.3 % për këtë vit. “Ekonomia pritet të mbyllet me një rritje prej 4.3 % për vitin 2024. Derisa deri në shtator është arritur një rritje prej 4.6 %. Shkalla mesatare e inflacionit në Kosovë arriti 1.7 % në nëntor, e pritet janë që inflacioni të mbyllet në 1.6 %, siç pritet të jetë edhe në vitin 2025”, tha ai.

## Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” regjistroi 4 milionë pasagjerë

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka regjistruar katër milionë pasagjerë, përfshirë këtu pasagjerë shqiptarë e të huaj, nga brenda e jashtë vendit, që kanë udhëtuar nga dhe drejt Prishtinës përmes këtij aeroporti. Në shënim të kësaj ngjarjeje të rëndësishme, kryeministri Kurti nënvizoi që nga koha e liberalizimit të vizave kemi më shumë se

dyfishim të pasagjerëve, 46 % rritje të fluturimeve si dhe kemi 16 destinacione të reja e 16 operatorë të rinj.

## U ndahen 100 euro pensionistëve dhe fëmijëve deri në 16 vjeç

Qeveria e Kosovës ua ka ndarë nga 100 euro shtesë për fundvit të gjithë pensionistëve dhe fëmijëve deri në 16 vjeç. Megjithatë, ky vendim i kritikua nga opozita e disa analistë se Kurti e bëri këtë për qëllime të fushatës zgjedhore. Një vendim i tillë ishte marrë edhe vitin e kaluar.

## ATK-ja mblodhi rreth 950 milionë euro në tatime

Agjencia Tatimore e Kosovës (ATK) ka mblodhur rreth 950 milionë euro në tatime nga janari deri në dhjetor të këtij viti. Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, në konferencën përmblylëse të vitit, ka theksuar se, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje për 100 milionë euro apo rreth 12 % në raport me vitin paraprak.

## Përdorim rekord i qymyrit në botë më 2024

Përdorimi botëror i qymyrit pritet të arrijë nivel rekord të të gjitha kohëve më 2024, ka thënë Agjencia Ndërkombëtare për Energji, teksa viti që po lëmë pas, sipas të gjitha gjasave, do të jetë më i ngrohti i regjistruar në histori. Pavarësisht prej thirrjeve për ta ndaluar djegien e lëndës më të ndyrë fosile të njerëzimit që po nxit ndryshime klimatike, ANE ka thënë se pret që kërkesa globale për qymyr të arrijë shifra rekorde për të tretin vit rresht, raporton AFP. Shkencëtarët kanë paralajmëruar se gazrat serrë që ngrohin planetin duhet të shkurtohen në mënyrë drastike për ta kufizuar ngrohjen globale, në mënyrë që të shmangen efektet katastrofike ndaj Tokës dhe njerëzimit.

## Deputetët miratojnë në lexim të dytë Projektligjin për Buxhetin e vitit 2025

Me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e

Kuvendit të Kosovës kanë miratuar në lexim të dytë Projektligjin mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, i cili kap vlerën e 3.6 miliardë eurove. Partitë opozitare nuk morën pjesë në votim. Më 11 nëntor deputetët e kishin miratuar në lexim të parë këtë projektligj. Vlera e projektbuxhetit për vitin 2025 është 9 për qind më e lartë se e buxhetit të vitit 2024, që kishte vlerën 3.3 miliardë euro.

## Qeveria njofton rritje pagash për sektorin publik nga janari

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vendosur t’i rrisë pagat në sektorin publik për 55 euro nga janari i vitit 2025. Ai ka bërë me dije se vlera e një koeficienti mbetet 110 euro, mirëpo rritet sasia e koeficienteve për njësi. Sipas Ligjit për Paga, niveli i koeficienteve është nga 2 deri në 18. Niveli shumëzohet me vlerën dhe përcakton pagën. Ai tha se rritja e dytë e pagave për 55 euro të tjera do të bëhet edhe verën e ardhshme, por vendi do të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare në shkurt 2025.





## ARKEP autorizon "Starlink"-un për të ofruar shërbime në Kosovë

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në Kosovë (ARKEP) e ka autorizuar kompaninë amerikane "Starlink" për ofrimin e qasje në internet në çdo lokacion të Kosovës. Në të gjithë globin, "Starlink" u ka mundësuar komuniteteve në nevojë të kenë qasje në arsim, shërbime shëndetësore, të mundësojnë punën në distancë dhe të ofrojnë mbështetje kritike të komunikimit gjatë fatkeqësive natyrore ose raste të tjera të emergjencave kombëtare. Hyrja e kësaj kompanie globale në tregun vendor do të ndikojë edhe në përfitime ekonomike dhe zhvillim të përgjithshëm të Kosovës. "Starlink" është rrjet privat satelitor i internetit që zotërohet prej kompanisë "SpaceX", të miliardarit Elon Musk. "Starlink" besohet se i ka rreth 4 800 pajisje në orbitë, përmes të cilave ofrohet internet në rreth 100 vend të botës.

## Kosova nuk përfaqësohet më nga UNMIK-u në CEFTA

Kosova do të përfaqësohet tani nga institucionet dhe zyrtarët e saj në Marrëveshjen për Tregtinë e Lirë të vendeve të Evropës Qendrore (CEFTA), pas një vendimi të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s për ta

pranuar kërkesën e saj për heqjen e UNMIK-ut nga roli i përfaqësuesit. Shtetet anëtare të CEFTA-s janë Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi dhe Moldavia. Rumania, Bullgaria dhe Kroacia u tërhoqën nga CEFTA pas anëtarësimit të tyre në BE.

## Qeveria e Kosovës i rrit pensionet për 20 për qind

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë vitit që lamë pas ka njoftuar se qeveria e tij ka vendosur t'i rrisë për 20 për qind pensionet që financohen nga shteti. Ai bëri me dije se pensionet e përcaktuara me Ligjin për Kategoritë e Luftës do të rriten për 20 për qind nga muaji janar 2025.

## Kosova heq kufizimin në Merdar për mallrat nga Serbia

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 7 tetor ka thënë se në pikën kufitare me Serbinë, Merdar, do të ndryshohet masa e sigurisë për mallrat që nisen nga ky vend. Ai ka thënë se qeveria e ka ndërruar masën e sigurisë nga kufizimi i plotë, në kontroll të shtuar, deri në sigurim të skanerëve të avancuar. Serbia ka reaguar pas vendimit, duke thënë se është hequr tensioni që ka ekzistuar për kohë të gjatë. Qeveria e Kosovës e kishte vendosur ndalesën ndaj importit të

mallrave nga Serbia në korrik të vitit 2023 për arsye "sigurie", pasi tre policë të Kosovës ishin arrestuar nga policia serbe. Megjithëse ata ishin liruar më vonë, vendimi për mallrat serbe kishte mbetur në fuqi.

## SBASHK-u dorëzon peticionin për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale

Sindikata e Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK) ia ka dorëzuar kryesisë së Kuvendit të Kosovës një peticion që kërkon ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale që financohen nga shteti. Peticioni është nënshkruar nga 20 606 qytetarë. SBASHK-u synon që përmes kësaj nisme të adresohen disa nga sfidat me të cilat përballen punonjësit e arsimit dhe të sektorëve të tjerë publikë që përfitojnë nga skemat pensione, duke kërkuar të ketë ndryshime në përfitimet e pensionistëve.

## Mbyllet disa pika të derivateve në veri të Kosovës

Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes të Tregut në Kosovë ka mbyllur disa pika të derivateve në veri për shkak se operonin pa leje të shitjes me pakicë të derivateve të naftës. Sipas njoftimit, pompat që u mbyllën gjendeshin në Zveçan dhe Leposaviq. Në fotografitë që i janë bashkëngjitur

njoftimit të lëshuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, shihet logoja e kompanisë NIS.

## AUV rrit kontrollin ndaj produkteve të shpendëve që importohen nga Brazili

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) në Kosovë gjatë vitit 2024 ka njoftuar se ka rritur nivelin e kontrollit për ngarkesat me produkte të shpendëve nga Brazili për shkak të shpërthimit të sëmundjes Newcastle. Kjo sëmundje prek shpendët shtëpiake dhe është shumë ngjithëse. AUV ka thënë se ka pranuar paralajmërim prej Ministrisë së Bujqësisë dhe Blegtorisë në Brazil për suspendimin e përkohshëm të certifikimit për eksportet e mishit të shpendëve dhe produkteve të tij.

## Nagip Krasniqi shkarkohet nga pozita e kryeshefit të KEK-ut

Bordi i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) e ka liruar Nagip Krasniqin nga detyra e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes. Ai ka qenë i pezulluar nga kjo detyrë nga viti 2023. Bordi i KEK-ut, në mbledhjen e datës 23.04.2024, njofton se mori vendim që në ditët në vijim të inicohen procedurat për shpalljen e konkursit për pozitën tanimë vakante të kryeshefit ekzekutiv. Nagip Krasniqi ishte arrestuar

më 19.04.2023 për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ushtrim të ndikimit dhe konflikt të interesit sa ishte kryeshef i KEK-ut.

## Rritja e kërkesës për rrymë "do t'i mbajë gjallë termocentralet me thëngjill"

Kërkesa për rrymë në botë është duke shënuar rritjen më të shpejtë në gati 20 vjet për shkak të përdorimit të kondicionerëve si pasojë e rritjes së temperaturave, ka thënë Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë, në një raport të publikuar të premten. Sipas gjetjeve, ky trend, që pritet të vazhdojë edhe më 2025, nënkupton vazhdimësinë e përdorimit të energjisë me thëngjill, ndonëse do të rriten kapacitetet e energjisë së ripërtërishme. Shumë vende në botë janë duke regjistruar temperaturë rekorde dhe valë të të nxehtit.

## Paga minimale në Kosovë rritet në 350 euro

Qeveria e Kosovës mori vendim gjatë një mbledhjeje ta rrisë pagën minimale në vend në 350 euro për punëtorët e të gjitha moshave. Kjo rritje u bë vetëm disa ditë pasi hyri në fuqi Ligji për Pagën Minimale, i cili parashihte një rritje të pagës minimale në 264 euro bruto për të gjithë të punësuarit në sektorin publik e privat. Por, me vendimin e ri të qeverisë së





## MCC-ja dhe Kosova lansojnë programin për energjinë në vlerë prej 236 milionë dollarësh

Gjatë vitit që lamë pas Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit e Qeverisë amerikane dhe Qeveria e Kosovës kanë lansuar zbatimin e programit kompakt, që është i

fokusuar në ofrimin e zgjidhjeve për energji të pastër. Programi, që sipas ambasadorit amerikan në Kosovë, Jeff Hovenier, është i vetmi në Evropë që ka MCC-ja,

është në vlerë prej 236.7 milionë dollarësh. Nga kjo vlerë, 202 milionë janë nga MCC-ja dhe 34.7 milionë të tjera janë kontribut i Qeverisë së Kosovës. "Ky program

do të ndërtojë vende për ruajtjen e energjisë apo bateri për ruajtjen e energjisë. Ky sistem i ruajtjes do të ndihmojë në tranzicionin, do të mundësojë integrimin e energjisë

së ripërtërisht dhe do ta lejojë Kosovën ta menaxhojë më mirë fuqinë e shpenzimeve", tha Hovenieri në ceremoninë e lansimit të programit.

kryeministrit Albin Kurti, shkalla e re e pagës minimale do të jetë dy euro për orë pune të rregullt, apo 350 euro bruto në muaj për orar të plotë.

### Operimi i hidrocentraleve të Deçanit dërgohet në Kushtetuese

Çështja e operimit të hidrocentraleve në rrjedhën e Lumëbardhit në komunën e Deçanit ka shkuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Organizata Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Pishtarët dhe disa qytetarë të Deçanit kanë dërguar në Kushtetuese kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së një aktgjykimi të Gjykatës Supreme të datës 5 mars 2024. Njëpërmjet këtij aktgjykimi ishin vlerësuar si të ligjshme procedurat dhe vendimet për dhënien e lejeve ujore dhe mjedisore për Hidrocentralet "Belaja", "Deçani" dhe "Lumëbardhi 2". Këto organizata dhe një grup i qytetarëve nga Deçani vlerësojnë se Aktgjykimi i Supremes është në kundërshtim me disa nene të Kushtetutës së Kosovës.

### Qeveria e Kosovës lanson projekt për investime nga mërgata

Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditorë dhe Agjencinë e ShBA-së për

Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), lansoi projektin "Dritarja për Investime të Diasporës", i cili synon të sjellë investime të mërgatës në Kosovë. Përmes këtij projekti, tha ai, mërgata do ta ketë më të lehtë aplikimin për kredi për investime në Kosovë.

### Kushtetuesja shpall të pavlefshëm Ligjin për Byronë për Konfiskimin e Pasurisë

Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Në vendim, Kushtetuesja i ka vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën katër nene të këtij ligji, por tha se duke pasur parasysh rëndësinë e këtyre neneve dhe pa ndryshimin dhe plotësimin e tyre nga Kuvendi i Kosovës, Ligji për Byronë Shtetërore "është shpallur i pavlefshëm në tërësinë e tij". Lënda në Kushtetuese u dërgua nga deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, që është subjekti më i madh opozitar.

### Kushtetuesja refuzon kërkesën për pezullimin e Rregullores së BQK-së për dinarin

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shpallur të papranueshëm

kërkesën e Vasilije Arsiqit, që gjykata të vlerësojë kushtetutshmërinë e Rregullores të Bankës Qendrore të Kosovës, që ka hyrë në fuqi më 1 shkurt. Kushtetuesja tha se Arsiq kishte kërkuar vendosjen e një mase të përkohshme, përkatësisht të pezullohej zbatimi i rregullores, që parasheh euron si monedhën e vetme për pagesa me para të gatshme. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se parashtruesi nuk kishte shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj për t'i mbështetur pretendimet për cenim të të drejtave dhe lirime themelore të njeriut.

### Miratohet marrëveshje për kredinë për banimin social

Më 23 maj Kuvendi miratoi marrëveshjen e kredisë në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHE). Për këtë marrëveshje votuan 80 deputetë, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në prezantimin e kësaj marrëveshjeje, ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se kjo kredi është për projektin "banimi social adekuat" dhe kap vlerën 25 milionë eurove. Marrëveshja

përfshin ngritjen e numrit të njërive për banim social që mund të bëhet duke rinovuar banesat sociale ekzistuese, shndërrimin e ndërtesave ekzistuese në banesa të reja sociale dhe në ndërtimin e banesave sociale.

### Për herë të parë Kosova merr vlerësim kreditor

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës bëri me dije se agjencia ndërkombëtare Fitch Ratings ka dhënë vlerësim kreditor 'BB' për Kosovën. Vlerësimi kreditor mat aftësinë e qeverisë për t'i shlyer borxhet e saj. "Ky vlerësim kreditor do të shërbejë si një pasaportë për Kosovën për çdo investitor të huaj që është i interesuar të shohë se a ia vlen të investohet në vendin tonë. Po ashtu, do të ndikojë në uljen e kostos së financimit që, rrjedhimisht, do të ketë mundësi më tepër për financim për bizneset tona", tha ministri i Financave, Hekuran Murati, përmes një video-deklarate të publikuar në "Facebook". Kjo është hera e parë që është publikuar një vlerësim kreditor për Kosovën. Sipas Ministrisë së Financave, kjo "merr parasysh qëndrueshmërinë e politikave fiskale, borxhin publik, deficitin, rritjen ekonomike, sektorin bankar dhe cilësinë e qeverisjes, ndër të tjera".

### Prokuroria e fton për intervistim ministren Hajdari për keqpërdorim të detyrës

Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi të hënën se ka thirrur për intervistim ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë të Kosovës (MINT), Rozeta Hajdari, e cila dyshohet për keqpërdorim të detyrës zyrtare në lidhje me rezervat shtetërore. Megjithatë, Prokuroria tha se Hajdari e ka mbrojtur veten në heshtje në paraqitjen e saj si e pandehur para prokurorëve. "Mirëpo, e njëjta sot nuk është deklaruar, dhe siç e parasheh Kodi i Procedurës Penale, ka shfrytëzuar të drejtën për t'u mbrojtur në heshtje", tha Prokuroria. Verën e kaluar ishin arrestuar tre persona, dy prej të cilëve pjesëtarë të Ministrisë së Hajdarit, të dyshuar për keqpërdorim të rezervave shtetërore.

### Punëtorët e Telekomit protestojnë pasi bllokimi i llogarisë së kompanisë i la pa paga

Pjesëtarët e Federatës Sindikale të Telekomit të Kosovës disa herë gjatë vitit kanë protestuar para objektit kryesor që shfrytëzohet prej



Telekomit në Prishtinë, në shenjë pakënaqësie për mosmarrje të pagës. Llogaritë e Telekomit të Kosovës ishin bllokuar disa herë si pasojë e një borxhi në vlerë të disa miliona eurove ndaj kompanisë tjetër telefonike “Z-Mobile”. Menaxhmenti i Telekomit pati deklaruar se më 29 shkurt 2024 Telekomit kishte marrë njoftim për bllokim të llogarive.

### Në veri nis shpërndarja e faturave të rrymës

Në veri të Kosovës nga 29 shkurti ka filluar shpërndarja e faturave të energjisë elektrike. Faturat i ka lëshuar kompania “Elektrosever”, që është në pronësi të kompanisë energjetike të Serbisë, EPS (Elektroprivreda Srbije). Kjo kompani mori licencën për autoritetet në Kosovë më 24 qershor të vitit 2023. Banorët e veriut të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, që nga viti 1999 nuk kanë paguar për energjinë e shpenzuar.

### Qeveria ndan fonde për punësimin e qytetarëve në veri

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) njoftoi të hënën se e ka ndërmarrë një masë për t'i ndihmuar të punësohen qytetarët në katër komunave me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok. Ministria tha se do ta subvencionojë 70 % të pagës bruto për gjashtë muaj me radhë deri në maksimumin prej 350 eurove për qytetarët në veri si shenjë përkrahjeje për punësimin e tyre.

### Kuvendi dështon ta miratojë një rezolutë që kërkon uljen e çmimit të rrymës

Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta miratojë një draft-rezolutë të propozuar nga opozita për uljen e çmimit të energjisë elektrike, pasi deputetët e partisë në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, abstenuan. Me 29 vota për, asnjë kundër dhe 55 abstenime, draft-rezoluta nuk i mori votat e nevojshme. Kjo është hera e dytë që kjo draft-rezolutë e propozuar nga Partia Demokratike, Lidhja Demokratike dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dështon në Kuvend, pasi partia e kryeministrit Albin Kurti e kishte braktisur seancën e kaluar kur ajo pritej të hidhej në votim më 18 janar. Rezoluta nuk ishte konsideruar serioze nga Lëvizja Vetëvendosje.



## Zgjerohet skema “Superpuna”

Qeveria e Kosovës ka vazhduar platformën “Superpuna” e cila ka nisur një vit më parë. Përmes kësaj platforme, ekzekutivi në

Prishtinë subvencionon punëdhënësin duke paguar pagën e punëtorit për gjashtë muaj në vlerë prej 264 eurosh. Punëdhënësi, pastaj,

ka të drejtë ta shtojë vlerën e pagës për punëtorin e angazhuar. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë një ngjarje të organizuar për këtë

çështje, tha se me vazhdimin e platformës do të zgjerohet edhe grup-mosha e personave që do të kenë të drejtë të aplikojnë.

### Hyn në fuqi vendimi i BQK-së për pagesat me euro

Më 1 shkurt në Kosovë ka hyrë në fuqi një rregullore e Bankës Qendrore të Kosovës që parasheh që vetëm valuta euro të përdoret për pagesa, duke i dhënë fund përdorimit të dinarit serb.

Ky vendim ka rritur shqetësimet e serbëve lokalë, të cilët marrin paga dhe pensione nga Serbia me dinarë, por edhe e përdorin këtë valutë për shitblerje. Megjithatë, Qeveria e Kosovës tha se zbatimi i rregullores për operacione me para të gatshme do të bëhet përmes një tranzicioni të lehtësuar.

### Lekaj dënohet me tre vjet e tetë muaj burgim për rastin e 53-milionëshit

Ish-ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, është dënuar me tre vjet e tetë muaj burgim për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe dëmtimit të buxhetit të Kosovës. Dënimi, i shqiptuar nga Gjykata Themelore në

Prishtinë më 31 janar, ka të bëjë me rastin e ndarjes së 53 milionë eurove shtesë konsorciumit “Bechtel&Enka” për ndërtimin e autostradës “Arbën Xhaferi”. Gjykata shqiptoi edhe dënim plotësues për deputetin e Kuvendit të Kosovës, Pal Lekaj, përmes të cilit ia ndalon për një periudhë prej tre vjet e gjashtë muaj ushtrimin e funksionit në administratën publike.



## MINT: Konsumatorët mund t'i shkëpusin kontratat me operatorët kabllorë

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) tha se konsumatorët mund t'i shkëpusin kontratat e tyre me operatorët kabllorë, nëse këta të fundit

nuk kanë përmbushur obligimet sipas kontratës. Sipas një njoftimi për medie, MINT tha se ka marrë këtë vendim pasi ka shqyrtuar qindra ankesa të


konsumatorëve, duke shtuar se obligon operatorët kabllorë “t'i largojnë kushtet e padrejta në kontratë”. MINT tha se detyrimi i vendosur që konsumatorët ta paguajnë

pjesën e mbetur të kontratës, nëse operatorët kabllorë ndryshojnë përmbajtjen e shërbimit /kanalet, është në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit.



# VITI 2025: STABILIZIM, TRANSPARENCË, ZHVILLIM

Kosova duhet të dalë nga bllokada brenda vetes dhe në raport me botën demokratike. Destabilizimi nuk është i ndërlidhur vetëm me përkeqësimin e situatës së sigurisë. Prandaj, shpresoj që viti 2025 të jetë vit për stabilizim, transparencë dhe zhvillim të Kosovës



Shkruan: Burim RAMADANI

Nuk ishte fare vit i lehtë. Për botën në përgjithësi, për Kosovën në mënyrë krejtësisht specifike. Viti 2024 u harroftë për nga dimensionet e rritjes së pasigurisë edhe publike, edhe kombëtare! Një vit tjetër qoftë viti 2025! Me domosdoshmërinë për stabilizimin, transparencën dhe zhvillimin.

## Destabilizimi që duhet kaluar

Destabilizimi nuk është i ndërlidhur vetëm me përkeqësimin e situatës së sigurisë. Kur shtetet ballafaqohen me çrregullimin e prioriteteve politike e shoqërore, ekonomike e diplomatike, dhe kur shtetet përballen me mungesë besimi brenda sistemit të vet politik e juridik, atëherë mund të vlerësohet se destabilizimi ka ndodhur. E tillë ishte e tërë kjo kohë e vitit 2024. Pak muaj pas sulmit terrorist nga grupi paramilitar serb në Banjskë, viti 2024 filloi dhe u përmbyll me tema të sigurizuara. Pra, një vit plot me tematika të sigurisë kombëtare, që dorën në zemër në pjesën më të madhe të ditëve të vitit ishte tema të abuzuara dhe të keqpërdorura për motive jo të sigurisë kombëtare. Kryesisht, motiveve të politikave të brendshme dhe grupeve të ngushta të njerëzve e elitave politike e shoqërore.

Viti 2025 do të duhej (shpresoj!) t'i japë një përgjigje edhe popullore, edhe politike e institucionale, edhe ekonomike e diplomatike situatës së këtyllë të destabilizuar. Qytetarët e Kosovës as nuk

meritojnë dhe as nuk do të duhej të tundoheshin deri në detaje për tema të këtylla të sigurisë, që në parim dhe substancë janë detyra të përditshme të sektorit të sigurisë. Pra, edhe pa i diskutuar në publik, në konferenca për media ditën e natën, sektori i sigurisë e kryen punën e vet në nivel edhe profesional, edhe sakrifikuës. Në anën tjetër, sa më shumë që vlerësimet e sektorit të sigurisë sillen nëpër konferenca për media dhe (rrjedhimisht) në opinionin publik, aq më shumë kjo ndikon në vështirësimin e punës së tyre, sepse fokusi, përkatësisht vendosja e 'reflektorëve' në punën e tyre nuk do të duhej të ishte përditshmëri. Por, për çfarë destabilizimi po flasim? Për çfarë sfidash, rreziqesh e kërcënimesh të sigurisë kombëtare po diskutojmë?

Një luftë hibride tashmë e më shumë se një dekadë kundër Kosovës ka marrë edhe formën e influencimit armiqësor, edhe ka shkakuar panik tek opinionin publik. Tek e fundit, cili do të ishte qëllimi i parë i një qasjeje armiqësore ndaj Kosovës? Sigurisht, krijimi i konfuzionit, shpërqendrimi, pesimizmit dhe mosbesimit brenda Kosovës, për Kosovën dhe ndaj partnerëve demokratik. Kjo, fatkeqësisht, në dimensionet e caktuara është arritur, derisa nivele tjera kanë vazhduar refuzimin, përkatësisht rezistencën ndaj kësaj.

Mungesa e një zhvillimi të qëndrueshëm, të mirëplanifikuar dhe të koordinuar me palët pjesëmarrëse është e dukshme. Sot, qytetari i Kosovës as nuk jeton më mirë, as më lirë, as më

sigurt. Të tri këto e kanë vënë Kosovën në një situatë jo të përshtatshme. Qytetari më keq, institucionet më neglizhente, ndjenja e pasigurisë e rritur.

## Lufta hibride – të kuptuarit dhe përgatitjet që po na mungojnë

Së pari, lufta hibride përfaqëson jo vetëm aktualitetin e këtyre dekadave të formave jo konvencionale dhe jo kinetike të luftës që po ndodh, por edhe një pjesë serioze të asaj nëpër institucionet dhe shoqëria është duke kaluar. Lufta hibride, në rastin tonë, patjetër se ndërlidhet me qëllimet dhe agjendat armiqësore të ndërhyrjes ruse, serbe, kineze dhe të aktorëve të tjerë shtetërorë e joshtetërorë ndaj Kosovës dhe Ballkanit.

Së dyti, në luftë hibride jemi të gjithë së bashku, si shtet dhe si shoqëri. Si institucione dhe si qytetarë. Por, numri i atyre që e kuptojnë thelbin e Luftës Hibride është jo vetëm i vogël, por krejtësisht i pamundshëm për të ndryshuar rrënjësisht gjendjen në Kosovë në këtë aspekt. Për më keq, IDIOTËT E DOBISHËM pretendojnë të jenë qytetarë besnik të këtij shteti, duke qenë në dozë të madhe pretendues të moralizimit, drejtësisë, ndershmërisë dhe vuajtjes. Të tillët jo vetëm që nuk kuptojnë se deri në çfarë niveli kanë arritur të shkaktojnë konfuzion, shpërqendrim, dezinformim dhe traumë në shoqërinë kosovare, por për më keq: mburren me këto! Sidoqoftë, Idiotët e Dobishëm janë

'yll' për kundërshtarët e Kosovës, të cilët as nuk kanë nevojë të paguajnë domosdoshmërisht përhapjen e pesimizmit dhe mosbesimit ndaj shtetit të Kosovës.

Së treti, në luftë hibride jo të gjithë aktorët institucionalë e vendimmarrës e mbajnë rolin e vet sipas përgjegjësi kushtetuese e ligjore, profesionale e qytetare. Lufta hibride është term që edhe është keqpërdorur kundër njerëzve që mendojnë ndryshe, qoftë strategjikisht, qoftë strukturalisht, qoftë politikisht apo thjesht kanë vizion tjetër për aktualitetin dhe të ardhmen. Paramendojeni se si titujt bombastik të njerëzve të veshur me pushtet e përgjegjësi adresojnë si luftë hibride kritikata publike rreth, për shembull, vendimeve qeveritare apo ministrore – për të cilat vendime ata marrin pagën nga populli i Kosovës dhe thjesht paguhen për t'i shërbyer po këtij populli.

Së katërti, në luftën hibride kapacitetet ekzistuese të një shteti – në rastin tonë, të Kosovës – as nuk janë të mjaftueshme dhe as nuk duhet të reduktohen. Përkundrazi, nga ShBA-ja, në Evropë e deri në Japoni e Zelandë të Re, shtetet investojnë në rritjen e kapaciteteve për kuptimin dhe përballjen me Luftën Hibride, sikurse edhe ruajnë dhe promovojnë kapacitetet njerëzore që ekzistojnë në ato shoqëri dhe institucione. Prandaj, në rastin tonë, vendimmarrësit duhet të heqin ngarkesat personale, grupore apo të motiveve tjera. Duhet investuar në kapacitete të reja – kryesisht njerëzore – dhe duhet ruajtur e mos hedhur në

baltë e nën baltë kapacitetet që janë të konsoliduara ndër vite. Sepse, konsolidimi i kapaciteteve profesionale në luftën hibride (por jo vetëm!) – qoftë si mekanizma institucionale, e qoftë si individë të profilizuar – arrihet vetëm pas shumë e shumë investimeve vetjake dhe përmes partnerëve të mirë të Kosovës. Kështu, hedhja në dhe nën baltë e mekanizmave dhe individëve – në këtë Kosovën tonë të re dhe pa traditë të gjatë shtetërore – jo vetëm që dëmton sigurinë kombëtare, por realisht i lë rrugë hapur zhvillimit dhe avancimit të Luftës Hibride nga aktorët armiqësorë, si pasojë e mungesave në sistemin e përballjes me to.

## Viti 2025 – mundësia që po vjen!

Qytetarët e Kosovës do të vendosin në vitin 2025 se çfarë po duan dhe si e shohin të ardhmen e shtetit e shoqërisë në periudhën që po vjen. Jo shumë prej njerëzve në Kosovë janë abstenues në vendimmarrje kolektive, sikurse janë zgjedhjet. Të paktën deri më tash, shoqëria kosovare duket të jetë shoqëri dukshëm e politizuar, të paktën në kuptimin e interesimit të përditshëm që shfaqin në zhvillimet politike e të sigurisë.

Qytetari në pak javë do të vendos për të ardhmen e vet jo vetëm personale. Prandaj, një mundësi që vjen në këtë periudhë është edhe demokratike, edhe e rregullt, edhe e domosdoshme.

Kosova duhet të del nga bllokada brenda vetes dhe në raport me botën demokratike.



# 2024-a, VIT ME ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË POLITIKËN E JASHTME GLOBALE



Shkruan: Valon MURTEZAJ

Në përgjithësi viti 2024 ishte një vit me zhvillime të rëndësishme në politikën e jashtme globale. Këto zhvillime ishin të mbushura me konflikte, tensione gjeopolitike dhe ndryshime politike. Të gjitha këto bënë që viti 2024 që po e lëmë pas të jetë

vit i sfidave të vështira që lidhen me politikën e jashtme dhe sigurinë ndërkombëtare.

Pushtimi rus në Ukrainë vazhdoi të dominojë vëmendjen botërore, me të gjitha ndikimet e mëdha në tregjet globale dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për fat të keq, ende paqja nuk shihet në horizont.

Konfliktet në Lindjen e Mesme, veçanërisht në Izrael, Palestinë dhe Siri, bënë që viti 2024 të mbahet mend si vit i tragjedi të mëdha dhe humbjes së jetëve të pafajshme.

Këto zhvillime ndikojnë në qasjen e kontinentit evropian po ashtu, për të adresuar sfidat globale dhe për ta forcuar rolin e saj në skenën ndërkombëtare.

BE-ja punoi për një strategji të re për Lindjen e Mesme, duke theksuar nevojën për një armëpushim në Gaza dhe një zgjidhje me dy shtete për konfliktin izraelit-palestinez. Kjo strategji kishte për synim gjithashtu rritjen e ndihmës humanitare në regjion.

Gjatë vitit 2024 BE-ja mbajti zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe si rezultat dolën institucionet e reja të Bashkimit Evropian. Për më tepër, viti 2024 do të mbahet si vit zgjedhor nëpër botë. Si rezultat, zgjedhjet luajtën një rol vendimtar në formësimin e politikës së jashtme këtë vit. Më shumë se dy miliardë njerëz në mbi 60 vende shkuan në votime. Shumë qeveri

ranë dhe shumë të tjera u ndërtuan. Përfshirë liderë të rinj në skenën politike botërore. Në Shtetet e Bashkuara populli amerikan votoi për një mandat të ri presidencial për Donald Trumpin.

Të gjitha këto ndryshime politike janë mundësi por, po ashtu, edhe sfida për sistemin global. Këtë do ta kuptojmë më qartë gjatë vitit 2025 dhe në vitet që vijjnë.

Kosova vazhdoi përpjekjet e saj drejt integritimit në BE, megjithëse progresi ishte i diskutueshëm. Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2024 theksoi se Kosova bëri përpjekje të mirë në disa fusha, por në anën tjetër avancimi drejt

integritimit evropian ishte i mangët.

Dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i lehtësuar nga BE-ja, kishte sfida të mëdha. Pavarësisht prej përpjekjeve, mund të thuhet që kishte shumë pak përparim në këtë proces. Serbia mbetet faktori kryesor destruktiv i mosprogresit në procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Këto ishin vetëm disa nga zhvillimet që karakterizuan vitin 2024 në fushën e politikës së jashtme, dhe që kanë një interes dhe impakt global, Evropian dhe për Kosovën padyshim. Duke pritur një vit të ri më shumë paqësor: Gëzuar 2025!

## DËSHTIMI I THELLË NË DIPLOMACI, SANKSIONET E BE-së, MUNGESA E STABILITETIT POLITIK DHE DËSHTIMI EKONOMIK JANË REALITETI I KOSOVËS 2024



Safet GËRXHALIU

Partneriteti me aleatët ndërkombëtarë, në veçanti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet mike evropiane, është parakushti dhe garancia e ecjes së Kosovës në rrugën drejt Këshillit Evropian, BE-së dhe NATO-s.

Republika e Kosovës është e arritura më e madhe kombit e paguar me gjak dhe sakrificë, prandaj fati i saj nuk duhet të mbetet në duart e praktikantëve politikë pa dijeni e me radikalizëm e militantizëm partiak e politik.

Viti 2024 karakterizohet me sfida të shumta, teste të rrezikshme dhe eksperimente politike që kanë prekur të gjitha aspektet e jetës ekonomike, politike, integruese, sociale dhe diplomatike të Republikës së Kosovës. Pavarësisht prej aspiratave për zhvillim dhe integrim më të thellë ndërkombëtar, ngjarjet e këtij

viti kanë theksuar dobësitë strukturore të vendit dhe kanë nxjerrë në pah domosdoshmërinë e një qasjeje të re dhe më të qëndrueshme drejt reformave.

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2024 ka qenë në një trajektore sfiduese, me një bilanc tregtar që mbetet negativ dhe eksportet që ranë mbi 6%. Kjo rënie thekson mungesën e kapaciteteve prodhuese, inovacionit, standardizimit dhe konkurrencës në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Sektori privat, që duhet të jetë shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik, është ballafaquar me sfida të shumta. Politikë e paqarta dhe shpeshherë të dëmshme të qeverisë, së bashku me mungesën e dialogut konstruktiv, kanë rezultuar në mbyllje masive të bizneseve të vogla dhe të mesme. Qasja majtiste qeveritare për barazi në varfëri dhe një luftë direkte me bizneset kanë ngufatur këtë sektor me pasojë të mëdha edhe në të ardhmen.

Transferimi i kapitalit jashtë vendit ka krijuar një klimë pasigurie, duke ngushtuar mundësitë për investime të reja dhe duke rënduar perspektivat e zhvillimit.

Inflacioni, edhe pse me një ulje

nominale, vazhdon të rëndojë mbi fuqinë blerëse të qytetarëve. Familjet janë detyruar ta shkurtojnë konsumin e produkteve bazë për ta përballuar rritjen e çmimeve të shërbimeve dhe produkteve të tjera. Kjo situatë e vështirë ekonomike ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe në stabilitetin social.

Papunësia vazhdon të jetë një plagë e hapur për Kosovën, veçanërisht për gratë dhe të rinjtë. Ndërsa statistikat zyrtare tregojnë një ulje të papunësisë, kjo është kryesisht rezultat i migrimit masiv të fuqisë punëtore drejt vendeve perëndimore. Ky fenomen ka krijuar boshllëqe serioze në tregun e punës, duke ndikuar negativisht në produktivitet dhe në mungesën e ekspertëve të kualifikuar në sektorë të rëndësishëm.

Një nga sfidat më kritike të vitit ka qenë sektori energjetik. Politikë për subvencionimin e pajisjeve termike për familjet rezultuan të pamjaftueshme për t'i përballuar nevojat energjetike të vendit. Gjatë muajve të dimrit kriza energjetike u përkeqësua, me ndërprerje të shpeshta të furnizimit dhe rritje të ndjeshme të çmimeve. Kjo

situatë ka rënduar jo vetëm familjet, por edhe bizneset, duke vënë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e tyre.

Mungesa e investimeve në arsim dhe mosrealizimi i premtimeve për ndërtimin e çerdheve dhe institucioneve profesionale kanë kufizuar mundësitë për zhvillim dhe punësim.

Arsimi profesional, që duhet të jetë një motor i integritimit të të rinjve në tregun e punës, vazhdon të mbetet një sektor i lënë pas dore.

Në sektorin e shëndetësisë mungesa e barnave esenciale dhe investimeve ka rënduar gjendjen e qytetarëve. Motivi i ulët i personelit shëndetësor dhe kushtet e punës kanë ndikuar në cilësinë e shërbimeve shëndetësore, duke thelluar pakënaqësitë sociale.

Në arenën ndërkombëtare, Kosova ka përjetuar një përkeqësim të marrëdhënieve me partnerët strategjikë. Sanksionet nga Bashkimi Evropian dhe tensionet e tjera diplomatike kanë ndikuar në rënie të investimeve të huaja dhe në perceptimin e Kosovës si një vend i pasigurt për të bërë biznes. Këto zhvillime theksojnë rëndësinë e një diplomacie aktive dhe efektive për përmirësimin e raporteve

ndërkombëtare dhe për të tërhequr investime të reja.


Viti 2024 duhet të shërbejë si një thirrje për reflektim të thellë për drejtuesit e vendit dhe për shoqërinë e Kosovës. Reformat strukturore në ekonomi, mbështetja për sektorin privat, përmirësimi i sistemit arsimor dhe një strategji afatgjatë për stabilizimin energjetik dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërkombëtare janë prioritetet që nuk mund të anashkalohe. Kosova ka potencialin për t'u shndërruar në një histori suksesi në Ballkan, por kjo kërkon një qasje më serioze dhe të qëndrueshme ndaj reformave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Nëse këto sfida trajtohen me vendosmëri, viti 2025 mund të jetë një pikë kthese për vendin drejt zhvillimit ekonomik dhe stabilitetit diplomatik.

Dështimet e diplomacisë politike dhe ekonomike nga Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës duhet të ndërpriten dhe të kërkohet përgjegjësi individuale dhe institucionale. Lufta për pushtet e jo për shtet e qytetarë është shndërruar në sëmundje të pashëruar për Kosovën.

Sa bëjmë për shtetin aq të fortë do ta kemi Republikën e Kosovës.



# SI TA RIBËJMË KOMBIN NË REALITETET E REJA



Milazim KRASNIQI

Vitin 2024 do ta kujtoj për mirë qoftë dhe vetëm për faktin se me librin tim "Postkolonialia" e kam hapur një temë të injoruar a të fshetur. Idenë e tij dëshiroj ta ndaj edhe me ju në këtë fundvit, me dëshirën që të na shërbejë për vitet në vijim. Titulli "Postkolonialia" shënjon gjendjen postkoloniale të njeriut shqiptar të Kosovës. Pra, njeriu i dalë nga robëria, nga pozita koloniale, është në situatë të meditojë, të reflektojë për gjendjen në të cilën ka qenë dhe për pasojat që ajo gjendje ka lënë në jetën e tij. Dhe më tutje të aftësohet që ta planifikojë të ardhmen e vet si njeri dhe si komb i lirë.

Nuk jam i sigurt se njerëzit tanë dinë shumë për gjendjen postkoloniale, edhe pse jetojnë brenda centrifugës së saj marramendëse. Pse nuk dinë? Sepse shkenca dhe artet, mediet e universitetet te ne, ende nuk janë marrë seriozisht me këtë problem. Ne ende nuk e kemi kuptuar rëndësinë që ka studimi dhe njohja e asaj përvoje që kemi kaluar nën sundimin kolonial serb. Disa njerëz te ne me mendësi ende janë brenda gjendjes koloniale, ndërsa pjesa tjetër, pjesa më e madhe, sillen sikur nuk kanë qenë kurrë viktime të kolonializmit. Këta të fundit e kanë përbrendësuar një lloj triumfalizmi dhe me të tentojnë t'i fshihin pasojat dhe traumat që ka lënë në jetën e tyre okupimi, sidomos spastrimi etnik i viteve nëntëdhjetë.

Në realitetin shkencor, kulturor, medial e akademik, gjendja postkoloniale është kohë e reflektimit për atë që i ka ndodhur individit e kombit, i cili ka qenë viktimë e kolonializmit. Ajo që sheh njeriu menjëherë në atë reflektim është jeta e dëmtuar e gjeneratave të tëra, të cilat i ka bluar kolonializimi, siç bluan guri i mullirit kokrrat e misrit. Jetët e dëmtuara në rrjedhë të kohëve nuk ribëhen. Por nëse në gjendjen postkoloniale fitohet vetëdija për atë që ka ndodhur, mund të lehtësohen pasojat dhe eventualisht të bëhet përpjekje

më e fortë për të mos rënë në një rast tjetër viktimë e variacioneve koloniale të poshtëritimit.

Në librin "Potkolonialia", në formën e ligjërimit poetik, e kam mbarështuar një reflektim të nuancuar, mbi jetën e dëmtuar në gjendjen tonë koloniale, që nga ajo personale e familjare e deri te jeta kombëtare. Secili njeri që ka jetuar në këtë vend deri në vitin 1999, secila familje shqiptare, i ka dëmtimet e veta nga sundimi kolonial serb. Vetëm duhet të gërvishiten kujtimet, kronikat familjare, dokumentet zyrtare dhe del në spikamë dëmtimi, që ka qenë pasojë e barbarisë së kolonizatorit. Të gjithë kolonizatorët janë barbarë, por në një progresion "orvelian" të bizaritetit, disa janë më barbarë sesa të tjerët. Kolonizatori serb mund të konkurrojë për lider të asaj liste makabre. Prandaj në disa raste jam detyruar ta formësoj edhe një qëndrim cinik të ashpër ndaj kolonizatorit dhe bartësve të gjendjes koloniale e aktorëve kolonialë, si shenjimi i triumfit të njeriut shqiptar mbi gjendjen koloniale. Mua më brengos fakti se një çerek shekulli pas çlirimit nga kolonizatori serb, ne ende nuk e kemi ndjenjën e triumfit kombëtar. Për ta ngjallë atë ndjenjë e atë vetëdije, ne duhet të formësojmë një botëvështrim të ri kulturor lidhur me kombin serb e shtetin serb dhe përvojat tona të hidhura njëshekullore nën sundimin e tyre. Duhet ta denoncojmë në të gjitha nivelet shkencore, artistike, mediale e akademike barbarinë e tyre. Brenda atij botëvështrimi ne duhet të afirmojmë përparësinë tonë kombëtare, si komb autokton, si komb paqedashës, si komb në aleancë me botën e lirë. Ne duhet ta ridimensionojmë edhe katalogun e tyre që kanë punuar e luftuar për mbijetesën tonë kombëtare dhe lirinë tonë kombëtare, gjatë sundimit kolonial serb, sepse shumë nga ato figura e ngjarje të periudhave të mëhershme, ne i

## FOTOGRAFI E VARUR NË GOZHDËN E FRIKËS

Në secilën klasë ishte fotografia e Titos e gozhdur në mur.

Tito kishte shikim hetues sa që dukej se na shihte të gjithëve, në çdo çast.

Në kokë mbante një kapelë me yll dhe veshur e kishte një kapotë të trashë. Na thonin se ai ishte komandanti suprem që kishte mposhtë në luftëra Hitlerin e Musolinin, ndërsa në paqe edhe Stalinin.

Në libra mësonim se çfarë kishte bërë Në Kumrovç, në Vjenë, në Rusi, në Zagreb, në Beograd, si i kishte udhëhequr komunistët në demonstrata, si kishte shpëtuar nga çdo atentat.

Mësuesi na thoshte të bënim kujdes në klasë çfarë bënim e çfarë thoshim sepse Tito e dinte se edhe çfarë mendonim.

Na thoshte se Titon duhet ta duam më shumë se prindërit tanë dhe pikë. Në rregull mendoja, por ai shikim i tij hetues pse më ngjallte aq shumë frikë? Më vonë e kuptova se edhe fotografia ishte pjesë e programit për të nxitë panik.

## VETËM ATA TË MARRË ISHIN MBI FRIKËN FITIMTARË

Porezniku\*Mirko ishte trupshkurtër, rahatike e çalamanë, fytyrëregjur, një mjeran.

Por, poreziku Mirko e shoqëronin policë të armatosur që arrestonin burra me plisa e i fusnin në maricë me një potez, dhe i shpienin në burg për porez. \*\*

Kur hynte Mirkoja në fshat dukej sikur kishte rënë epidemia: burrat fshiheshin ku të mundnin, gratë nxirrin pshërëtim, fëmijët i pllakoste lemeria.

Rezistencë bënin vetëm dy-tre të marrët e katundit. Ata edhe përballë vetë Mirkos dukeshin trima e triumfalë sepse e kishin prekur qëmoti fundin e fundit.

Vetëm ata ndiheshin të lirë e triumaftorë Në shtetin kolonizator. \*Tagrambledhësi \*\* tatim

kemi injoruar e edhe harruar. Ne duhet ta forcojmë pozicionin tonë gjeopolitik e gjeostrategjik, larg iniciativave të vjetra e të reja, që nga pansllavizmi e deri te BRICS. Ne duhet të kërkojmë hapësirat e reja të integritimit brendashqiptar, në kontekstin e integritimit evropian e atlantike. Ne faktikisht duhet ta

ribëjmë kombin shqiptar në realitetet e reja. Dhe gjithë ky proces kalon pashmangshëm nëpër introspeksionin e asaj që na ka ndodhë nën sundimin kolonial serb. Fijet kombëtare që na janë këputur në vitin 1912, duhet të rilidhen përfundimisht. Ato fije nuk mund t'i rilidhin politikanë

hazarderë e aventurierë si Edi Rama e Albin Kurti. Ato fije duhet t'i lidhin studimet shkencore, veprat artistike, produktet mediale dhe edukimet universitare. Unë shpresoj dhe uroj që viti 2025 të jetë vit kthese në këtë projekt. Dhe uroj shëndet e më shumë mençuri për të gjithë ne!

## CERVENA ZVEZDA A PARTIZANI

A je me Zvezden a me Partizanin pyesnin djemtë njëri tjetrin duke shikuar kërcënueshëm e duke ngritur zanin.

Djem të rinj e të leckosur që ruanin bagëtinë në kullotë ishin o me Zvezden o me Partizanin, si pasardhës të ilirëve kryekëqym për gjera që s'u përkisnin po t'ua prishje, mund ta bënin namin.

Natyrisht edhe këta si ilirët e humbur ishin viktime të kolonializimit por nuk e dinin djemtë e mjerë. Atyre që kishin ditur çka nuk ishin gjuhën kolonët ua kishin prerë. \*

## "ZHIVELA SRBIJA"

Në nevojtojen e një vagoni treni udhëtarësh nga Fushë Kosova drejt kryeqytetit të Serbisë, i cili lëvizte ngathë, si një karvan gomarësh ishte ky mbishkrim, si provë serbe e atdhetarisë.

Guximtari kish bërë një veprim me vlerë ndonëse kuptohej se e kish bërë me ngut. "Zhivela Srbija"\* e kishte shkruar në derë, me germa të përfutuara me mut. \*Rroftë Serbia

## TRENI PËR NË BURGJE

Në trenin Fushë Kosovë-Beograd gjithmonë kishte shumë udhëtarë shqiptarë.

Ata mbanin me vete do çanta të mëdha me rrobe e me ushqime thua se po shkonin në pushime.

Në fakt, ata shkonin nëpër burgjet e hapërdara anekënd Jugosllavisë, të ngarkuar me peshën e mallit e mërziisë.

Ata shkonin në Nish, në Novi Sad, në Pozharevc, Në Stara Gradishkë, në Golli Otok. Rrugën e shkuarjes dhe të kthimit Gjithmonë e lanin me lot.

Nëpër ato burgje u mbaheshin pengje fëmijët, prindërit, vëllezërit, bashkëshortët dhe shumë miq që shteti i kishte shpall armiq.

Udhëtonin me ata trena, të rraskapitur dhe shpresonin të mos vdisnin para se atë shtet të kalbur si një qen të ngordhur ta shihnin.

(Nga libri "Postkolonialia, Logos A, Shkup, 2024)



# KËTO JANË 10 ARRITJET TONA KRYESORE TË PËRBASHKËTA PËR VITIN 2024



Albin KURTI

**1.** Së pari, liberalizimi i vizave nga Bashkimi Evropian, Tajlanda, Emiratat e Bashkuara Arabe dhe Tajvani si dhe njohja e pasaportës së Republikës së Kosovës nga dy shtete mosnjohëse, Spanja dhe Armenia. Viti 2024 ka qenë viti i pasaportës sonë. Ajo sot rritet më lart se kurdoherë në indekset ndërkombëtare të pasaportave dhe sipas Indeksit Henley sivjet është në mesin e top 10 pasaportave të botës që kanë shënuar përmirësimin në të madh në dekadën e fundit.

**2.** Këtë vit, filloi regjistrimi dhe inkasimi i energjisë elektrike në katër komunat tona në veri, për herë të parë pas më shumë se dy dekadave. Gjatë këtij viti, gjithashtu ka përfunduar me sukses procesi i konvertimit të patentë shofereve ilegal në ata të Republikës së Kosovës. Janë regjistruar mbi 6300 konvertime, shumica prej tyre nga qytetarët e katër komunave në veri të vendit, duke dëshmuar vullnetin dhe gatishmërinë për integrim, e cila nuk ka munguar asnjëherë nga qytetarët, por është penguar në vazhdimësi nga struktura ilegale dhe Beogradi zyrtar. Shumë prej këtyre strukturave ilegale tashmë janë mbyllur, sepse janë të jashtëligjshme. Atje tani kemi një situatë krejt tjetër.

**3.** Pas shkëputjes nga blloku energjetik me Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut dhe bashkimin me bllokun energjetik rregullues me Shqipërinë, inaugurimi i bursës ALPEX është arritura tjetër më e madhe në pavarësimin tonë energjetik si dhe në bashkëpunimin tonë kombëtar. Krahas saj, e kemi përmblyllë me sukses Ankandin e parë diellor në histori të Republikës për kapacitete të reja prej 100MË, të cilin e fitoi konsorciumi nga mërgata jonë në Zvicër "Orllati" dhe këtë muaj kemi hapur ankandin e dytë për energji të ripërtërishme, të parën me energji të erës, me kapacitet gjithashtu 100MË. Sivjet gjithashtu ka hyrë në fuqi Programi Kompakt i Sfidës së Korporatës së Mijëvjeçarit (MCC) që përfshin një investim prej 236.7 milionë dollarësh për energji. Pra, viti 2024 paraqet themelet e forta të sigurisë sonë energjetike dhe të ndërtimit të kapaciteteve të reja që na bëjnë më të fortë përballë krizave të mundshme.

**4.** Shëndetësia publike është bërë më e mirë, më e lirë dhe me më shumë shërbime. Klinika e Ortopedisë, Klinika e Onkologjisë, Urologjisë, Gjinekologjisë, Kardio-kirurgjisë, Klinika Emergjente, Blloku Operativ në Klinikën Torakale, Blloku Operativ në

Neurokirurgji – Kirurgji Vaskulare, Reparti i Pediatriisë në Mitrovicë, Transfuzioni i Gjakut në Gjilan, Klinika e Psikiatriisë së Fëmijëve janë transformuar të gjitha këto rrënjësisht e tërësisht. Me udhëzimin Administrativ "Bashkëpagesat për shërbime shëndetësore" disa prej shërbimeve jetike për qytetarë janë pa pagesë ose me çmime më të përballueshme. Kurse me Ligjin për çmimet e unifikuara të barnave dhe miratimit të listës, duke filluar nga 1 shkurti i vitit 2025, çmimet e barnave do të jenë shumëfish më të ulëta.

**5.** Pensionet janë rritur për 20%. Pensionistët e moshës, përfituesit e skemave pensionale invalidore dhe të aftësive të kufizuara tashmë veçse i marrin pensionet e tyre me rritje, kurse nga muaji i ardhshëm fillon ekzekutimi i pensioneve me rritje të kategorive të dala nga lufta. Përveç rritjes së rregullt, të gjithë pensionistët tanë edhe këtë vit, sikurse vitin e kaluar, e për të pestë herë me radhë përgjatë mandatit tonë, këtë muaj do të marrin shtesën e njehershme prej 100 euro.

**6.** I kemi dyfishuar dhe trefishuar shtesat për fëmijë, përkatësisht dyfishim të shtesave për familjet që kanë një ose dy fëmijë, kurse trefishim për familjet që kanë tre ose më

shumë fëmijë. Po ashtu sikurse vitin e kaluar u kemi ndarë edhe një mbështetje shtesë për fundvit në vlerë prej 100 euro. Gjithsej për mbi 400 mijë fëmijë të vendit tonë.

**7.** Pas 13 vjetëve, kemi pagë të re minimale e cila është më shumë se dyfish më e lartë. Kurse, falë performacës së mirë ekonomike këtë vit, do të kemi përsëri rritje të pagave në sektorin publik. Paga e re Bazë që hyn në fuqi në vitin 2025 do të jetë për 110 euro më shumë. Rritja do të bëhet në dy faza. Faza e parë fillon në janar të vitit të ardhshëm, pra muajin tjetër dhe parashihet një rritje prej 55 euro, kurse faza e dytë hyn në fuqi nga korriku i vitit 2025, për të plotësuar totalin prej 110 euro rritje, apo një njësi më lartë të koeficientit të pagës bazë.

**8.** Në emër të drejtësisë, paqes dhe ruajtjes së vërtetës, e kemi funksionalizuar Institutin për Dokumentimin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës i cili brenda këtij viti ka grumbulluar rreth 190 metra gjatësi të materialit fizik arkivor dhe rreth 15 terabajt (TB) material digjital (video, audio, foto), që dokumentojnë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë, nga 67 burime të ndryshme. E kemi përzgjedhur konceptin fitues dhe e kemi nënshkruar kontratën për hartim të Master Planit për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. Gjithashtu,

kemi marrë edhe vendimin për themelimin e Muzeut të Gjenocidit dhe Përpjekjes për Liri.

**9.** Ka përfunduar me sukses procesi i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, një ndërmarrje e jashtëzakonshme institucionale dhe tejet e rëndësishme për vendin tonë që u vlerësua me nota të larta nga ekipet mbikëqyrëse të organizatave ndërkombëtare partnere, ekspertët e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë, UNFPA dhe Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropë, UNECE.

**10.** Krahas rritjes së numrit të ushtarëve, fuqizimit të ushtrisë dhe blerjes së armatimeve të ndryshme, bëmë edhe një hap të madh në vendosjen e themeleve të industrisë sonë të mbrojtjes, duke nënshkruar kontratë me prodhuesin shtetëror turk MKE për funksionalizimin e Fabrikës së Municioneve.

Unë sot i listova vetëm 10. Ka shumë rezultate tjera që nuk janë në këtë listë, e mbase edhe mund të ishin. Për t'u bërë drejtësi edhe për to, të nderuar anëtarë të kabinetit tonë qeveritar, unë ju ftoj që secili prej jush deri në fund të vitit të ndani me qytetarët tanë, të cilëve ju shërbejmë bashkërisht, pesë rezultatet kryesore të punës suaj për vitin 2024.



# GUVERNATORI ISMAILI FLET PËR SFIDAT DHE TË ARRITURAT E BQK-së: SISTEMI FINANCIAR NË VEND ËSHTË I QËNDRUESHËM

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka folur për sfidat dhe të arriturat e institucionit që drejton për vitin 2024. Ai ka theksuar se projeksionet e BQK-së janë që rritja ekonomike në Kosovë pritet të jetë rreth 4.3 për qind, kurse shkalla e inflacionit rreth 1.6 për qind.

Në anën tjetër, dërgesat e mërgatës deri në muajin shtator 2024 arritën vlerën e 1 miliard eurove, ndërsa Investimet e Huaja Direkte deri në shtator 2024 arritën vlerën e 657.3 milionë eurove.

Sa i përket sektorit financiar, ai ka thënë se u rikonfirmua se sistemi financiar në vend është i qëndrueshëm, stabil, likuid dhe mirë i kapitalizuar, me cilësi të lartë të aseteve, është avancim në gjithëpërfshirjen dhe qasjen financiare të qytetarëve.

Ai ka thënë se me masat e ndërmarra nga BQK-ja, të njohura pozitivisht edhe nga vlerësimet ndërkombëtare për vendin në proceset integruese, është rritur dukshëm integriteti i sektorit financiar dhe rregulluar furnizimi me para i ekonomisë, është luftuar dukuria e parave të falsifikuara, është avancuar edukimi financiar, si dhe janë ndërmarrë veprime në aspekt të zbatimit të ligjshmërisë në sektorin financiar sipas legjislacionit përkatës. "Progres i theksuar është shënuar në avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative të BQK-së, ndërsa po vazhdojnë reformat e nisura në avancimin e mbikëqyrjes financiare në banka, sigurime, institucione financiare jobankare, fonde pensionale, si dhe sistemin e pagesave. Vendime të rëndësishme janë ndërmarrë në këto drejtime, derisa partneriteti ndërkombëtar përmes asistencave të nevojshme teknike po mbështet fuqimisht këto reforma. Fillimi i zbatimit të shtesave të kapitalit si instrumente makroprudenciale në njërën anë, krahas rritjes substanciale të kontributit të bankave në Fondin e Sigurimit të Depozitave, e përcjellë me reformën e nisur në legjislacionin përkatës, do të ketë ndikim pozitiv si në rritjen e bazës së depozitarëve, po ashtu edhe të kreditimit dhe shërbimeve të tjera të ndërlidhura", ka pohuar ai. Sipas guvernatorit Ismaili,



kreditimi është rritur në mënyrë të kënaqshme, duke e mbështetur ekonominë, ndërsa pritet që sektori ta rrisë edhe më tej konkurrueshmësinë dhe të ofrojë sa më shume produkte adekuate për kontekstin lokal të sektorit financiar të vendit.

Ndërkaq thotë se legjislacioni i ri pritet të ndikojë pozitivisht në këtë drejtim, bashkë me fuqizimin e sektorit financiar. "Treguesi i kredive joperformuese (NPL) vazhdon të mbetet i ulët prej 2 % sipas të dhënave të muajit nëntor 2024, përkatësisht 2.4 për qind për sektorin e ndërmarrjeve dhe 1.5 për qind për ekonominë familjare. Për sa i përket performacës së sektorit financiar, numri i llogarive ka arritur në 2.5 milionë prej të cilave mbi 1 milion kanë qasje në shërbimet e e-bankingut. Numri i transaksioneve në POS brenda një viti është rritur me 39 %, ndërsa numri i transaksioneve në

ATM deri në fund të muajit nëntor 2024 është rritur vetëm 4 %. Vlen të theksohet se si rezultat i zbatimit të plotë të Llogarisë së Pagesës me Shërbime Bazike, deri më tani janë konvertuar rreth 390 mijë llogari si të tilla, duke ndikuar drejtpërdrejt në koston e transaksioneve bankare të qytetarëve tanë", është shprehur guvernatori i BQK-së.

Në prezantim të reformave të brendshme organizative, ai theksoi se është rishikuar struktura organizative, duke u fokusuar në objektivat dhe planin strategjik, i cili potencoi se "është funksionalizuar Bordi Ekzekutiv, është forcuar qeverisja korporatave dhe janë funksionalizuar të gjitha strukturat e nevojshme të BQK-së, siç është konfirmuar edhe nga raportet ndërkombëtare".

Në kuadër të avokimit dhe ndërkombëtarizimit të BQK-së dhe sektorit financiar,

guvernatori Ismaili tregoi se janë zhvilluar dhjetëra vizita me institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe takime me përfaqësuesit ndërkombëtare, që veprojnë në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, ai bëri me dije se BQK-ja gjatë këtij viti ka përmbyllur para-aplikimin për Zonën Unike të Pagesave në euro e njohur si SEPA te Komisioni Evropian. "Menjëherë pas miratimit të tri ligjeve të rëndësishme për sektorin financiar, si: Ligji për Bankat, Ligji për Shërbimet e Pagesave dhe plotësim/ ndryshimet e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Bordi i BQK-së miratoi njëzet rregulloret përkatëse të cilat ishin të nevojshme për aplikim dhe të cilat hyjnë në fuqi pas hyrjes në fuqi të ligjeve respektive", thotë ai. Duke folur për projektet dhe aktivitetet strategjike që lidhen me

gjithë përfshirjen financiare të qytetarëve, guvernatori Ismaili ka treguar se janë bërë përmirësime në pjesën e mbrojtjes së konsumatorit, ku është krijuar departamenti i ri, me qëllim të shqyrtimit të praktikave të tregut. Më tutje, ai ka potencuar se është avancuar dhe rritur numri i publikimeve në kanalet e komunikimit të BQK-së, duke përfshirë publikime të rregullta të ngjarjeve, zhvillimeve dhe infografikave që janë të interesit për publikun.

Po ashtu, guvernatori Ismaili ka treguar se tashmë është funksionalizuar dhe po lansohet Platforma për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare në kuadër të edukimit financiar, zhvilluar për t'u përdorur nga konsumatorët për informimin dhe krahasimin e tarifave të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga institucionet financiare.





# NGJARJET KRYESORE NË BOTË QË SHËNUAN VITIN 2024

PRISHTINË, DHJETOR / JANAR - Rrëzimi i Assadit nga pushteti, lufta në Ukrainë, lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit, zgjedhja e Trumpit president i ShBA-së, rënia e qeverisë së Scholzit, mërimi i kryeministrit të ri të Francës, sulmi terrorist në tregun e Krishtlindjes në Gjermani, mbyrtja e 10 mijë emigrantëve, rizgjedhja e Putinit për mandatin e 5-të president i Rusisë, fletarrestimi i lëshuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për Netanyahu dhe zyrtarët e Hamasit, zgjedhja e Mark Ruttes në krye të NATO-s, përmbajtjet masive në Evropën Qendrore, ishin disa nga ngjarjet më të rëndësishme që e karakterizuan vitin 2024

## Rrëzohet avioni në Kazakistan, 38 të vdekur

Një avion udhëtarësh Embraer që fluturonte nga Azerbajxhani për në Rusi u rrëzua më 25 dhjetor pranë qytetit Aktau në Kazakistan. Në avion ishin 62 udhëtarë dhe 5 anëtarë të ekuipazhit në bord, kanë njoftuar autoritetet kazake. Të paktën 29 persona i mbijetuan aksidentit dhe më shumë se 38 prej tyre kanë vdekur.

## Mbi 10 000 imigrantë u mbytën këtë vit në tentim për të shkuar në Spanjë

Më shumë se 10 000 imigrantë humbën jetën në përpjekje për të mbërritur në Spanjë përmes detit, sipas një raporti të publikuar nga një grup spanjoll për të drejtat e imigrantëve. Kjo shifër nënkupton se 30 imigrantë kanë vdekur mesatarisht çdo ditë në vitin 2024 në tentim për të shkuar në Spanjë përmes anijeve, ka njoftuar grupi Caminando Fronteras. Numri i të vdekurve u rrit për 58 për qind krahasuar me vitin e kaluar, thuhet në raport.

## Disa të vdekur dhe 200 të plagosur nga sulmi në tregun e Krishtlindjes në Gjermani

Autoritetet gjermane kanë ngritur aktakuzë për vrasje dhe tentim-vrasje ndaj të dyshuarit për sulmin vdekjeprurës në tregun e Krishtlindjes në qytetin Magdeburg, ku u vranë pesë qytetarë dhe u plagosën 200 të tjerë. Ende nuk dihet qartë motivi i sulmuesit në Magdeburg për sulmin

vdekjeprurës në tregun e Krishtlindjeve. Dihet vetëm që ai është shtetas saudit dhe ndodhet në paraburgim. Por që pas sulmit, skena e ekstremit të djathtë në Gjermani ka nisur të përhapë gjuhë urrejtjeje ndaj migrantëve.

## Rrëzohet Assadi nga pushteti

Rebelët sirianë kanë rrëzuar nga pushteti presidentin Bashar al-Assad pasi morën kontrollin e Damaskut, duke e detyruar atë të ikte dhe duke i dhënë fund sundimit autokratik të familjes së tij pas më shumë se 14 vitesh luftë civile. Rebelët i dhanë gjithashtu një goditje të madhe ndikimit të Rusisë dhe Iranit në Siri në zemër të rajonit - aleatë që kishin mbështetur al-Assadin gjatë periudhave kritike të konfliktit. Fuqitë botërore janë zotuar se do të punojnë për stabilitet në Siri dhe rajonin përreth.

## E djathta ekstreme në Evropë, me rritje në 2024-n

Mbështetja për partitë e ekstremit të djathtë në Evropë vazhdoi të rritej në vitin 2024.

Analistët thonë se kjo prirje u nxit nga shqetësimet për imigracionin, inflacionin dhe luftën në Ukrainë. Zgjedhjet parlamentare të Bashkimit Evropian në qershor rezultuan me një rritje të mbështetjes për partitë e ekstremit të djathtë në disa shtete anëtare, megjithëse partitë e qendrës vazhdojnë ta mbajnë pushtetin në institucionet e BE-së në Bruksel.

## Gjykata e Francës mban në fuqi dënimin e Sarkozyt për korrupsion

Gjykata Supreme e Francës ka mbajtur në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit, e cila e kishte shpallur ish-presidentin francez Nicolas Sarkozy, fajtor për korrupsion dhe ushtrim të ndikimit derisa ishte lider i vendit. Sarkozy, 69 vjeç, përballet me burgim, megjithatë ai pritet t'i kërkojë gjykatës ta lajë dënimin në shtëpi duke e mbajtur një byzylyk elektrik në dorë. Ai u shpall fajtor për korrupsion dhe ushtrim të ndikimit nga gjykata e Parisit më 2021 dhe nga Gjykata e Apelit më 2023 për përpjekje për t'i dhënë rryshfet një gjykatësi në këmbim të informatave për një rast ligjor në të cilin ishte përfshirë.

## Scholzi e humbet votëbesimin, hapet rruga për zgjedhje të reja në Gjermani

Kancelari i Gjermanisë, Olaf Scholz, e ka humbur votëbesimin në parlamentin e vendit, me çfarë i ka hapur vendit rrugën për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në fund të shkurtit. Scholzi e fitoi besimin e 207 ligjvënësve në Bundestag, por 394 të tjerë votuan kundër tij, ndërsa 116 abstenuan. Atij i nevojitej një shumicë prej 367 votash për ta fituar votëbesimin. Scholzi udhëheq një qeveri pakicë, pasi koalicioni i tij qeverisës trepartiak dështoi më 6 nëntor për shkak të mosmarrëveshjeve për mënyrën se si ta ringjallin ekonominë e ngecur të vendit.

## Macroni emëron François Bayroun kryeministër të ri të Francës

Presidenti francez Emmanuel Macron ka emëruar politikanin e qendrës, François Bayroun, kryeministër të ri, vetëm një javë pas rënies së qeverisë paraprake. Opozita e ka rrëzuar qeverinë e ish-



kryeministrit konservator Michel Barnier për shkak të mospajtimeve për buxhetin, ndonëse ka qenë vetëm tre muaj në zyrë. Franca është në ngërç politik pasi zgjedhjet e mbajtura në qershor dhe korrik nuk kanë prodhuar ndonjë rezultat të qartë.

### Bullgaria dhe Rumania bëhen anëtare të plota të zonës Schengen

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian ua kanë hapur rrugën Bullgarisë dhe Rumanisë për t'u bërë anëtare të plota të zonës për lëvizje të lirë Schengen, prej fillimit të vitit tjetër. Bullgaria dhe Rumania, të dyja vende anëtare të BE-së prej vitit 2007, kanë qenë pjesërisht të integruara në zonën për lëvizje të lirë, prej muajit mars, pasi u është mundësuar vetëm trafiku ajror dhe detar, pa kontrolle kufitare.

### 54 gazetarë të vrarë më 2024

Këtë vit janë vrarë 54 gazetarë në botë, teksa kanë qenë duke kryer punën e tyre, apo për shkak të profesionit, është thënë në raportin vjetor të organizatës ndërkombëtare, Reporterët pa Kufij. Sipas organizatës, ushtria izraelite është përgjegjëse për vdekjet e 18 gazetarëve këtë vit - 16 në Gazë dhe dy në Liban. Sipas raportit, territori palestinez është më i rrezikshmi për gazetarët, pasi atje është regjistruar shifra më e lartë e gazetarëve të vrarë në pesë vjetët e fundit.

### 43 mijë ushtarë ukrainas janë vrarë në luftë

Rreth 43 000 ushtarë ukrainas janë vrarë prej nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, në një deklaram të rrallë për numrin e viktimave. Në një postim në rrjetet sociale, presidenti ukrainas ka thënë se janë raportuar 370 000 persona të plagosur, ndonëse në këtë shifër ai ka thënë se përfshihen edhe ushtarët që janë plagosur më shumë se një herë. Ai ka pretenduar se si pasojë e luftës janë vrarë 198 000 ushtarë rusë dhe janë plagosur 550 000 të tjerë.

### GjNP-ja lëshon fletarrestime për Netanyahu dhe zyrtarët e Hamasit

Gjykata Ndërkombëtare Penale (GjNP) ka lëshuar fletarrestime për kryeministrin e Izraelit, Benjamin



## Trumpi fiton zgjedhjet në ShBA

Donald Trumpi ka siguruar 270 votat e nevojshme të Kolegjit Zgjedhor për të fituar zgjedhjet presidenciale të ShBA-së, duke mposhtur Kamala Harrisin. Me një fitore

në Uiskonsin, Trump, ish-presidenti dhe kandidati i Partisë Republikane, kaloi 270 votat e nevojshme për ta siguruar fitoren në garën presidenciale kundër Harrisit,

aktualisht zëvendëspresidente e Shteteve të Bashkuara dhe kandidate e Partisë Demokratike. Trumpi merr detyrën e presidentit më 20 janar.

Netanyahu, ish-ministrin e tij të Mbrojtjes, si dhe për zyrtarët e Hamasit, duke i akuzuar ata për krime lufte dhe për krime kundër njerëzimit për luftën në Rripin e Gazës, dhe për sulmet e tetorit 2023 në Izrael. Netanyahu e dënoi fletarrestimin e lëshuar ndaj tij, duke thënë se Izraeli "kundërshton me neveri veprimet absurde dhe të rreme". Në deklaratën e lëshuar nga zyra e tij, ai tha se "nuk ka asgjë më të drejtë sesa lufta që Izraeli po kryen në Gazë".

### Zvicra ndalon mbulimin e fytyrës në hapësira publike nga janari

Një vendim kontrovers i Zvicrës për ndalimin e mbulimit të fytyrës në hapësira publike, i njohur gjerësisht si "ndalimi i burkave", do të hyjë në fuqi më 1 janar të 2025-s. Ky ndalim, që kaloi me një dallim të vogël votash në një referendum të vitit 2021 dhe që u dënua nga shoqatat myslimane, u iniciua nga i njëjti grup që organizoi ndalimin e minareve të reja në vitin 2009.

Këshilli Federal qeverisës tha në një deklaratë se ka vendosur datën e fillimit të ndalimit dhe se kushdo që do ta shkelë atë pa të drejtë do të

përballet me një gjobë deri në 1 000 franga zvicerane.

### Mbi 43 000 palestinezë të vrarë në luftën njëvjeçare në Gazë

Më shumë se 43 000 palestinezë, mbi gjysma gra dhe fëmijë, janë vrarë deri tani në luftën njëvjeçare në Rripin e Gazës, ka njoftuar Ministria palestineze e Shëndetësisë. Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit filloi pasi militantët e Hamasit i thyen pengesat kufitare në jug të Izraelit dhe u futën vrullshëm matanë kufirit, duke i vrarë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe duke i rrëmbyer 250 të tjerë.

### Fethullah Gulen, rival i Erdoganit, vdes në ShBA

Kleriku turk Fethullah Gulen ka vdekur në moshën 83-vjeçare në Shtetet e Bashkuara. Gulen, dikur aleat i presidentit turk Recep Tayyip Erdogan, ishte akuzuar për orkestrimin e grusht-shtetit të dështuar në Turqi më 2016. Grusht-shteti i dështuar kundër Erdoganit dhe qeverisë së tij ishte një pikë kthese për shtetin. Afër 250 persona u vranë, kur ushtarët e rebeluar rrëmbyen avionë, tanke dhe pajisje të

tjera të rënda ushtarake, teksa tentuan ta rrëzonin presidentin nga pushteti.

### Stoltenbergu emërohet shef i Konferencës së Munihut për Siguri

Jens Stoltenberg, deri më tani sekretar i përgjithshëm i NATO-s, është emëruar zyrtarisht kreu i ri i Konferencës së Munihut për Siguri, njëri prej platformave për të rëndësishme ndërkombëtare për politika të sigurisë. Ai pritet të marrë këtë pozitë zyrtarisht pas konferencës së radhës që do të mbahet në shkurt të vitit 2025. Aktualisht shef i organizatës është Christoph Heusgen.

### Mark Rutte zgjidhet në krye të NATO-s

32 vendet anëtare të aleancës së NATO-s në muajin qershor zgjodhën kryeministrin holandez Mark Rutte në krye të organizatës më të madhe të sigurisë në botë, në një kohë kritike për sigurinë evropiane ndërsa vazhdon agresioni rus në Ukrainë. Marrja e detyrës së sekretarit të përgjithshëm nga Rutte ndodhi në një çast historik për aleancën, teksa pushtimi rus i Ukrainës po i afrohet ditës 1 000.

### Izraeli vret udhëheqësin e grupit militant Hezbollah, Hassan Nasrallah

Udhëheqësi i grupit militant Hezbollah, Hassan Nasrallah, u vra në një sulm ajror izraelit në Bejrut të premten. Ushtria izraelite tha se disa komandantë të lartë të Hezbollahit u vranë së bashku me Hassan Nasrallahun në një sulm të fuqishëm ajror. Nasrallah ka udhëhequr grupin militant libanez në tri dekadat e fundit dhe e ka transformuar atë në një nga grupet paraushtarake më të fuqishme në Lindjen e Mesme.

### Bideni infektohet me koronavirus

Presidenti amerikan Joe Biden është infektuar me koronavirus dhe ka simptoma të lehta, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë më 17 korrik. Zëdhënësja e tij për medie, Karine Jean-Pierre, ka thënë se presidenti amerikan është i vaksinuar dhe ka dozë përforcuese kundër virusit që shkakton sëmundjen Covid-19. Bideni është infektuar edhe dy herë të tjera me këtë koronavirus në të kaluarën.

### Shirat e rrëmbyer dhe përmbytjet shkaktojnë viktima dhe evakuime masive në Evropën Qendrore

Numri i të vdekurve nga përmbytjet në Evropën Qendrore u rrit dhe mijëra vetë u evakuuan në Republikën Çeke pasi shirat e rrëmbyer vazhduan, duke shkakuar përmbytje në disa pjesë të rajonit. Një person u mbyt në Poloninë jugperëndimore, një zjarrfikës humbi jetën në Austri dhe dy persona të tjerë humbën jetën në Rumani, ku përmbytjet morën jetën e katër personave të shtunën. Vetëm në Çeki janë evakuuar mbi 10 000 veta.

### Gjermania forcon masat e sigurisë dhe politikat për azil

Koalicioni qeverisës në Gjermani ra dakord t'i forcojë masat për sigurinë si dhe politikat për dhënien e azilit pas një sulmi vdekjeprurës të lidhur me grupin militant Shteti Islamik që ka ndezur edhe më shumë kundërshtitë e së djathtës së skajshme dhe kritikant ndaj autoriteteve berlineze rreth qasjes së tyre mbi politikat e emigracionit. Tre persona u vranë dhe tetë të tjerë u plagosën në sulmin me thikë gjatë një festivali që shënonte 650-vjetorin e qytetit



të Solingenit. Ngjarja ka shtuar mosmarrëveshjet politike mbi rregullat e azilit dhe debimit në prag të zgjedhjeve vendore.

### Brazil, rrëzohet avioni me 62 individë në bord

Një avion me 62 pasagjerë në bord u rrëzua më 9 gusht në një zonë banimi në afërsi të Sao Paulo, në Brazil. Të gjithë udhëtarët në avion humbën jetën, thanë autoritetet vendase pranë vendit të ngjarjes. Një video-regjistrim i postuar në rrjetet sociale tregoi pamjet e avionit, të prodhimit 'ATR', ndërsa humb kontrollin dhe bie në afërsi të disa shtëpive. Sasi të madhe tymi u ngritën pas rrëzimit të tij.

### Bideni tërhiqet nga gara presidenciale, mbështet nënpresidenten Harris kandidate

Presidenti i Shteteve të Bashkuara Joe Biden u tërhoq të dielën nga gara presidenciale. Ai njoftoi për vendimin pas thirrjeve të shumta në partinë e tij për të dalë nga gara pasi kishin humbur besimin tek aftësia e tij për të fituar ndaj rivalit republikan Donald Trump.

### Von der Leyen rizgjidhet në krye të Komisionit Evropian

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, është zgjedhur edhe për një mandat në krye të këtij institucioni. Për t'i dhënë edhe një mandat pesëvjeçar von der Leyen votuan 401 eurodeputetë. Asaj i duheshin 360 vota nga 719 deputetë në Parlamentin Evropian. Ky institucion ka 720 ligjvënës, por një eurodeputet katalanas ende nuk ka marrë mandatin.

### Atentat ndaj ish-presidentit Trump

I riu Thomas Matthew Crooks shkoi në vendin ku do të mbahej tubimi elektoral i ish-presidentit Donald Trump, me një çantë të madhe shpine dhe një pajisje për ta matur distancën nga çatia pas skenës ku ish-presidenti do të fliste brenda një ore. Aty ai hapi zjarr, gjashtë minuta pasi Trumpi filloi të fliste, në një përpjekje për ta vrarë kandidatin republikan për president. Sulmuesi vrau një pjesëmarrës në tubim dhe plagosi rëndë dy të tjerë. Trumpi u plagos lehtë në vesh dhe u shfaq vetëm disa ditë më vonë në Kuvendin Kombëtar të Partisë Republikane në Miluoki me një fashë në veshin e dëmtuar. Sulmi u dënua nga



shumë udhëheqës gjithandej botës të cilët thanë se dhuna politike është e papranueshme.

### Sulmohet me të shtëna kryeministri sllovak Robert Fico

Një sulmues i armatosur plagosi kryeministrin e Sllovakisë, Robert Fico. Kabineti i Ficos konfirmoi plagosjen dhe tha se jeta e tij është në rrezik, mirëpo pas disa ditësh trajtimi në spital, ai mori vetën dhe nisi punën si kryeministër. Atentatori u arrestua në vendngjarje. Motivet e atentatit ende nuk janë bërë të ditura. Fico rimori detyrën e kryeministrit në tetor 2023 dhe ka qenë kryeministër i Sllovakisë edhe në vitet 2006 deri më 2010 dhe 2012 deri më 2018. Në vitin 2018 atij iu desh të japë dorëheqje pas vrasjes së gazetarit Jan Kuciak dhe të fejuarës së tij. Kuciak pati hulumtuar për lidhjet mes mafies italiane dhe partisë së Ficos në pushtet.

### Putini fillon mandatin e pestë të presidentit

Vladimir Putini ka filluar mandatin e pestë si udhëheqës i Rusisë me një ceremoni pompoze në Kremlin. Ai nisi një mandat tjetër gjashtëvjeçar, pasi eliminoi kundërshtarët e tij politikë, filloi luftën shkatërrimtare në Ukrainë dhe përqendroi të gjithë pushtetin në duart e tij. Në ceremoninë brenda Pallatit të Madh të Kremlin, Putini vuri dorën mbi kushtetutën ruse dhe u zotua ta mbrojë atë, ndërsa vështrohej nga të pranishmit e përzgjedhur.

### NATO-ja shënoi 75-vjetorin mes sfidave të sigurisë

NATO-ja këtë vit që lamë pas shënoi 75-vjetorin e themelimit me premtimin e kryediplomatëve të vendeve të saj se do të qëndrojnë në krah të Ukrainës, por lufta po e vë në provë unitetin dhe vendosmërinë e aleancës. Traktati i themelimit të saj u nënshkrua më 4 prill të vitit 1949.

### Anija hapësinore private hyn në orbitën e Hënës

Një anije hapësinore private amerikane hyri në orbitë përreth Hënës të mërkurën, një ditë përpara se të tentojë një sipërmarrje edhe më të vështirë - uljen në sipërfaqen e Hënës. Një ulje e suksesshme do ta rikthente praninë amerikane në Hënë për herë të parë që kur astronautët e NASA-s i dhanë fund programit Apollo në vitin 1972. Nëse del me sukses, kjo kompani do të bëhej entiteti i parë privat që do të realizonte një ulje të suksesshme në Hënë.

### Gjykata vendos kundër ish-presidentit Trump gjobë prej 355 milionë dollarësh

Në muajin shkurt një gjykatës në Nju-Jork vendosi të premtën kundër ish-presidentit Donald Trump, duke e gjobitur me 355 milionë dollarë për atë që gjykatësi e quajti një skemë shumëvjeçare për t'i mashtruar bankat dhe të tjerë, nëpërmjet deklaratave

financiare që frynë artificialisht vlerën e pasurisë së ish-presidentit. Gjykata, gjithashtu, ia ndaloi ish-presidentit të ushtrojë aktivitetet biznesi në Nju-Jork për tre vjet.

### Vdes Alexei Navalny, armiku më i ashpër politik i presidentit rus Putin

Shërbimi rus i burgjeve tha se udhëheqësi i burgosur i opozitës ruse Alexei Navalny vdiq më 16 shkurt në rajonin Yamalo-Nenets. Pas këtij njoftimi, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, fajësoi presidentin rus Vladimir Putin për vdekjen e Navalnyt, duke thënë se "nuk ishte i befasuar", por se ishte "i revoltuar" nga vdekja e udhëheqësit opozitar rus. Ai u arrestua në janar të vitit 2021 pasi u kthye në Moskë nga Gjermania ku po kurohej pas helmimit me agjent nervor, për të cilin fajësoi Kremlinin. Ndërsa po vuante një dënim prej nëntë vitesh heqje lirie, në gusht të vitit të kaluar u dënua me 19 vjet burg nën akuzat për ekstremizëm.

### Senati miraton 95.3 miliardë dollarë ndihma për Ukrainën, Izraelin dhe Tajvanin

Senati amerikan ka miratuar në shkurt një paketë ndihme prej 95.3 miliardë dollarësh për Ukrainën, Izraelin dhe Tajvanin, pas muajsh negociatash të vështira dhe mes ndasive politike në rritje në Partinë Republikane mbi rolin e Shteteve të Bashkuara në arenën ndërkombëtare. Ligjvënësit e miratuan paketën

me 70 vota për dhe 29 kundër, duke tejkaluar pragun e 60 votave të nevojshme. Tani projekt-ligji shkon në Dhomën e Përfaqësuesve.

### Parlamenti turk miraton anëtarësimin e Suedisë në NATO

Deputetët turq kanë ratifikuar kërkesën e Suedisë për anëtarësim në NATO, duke e bërë edhe më të afërt hyrjen e këtij vendi në aleancë. Suedia, bashkë me Finlandën, u kanë dhënë fund disa dekadave neutralitetit më 2022, dhe kanë vendosur t'i bashkohen NATO-s, pas nisjes së luftës së Rusisë në Ukrainë. Teksa Finlanda është pranuar, Suedisë i është penguar rruga nga Turqia, e ka pasur disa mospajtime me Suedinë lidhur me atë që e ka konsideruar përkrahje të Stokholmit për separatistët kurdë, duke përmendur pjesëtarë të Partisë Popullore të Kurdistanit (PKK). Turqia, bashkë me Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian, e konsiderojnë PKK-në organizatë terroriste.


### NATO fillon stërvitjen më të madhe ushtarake prej dekadash

NATO filloi të mërkurën stërvitjen më të madhe ushtarake që nga periudha e Luftës së Ftohtë dhe një luftanije amerikane u largua nga Shtetet e Bashkuara për të kaluar përmes Atlantikut drejt territorit të aleancës në Evropë. Aleanca ushtarake perëndimore ka thënë se rreth 90 mijë forca do të marrin pjesë në stërvitjen disamujore të quajtur "Steadfast Defender 2024" ("Mbrotjtësi i Vendosur 2024"). Operacioni stërvitor ka për qëllim të vërë në provë mbrojtjen e NATO-s, ndërkohë që vazhdon lufta e Rusisë në Ukrainë.

### Mbreti Charles diagnostikohet me kancer

Mbreti i Mbretërisë së Bashkuar, Charles III, është diagnostikuar me një formë të kancerit dhe ka nisur trajtimin, njoftoi Pallati Bakingam më 5 shkurt. Më pak se 18 muaj në mbretërimin e tij, Mbreti Charles do t'i pezullojë detyrat publike, por do të vazhdojë të merret me çështje shtetërore dhe nuk do të heqë dorë nga rolet e tij kushtetuese si kreu i shtetit, pati njoftuar Pallati. Sipas njoftimit, diagnostikimi me kancer nuk është i lidhur me trajtimin për probleme me prostatë që Charles iu nënshtrua së fundmi. Pallati nuk njoftoi se nga çfarë forme e kancerit është prekur monarku 75-vjeçar.

(Përgatiti: Mal QORRA)



GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ

# DO TË DOJA QË LIBRAT E MI TË BOTOHESHIN PAS VDEKJES

Intervistë për *Paris Review*

**Peter Stone:** Si ndiheni që po përdorim magnetofon për intervistën?

GABRIEL GARCIA MARQUEZ: Problemi është se në çastin që e di se intervista është duke u regjistruar, sjellja jote ndryshon. Në rastin tim vihem menjëherë në pozitë mbrojtëse. Si gazetar mendoj se ende nuk kemi mësuar si ta përdorim magnetofonin për të bërë një intervistë. Mendoj se mënyra më e mirë është të bësh një bisedë të gjatë pa mbajtur asnjë shënim. Më pas, gazetari duhet ta kujtojë bisedën dhe ta shkruajë si një përshtypje të asaj që ndjeu, duke mos përdorur domosdoshmërisht fjalët e sakta të thëna. Një metodë tjetër e dobishme është të mbash shënime dhe më pas t'i interpretosh deri diku me besnikëri ndaj personit të intervistuar. Ajo që të shqetëson në lidhje me regjistrimin e gjithçkaje është se nuk tregohesh besnik ndaj personit që

intervistohet, sepse e regjistron edhe kur flet kot. Kjo është arsyeja pse kur ka një magnetofon jam i vetëdijshëm se jam duke u intervistuar, kur nuk ka magnetofon, flas në mënyrë të pavetëdijshme dhe krejtësisht të natyrshme.

*Meqenëse filluam të flasim për gazetarinë, si ndiheni të jeni sërish gazetar, pasi keni shkruar romane për kaq shumë kohë? A e bëni atë me një ndjesi tjetër apo e shihni me një sy tjetër?*

Gjithmonë kam qenë i bindur se profesioni im i vërtetë është ai i gazetarit. Ajo që nuk më pëlqente më parë në gazetari ishin kushtet e punës. Veç kësaj, mendimet dhe idetë e mia duhej të kushtëzoheshin nga interesat e gazetës. Tani, pasi kam punuar si romancier dhe kam arritur pavarësinë financiare si romancier, mund t'i zgjedh temat që më interesojnë dhe që përkojnë në çdo rast me idetë e mia.

Gjithmonë më pëlqen shumë ta shfrytëzoh rastin për të shkruar një shkrim të shkëlqyer gazetaresk.

*A kanë gazetari dhe romancierit përgjegjësi të ndryshme për gjetjen e ekuilibrit mes të vërtetës dhe imagjinatës?*

Në gazetari vetëm një fakt që është i trilluar bën të paragjykohet e gjithë vepra. Krejt e kundërta, në letërsi një fakt i vetëm që është i vërtetë i jep legjitimitet të gjithë veprës. Ky është i vetmi ndryshim dhe ka të bëjë në angazhimin e shkrimtarit. Një romancier mund të bëjë gjithçka që dëshiron për sa kohë arrin t'i bëjë njerëzit ta besojnë.

*Si filluat të shkruanit?*

Duke vizatuar. Duke vizatuar karikatura. Para se të lexoja apo shkruaja, bëja vizatime komike në shkollë dhe në shtëpi. Është për të qeshur tani që e kuptoj se kur isha në shkollën e mesme më shihnin si shkrimtar megjithëse, në fakt,

nuk kisha shkruar kurrë asgjë. Nëse duhej shkruar një pamflet, letër ose peticion, isha unë ai që do ta bëja sepse mendohej se unë isha shkrimtari. Kur u futa në kolegji, kisha një formim letrar shumë të mirë në përgjithësi, dukshëm mbi mesataren e miqve të mi. Te universiteti në Bogotá fillova të bëj miq të rinj, të cilët më njohën me shkrimtarët bashkëkohorë. Një natë një mik më dha hua një libër me tregime të Franc Kafkës. U ktheva në pensionin ku rrija dhe fillova ta lexoja *Metamorfozën*. U habita aq shumë pasi lexova rreshtin e parë sa gati rashë nga shtrati. Rreshti i parë është: "Kur një mëngjes Gregor Zamza u zgjua pas ëndërrash të trazuara, vuri re në shtrat se ishte shndërruar në një kandërr të përbindshme". Kur e lexova rreshtin, mendova me vete se nuk e dija se lejohesh të shkruaje gjëra të tilla, nëse do ta dija, do të kisha filluar të shkruaja shumë kohë më parë. Kështu që

shkrova menjëherë tregime. Janë tregime tërësisht intelektuale, sepse i shkruaja mbështetur në përvojën time letrare dhe nuk e kisha gjetur ende lidhjen në mes të letërsisë dhe jetës. Tregimet u botuan në shtojcën letrare të gazetës *El Espectador* në Bogotá dhe patën njëfarë sukcesi asokohe - ndoshta sepse askush në Kolumbi nuk shkruante tregime intelektuale. Ajo që shkruhej atëherë ishte më së shumti për jetën në fshat dhe jetën shoqërore. Kur shkrova tregimet e mia të para, më thanë se kishin ndikime xhojsiane.

*E kishit lexuar Xhojsin në atë kohë?*

Nuk e kisha lexuar kurrë Xhojsin, kështu që fillova ta lexoja *Uliksin*. Lexova të vetmin botim spanjoll që ekzistonte. Që atëherë, pasi lexova *Uliksin* në anglisht si dhe një përkthim shumë të mirë në frëngjisht, mund të kuptoja se përkthimi original spanjisht ishte



shumë i dobët, por mësova diçka që do të ishte shumë e dobishme për mua në të ardhmen duke mësuar teknikën e monologut të brendshëm. Më vonë e gjeta te Virxhinia Vulfi dhe më pëlqen mënyra se si ajo e përdor më mirë se Xhojsi. Edhe pse më vonë kuptova se personi që shpiku këtë lloj monologu të brendshëm ishte shkrimtari anonim i *Lazarillo de Tormes*.

*A mund të na thoni disa nga ndikimet tuaja të hershme letrare?*

Njerëzit që më ndihmuan për ta hequr qafe qëndrimin tim intelektual ndaj tregimit ishin shkrimtarët amerikanë të Brezitet të Humbur. Kuptova se letërsia e tyre kishte një marrëdhënie me jetën që tregimet e mia nuk e kishin. Dhe më pas ndodhi një ngjarje e cila ishte shumë e rëndësishme në lidhje me këtë qëndrim. Ndodhi në Bogotazo, më 9 prill 1948, kur një udhëheqës politik, Jorge Eliécer Gaitáni, u qëllua dhe njerëzit e Bogotás u dyndën në rrugë. Isha në pension gati për të ngrënë drekë kur mora vesh lajmin. Vrapova drejt vendit, por Gaitáni sapo ishte futur në një taksì dhe po dërgohej në një spital. Rrugës për në pension, pashë njerëzit që tashmë kishin dalë në rrugë dhe po bënin demonstratë, po plaçkitnin dyqane dhe dignin ndërtesa. Iu bashkova atyre. Atë pasdite dhe atë mbrëmje u bëra i vetëdijshëm për llojin e vendit ku jetoja dhe sa pak lidhje kishin tregimet e mia me të. Kur më vonë u detyrova të kthehesha në Barranquilla në Karaibe, ku kisha kaluar fëmijërinë time, kuptova se ky ishte lloji i jetës që kisha jetuar, jeta që njihja dhe për të cilin doja të shkruaja.

Rreth viteve 1950-'51 ndodhi një ngjarje tjetër që ndikoi në prirjet e mia letrare. Nëna më kërkoi ta shoqëroja për në Aracataca, ku

kisha lindur dhe ta shisja shtëpinë ku kalova vitet e para të jetës. Kur mbërrita, në fillim ishte mjaft tronditëse, sepse tani isha njëzet e dy vjeç dhe nuk kisha qenë atje që tetë vjeç. Asgjë nuk kishte ndryshuar, por ndieja se nuk po shikoja në të vërtetë fshatin, por po e përjetoja sikur po e lexoja. Më dukej sikur gjithçka që pashë tashmë ishte shkruar, dhe gjithçka që duhej të bëja ishte të ulesha dhe të kopjoja atë që ishte atje dhe që po lexoja. Për qëllime praktike, gjithçka ishte kthyer në letërsi, shtëpitë, njerëzit dhe kujtimet. Nuk jam i sigurt nëse e kisha lexuar tashmë Uilljam Folknerin apo jo, por tani e di se vetëm një teknikë si ajo e Folknerit më mundësonte të shkruaja atë që po shihja. Atmosfera, dekadencia, vapa në fshat ishin përafërsisht të njëjta si ajo që kishte ndër Folkneri. Ishte një rajon me plantacion bananesh i banuar nga shumë amerikanë të kompanive të frutave që i dhanë të njëjtën atmosferë që kisha gjetur te shkrimtarët amerikanë të Jugut të thellë. Kritikët kanë folur për ndikimin letrar të Folknerit, por unë e shoh si përkim rastësor: thjesht kisha gjetur lëndë që duhej të shtelloja në të njëjtën mënyrë që Folkneri kishte shtjelluar lëndë të ngjashme. Pas atij udhëtimit në fshat u ktheva për të shkruar *Stuhia e gjetheve*, romanin tim të parë. Ajo që më ndodhi në të vërtetë në atë udhëtim në Aracataca ishte se kuptova se gjithçka që kishte ndodhur në fëmijërinë time kishte një vlerë letrare që vetëm tani po e kuptoja. Që nga çasti që shkrova *Stuhia e gjetheve* doja të bëhesha shkrimtar, askush nuk mund të më ndalonte dhe e vetmja gjë që më mbetej të bëja ishte të bëhesha shkrimtari më i mirë në botë. Kjo ndodhi në vitin 1953, por vetëm në vitin 1967 mora shpërblimet e

para financiare pasi shkrova pesë nga tetë librat e mi.

*A mendoni se është e zakonshme që shkrimtarët e rinj ta mohojnë vlerën e fëmijërisë dhe përvojave të tyre dhe të intelektualizohen siç ndodhi me ju në fillim?*

Jo, procesi zakonisht ndodh anasjelltas, por nëse do të më duhej t'i jepja një shkrimtari të ri ndonjë këshillë, do t'i thosha të shkruaj për diçka që i ka ndodhur, është gjithmonë e lehtë të dallosh nëse një shkrimtar po shkruan për diçka që i ka ndodhur ose për diçka që ka lexuar ose i është thënë. Pablo Neruda ka një varg në një poezi që thotë: "Zot më ndihmo të mos shpik kur këndo". Gjithmonë më argëton ideja që lavdërimi më i madh për veprën time është për imagjinatën, ndërsa e vërteta është se nuk ka asnjë rresht në të gjithë veprën time që të mos jetë mbështetur në realitet. Problemi është se realiteti i Karaibeve i ngjan imagjinatës më të egër.

*Për kë po shkruanit atëherë? Kush ju lexonte?*

*Stuhia e gjetheve* u shkrua për miqtë që më ndihmonin, më jepnin hua libra dhe ishin shumë entuziastë për veprën time. Në përgjithësi, mendoj se zakonisht shkruhet për dikë. Kur shkruaj, jam gjithmonë i vetëdijshëm se këtij shoku do t'i pëlqejë kjo, ose se një shok tjetër do të pëlqejë atë paragraf ose kapitull, mendoj gjithmonë për njerëz të veçantë. Në fund fare, të gjithë librat shkruhen për miqtë. Problemi pas shkrimit të *Njëqind vjet vetmi* ishte se tani nuk e di më për kë po shkruaj mes atyre miliona

lexuesve, dhe kjo më mërzi dhe më pengon. Është sikur një milion sy po të shikojnë dhe ti në të vërtetë nuk e di se çfarë mendojnë ata.

*Si do ta përshkruanit procesin e kërkimit të një stili që keni kaluar pas shkrimit të 'Stuhia e gjetheve' dhe para se të ishit në gjendje të shkruanit 'Njëqind vjet vetmi'?*

Pasi shkrova *Stuhia e gjetheve* vendosa të shkruaj për fshatin dhe fëmijërinë si një mënyrë arratisjeje nga detyrimi për t'u përballur dhe shkruar për realitetin politik të vendit. Kisha përshtypjen e rreme se po fshihesha pas kësaj lloj nostalgjie në vend që të përballesha me gjërat politike që po ndodhnin. Kjo ishte koha kur u diskutua shumë për marrëdhëniet në mes të letërsisë dhe politikës. Vazhdova të përpiquesha të mbyllja hendekun mes të dyjave. Ndikimi im kishte qenë Folkneri; tani ishte Heminguej. Shkrova *Kolonelit s'ka kush t'i shkruaj, Ora e ligë dhe Varrimi i nënëmardhes*, të cilat janë shkruar të gjitha pak a shumë në të njëjtën kohë dhe kanë shumë gjëra të përbashkëta. Këto histori kanë ngjarje që ndodhin në një fshat të ndryshëm nga ai në të cilin ndodhin te *Stuhia e gjetheve* dhe *Njëqind vjet vetmi*. Është një fshat në të cilin nuk ka magji. Është letërsi publicistike. Por kur mbarova *Ora e ligë* kuptova që të gjitha pikëpamjet e mia ishin sërish të gabuara. Kuptova se, në fakt, shkrimet për fëmijërinë ishin më shumë politike dhe kishin të bënin me realitetin e vendit tim më shumë sesa kisha menduar. Pas *Orës së ligë* nuk shkrova asgjë për pesë vjet. Gjithmonë kisha një ide se çfarë doja të bëja, por diçka mungonte dhe nuk isha i sigurt se çfarë, derisa një ditë zbulova tonin e duhur - tonin që përdora përfundimisht në *Njëqind vjet*


*vetmi*. Ai mbështetej në mënyrën se si gjyshja ime i tregonte historitë e saj. Ajo tregonte gjëra që dukeshin të mbinatyrshe dhe fantastike, por i rrëfente me natyrshmëri të plotë. Kur më në fund zbulova tonin që duhej të përdorja, u ula dhe për tetëmbëdhjetë muaj punova çdo ditë.

*Si e shprehte ajo aq natyrshëm "fantastiken"?*

Më e rëndësishmja ishte shprehja që kishte në fytyrë. Nuk e ndryshonte shprehjen e fytyrës kur tregonte historitë e saj dhe të gjithë ishin të habitur. Në përpjekjet e mëparshme për të shkruar *Njëqind vjet vetmi*, u përpoqa ta tregoja historinë pa besuar në të. Zbulova se ajo që duhej të bëja ishte t'i besoja vetë historitë dhe ta shkruaja me të njëjtën shprehje me të cilën gjyshja ime i tregonte: me fytyrë të njëtrajtshme.

*Duket se ka edhe një cilësi gazetareske në atë teknikë apo ton. Ju përshkruani ngjarje në dukje fantastike me hollësi aq të vogla sa i bën ato reale. A është kjo diçka që e keni marrë nga gazetaria?*

Ky është një truk gazetaresk që mund ta përdorësh edhe në letërsi. Për shembull, nëse thoni se ka elefantë që fluturojnë në qiell, njerëzit s'do t'ju besojnë. Por nëse thoni se ka katërqind e njëzet e pesë elefantë në qiell, njerëzit me siguri do t'ju besojnë. *Njëqind vjet vetmi* është plot me gjëra të tilla. Kjo është pikërisht teknika që përdori gjyshja ime, më kujtohet veçanërisht historia për personazhin që është i rrethuar nga fluturat e verdha. Kur isha shumë i vogël, erdhi një elektrikist në shtëpi. U bëra shumë kureshtar sepse mbante një zile me të cilën zbriste nga shtyllat





elektrike. Gjyshja ime thoshte se sa herë që ky burrë i binte tokës me shkop, mund ta mbushte shtëpinë plot me flutura. Por kur po shkruaja këtë, zbulova se nëse s'do të thosha se fluturat ishin të verdha, njerëzit nuk do ta besonin. Kur po shkruaja episodin e Remedios Bukuroshes që shkon në parajsë, m'u desh shumë kohë për ta bërë të besueshme. Një ditë dola në kopsht dhe pashë një grua që vinte në shtëpi për të larë dhe po i nxirrte çarçafët për t'i tharë, kishte shumë erë. Ajo po fliste me erën që të mos ia hidhte çarçafët në tokë. Zbulova se po t'i përdorja çarçafët Remedios Bukuroshja, do të ngjitej atje. Kështu e bëra, për ta bërë të besueshme. Problemi për çdo shkrimtar është besueshmëria. Çdokush mund të shkruajë për çdo gjë për aq kohë sa është i besueshëm.

*Cila ishte origjina e murtajes së pagjumësisë në "Njëqind vjet vetmi"?*

Duke filluar me Edipin, gjithmonë kam qenë i interesuar për murtajen. Kam studiuar shumë për murtajen e Mesjetës. Një nga librat e mi të parapëlqyer është *Ditari i vitit të murtajes* i Daniel Defoes. Ai është si një gazetar dhe ajo që thotë duket si fantazi e pastër. Për shumë vjet mendoja se Defoe kishte shkruar për murtajen e Londrës siç e kishte parë, por më pas zbulova se ishte roman, sepse Defoe ishte më pak se shtatë vjeç kur murtaja u përhap në Londër. Murtaja ka qenë gjithmonë një nga temat e mia të përsëritura dhe në forma të ndryshme. Për shumë vjet mendoja se dhuna politike në Kolumbi kishte të njëjtin metafizikë si murtaja. Para

*Njëqind vjet vetmi* kisha përdorur një murtaje për të vrarë të gjithë zogjtë në një histori me titull *Dita pas së shtunës në Njëqind vjet vetmi*, përdora murtajen e pagjumësisë si truk letrar, pasi është e kundërta e murtajes së gjumit. Në fund të fundit, letërsia nuk është gjë tjetër veçse zdrukthëtari.

*A mund ta shpjegoni pak më shumë këtë analogji?*

Të dyja janë punë shumë e vështirë. Të shkruash diçka është pothuajse aq e vështirë sa të bësh një tavolinë. Me të dyja po punoni me realitetin, një material duhet të jetë po aq i fortë sa druri. Të dyja janë plot truke dhe teknika. Në thelb, përfshihet shumë pak magji dhe shumë punë e vështirë. Dhe ashtu si Prusti, edhe unë mendoj se nevojitet dhjetë për qind frymëzim dhe nëntëdhjetë për qind djersë. Kurrë nuk kam bërë punë zdrukthëtarie, por është puna që e admiroj më shumë, veçanërisht sepse nuk mund të gjesh kurrë dikë tjetër ta bëjë diçka për ty, si e do ti.

*A janë personazhet në "Vjeshta e Patriarkut", diktatorët, për shembull, të modeluar sipas njerëzve të vërtetë? Duket se ka ngjashmëri me Franco, Perón dhe Trujjo.*

Në çdo roman personazhi është një kolazh i personazheve të ndryshëm që ke njohur, ke dëgjuar ose ke lexuar për ta. Kam lexuar gjithçka që kam gjetur për diktatorët e Amerikës Latine të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli. Po kështu kam biseduar me shumë njerëz që kishin jetuar nën diktatura. E kam bërë këtë për të paktën dhjetë vjet.

Dhe kur pata një ide të qartë se si do të ishte personazhi, u përpoqa të harroja gjithçka që kisha lexuar dhe dëgjuar, në mënyrë që të trilloja, pa përdorur asnjë situatë që kishte ndodhur në jetën reale. Për një çast e kuptova se nuk kisha jetuar për asnjë periudhë kohore nën një diktaturë, kështu që mendova se nëse do ta shkruaja librin në Spanjë, do të mund të shihja se si ishte atmosfera e të jetuarit në një diktaturë. Por kuptova se atmosfera ishte shumë e ndryshme te Spanja nën Frankon nga ajo e një diktature të Karaibeve. Kështu që libri ishte deri diku i bllokuar për rreth një vit. Diçka mungonte dhe nuk isha i sigurt se çfarë ishte. Pastaj brenda natës vendosa që gjëja më e mirë ishte të ktheheshim në Karaibe. Kështu që të gjithë u kthyem në Barranquilla, Kolumbi. Bëra një deklaratë për gazetarët që ata menduan se ishte shaka. Thashë se po kthehesha se kisha harruar se si mbante era e guavas. Në të vërtetë, ishte ajo që më duhej për ta përfunduar librin tim. Bëra një udhëtim nëpër Karaibe. Teksa kaloja nga ishulli në ishull gjeta elementet që i kishin munguar romanit tim.

*Shpesh përdorni temën e vetmisë së pushtetit.*

Sa më shumë pushtet të kesh, aq më e vështirë është të kuptosh se kush po të gënjen dhe kush jo. Kur ka pushtet absolut, nuk ka kontakt me realitetin, dhe ky është lloji më i keq i vetmisë. Një person shumë i fuqishëm, një diktator, është i rrethuar nga interesa dhe njerëz, qëllimi përfundimtar i të cilëve është ta izolojnë nga realiteti; gjithçka funksionin në harmoni për ta izoluar.

*Po vetmia e shkrimtarit? A është ndryshe?*

Ka të bëjë shumë me vetminë e pushtetit. Përpjekjet e shumë shkrimtarëve për ta portretizuar realitetin shpesh e çojnë në një pamje të shtrembëruar të tij. Në përpjekjen për ta zhvendosur realitetin, mund të përfundojë duke humbur kontaktin me të, në një kullë fildishi, siç thuhet, gazetaria është një roje shumë e mirë kundër kësaj. Kjo është arsyeja pse gjithmonë jam përpjekur të vazhdoj të bëj gazetari, sepse më mban në kontakt me fjalën e vërtetë, veçanërisht me gazetarinë politike dhe politikën. Vetmia që më kërcënoi pas *Njëqind vjet vetmi* nuk ishte vetmia e shkrimtarit, ishte vetmia e famës, e cila i ngjan shumë më tepër vetmisë së pushtetit. Miqtë e mi më mbrojtën nga ai. Ata janë gjithmonë aty.

*Si nis procesi i të shkruarit? Një nga imazhet e përsëritura në "Vjeshta e patriarkut" janë lopët në pallat. A ishte ky një nga imazhet origjinale?*

Kam një libër fotografie që do t'ju tregoj. E kam thënë në raste të ndryshme se në zanafillën e të gjithë librave të mi është gjithmonë një imazh. Imazhi i parë i *Vjeshta e patriarkut* ishte një burrë tejet i moshuar në një pallat shumë luksoz, në të cilin hyjnë lopët dhe hanë perdet. Por ai imazh nuk u konkretizua derisa pashë fotografinë. Në Romë hyra në një librari ku fillova të shikoja albume, të cilat më pëlqen t'i mbledh. E pashë këtë foto, ishte thjesht e përsosur. E kuptova menjëherë si do të ishte skena. Meqenëse nuk jam një intelektual i madh, mund t'i gjej fillesat e ngjarjeve te gjërat e përditshme, në

jetë dhe jo në kryeveprat e mëdha.

*A marrin ndonjëherë romanet tuaja kthesa të papritura?*

Kjo më ndodhte në fillim. Në tregimet e para kisha një ide të përgjithshme për gjendjen shpirtërore, por e lija veten të zihesha në befasi. Këshilla më e mirë që më dhanë që herët ishte se ishte në rregull të punoja në atë mënyrë kur isha i ri, sepse kisha një përrua frymëzimi. Por më thanë se nëse s'do ta mësoja teknikën, do të isha në telashe më vonë kur frymëzimi të kishte ikur dhe teknika të ishte e nevojshme për ta kompensuar. Nëse nuk do ta kishte mësuar këtë me kohë, tani nuk do të isha në gjendje ta përshkruaj paraprakisht strukturën e një libri. Struktura është një problem thjesht teknik dhe nëse nuk e mëson herët, nuk do ta mësosh kurrë.

*Atëherë disiplina është shumë e rëndësishme për ju?*

Nuk mendoj se mund të shkruash një libër që vlen sadopak pa disiplinë të jashtëzakonshme.

*Po nxitësit artificialë?*

Një gjë që Hemingueji ka shkruar dhe që më ka bërë shumë përshtypje ishte se të shkruarit për të ishte si boksi. Ai kujdesej për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Folknerit i kishte dalë nami për pijanik, por në çdo intervistë që jepte thoshte se e kishte të pamundur të shkruante një rresht të vetëm kur ishte i dehur. Këtë e ka thënë edhe Hemingueji. Lexuesit e dobët më kanë pyetur nëse kam marrë drogë kur kam shkruar disa nga veprat e mia. Por kjo tregon se ata nuk dinë asgjë për letërsinë apo drogat. Për të qenë



një shkrimtar i mirë duhet të jesh absolutisht i kthjellët në çdo çast të shkrimit dhe me shëndet të mirë. Unë jam shumë kundër konceptit romantik të të shkruarit, sipas të cilit, akti i të shkruarit është një sakrificë dhe se sa më të këqija të jenë kushtet ose gjendja emocionale, aq më i mirë del shkrimi. Mendoj se duhet të jesh në gjendje shumë të mirë emocionale dhe fizike. Krijimi letrar për mua kërkon shëndet të mirë dhe këtë e kuptoi Brezi i Humbur. Ata ishin njerëz që e donin jetën.

*Blaise Cendrars ka thënë se të shkruarit është një privilegj në krahasim me shumicën e punëve të tjera dhe se shkrimtarët i zmadhojnë vuajtjet e tyre. Çfarë mendoni ju?*

Mendoj se të shkruarit është shumë i vështirë ashtu si çdo punë e kryer me kujdes. Megjithatë, privilegj është të bësh një punë për kënaqësinë tënde. Them se jam tepër kërkues ndaj vetes dhe të tjerëve, sepse nuk i duroj dot gabimet. Mendoj se është privilegj të bësh diçka me një shkallë përsosmërie. Megjithatë, është e vërtetë që shkrimtarët shpesh janë megalomanë dhe e shohin veten si qendrën e universit dhe të ndërgjegjes së shoqërisë. Por ajo që admiroj më shumë është diçka e bërë mirë. Jam gjithmonë shumë i lumtur kur udhëtoj dhe të kuptoj që pilotët janë pilotë më të mirë se unë si shkrimtar.

*Kur është koha më e mirë për të shkruar tani? A keni një orar pune?*

Kur u bëra një shkrimtar profesionist, problemi më i madh që kisha ishte orari i të shkruarit. Të jesh gazetar do të thoshte të punoje natën. Kur fillova të shkruaja me kohë të plotë, isha dyzet vjeç, të

shkruarit në thelb niste nga ora nëntë e mëngjesit deri në dy pasdite kur djemtë e mi ktheheshin nga shkolla. Meqenëse isha mësuar me punë të vështirë, ndihesha në faj që po punoja vetëm në mëngjes, kështu që u përpoqa të punoja pasditeve, por zbulova se ajo që shkruaja pasdite duhej të rishkruhej të nesërmen në mëngjes, prandaj vendosa të punoja nga ora nëntë deri në orën dy e gjysmë dhe të mos bëja asgjë tjetër. Pasditeve kam takime dhe intervista dhe gjëra të tjera të parëndësishme. Mund të punoj vetëm në mjedise të njohura dhe pasi jam në brendësi të asaj që po shkruaj. Nuk mund të shkruaj në hotele, ose me makina shkrimi të marra hua. Më krijon probleme sepse kur udhëtoj s'mund të punoj. Sigurisht, gjithmonë përpjeksh të gesh një pretekst për të punuar më pak. Kjo është arsyeja pse kushtet që i vendos vetes janë gjithmonë më të vështira. Ti shpreson për frymëzim pavarësisht prej rrethanave, një fjalë që romantikët e kanë shfrytëzuar shumë. Jam i bindur se ka një gjendje të veçantë shpirtërore në të cilën mund të shkruash dhe gjërat thjesht rrjedhin. Atëherë zhduken të gjitha pretekstet si mund të shkruash vetëm në shtëpi. Ai çast dhe ajo gjendje shpirtërore duket se vjen kur ti ke gjetur temën e duhur dhe mënyrat e duhura për ta trajtuar. Dhe duhet të jetë diçka që ti e pëlqen vërtet, sepse nuk ka punë më të keqe se të bësh diçka që nuk të pëlqen. Një nga gjërat më të vështira është paragrafi i parë. Kam harxhuar shumë muaj në paragrafin e parë dhe, sapo ta kem, pjesa tjetër del shumë lehtë. Në paragrafin e parë zgjedh shumicën e problemeve me librin tënd. Përcaktohen tema, stili, toni. Të paktën në rastin tim, paragrafi i

parë është një lloj shembulli i asaj që do të jetë pjesa tjetër e librit. Kjo është arsyeja pse shkrimi i një libri me tregime është shumë më i vështirë se shkrimi i një romani. Sa herë që shkruan një tregim, duhet të fillosh nga e para.

*Mendoni se kritikët ju klasifikojnë shumë mirë?*

Kritikët për mua janë shembulli më i madh se çfarë është intelektualizmi. Para së gjithash, ata kanë një teori se si duhet të jetë një shkrimtar. Përpiqen ta bëjnë shkrimtarin t'i përshtatet modelit të tyre dhe, nëse nuk i përshtatet, përsëri përpiqen ta fusin me forcë në atë model. Unë po i përgjigjem kësaj vetëm sepse më keni pyetur. Në të vërtetë nuk kam interes për atë që kritikët mendojnë për mua; as që kam lexuar kritikë letrare prej shumë vitesh. Ata kanë mëtuar për vete detyrën për të qenë ndërmjetës mes autorit dhe lexuesit. Gjithmonë jam përpjekur të jem një shkrimtar shumë i qartë dhe i saktë, duke u përpjekur të arrij drejtpërdrejt te lexuesi pa pasur nevojë të kaloj përmes kritikës.

*A mendoni se fama apo suksesi që vjen shumë herët në karrierën e një shkrimtari është e dëmshme?*

Në çdo moshë është e dëmshme. Do të kisha dashur që librat e mi të botoheshin pas vdekjes, të paktën në vendet kapitaliste, ku ti kthehesh në një lloj malli.

*Pse mendoni se fama është kaq shkatërruese për një shkrimtar?*

Kryesisht sepse ndërhyr në jetën tënde private. Të heq kohën që kalon me miqtë dhe kohën kur mund të punosh. Priret të të izolosh nga bota e vërtetë. Një shkrimtar i famshëm që dëshiron të vazhdojë të shkruajë duhet të mbrohet

vazhdimisht nga fama. Nuk më pëlqen shumë ta them këtë sepse nuk duket kurrë e sinqertë, por mund të kisha dashur që librat e mi të ishin botuar pas vdekjes sime, kështu që nuk do të më duhej të merresha me këtë punën e famës dhe të shkrimtarit të madh. Në rastin tim, e vetmja përparësi e famës është se kam mundur t'i jap një përdorim politik. Përndryshe, është shumë e pakëndshme. Problemi është se ti je i famshëm për njëzet e katër orë në ditë dhe nuk mund të thuash: "Mirë, nuk do të jem i famshëm deri nesër", ose të shtypësh një buton dhe të thuash: "Nuk do të jem i famshëm këtu ose tani".

*A e keni parashikuar suksesin e jashtëzakonshëm të "Njëqind vjet vetmi"?*

E dija se do të ishte një libër që do t'i kënaqte miqtë e mi më shumë se të tjerët. Por kur botuesi spanjoll më tha se do të shtypte tetë mijë kopje, u habita, sepse librat e mi të tjerë nuk ishin shitur kurrë më shumë se shtatëqind kopje. E pyeta pse të mos fillonte më ngadalë, por ai tha se ishte i bindur se ishte libër i mirë dhe se të tetë mijë kopjet do të shiteshin midis majit dhe dhjetorit. Në fakt, ato u shitën të gjitha brenda një jave në Buenos Aires.

*Pse mendoni se pati kaq sukses "Njëqind vjet vetmi"?*

Nuk e kam idenë më të vogël, sepse jam një kritik shumë i keq i veprave të mia. Një nga shpjegimet më të shpeshta që kam dëgjuar është se ai është një libër për jetën private të njerëzve të Amerikës Latine, një libër që është shkruar nga dikush i vendit. Ky shpjegim më befason sepse në përpjekjen time të parë për ta shkruar, titulli i librit ishte Shtëpia. Doja që të gjitha ngjarjet e romanit të zhvilloheshin

brenda shtëpisë dhe çdo gjë e jashtme do të ishte vetëm ndikimi i saj në shtëpi, më vonë e braktisa titullin Shtëpia, por sapo libri arrin në qytetin e Macondos, nuk shkoj kurrë më tej. Një shpjegim tjetër që kam dëgjuar është se çdo lexues mund të bëjë me personazhet e librit atë që dëshiron dhe t'i bëjë të vetët. Nuk dua që të bëhet film, pasi shikuesi i filmit sheh një fytyrë që mund të mos e kishte imagjinuar.

*Keni ndonjë ambicie apo keqardhje afatgjatë si shkrimtar?*

Mendoj se përgjigja ime është e njëjtë me atë që ju dhashë për famën. Më pyetën një ditë nëse do të më interesonte çmimi Nobel, por ta dini se për mua do të ishte një katastrofë absolute. Sigurisht që do të më interesonte ta meritoja, por do të ishte e tmerrshme ta merrja. Thjesht do të ndërlikonte më shumë problemet e famës. E vetmja gjë për të cilën pendohem shumë në jetë është që nuk kam një vajzë.

Dimër, 1981

*Shënim i përkthyesit:* Marquesi fitoni Çmimin Nobel për Letërsi vetëm një vit më vonë, në vitin 1982, me motivacionin: "Për romanet dhe tregimet në të cilat fantastikja dhe realja kombinohen në një botë të pasur imagjinare, që pasqyron jetën dhe konfliktet e një kontinenti". Romani i lënë në dorëshkrim "Shihemi në gusht" u botua pas vdekjes, edhe në gjuhën shqipe, më 6 mars 2024, në ditën e lindjes së nëntëdhjetë e shtatë të autorit.

*Përktheu nga anglishtja:*

Granit Zela

Marrë nga numri 22 i revistës "Akademia"





HAROLD PINTER

# ARTI, E VËRTETA DHE POLITIKA

Ligjërata e Nobelit, 7 dhjetor 2005

Në vitin 1958 shkrova sa vijon: "Nuk ka dallime të forta midis asaj që është reale dhe asaj që është joreale, as midis asaj që është e vërtetë dhe asaj që është e rreme. Një gjë nuk është domosdoshmërisht e vërtetë ose e rreme. Mund të jetë edhe e vërtetë edhe e rreme. Edhe sot besoj se këto pohime përmbajnë një thelb që rezonon dhe mbeten të vlefshme për udhëtimin drejt së vërtetës përmes artit. Si shkrimtar i qëndroj me bindje, por si qytetar më duhet të ndalem dhe të pyes: Çfarë është e vërtetë? Çfarë është e pavërtetë?"

E vërteta në dramë është një përndjekje e përjetshme, një ndjekje e errët drejt dritës. Nuk e kap kurrë të plotë, por kërkimi i saj është një domosdoshmëri ekzistenciale, një etje që nuk shuhet. Ky kërkim është ai që i jep frymëzim vetë përpjekjes. Është ai që e gjallëron udhën e artit.

Shpesh e vërteta të shfaqet papritmas, në errësirën e paqartësisë, si një përplasje e dhimbshme apo si një pasqyrë e zbehtë që duket se ngjan me të. Dhe shpesh as nuk e kupton që e ke prekur. Por ja e madhërisht: në art nuk ka një të vërtetë të vetme. Ka shumë, të pafundme,

të cilat përleshën mes vetes, refuzojnë njëra-tjetrën, pasqyrojnë, sfidojnë dhe nganjëherë tërhiqen nga njëra-tjetra si valët që përplasen mbi shkëmbinjtë. Dhe kur mendon se e ke kapur atë çast magjik, atë grimë të së vërtetës, ajo të rrëshqet si rëra ndër gishta dhe tretet.

Më pyesin shpesh: Si lindin dramata tua? Nuk di të përgjigjem. Nuk di as t'i përmbledh. Veç mund të them: Kjo ndodhi. Këto ishin fjalët që thanë. Këto ishin veprimet që kryen. Asgjë më shumë, asgjë më pak.

Shumica e dramave lindin prej një fjale, një imazhi, apo një fije të thjeshtë mendimi. Fjala e shpallur shpeshherë merr formë në një imazh që shfaqet në të njëjtën rrjedhë spontane. Po jap dy shembuj nga dy drama, *Kthimi në shtëpi dhe Kohët e vjetra*, të cilat lindën prej linjash që më erdhën si vetëtimë, të ndjekura nga një imazh dhe, së fundmi, nga vetë unë.

Linja e parë e *Kthimit në shtëpi* është: "Çfarë ke bërë me gërshtërit?" Ndërsa ajo e *Kohëve të vjetra* është thjesht një fjalë: "E errët". Në të dyja rastet nuk kisha asnjë njohuri paraprake.

Në rastin e parë dikush kërkonte një palë gërshtëri dhe kërkonte përgjigje nga dikush që e dyshonte për vjedhje. Por menjëherë kuptova se personi i drejtuar nuk i bënte as dert për gërshtërit dhe as për atë që e pyeste, në të vërtetë.

"E errët" më tingëlloi si një përshkrim i flokëve të një gruaje, një përgjigje ndaj pyetjeve të pashprehura. Në secilin rast gjeta veten të detyruar ta ndjek këtë fije të mendimit. Kjo ndodhi përmes një zbulimi pamor - një zhytje e ngadaltë nga hija drejt dritës, një proces ku e padukshmja ngjizet në qartësi.

Gjithmonë nis një dramë për t'i emërtuar personazhet me A, B dhe C.

Në atë që më pas u bë *Kthimi në shtëpi*, pashë një burrë të hynte në një dhomë të zhveshur, dhe i drejtonte pyetjen një burri më të ri, i ulur në një divan të shëmtuar, lexonte një gazetë për gara kuajsh.

Më dukej se A-ja që një baba, ndërsa B-ja një djalë i tij, por nuk kisha prova. Kjo u provua më vonë kur B (që më pas u quajt Leni) i thotë A-së (që më vonë u quajt Maks):

"Baba, a të pengon nëse

ndërroj temën? Dua të të pyes diçka. Darka që hëngrëm më parë, si quhej? Si e quan? Pse nuk blen një qen? Ti je kuzhinier qensh. Seriozisht. Mendon se po gatuan për një tufë qensh".

Prandaj, meqë B e quajti A-në "baba", m'u duk e arsyeshme të supozoja se ata ishin baba e bir.

Ai ishte gjithashtu dukshëm kuzhinieri dhe gatimi i tij nuk dukej të ishte shumë i vlerësuar. A nënkuptonte kjo se nuk kishte nënë? Nuk e dija. Por, siç i thashë vetes asokohe, fillimet tona kurrë nuk mund ta njohin fundin tonë.

Në rastin e *Kohëve të vjetra*: Një dritare e madhe. Qielli i mbrëmjes. Një burrë, A (më vonë i quajtur Dili), dhe një grua, B (më vonë e quajtur Kejt), të ulur me gota në duar. "E shëndoshë apo e dobët?" pyet burri. Për kë po flisnin?

Papritur e pashë një grua tjetër, C (më vonë quajtur Ana), sakaq rrinte pranë dritares, në një dritë tjetër, me shpinën kthyer nga ta, flokët e saj të errët si nata.

Që një pamje që zbulonte më shumë se sa mund të kuptohej menjëherë - një hije e së shkuarës që endej mes dritës të së tashmes. Është një çast tejet i veçantë, ai i krijimit të personazheve që

deri në atë çast nuk kanë njohur ekzistencë. Çfarë ndodh më pas është një rrugëtim i lëkundshëm, i paqartë, madje shpeshherë me gjurmë halucinacionesh, edhe pse ndonjëherë mund të shpërthejë si një ortek i papërmbajtshëm. Pozicioni i autorit në këtë proces mbetet i çuditshëm. Në njëfarë mënyre, personazhet nuk e presin krahëhapur. Ato e sfidojnë, e përballin me qëndresë; janë të vështira për t'u përkufizuar, të pamundura për t'u përvetësuar. Autorit nuk i jepet mundësia t'u diktojë. Në vend të kësaj, ai luan një lojë të pafundme me to - macja dhe miu, sylldhur, fshehje dhe zbulim. Por, në fund, përballë tij shfaqen njerëz të gjallë, me mish dhe shpirt, njerëz me vullnet të pavarur dhe një ndjeshmëri të tyre, të formësuar nga pjesë përbërëse që autori nuk mund t'i ndryshojë, t'i shtrembërojë apo t'i manipulojë.

Gjuha në art mbetet një akt i vështirë dhe shumëkuptimor - një kënetë që të gllabëron, një trampolinë që të hedhë lart pa paralajmërim, një sipërfaqe akulli që mund të çahet në çdo çast nën këmbët e autorit.

Megjithatë, siç kam theksuar,





kërkimi për të vërtetën nuk mund të ndalet. Ai nuk mund të shtyhet, as të anashkalohet. Duhet të përballet menjëherë, aty ku ndodh vetë akti krijues.

Teatri politik, në vetvete, sjell një grup krejt tjetër problemesh. Predikimet dhe moralizimet duhen shmangur me çdo kusht. Objektiviteti është tërësisht thelbësor. Personazheve duhet t'u lihet liria e plotë për të marrë frymë në hapësirën e tyre. Autori nuk mund t'i mbyllë në kufijtë e shijes, prirjeve apo paragjykimëve të tij. Ai duhet të jetë i gatshëm t'u qaset nga çdo këndvështrim, kur humltonon një spektër të gjerë pikëpamjesh, ndonjëherë i kapë në befasi, por gjithsesi duke u dhënë lirinë ta ndjekin rrugën e tyre. Kjo, sigurisht, nuk ecën gjithmonë. Ndërkaq, satira politike ndjek një qasje krejtësisht të kundërt. Ajo përfaqon të kundërtën, dhe pikërisht kjo është detyra e saj.

Në dramën *Festa e ditëlindjes* unë besoj se kam lejuar një mori mundësish të lundrojnë brenda një pylli të dendur të së mundshmes, përpara se të përqendrohem në një akt përfundimtar nënshtrimi. Nga ana tjetër, *Gjuha e Malit* nuk mëton të përshkojë një shtrirje të tillë. Ajo është egër, e shkurtër dhe e zymtë, por ushtarët në këtë dramë gjejnë njëfarë argëtimi në ashpërsinë e tyre. Ndonjëherë harrojmë se torturuesit mërzhiten lehtë; atyre u duhet një farë zbatimjeje për ta mbajtur shpirtin lart. Kjo, fatkeqësisht, është konfirmuar nga ngjarjet e njohura në Abu Graib të Bagdadit. *Gjuha e Malit* zgjat vetëm 20 minuta, por mund të zgjaste pafundësisht, duke përsëritur të njëjtin model në një lak të pamëshirshëm, orë pas ore.

Ndërkohë, *Hiri në hi* më ngjan sikur ndodh nën ujë. Një grua që mbytet; dora e saj shtrihet përmes valëve, më pas bie në thellësi, zhduket nga pamja. Ajo kërkon të tjerë, por nuk gjen askënd - as mbi ujë, as nën të. Aty janë vetëm hijet, reflektimet, një boshllëk notues. Gruaja

shndërrohet në një figurë të humbur brenda një peizazhi mbytyës, një qenie e pafuqishme për t'u çliruar nga fati që dikur dukej se u përkiste vetëm të tjerëve.

Por, ashtu siç vdiqën ata, edhe ajo duhej të vdiste.

Gjuha politike, siç përdoret nga politikanët, nuk bën të hyjë në këtë terren, sepse pjesa më e madhe e politikanëve, bazuar në dëshmitë që kemi, nuk kanë interes për të vërtetën, por për pushtetin dhe për ruajtjen e tij. Për të mbajtur këtë pushtet të pacenuar, është thelbësore që njerëzit të mbeten në terrin e paditurisë, të jetojnë të verbuar nga mungesa e së vërtetës, madje edhe të vërtetës së jetës së tyre.

Ajo që na mbështjell, pra, është një thurje e gjerë mashtrimesh mbi të cilën ushqehemi.

Siç e di çdo shpirt këtu i pranishëm, përligjja për pushtimin e Irakut ishte pohimi se Sadam Huseini zotëronte një sasi të armëve vdekjeprurëse të shkatërrimit masiv, disa prej të cilave thuhej se mund të viheshin në veprim përbrenda 45 minutash, për të sjellë një shkatërrim rrëqethës. Na siguroan se kjo që e vërtetë. Nuk ishte. Na thanë se Iraku kishte lidhje me Al-Kaidën dhe ndante përgjegjësinë për aktin tragjik të 11 shtatorit 2001. Na bindën se kjo që e saktë. Nuk ishte. Na thanë se Iraku përbente kërcënim për sigurinë globale. Na garantuan për këtë. Nuk ishte e vërtetë.

E vërteta është diçka krejtësisht tjetër. E vërteta lidhet me mënyrën se si Shtetet e Bashkuara e perceptojnë rolin e tyre në botë dhe si zgjedhin ta mishërojnë atë.

Por, para se të kthehem tek e tashmja, dua të ndalem tek e kaluara e afërt, me ç'rast nënkuptoj politikën e jashtme të Shteteve të Bashkuara që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Besoj se është detyrë e jona ta nënshtrijmë këtë periudhë, sado në mënyrë të kufizuar, një analizë, edhe pse

koha na kufizon këtu.

Të gjithë e njohim atë që ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në të gjithë Evropën Lindore gjatë periudhës pas Luftës së Dytë Botërore: dhuna sistematike, mizoritë e përhapura, shtypja e pamëshirshme e mendimit të lirë. Të gjitha këto janë dokumentuar dhe vërtetuar plotësisht. Por, pohimi im është se krimet e Shteteve të Bashkuara në të njëjtën periudhë janë regjistruar vetëm sipërfaqësisht, për të mos thënë që janë injoruar, mohuar, apo kundërshtuar të pranohen si krime. Besoj se kjo duhet të shkojë në vendin e duhur dhe se kjo e vërtetë ka një peshë të madhe në përcaktimin e pozitës së botës sot. Megjithëse, pjesërisht e frenuar nga ekzistenca e Bashkimit Sovjetik, veprimet e Shteteve të Bashkuara në mbarë globin e bënë të qartë se ato kishin vendosur të vepronin sipas dëshirës së tyre, pa kufizime.

Pushtimi i drejtpërdrejtë i një shteti sovran nuk ka qenë kurrë metoda e parapëlqyer e Amerikës. Kryesisht, ajo ka përfaqëuar atë që përshkruhet si "konflikt me intensitet të ulët". Konflikti me intensitet të ulët do të thotë që mijëra njerëz vdesin, por më ngadalë sesa nga një bombë që shpërthen në një çast. Kjo nënkupton infektimin e zemrës së një kombi, mbjelljen e një kanceri të keq që përhapet dhe lëngon si një plagë gangrenoze. Kur popullsia është nënshtruar - ose është shtypur me dhunë deri në vdekje - e njëjta gjë - dhe miqtë tuaj, ushtarakët dhe ndërmarrjet e mëdha, rehatojnë veten në pushtet, ju dilni para kamerave dhe shpallni se demokracia ka triumfuar. Kjo ishte një praktikë e zakonshme e politikës së jashtme amerikane në vitet për të cilat flas.

Tragedia e Nikaraguas është një rast tepër domethënës. E kam zgjedhur këtu si shembull të

qartë të mënyrës se si Amerika e ka konceptuar rolin e saj në botë, atëherë dhe tani. Kam qenë i pranishëm në një takim në ambasadën amerikane në Londër në fund të viteve 1980. Kongresi Amerikan po e vendoste nëse do të mbështeste më tej grupin Kontras (grup rebel në Nikaragua) në fushatën kundër shtetit të Nikaraguas. Unë isha pjesë e një delegacioni që fliste në mbrojtje të Nikaraguas, por anëtarin më të rëndësishëm ishte atë Xhon Metkalf. Kreu i trupës amerikane ishte Raymond Seitz (atëherë zëvendësambasador, më vonë ambasador). Atë Metkalf tha: "Zotëri, unë drejtoj një famullin në veri të Nikaraguas. Besimtarët e mi ndërtuan një shkollë, një qendër shëndetësore, një qendër kulturore. Kemi jetuar në paqe. Disa muaj më parë një forcë e Kontras sulmoi famullinë. Shkatërroi gjithçka: shkollën, qendrën shëndetësore, qendrën kulturore. Përdhunoi infermieret dhe mësueset, masakroi mjekët në mënyrën më mizore. U soll si barbarë. Ju lutem kërkoni nga qeveria amerikane të tërhiqet nga kjo veprimtari terroriste e tmerrshme".

Raymond Seitz, një njeri i njohur për arsyeshmërinë dhe elegancën e tij, i admiruar në qarqet diplomatike, dëgjoi me vëmendje. Pastaj, pas një pauze të rëndë, foli me solemnitet:

"Atë", tha ai, "më lejoni t'ju them diçka. Në luftë të pafajshmit gjithmonë vuajnë".

Heshtja ngrirejse pushtoi dhomën. Ne e vështruam të gjithë, të palëvizshëm. As ai nuk lëvizti.

Njerëzit e pafajshëm, në të vërtetë, gjithmonë vuajnë.

Më në fund, dikush tha: "Por në këtë rast, 'njerëzit e pafajshëm' qenë viktima të një mizorie të përgjakshme të mbështetur nga qeveria juaj, një ndër shumë të tilla.

Nëse Kongresi lejon më shumë fonde për Kontras (grupe rebele në Nikaragua) do të ndodhin mizori të tjera të kësaj natyre. A nuk është kështu? A nuk është qeveria juaj, pra, fajtorë për mbështetjen e akteve të vrasjes dhe shkatërrimit ndaj qytetarëve të një shteti sovran?"

Seitz mbeti i patrazuar. "Nuk pajtohem që faktet, ashtu siç janë paraqitur, mbështesin pohimet tuaja", tha ai.

Teksa po largoheshim nga ambasada, një ndihmës amerikan më tha se i pëlqenin dramat e mia. Nuk iu përgjigja.

Dua t'ju kujtoj se në atë kohë presidenti Regan bëri këtë deklaratë: "Kontras" janë të barazvlefshmit moral të Etërve Tanë Themeltarë. Shtetet e Bashkuara mbështetën diktaturën e dhunshme të Somozes në Nikaragua për më shumë se 40 vjet. Populli nikaraguas, i udhëhequr nga sandinistët, përmbysi këtë regjim në vitin 1979, një revolucion

popullor mbresëlënës.

Sandinistët nuk ishin të përsosur. Ata kishin pjesën e tyre të arrogancës dhe filozofia e tyre politike përmbante elemente kundërtë. Por ata ishin të mençur, të arsyeshëm dhe të qytetëruar. Ata u përpoqën të krijonin një shoqëri të qëndrueshme, të denjë dhe pluraliste. Dënimi me vdekje u shfuqizua. Qindra mijëra fshatarë të varfër u rikthyen në jetë.

Më shumë se 100 000 familje morën tituj mbi tokën. U ndëruan dy mijë shkolla. Një fushatë e jashtëzakonshme për luftimin e analfabetizmit e uli atë në më pak se një të shtatën. U vendos arsim dhe një sistem shëndetësor falas. Vdekshmëria foshnjore u ul me një të tretën. Poliomieliti u zhduk.

Shtetet e Bashkuara i dënuan këto arritje si një nënshtrim marksist-leninist. Sipas qeverisë amerikane, po vendosej një shembull i rrezikshëm. Nëse Nikaragua do t'i lejohej të vendoste norma bazë të drejtësisë sociale dhe ekonomike, t'i përmirësonte kushtet e kujdesit shëndetësor dhe arsimit, dhe të arrinte unitet shoqëror dhe respekt të vetvetes, vendet fqinje do të fillonin të bëjnë pyetje të ngjashme dhe të ndërmerrnin hapa të ngjashëm. Në atë kohë, natyrisht, rronte një kundërshti e ashpër ndaj status quos në El Salvador.

Më herët fola për një 'pëlhurë gënjeshtër' që na rrethojnë. Presidenti Regan e përshkruante zakonisht Nikaraguan si një 'burg totalitar'. Kjo pranohej përgjithësisht nga mediet dhe, pa dyshim, nga qeveria britanike, si një vërejtje e drejtë dhe e saktë. Por, në të vërtetë, nuk kishte asnjë shënim të grupeve të vdekjes nën qeverisjen sandiniste. Nuk kishte asnjë shënim për torturat. Nuk kishte asnjë të dhënë për dhunën ushtarake e sistematike apo zyrtare. Asnjë prift nuk u vra ndonjëherë në Nikaragua. Në fakt, tre priftërinj qenë pjesë e qeverisë, dy jezuitë dhe një misionar Mariknoll. Burgjet totalitare ndodheshin në të vërtetë përkrah njëra-tjetrës, në El Salvador dhe Guatemalë. Shtetet e Bashkuara kishin rrëzuar qeverinë e zgjedhur në mënyrë demokratike të Guatemalës në vitin 1954 dhe vlerësohet se mbi 200 000 njerëz kishin qenë viktima të diktaturave ushtarake të njëpasnjëshme.

Gjashtë nga jezuitët më të dalluar në botë u vranë brutalisht në Universitetin e Amerikës Qendrore në San Salvador në vitin 1989 nga një batalion i regjimentit Alcatl, i trajnuar në Fort Benning, Georgia, ShBA. Ajo figurë jashtëzakonisht e guximshme, kryepeshkopi Romero u vra gjatë meshës. Vlerësohet se 75 000 njerëz humbën jetën. Pse u vranë? U vranë ngaqë besonin se një jetë më e mirë ishte e mundshme dhe se duhej arritur. Për këtë arsye ky



besim i shënjojte menjëherë si komunistë. Ata vdiqën sepse guxuan ta sfidonin status quon, këtë nivel të pafund të varfërisë, sëmundjes, përkeqësimit dhe shtypjes, të cilat kishin qenë trashëgimia e tyre që nga lindja.

Shtetet e Bashkuara më në fund rrëzuan qeverinë sandiniste. U deshën disa vjet dhe përpjekje e mundime, por përndjekja e pamëshirshme ekonomike dhe 30 000 të vdekur më në fund e dobësuan shpirtin e popullit nikaraguas. Ata ishin të rraskapitur dhe të varfëruar sërish. Kazinotë u rikthyen në vend. Kujdesi shëndetësor dhe arsimit falas mbaruan. Bizneset e mëdha u kthyen me një hakmarrje. 'Demokracia' kishte fituar.

Por kjo 'politikë' nuk kufizohet vetëm në Amerikën Qendrore. Ajo zbatohet në të gjithë botën. Si e tillë që e pa fund. Dhe është sikur nuk ka ndodhur kurrë.

Shtetet e Bashkuara mbështetën dhe në shumë raste krijuan çdo diktaturë ushtarake të krahut të djathtë në botë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. I drejtohem si rast Indonezisë, Greqisë, Uruguait, Brazilit, Paraguait, Haitit, Turqisë, Filipineve, Guatemalës, El Salvadorit dhe, natyrisht, Kilit. Tmerret që Shtetet e Bashkuara shkaktuan në Kili në vitin 1973 nuk mund të shlyhen dhe nuk mund të falen kurrë.

Qindra mijëra vdekje ndodhën nëpër këto vende. A ndodhën ato? Dhe a janë në të gjitha rastet të lidhura me politikën e jashtme të ShBA-së? Përgjigjja është po, por ato ndodhën dhe janë përgjegjësi e politikës së jashtme amerikane. Por nuk do ta dini.

Sikur të mos kishte ndodhur kurrë. Asgjë nuk ka ndodhur kurrë. Edhe kur ndodhte, sikur të

mos ndodhte. Nuk kishte rëndësi. Nuk zgjonte interes. Krimet e Shteteve të Bashkuara kanë qenë sistematike, të pamëshirshme, dhunuëse, të pandalshme, por shumë pak njerëz në të vërtetë kanë folur për to. Duhet ta përgëzojmë Amerikën. Ka ushtruar një manipulim të pashembullt të pushtetit në të gjithë botën, duke u maskuar si një forcë për të mirën universale.

Megjithatë, është një veprim i shkëlqyer, madje humoristik, një akt hipnoze i jashtëzakonshëm dhe shumë i suksesshëm.

Po ju them se Shtetet e Bashkuara janë padyshim shfaqja më e madhe që ekziston. Mund të jetë e egër, e pandjeshme, përbuzëse dhe e pamëshirshme por, gjithashtu, është shumë e zgjuar. Si shitëse është e pakrahasueshme, dhe malli i saj më i shitshëm është vetëdashuria. Është një fitimtare. Dëgjoni të gjithë presidentët amerikanë në televizion që thonë fjalët "populli amerikan", si në frazën: "Unë i them popullit amerikan se është koha për t'u lutur dhe për t'i mbrojtur të drejtat e popullit amerikan, dhe i kërkoj popullit amerikan t'i besojë presidentit në veprimin që ai do të ndër marrë në emër të popullit amerikan".

Në të vërtetë kjo është një mënyrë veprimi e shkëlqyer dhe që shndrit. Gjuha përdoret në të vërtetë për ta mbajtur mendimin larg. Fjalët 'populli amerikan' krijojnë një jastëk të vërtetë qetësues. Nuk ka nevojë të mendoni. Thjesht shtrihuni në atë jastëk. Ky jastëk mund ta mbyllë inteligjencën dhe aftësitë tuaja kritike, por është shumë i rehatshëm.

Ndaj ky përshkrim nuk vlen

natyrisht për 40 milionë njerëzit që jetojnë nën kufirin e varfërisë dhe për dy milionë burrat dhe gratë që mbahen në burgjet masive që shtrihen anembanë ShBA-së.

Shtetet e Bashkuara nuk shqetësohen më për konfliktet me intensitet të ulët. Nuk shohin më ndonjë arsye për të qenë të ndruajtur apo të fshehtë. Ato i vendosin kartat në tavolinë pa frikë apo favor. Për këtë shkak Kombet e Bashkuara thjesht nuk i shqetëson aspak ligji ndërkombëtar apo kritikën e jashtme të cilat i shohin si të pafuqishme dhe të parëndësishme. Ato kanë gjithashtu një qengj të vogël që i ndjek si lodër në zinxhir, Britaninë e Madhe të mjerë dhe të nënshtruar.

Çfarë ka ndodhur me ndjeshmërinë tonë morale? A e kemi pasur ndonjëherë? Çfarë kuptimi kanë këto fjalë? A i drejtohen një termi shumë rrallë të përdorur këto ditë - ndërgjegjes? Një ndërgjegje jo vetëm për veprimet tona, por për përgjegjësinë tonë të përbashkët në veprimet e të tjerëve? A është e gjitha kjo e vdekur? Shikoni Guantanamo Bej. Qindra njerëz të ndaluar pa akuza për më shumë se tre vjet, pa përfaqësim ligjor apo proces të rregullt, teknikisht të ndaluar përjetësisht. Kjo strukturë krejtësisht e paligjshme mbahet në kundërshtim të hapur me Konventën e Gjenevës. Jo vetëm që tolerohet, por mezi mendohet nga ajo që quhet 'komuniteti ndërkombëtar'. Ky skandal kriminal po kryhet nga një vend që e shpall veten 'udhëheqësi i botës së lirë'. A mendojmë ne për banorët e Guantamos? Çfarë thonë mediet për ta? Ata shfaqen

herë pas here - një lajm i vogël në faqen gjashtë. Janë hedhur në një zonë të askujt, nga e cila ndoshta nuk do të kthehen kurrë. Tani për tani shumë prej tyre janë në grevë urie, dhe ushqehen me forcë, përfshirë edhe banorë britanikë. Nuk ka asnjë mirësjellje në këto veprime të ushqyerjes me forcë. Pa ndonjë qetësues apo anestezi. Thjesht një tub që futet në hundë dhe shkon deri në fytyrë. Vjell gjak. Kjo është torturë. Çfarë ka thënë sekretari i Jashtëm britanik për këtë? Asgjë. Çfarë ka thënë kryeministri britanik për këtë? Asgjë. Pse jo? Sepse Shtetet e Bashkuara kanë thënë: kritika e sjelljes sonë në Guantanamo Bej merret si një veprim jomiqësor. Ose jeni me ne, ose kundër nesh. Dhe kështu Toni Bleri hesht.

Pushtimi i Irakut që një akt banditesk, një vepër terrorizmi shtetëror e papranueshme, që tregoi një përçmim të tërë për konceptin e ligjit ndërkombëtar. Ky pushtim që një veprim ushtarak arbitrar i frymëzuar nga një sërë gënjeshtresh dhe manipulimesh të rënda të medieve dhe, në këtë mënyrë, të publikut; një veprim i synuar për ta përforcuar kontrollin ushtarak dhe ekonomik të ShBA-së në Lindjen e Mesme, për t'u fshehur - si një mjet i fundit, pasi të gjitha arsyetimet e tjera dështuan - si një çlirim. Një pohim i fuqishëm i forcës ushtarake, përgjegjëse për vdekjen dhe gjymtimin e mijëra njerëzve të pafajshëm.

Ne sollëm dhunën, bomba të grumbulluara, uranium të shteruar, veprat e rasteve të pafundme të vrasjeve të zakonshme, mjerim, poshtërim dhe vdekje për popullin irakian dhe e quajmë këtë "sjellje të lirisë dhe demokracisë në Lindjen e Mesme".

Sa njerëz duhet të vrisni përpara se të quheni masakruer dhe kriminel luftime? Njëqind mijë? Mjaftueshëm, do të mendoja. Prandaj, është e drejtë që Bushi dhe Bleri të akuzohen para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Por Bushi ka qenë i zgjuar. Ai nuk e ka aprovuar Gjykatën Penale Ndërkombëtare të Drejtësisë. Prandaj, nëse ndonjë ushtar amerikan ose politikan e gjen veten në bankën e të akuzuarve, Bushi ka paralajmëruar se do t'i dërgojë marinsat. Por Toni Bleri e ka aprovuar Gjykatën dhe prandaj është në gatishtëri për ndjekje penale. Ne mund t'i lëmë Gjykatës ta ketë adresën e tij nëse ata janë të interesuar. Është numri 10, Daunin Strit, Londër.

Vdekja në këtë kontekst është e parëndësishme. Të dy, Bushi dhe Bleri, e vendosin vdekjen shumë larg në prapavijë. Të paktën 100 000 irakianë u vranë nga bombat dhe raketat amerikane përpara se të fillonte kryengritja në Irak. Këta njerëz nuk janë të një çasti. Vdekja e tyre nuk ekziston. Ato janë bosh. Ata as nuk janë shënuar si të vdekur.

"Ne nuk bëjmë numërimin e trupit", tha gjenerali amerikan Tomi Franks.

Në fillim të pushtimit në faqen e parë të gazetave britanike u botua një fotografi e Toni Blerit duke puthur faqen e një djali të vogël irakian. "Një fëmijë mirënjohës", tha mbishkrimi. Disa ditë më vonë kishte një histori dhe fotografi, në një faqe të brendshme, të një djali tjetër katërveçar pa krahë. Familja e tij ishte hedhur në erë nga një raketë. Ai ishte i vetmi i mbi-jetuar. "Kur t'i kthej krahët?" pyeti ai. Historia u hoq. Epo, Toni Bleri



nuk po e mbante në krahë as trupin e ndonjë femije tjetër të gjymtuar, as trupin e ndonjë kufome të përgjakur. Gjaku është i ndotur. Ju ndot këmishën dhe kravatën kur jeni duke bërë një fjalim të sinqertë në televizion.

2 000 të vdekurit amerikanë janë një turp. Ata mbarten në varret e tyre në errësirë. Funeralet janë pa vëmendje, jashtë rrezikut. Të gjymtuarit kalben në shtretërit e tyre, disa për pjesën tjetër të jetës. Pra, të dy të vdekurit dhe të gjymtuarit kalben në varre të ndryshme.

Këtu është një ekstrakt nga një poezi e Pablo Nerudës, “Unë po shpjegoj disa gjëra”: Dhe një mëngjes gjithçka digjej, një mëngjes zjarret shpërthyen nga toka duke përpirë qeniet njerëzore, dhe që nga ajo kohë, zjarr, barut që nga ajo kohë, dhe që nga ajo kohë, gjak.

Banditë me avionë e maurë, banditë me unaza në gishta dhe dukësia, banditë me fretër të zinj që shpërndanin bekime, erdhën nëpër qiell për të vlarë femijë, dhe gjaku i femijëve rrodhi nëpër rrugë pa bujë – si gjak femijëror. Çakaj që dhe çakajtë do t’i përçmonin, gurë që dhe gjembat e tharë do t’i kafshonin e do t’i pështynin, gjarpërinj që dhe gjarpërinjtë do t’i neveritnin. Përballë teje kam parë gjakun e Spanjës që ngrihej si baticë, për të të mbytur në një valë krenarie dhe thikash.

Gjeneralë tradhtarë: shihni shtëpinë time të shkatërruar, shihni Spanjën e thyer: nga çdo shtëpi rrjedh metal i djegur në vend të luleve. Nga çdo plagë e Spanjës del Spanja. Dhe nga çdo femijë i vlarë lind një pushkë me sy. Dhe nga çdo krim lindin

plumba që një ditë do ta gjejnë shenjën e demit të zemrave tuaja. Dhe ju do të pyesni: pse poezia e tij nuk flet për ëndrra, për gjethe, për vullkanet madhështore të vendlindjes së tij? Ejani dhe shihni gjakun nëpër rrugë. Ejani dhe shihni gjakun nëpër rrugë. Ejani dhe shihni gjakun nëpër rrugë!” Më lejoni ta bëj mjaft të qartë se duke cituar nga poema e Nerudës, në asnjë mënyrë nuk e krahasoj Spanjën republikane me Irakun e Sadam Huseinit. Unë citoj Nerudën sepse askund në poezinë bashkëkohore nuk kam lexuar një përshkrim kaq të fuqishëm emocional të bombardimeve të civilëve.

Unë e kam thënë më herët se Shtetet e Bashkuara tani janë plotësisht të sinqerta në lidhje me vendosjen e kartave të tyre në tavolinë. Ky është rasti. Politika e saj e deklaruar zyrtare tani përkufizohet si “mbizotërim gjithëpërfshirës”. Ky nuk është termi im. Është i tyre. “Mbizotërim gjithëpërfshirës” nënkupton kontrollin e tokës, detit, ajrit dhe hapësirës dhe të gjitha burimeve përcjellëse.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës sot mbajnë 702 baza ushtarake të shpërndara në mbarë globin, në 132 shtete, me përjashtimin e denjë dhe të admirueshëm të Suedisë.

Si përfunduan aty nuk e dimë saktësisht, por aty janë, pa asnjë dyshim.

Shtetet e Bashkuara zotërojnë 8 000 koka bërthamore aktive dhe funksionale. Dy mijë prej tyre janë në gatishmëri të menjëhershme, gati për t’u lëshuar brenda 15 minutash nga dhënia e alarmit. Po zhvillojnë sisteme të reja të forcës bërthamore, të

njohura si “shkatërrues bunkerësh”. Britanikët, gjithnjë bashkëpunues, kanë ndër mend ta zëvendësojnë raketën e tyre bërthamore, Trident. Po pyes veten: Kujt ia kanë drejtuar?

Osama bin Ladenit? Ty? Mua? Joe Dokesit? Kinës? Parisit? Kush mund ta dijë?

Ajo që dimë me siguri është se kjo marrëzi foshnjore – posedimi dhe kërcënimi për përdorimin e armëve bërthamore – është thelbi i filozofisë politike të sotme amerikane. Duhet t’ia kujtojmë vetes se Shtetet e Bashkuara ndodhen në një gjendje të përherëshme gatishmërie ushtarake dhe nuk tregojnë asnjë shenjë për ta zbutur këtë qëndrim.

Mijëra, në mos miliona njerëz brenda vetë Shteteve të Bashkuara, ndihen të tronditur, të turpëruar dhe të zemëruar nga veprimet e qeverisë së tyre. Megjithatë, në këtë çast, ata nuk përbëjnë ende një forcë politike të vazhdueshme. Por ankthi, pasiguria dhe frika, që po rriten dita-ditës në Amerikë, nuk duken aspak të paracaktuara të zbehën. E di që presidenti Bush ka shumë shkrimtarë jashtëzakonisht të aftë, por unë do të doja të jem vullnetar për këtë punë. Unë propozoj adresën e mëposhtme të shkurtër që ai mund t’i bëjë kombit në televizion. E shoh në var, flokë të krehura me kujdes, serioz, fitues, i sinqertë, shpesh mashtrues, ndonjëherë përdor një buzëqeshje të hidhur, çuditërisht tërheqës, burrë mashkullor.

“Zoti është i mirë. Zoti është i madh. Zoti është i mirë. Zoti im është i mirë. Zoti i Bin Ladenit është i keq. Ai është një Zot i keq.

Zoti i Sadamit ishte i keq, veçse ai nuk kishte një të tillë. Ai ishte një barbar. Ne nuk jemi barbarë. Ne nuk ua presim kokat njerëzve. Ne besojmë në liri. Po ashtu edhe Zoti. Unë nuk jam barbar. Unë jam lideri i zgjedhur në mënyrë demokratike, i një demokracie liridashëse. Ne jemi një shoqëri e dhembshur. Ne japim goditje elektrike të dhembshur dhe injeksion vdekjeprurës të dhembshur. Ne jemi një komb i madh. Unë nuk jam diktator. Ai është. Unë nuk jam barbar. Ai është. Dhe ai është. Ata të gjithë janë. Unë kam autoritet moral. E shihni këtë grusht? Ky është autoriteti im moral. Dhe mos e harro”.

Jeta e një shkrimtari është një veprimtari shumë e cenueshme, pothuajse e zhveshur.

Nuk duhet të qajmë për këtë. Shkrimtari bën zgjedhjen e tij dhe është mbërthyer me të. Por është e vërtetë të thuash se je i hapur ndaj të gjitha erërave, disa prej tyre me të vërtetë të akullta. Ju jeni jashtë vetëm, jashtë në një gjymtyrë. Nuk gjen asnjë strehë, asnjë mbrojtje – nëse nuk gënjen – në këtë rast sigurisht që ke ndërtuar mbrojtjen tënde dhe mund të argumentohet, bëhesh politikan.

I jam referuar vdekjes disa herë këtë mbrëmje. Tani do të citoj një poezi timen të quajtur *Vdekja*.

Ku u gjet trupi i pajetë?  
Kush e zbuloi trupin e pajetë?  
A ishte trupi i pajetë kur u gjet?  
Si u zbulua trupi i pajetë?  
Kush ishte ai trup i pajetë?  
Kush ishte babai, vajza, vëllai, daja, motra, nëna apo djali i trupit të pajetë dhe të braktisur?  
A që trupi i pajetë kur u braktis?  
A që ai në të vërtetë i braktisur?

Nga kush u la pas dore?  
A ishte trupi i pajetë i zhveshur, apo veshur për një udhëtim të fundit?

Çfarë ju bëri të shpallnit trupin e pajetë si të tillë?

A e shpallët ju vetë vdekjen e tij?  
Sa mirë e njihnit atë trup?

Si e kuptuat se ai trup ishte pajetë?

A e pastruat trupin e pajetë?

A ia mbyllët sytë e ftohtë?

A e varrosët trupin?

A e latë të braktisur?

A e puthët trupin e pajetë?

Kur shohim veten në një pasqyrë, mendojmë se imazhi që na shfaqet është i saktë. Por mjafton një lëvizim një milimetër dhe pamja ndryshon. Në të vërtetë, ne po soditim një shtrirje të pafund përfytyrimesh. Megjithatë, ndonjëherë një shkrimtar duhet ta thyejë pasqyrën – sepse është përtej saj, në anën tjetër, e vërteta na shikon drejt e në sy.

Jam i bindur se, pavarësisht prej pengesave të mëdha që na rrethojnë, një këmbëngulje intelektuale e palëkundur, një përkushtim i pamëshirshëm dhe i vendosur për ta zbuluar thelbin e së vërtetës në jetën dhe shoqëritë tona, si qytetarë, është një detyrë themelore që na përket të gjithëve. Në të vërtetë, është një domosdoshmëri.

Nëse një vizion i tillë nuk mishërohet në mendimin tonë politik, nuk mund të kemi asnjë shpresë për të rikthyer atë që është pranë humbjes – dinjitetin njerëzor.

*Përktheu nga anglishtja:*

*Kadri Mehmeti*

*Marrë nga numri 22 i revistës*

*“Akademia”*





SUSAN SONTAG

# KUNDËR INTERPRETIMIT

Përmbajtja është një shfaqje e shpejtë e diçkaje, një përballje si një shkëndijë. Përmbajtja është shumë e vogël - krejtësisht e vogël.

Vetëm njerëzit sipërfaqësorë nuk gjykojnë përmes pamjeve. Misteri i botës është e dukshmja, jo e padukshmja.

UILLIAM DE KOONING, në një bisedë

OSKAR UAJLLD, në një letër

Përvoja më e hershme e artit duhet të ketë qenë se ai ishte pëshpëritës, magjik; arti ishte një instrument rituali. (Krahaso. Pikturat në shpellat në *Lascaux*, *Altamira*, *Niaux*, *La Pasiega* etj.) Teoria më e hershme e artit, ajo e filozofëve grekë, sugjeronte se arti ishte mimesis, imitim i realitetit.

Pikërisht në këtë pikë u ngrit pyetja e veçantë e vlerës së artit.

Sepse teoria mimetike, me vetë termat e saj, sfidon artin për ta përligjur veten.

Platoni, i cili propozoi teorinë, duket se e ka bërë këtë për të vendosur se vlera e artit është e dyshimtë. Meqenëse ai i vlerësonte gjërat e zakonshme materiale si objekte mimetike, imitime të formave apo strukturave transhendente; para së gjithash edhe piktura më e mirë e një shtrati do të ishte vetëm një "imitim i një imitimi". Për Platonin arti nuk ishte veçanërisht i dobishëm (pikturimi i një shtrati nuk është i mirë për të fjetur dhe as, në kuptimin e ngushtë, e të

vërtetë).

Dhe argumentet e Aristotelit në mbrojtje të artit nuk e sfidojnë plotësisht pikëpamjen e Platonit se çdo art është një iluzion i stërholluar - "*trompe l'oeil*" dhe, për rrjedhojë, një gënjeshtër. Por ai kundërshtoi idenë e Platonit se arti është i padobishëm, i vërtetë ose jo, arti, sipas Aristotelit, ka vlerë sepse është një formë shërimi. Në fund të fundit, arti është i dobishëm si mjet shërues, pasi ngjall dhe pastron ndjenjat e rrezikshme.

Te Platoni dhe Aristoteli teoria mimetike e artit shkon paralelisht me supozimin se arti është gjithmonë figurativ. I përjetshëm, e i papërfunduar mbetet projekti i interpretimit - mbështetur pareshur nga ithtarët e tij. Përkundrazi, është pikërisht ai zakoni i qasjes ndaj veprave të artit për t'i interpretuar që mban gjallë idenë, sikur rron diçka e tillë si përmbajtja e një vepre arti.

Por mbështetësit thonë se përmbajtja është një shkëndijë e

diçkaje, një përballje e shpejtë si vetëtimë. Është diçka fare e vogël - pra, teoria e pasqyrit nuk ka pse t'i mbyllë sytë ndaj artit zbukurues ose të çformuar.

Gabimi që arti duhet të jetë domosdo "real" mund të ndryshohet ose hidhet poshtë pa dalë jashtë problemeve të përcaktuara nga teoria e pasqyrit.

## II

Teoria mimetike nuk duhet t'i mbyllë sytë ndaj artit dekorativ dhe abstrakt.

Gabimi se arti është domosdoshmërisht një "realizëm" mund të maskohet ose hiqet pa u zhvendosur kurrë jashtë problemeve të përcaktuara nga teoria mimetike.

Fakti është se e gjithë vetëdija perëndimore dhe përfytyrimi mbi artin kanë mbetur brenda kufijve të vendosur nga teoria greke e artit si mimesis ose paraqitje. Në të vërtetë është pikërisht kjo teori që e bën artin - përtej veprave të

veçanta artistike - problematik, të nevojshëm për mbrojtje. Dhe është pikërisht kjo mbrojtje e artit që lind atë pamje të çuditshme ku diçka që kemi mësuar ta quajmë "formë", ndahet nga diçka që e quajmë "përmbajtje", dhe një prirje e sinqertë bën që përmbajtja të shihet si thelbësore dhe forma si diçka dytësore.

Edhe në kohët moderne, kur shumica e artistëve dhe kritikëve e kanë hedhur poshtë teorinë e artit si përfaqësim i një realiteti të jashtëm në favor të teorisë së artit si shprehje subjektive, tipari kryesor i teorisë mimetike vazhdon. Pavarësisht nëse e konceptojmë veprën e artit sipas modelit të një tabloje (artin si pamje e realitetit) ose sipas modelit të një deklaratë (arti si deklaratë e artistit), përmbajtja mbetet ende e para. Përmbajtja mund të ketë ndryshuar. Tani mund të jetë më pak figurative, më pak realiste. Por ende supozohet se një vepër arti është përmbajtja e saj. Ose, siç thuhet

zakonisht sot, që një vepër arti sipas definicionit thotë diçka. ("Ajo që X po thotë është". "Ajo që X po përpiqet të thotë është...", "Ajo që X tha është..." etj.)

Asnjëri prej nesh nuk mund ta rikthejë atë pafajësi të hershme, atë epokë kur arti nuk kishte nevojë të përligjte veten, kur askush nuk i bënte një veprë arti pyetjen se çfarë thoshte, sepse njeriu e dinte (ose pandehte se e dinte) se çfarë bënte ajo. Që prej këtij çasti e deri në kufijtë e ndërgjegjes, mbartim mbi vete detyrën e mbrojtjes së artit. Ajo që mbetet është të debatojmë për mënyrat e ndryshme të kësaj mbrojtjeje. Madje jemi të thirrur të përmbysim çdo qasje mbrojtëse që bëhet e ashpër, e rënduar apo e verbër ndaj kërkesave dhe praktikave bashkëkohore.

Një shembull i tillë është sot vetë koncepti i përmbajtjes. Çfarëdo funksioni të ketë pasur në të kaluarën, sot kjo ide përfaqëson kryesisht një pengesë, një bezdi,



një filistinizëm të hapur ose të maskuar. Megjithatë zhvillimet bashkëkohore në shumë forma arti duket se na largojnë gjithnjë e më shumë nga ideja se një vepër arti është e përkufizuar nga përmbajtja e saj, kjo ide vazhdon të ushtrojë një ndikim të jashtëzakonshëm. Dua të sugjeroj se kjo ndodh sepse koncepti i përmbajtjes është përdorur tani nën petkun e një metode të caktuar interpretimi, e cila është rrënjësor thellësisht në ndërgjegjen e shumicës së atyre që i qasen artit me seriozitet.

Ajo që nënkupton mbivlerësimi i kësaj ideje është një ndërmarrje e stërzgatur interpretimi, ende e paplotësuar. Në të kundërtën, është pikërisht zakoni për t'iu qasur veprave të artit vetëm nëpërmjet interpretimit që ushqen iluzionin se ekziston një e ashtuquajtur "përmbajtje" e veprës së artit.

### III

Natyrisht, nuk e kam fjalën për interpretimin në kuptimin më të gjerë, kuptimin në të cilin Nietzsche (me të drejtë) thotë: "Nuk ka fakte, vetëm interpretime". Me interpretim nënkuptoj këtu një akt të vetëdijshëm të mendjes që ilustron një kod të caktuar, "rregulla" të caktuara interpretimi. I drejtuar nga arti, interpretimi do të thotë të shkëlqësh një grup elementësh (X, Y, Z, e kështu me radhë) nga e gjithë vepra. Detyra e interpretimit është praktikisht ajo e përkthimit të tij. Përkthyesi thotë: Shiko, a nuk e sheh se X është me të vërtetë - ose, me të vërtetë do të thotë - A? Se Y është

vërtet B?

Se Z është vërtet C?

Cila situatë mund ta shtyjë këtë sipërmarrje kureshtare për shndërrimin e një teksti? Historia na jep burimet për një përgjigje. Interpretimi shfaqet për herë të parë në kulturën e antikitetit të vonë klasik, kur fuqia dhe besueshmëria e mitit ishte thyer nga këndvështrimi "realist" i botës i paraqitur nga iluminizmi shkencor. Sapo u shtrua pyetja që shqetëson ndërgjegjen post-mitike - ajo e pamjes së simboleve fetare, tekstet e lashta, në formën e tyre të pacenuar, nuk ishin më të pranueshme. Pastaj u thirr interpretimi, për t'i pajtuar tekstet e lashta me kërkesat "moderne". Kështu, stoikët, në përputhje me pikëpamjen e tyre se perënditë duhej të ishin të moralshëm, alegorizuan veçoritë e vrazhda të Zeusit dhe rrethit të tij të zhurmsëm në epikat e Homerit. Ajo që Homeri vërtet caktoi nga tradhtia bashkëshortore e Zeusit me Leton, shpjeguan ata, ishte bashkimi midis fuqisë dhe mençurisë. Në të njëjtën mënyrë, Filoni i Aleksandrisë i interpretoi rrëfimet e drejtpërdrejta historike të Biblës hebraike si paradigma shpirtërore.

Historia e eksodit nga Egjipti, bredhja në shkretëtirë për dyzet vjet dhe hyrja në tokën e premtuar, tha Filo, ishte me të vërtetë një alegori e emancipimit, mundimeve dhe çlirimit përfundimtar të shpirtit individual. Pra, interpretimi presupozon një mospërputhje midis kuptimit të qartë të tekstit dhe kërkesave të lexuesve (më vonë). Ai kërkon të zgjidhë këtë mospërputhje. Situata është që

për ndonjë arsye një tekst është bërë i papranueshëm; megjithatë nuk mund të hidhet poshtë. Interpretimi është një qasje e tejskajshme për të ruajtur një tekst të vjetër, i cili mendohet shumë i çmuar për t'u hedhur poshtë, duke e ripërtërirë atë. Përkthyesi, pa e fshirë apo rishkruar tekstin, po e ndryshon atë. Por ai nuk mund ta pranohet ta bëjë këtë. Ai pandeh se po e bën atë të kuptueshëm, kur zbulon kuptimin e tij të vërtetë. Sado që interpretuesit e ndryshojnë tekstin (një shembull tjetër famëkeq janë interpretimet "shpirtërore" rabinike dhe të krishtera dhe qartësisht erotike.

### IV

*Kënga e Këngëve*, ata duhet të pretendojnë se po lexojnë një ndonjë që tashmë është atje.

Interpretimi në kohën tonë, megjithatë, është edhe më kompleks. Sepse zelli bashkëkohor për projektin e interpretimit shpesh nxitet jo nga devotshmëria ndaj tekstit të mundimshëm (që mund të fshehtë një sulm), por nga një ashpërsi e dukshme, një përbuzje e hapur ndaj paraqitjes. Stili i vjetër i interpretimit që këmbëngulës, por respektues; ai ngriti një kuptim tjetër mbi atë të fjalëpërfjalshëm. Stili modern i interpretimit gërmon, dhe ndërkohë që gërmon, shkatërron; gërmon "pas" tekstit, për të gjetur një nëntekst që është i vërtetë. Doktrinat moderne më të njohura dhe më me ndikim, ato të Marksit dhe Frojdit, në të vërtetë përbëjnë sisteme të përpunuara të hermeneutikës, teori të vrazhda dhe të pabesa të interpretimit. Të gjitha fenomenet e vëzhgueshme janë të vendosura në kllapa, në frazën e Frojdit, si përmbajtje e dukshme. Kjo përmbajtje e dukshme duhet të hetohet dhe të shtyhet mënjandë për ta gjetur kuptimin e vërtetë - përmbajtjen e fshehtë poshtë. Për Marksit ngjarjet shoqërore, si revolucionet dhe luftërat; për Frojdit, ngjarjet e jetëve individuale (si simptomat neurotike dhe rrëshqitjet e gjuhës) si dhe tekstet (si një ëndërr ose një vepër arti) - të gjitha trajtohen si raste për interpretim. Sipas Marksit dhe Frojdit, këto ngjarje duken vetëm se janë të kuptueshme. Në fakt, ato s'kanë kuptim pa interpretim. Të kuptosh është të interpretosh. Dhe të interpretosh do të thotë ta rishfaqësh dukurinë; në thelb, të glesh një barasvlerës për të.

Kështu, interpretimi nuk është (siç supozojnë shumica e njerëzve) një vlerë absolute, një gjest i mendjes i vendosur në një sferë të përjetshme të aftësive. Interpretimi vetë duhet të vlerësohet, brenda një këndvështrimi historik të ndërgjegjes njerëzore. Në disa kontekste kulturore, interpretimi është një akt çlirues. Është një mjet për të rishikuar, për të transvlerësuar, për t'i shpëtuar të shkuarës së vdekur. Në kontekste të tjera kulturore, ai është reaksionar, i paturpshëm,

frikacak, mbyttës.

Sot është një kohë e tillë, kur ndërmarrjet e interpretimit janë kryesisht reaksionare, mbyttëse. Ashtu si tymrat e automobilave dhe të industrisë së rëndë që ndotin hapësirën urbane, derdhja e interpretimeve të artit sot helmon ndjeshmërinë tonë. Në një kulturë, dilema tashmë klasike e së cilës është zvogëlimi i intelektit në kurriz të fuqisë dhe aftësisë sensuale, interpretimi është hakmarrja e intelektit ndaj artit.

Edhe më shumë. Është hakmarrja e intelektit ndaj botës. Të interpretosh do të thotë të varfërosh, ta varfërosh botën - në mënyrë që të krijosh një shkëndijë "kuptimesh" për botën. Është për ta kthyer botën në këtë botë.

("Kjo botë"! Sikur të kishte ndonjë tjetër.)

Bota jonë është shteruar, e varfëruar mjaftueshëm. Larg çdo kopjeje të saj, derisa të përjetojmë përsëri menjëhershëm atë që kemi.

### V

Në të shumtën e rasteve moderne, interpretimi është një ngurrim filistin për ta lënë vetëm veprën e artit. Arti i vërtetë ka aftësinë të na bëjë nervozë. Kur e shkrin veprën e artit në përmbajtjen e saj dhe më pas e interpreton me kujdes, njeriu ia del në krye, duke e bërë atë më të butë dhe më të zotërueshëm.

Ky filistinizëm i interpretimit është më i përhapur në letërsi se në çdo art tjetër. Tash e dekada, kritikët letrarë e kanë kuptuar se është detyrë e tyre t'i përkthejnë elementet e poemës, dramës, romanit ose tregimit në diçka tjetër. Ndonjëherë një shkrimtar do të jetë aq i shqetësuar para fuqisë së zhveshur të artit të tij, sa që do të vendosë brenda vetë veprës - megjithatë me pak ndrojtje, një prekje të shijes së mirë të ironisë - interpretimin e qartë dhe të drejtpërdrejtë të saj. Tomas Mani është një shembull i një autori të tillë tepër bashkëpunues. Në rastin e autorëve më kokëfortë, kritiku është shumë i lumtur për ta kryer punën.

Vepra e Kafkës, për shembull, i është nënshtruar një përgjakjeje masive nga jo më pak se tri ushtri përkthyesish. Ata që e lexojnë Kafkën si një alegori sociale shohin raste studimore të frustrimeve dhe çmendurisë së burokracisë moderne dhe nxjerrjes së saj përfundimtare në shtetin totalitar.

Ata që e lexojnë Kafkën si një alegori psikoanalitike shohin zbulime të dëshpëruara të frikës së Kafkës ndaj babait, ankthet e tij të treshjes, ndjenjën e pafuqisë, trillimin e ëndrrave të tij.

Ata që e lexojnë Kafkën si një alegori fetare shpjegojnë se K. në librin *Kështjella* po përpigjet të hyjë në parajsë, se Josef K. në *Procesin* e tij po gjykohet nga drejtësia e paepur dhe misterioze e Zotit... Një tjetër vepër që ka tërhequr interpretues si shushunjat është ajo e Samuel

Beketit. Dramat delikate të vetëdijes së tërhequr të Beketit - të ndara deri te më thelbësoret, të prera, shpesh të përfaqësuar si të palëvizshme fizikisht - lexohen si një shpallje për tjetërsimin e njeriut modern nga kuptimi ose nga Zoti, ose si një alegori psikopatologjie.

Prusti, Xhojsi, Folkneri, Rilke, Lorenci, Zhidi... dikush mund të vazhdojë të citojë autor pas autori, lista është e pafundme e atyre rreth të cilëve kanë zënë ngërçe të dendura interpretimi, por duhet theksuar se interpretimi nuk është thjesht komplimenti që mediokriteti i bën gjenit. Është, në të vërtetë, mënyra moderne për të kuptuar diçka dhe zbatohet për vepra të çdo cilësie. Kështu, në shënime të Elia Kazani botoi në prodhimin e tij *Një tramvaj quhet dëshira*, bëhet e qartë se, për ta drejtuar shfaqjen, Kazani duhej të zbulonte se Shtenli Kowalski përfaqësonte barbarizmin sensual dhe hakmarrës që po përfshinte kulturën tonë, ndërsa Blansh Du Bua ishte qytetërimi perëndimor, poezi, veshje delikate, ndriçim të zbehtë, ndjenja të rafinuara dhe gjithçka, megjithatë pak më keq për t'u veshur. Melodrama e fuqishme psikologjike e Tenese Uilliamsit tani u bë e kuptueshme: bëhej fjalë për diçka, për rënien e qytetërimin perëndimor.

Me sa duket, nëse do të vazhdonte të ishte një shfaqje për një bruneje të pashme të quajtur Stanli Kowalski dhe një bukuroshe të zbehur të quajtur Blansh Du Bua, nuk do të ishte e zotërueshme.

Nuk ka rëndësi nëse artistët synojnë apo nuk kanë ndër mend që veprat e tyre të interpretohen. Ndoshta Tenese Uilliamsi mendon se tramvaji ka të bëjë me atë që Kazani mendon se është. Ndoshta Kokteau në librin *Gjaku i një poeti* dhe tek *Orfeu* donte leximet e hollësishtme që u janë dhënë këtyre filmave, për sa i përket simbolizmit frojdian dhe kritikës sociale. Por merita e këtyre veprave sigurisht që qëndron diku tjetër dhe jo në "kuptimet" e tyre. Në të vërtetë, është pikërisht në masën që dramati e Uilliamsit dhe filmat e Kokteaus sugjerojnë këto kuptime të çuditshme që ato janë të meta, të rreme, të sajuara, pa bindje.

Nga intervistat, duket se Alen Rene dhe Alen Rob-Grijje projektuan me vetëdije *Vitin e shkuar* në *Marienbad* për të pritur një mori interpretimesh po aq të besueshme. Por tundimit për të interpretuar *Marienbadin* duhet t'i bëhet ballë. Ajo që ka rëndësi në *Marienbad* është menjëhershëmëria e pastër, e papërkthyeshme, sensuale e disa prej imazheve të tij dhe zgjidhjet e tij rigorozë, nëse të ngushta, për disa probleme të formës kinematografike.

Përsëri, Ingmar Bergmani mund të ketë nënkuptuar tankun që gjëmonte në rrugën e zbrazët të natës në *Heshtjen* si një simbol fallik. Por nëse e bënte, ishte një



mendim i marrë. ("Mos i beso kurrë tregimtarit, besoji përrallës", tha Lorenci). Marrë si një objekt i zhveshur, si një përputhje e menjëhershme shqisore për ndodhitë e papritura, të blinduara e të mistershme brenda hotelit, ajo sekuencë me tankun është çasti më goditës i filmit.

Ata që mbështeten në një interpretim frojdian të tankut nuk bëjnë tjetër veçse shfaqin mungesën e tyre të përgjigjes ndaj asaj që gjendet përpara syve në ekran.

Është gjithmonë rasti që interpretimi i këtij lloji tregon një pakënaqësi (të ndërgjegjshme ose të pavetëdijshme) me punën, një dëshirë për ta zëvendësuar atë me diçka tjetër.

Interpretimi, i bazuar në teorinë shumë të dyshimtë, se një vepër arti përbëhet nga elementë të përmbajtjes, cenon artin. Ai e bën artin si një artikull për përdorim, për rregullimin në një skemë të përgjithshme kategorish.

## VI

Natyrisht, interpretimi nuk mbizotëron gjithmonë. Në fakt, një pjesë e madhe e artit të sotëm mund të kuptohet si i motivuar nga një largim nga interpretimi. Për ta shmangur interpretimin, arti mund të bëhet parodi. Ose mund të bëhet abstrakt. Ose mund të bëhet ("thjeshtë") dekorativ. Ose mund të bëhet jo-art.

Ikja nga interpretimi duket veçanërisht një tipar i pikturës moderne. Piktura abstrakte është përpjekja për të mos pasur, në kuptimin e zakonshëm, përmbajtje; meqenëse nuk ka përmbajtje, nuk mund të ketë interpretim. Pop arti funksionon në të kundërtën e të njëjtit përfundim; duke përdorur një përmbajtje kaq të padyshimtë, aq "çfarë është", ajo gjithashtu përfundon duke qenë e pakuptueshme.

Edhe një pjesë e madhe e poezisë moderne, duke u nisur nga eksperimentet e mëdha të poezisë franceze (përfshirë lëvizjen që në mënyrë mashtroese quhet simbolizëm) për të vendosur heshtjen në poezi dhe për ta rikthyer magjinë e fjalës, ka shpëtuar nga kontrolli i ashpër i interpretimit.

Revolucioni më i fundit në shijen bashkëkohore në poezi - revolucionin që ka rrëzuar Elioti dhe ka ngritur Paundi përfaqëson një largim nga përmbajtja në poezi në kuptimin e vjetër, një padurim me atë që e bëri poezinë moderne pre e zellit të interpretuesve.

E kam fjalën kryesisht për situatën në Amerikë, dhe është e natyrshme.

Interpretimi është i shfrenuar këtu në ato arte me një avangardë të dobët dhe të papërfillshme: fikcioni dhe drama. Shumica e romancierëve dhe dramaturgëve amerikanë janë në të vërtetë ose gazetarë ose zotërinj sociologë dhe psikologë. Ata shkruajnë përngjasimin letrar të muzikës

programore.

Dhe kaq fillestar, i pafrymëzuar dhe i ndenjtur ka qenë kuptimi i asaj që mund të bëhet me formën në trillim dhe dramë, saqë edhe kur përmbajtja nuk është thjeshtë të dhëna, lajm, ajo është ende në mënyrë të veçantë e dukshme, më e lehtë, më e zbuluar. Në masën që romanet dhe shfaqjet (në Amerikë), ndryshe nga poezia, piktura dhe muzika, nuk pasqyrojnë ndonjë shqetësim interesant me ndryshimet në formën e tyre, këto arte mbeten të prira ndaj sulmeve nga interpretimi.

Por avangardizmi programatik - që ka nënkuptuar kryesisht eksperimente me formën në kurriz të përmbajtjes - nuk është mbrojtja e vetme kundër infektimit të artit nga interpretimet. Të paktën, shpresoj që jo. Sepse kjo do të ishte të angazhohej arti për të qenë vazhdimisht në arrati. (Ai gjithashtu përjetëson vetë dallimin midis formës dhe përmbajtjes që është, në fund të fundit, një iluzion.) Në mënyrë ideale është e mundur t'u shmangemi interpretuesve në një mënyrë tjetër, duke bërë vepra arti, sipërfaqja e të cilave është kaq e unifikuar dhe e pastër, vrulli i të cilave është kaq rrufeshëm, vendi i të cilit është aq i drejtpërdrejtë sa puna mund të jetë... ashtu siç është. A është e mundur kjo tani? Kjo ndodh në filma, besoj. Kjo është arsyeja pse kinemaja është më e gjalla, më emocionuesja, më e rëndësishmja nga të gjitha format e artit tani. Ndoshta mënyra se si dikush tregon se sa e gjallë është një formë e veçantë arti, është nga gjerësia që jep për të bërë gabime në të, dhe prapë të jesh mirë. Për shembull, disa nga filmat e Bergmanit - edhe pse të mbushur me mesazhe të çalë për frymën moderne, duke bërë kështu interpretime ftuese - prapë triumfojnë mbi synimet mburravece të regjisorit të tyre. Në *Drita e dimrit dhe heshtja*, bukuria dhe mashtrimi pamor i pamjeve përmbysin para syve tanë pseudo-intelektualitetin e çuditshëm të tregimit dhe disa prej dialogëve. (Shembulli më i shquar i këtij lloji mospërputhjeje është puna e D. W. Griffith.) Në filmat e mirë ka gjithmonë një drejtësi që na çliron tërësisht nga kruajtja për të interpretuar. Shumë filma të vjetër të Hollivudit, si ato të Cukor, Ualsh, Hauks dhe regjisorë të tjerë të panumërt, kanë këtë cilësi çlirimtare antisimbolike, jo më pak se vepra më e mirë e regjisorëve të rinj evropianë, si *Truffaut's Shoot the Piano Player* dhe *Jules and Jim*. *Godard's Breathless dhe Vivre Sa Vie*, *L'Avventura e Antonioni* dhe *Të fejuarit e Olmit*.

Fakti që filmat nuk janë kapërcyer nga interpretuesit është pjesërisht për shkak të risive të kinemasë si art. I detyrohet edhe rastësisë së lumtur që filmat për një kohë kaq të gjatë ishin vetëm filma; me fjalë të tjera, se ata kuptoheshin se ishin pjesë e



masës, në krahasim me kulturën e lartë, dhe u lanë vetëm nga shumica e njerëzve me mendje. Pastaj, gjithashtu, ka gjithmonë diçka tjetër përveç përmbajtjes në kinema për të kapur, për ata që duan të analizojnë. Meqenëse kinemaja, ndryshe nga romani, zotëron një fjalor formash - teknologjinë eksplicite, komplekse dhe të diskutueshme të lëvizjeve të kamerës, prerjes dhe përbërjes së kornizës që hyn në realizimin e një filmi.

Çfarë lloj kritike, komenti për artet, është e dëshirueshme sot?

Sepse nuk po them se veprat e artit janë të pashprehura, se ato nuk mund të përshkruhen apo parafrazohen. Ato mund të jenë. Pyetja është se si. Si do të dukej kritika që do t'i shërbente veprës së artit, jo t'i uzurponte vendin?

Ajo që duhet, së pari, është më shumë vëmendje ndaj formës në art. Nëse stresi i tepërt në përmbajtje provokon arrogancën e interpretimit, përshkrimet më të zgjeruara dhe më të plota të formës do të heshtin. Ajo që nevojitet është një fjalor - një fjalor përshkrues dhe jo përshkrimor - për format. Kritika më e mirë, dhe është e pazakontë, është e këtij lloji.

Për filmin, dramën dhe pikturën, respektivisht, mund të mendoj për esenë e Erwin Panofski, "*Stili dhe mediumi në filmat*", eseja e Northrop Frajit, "*Një përmbledhje e zhanreve dramatike*", eseja e Pier Frankastelit, "*Shkatërrimi i një hapësire plastike*". Libri i Roland Bartit, *Mbi Rasinin* dhe dy esetë e tij mbi Rob Griles janë shembuj të analizës formale të aplikuar në punën e një autori të vetëm. (Esetë më të mira në *Mimesisin* e Erik Auerbahut, si dhe "*Plaga e Odiseut*", janë, gjithashtu, të këtij lloji.) Një shembull i analizës formale të aplikuar njëkohësisht për zhanrin dhe autorin është eseja e Ualter Benjaminit, "*Përshkruesi i historisë: reflektime mbi veprat e Nikolai Leskovit*".

Po aq të vlefshme do të ishin aktet e kritikës që do të ofronin një përshkrim vërtet të saktë, të mprehtë dhe të dashur të pamjes së një vepre arti. Kjo duket edhe më e vështirë për t'u bërë sesa analiza formale. Disa nga kritikantët e filmit të Mani Farberit, eseja e Dori Van Gentit "*Bota e Dikensit*".

"*Një pamje nga Toxhersi*", eseja e Randall Xharellit mbi Ualt Uitmanin janë ndër shembujt e rrallë të asaj që dua të them. Këto janë ese që zbulojnë sipërfaqen sensuale të artit pa u përbuzur në të.

Transparenca është vlera më e lartë, më çliruese në art - dhe në kritikë - sot. Transparenca do të thotë ta përjetosh ndriçimin e sendit në vetvete, të gjërave që janë ato që janë. Kjo është madhështia e, për shembull, filmave të Breso dhe Ozu dhe Reno, *Rregullat e lojës*.

Njëherë e një kohë (të themi, për Danten), duhet të ketë qenë një lëvizje revolucionare dhe krijuese për të projektuar vepra arti në mënyrë që ato të mund të përjetoheshin në disa nivele. Tani nuk është. Ai përforcon parimin e tepërcës që është vuajtja kryesore e jetës moderne.

Dikur (një kohë kur arti i lartë ishte i pakët), duhet të ketë qenë një lëvizje revolucionare dhe krijuese për t'i interpretuar veprat e artit. Tani nuk është. Ajo që ne vendosëm se nuk kemi nevojë tani është ta asimilojmë artin në mendim, ose (më keq akoma) artin në kulturë.

Interpretimi e merr si të mirëqenë përvojën shqisore të veprës së artit dhe rrjedh prej andej. Kjo nuk mund të merret si e mirëqenë tani.

Mendon për shumëzimin e plotë të veprave të artit të disponueshme për secilin prej nesh, të shtuara ndaj shijeve, aromave dhe pamjeve kontradiktore të mjedisit urban që bombardojnë shqisat tona. E jona është një kulturë e bazuar në teprim, në mbiproduhim; rezultati është një humbje e vazhdueshme e mprehtësisë në përvojën tonë shqisore. Të gjitha kushtet e jetës

moderne - plotësia e saj materiale, format e rrëfimit. Ndoshta kritika filmike do të jetë rasti i një përparimi këtu, pasi filmat janë kryesisht një formë pamore, por janë edhe një nënndarje e letërsisë.

Një nga vështirësitë është se ideja jonë për formën është hapësinore (metaforat greke për formën rrjedhin të gjitha nga nocionet e hapësirës). Kjo është arsyeja pse ne kemi një fjalor më të gatshëm të formave për artet hapësinore sesa për artet kohore. Përrjashtim midis arteve të përkohshme, natyrisht, është drama; ndoshta kjo sepse drama është një formë narrative (d.m.th., kohore) që shtrihet vizualisht dhe pikturalisht, në një skenë... Ajo që ende nuk e kemi është një poetikë e romanit, një nocion i qartë i një mbledhjeje të pastër që lidhet për t'i zbehur aftësitë tona shqisore. Dhe është në dritën e gjendjes së shqisave tona, të mundësive tona (më shumë sesa ato të një epoke tjetër), që detyra e kritikës duhet të vlerësohet. Ajo që është e rëndësishme tani është t'i përmirësojmë shqisat tona. Ne duhet të mësojmë të shohim më shumë, të dëgjojmë më shumë, të ndjejmë më shumë.

Detyra jonë nuk është të gjejmë tepri sa më të madhe të vetë përmbajtjes në një vepër arti, aq më pak të nxjerrim më shumë përmbajtje nga vepra sesa është tashmë atje. Detyra jonë është ta shkurtrojmë përmbajtjen në mënyrë që të mund ta shohim atë gjë.

Qëllimi i të gjithë komenteve mbi artin tani duhet të jetë që veprat e artit - dhe, për analogji, përvoja jonë - më shumë, sesa më pak, reale për ne.

Funksioni i kritikës duhet të jetë të tregojë se si është ajo që është, madje që është ajo që është, sesa të tregojë se çfarë do të thotë.

Në vend të një hermeneutike na duhet një erotikë e artit.

Përktheu nga anglishtja:  
Kadri MEHMETI

Marrë nga numri 22 i revistës  
"Akademia"



EZOPI

# SHQIPONJA DHE DHELPA

Një shqiponjë zuri miqësi me një dhelpër dhe të dyja vendosën t'i ndërtonin foletë e tyre pranë e pranë për ta forcuar edhe më tepër miqësinë. Shqiponja u ngjit në një pemë të lartë dhe i çeli aty zogjtë e vet, kurse dhelpëra i polli këlyshët në rrënjët e saj. Njëherë dhelpëra kish dalë për

gjueti dhe shqiponja e uritur, zbriti nën pemë, rrëmbeu këlyshët e dhelpërs dhe i hëngri me zogjtë e saj.

Kur u kthye dhelpëra dhe e kuptoi se ç'kishte ndodhur nuk i erdhi aq keq për humbjen e këlyshëve sesa për atë që s'mund t'ia shpërblente me të njëjtën mënyrë. Sepse, si kaf-

shë toke që ishte, s'mund të gjuante një zog qielli. Prandaj qëndroi diku larg dhe bëri atë që iu mbetet më të dobëtëve dhe më të pafuqishmëve, të përgjonte armi-kun e saj. Por punët erdhën në atë mënyrë, që shqiponja të ndëshkohej rreptë për prishjen e miqësisë. Disa njerëz kishin therur

një dhi aty pranë. Shqiponja shigjetoi nga lart, rrëmbeu nga zjarri të brendshmet e ngrohta të dhisë dhe i solli në follenë e vet. Sapo i la aty, fryu një erë e fortë dhe pas pak një degë e thatë mori zjarr. Shqiponjat e vogla, ende pa flatra, u hutuan nëpër flakë dhe ranë në tokë. Dhelpëra i

zuri dhe i hëngri të gjitha para syve të shqiponjës.

Fabula tregon, se ata që tradhtojnë miqësinë, edhe nëse i shpëtojnë gjykimit të atyre, ndaj të cilëve kanë bërë padrejtësi, meqë këta të fundit janë të pafuqi-shëm, nuk i shpëtojnë dot ndëshkimit të Zotit.

# SHQIPONJA, SORRA DHE BARIU

Një shqiponjë shigjetoi me vrull nga një shkëmb i lartë dhe rrëmbeu një qengj. Një sorrë që e pa, plasi nga zilia dhe deshi të bënte edhe ajo të

njëjtën gjë. U ul me zhurmë dhe qëndroi mbi një dash. Por thonjtë iu mplek-sën në leshin e dashit, aq sa nuk mundi të ngrihej. Rrahu ajrin

me flatra me aq forcë, sa e pikasi bariu, i cili i shkoi pranë, e zuri dhe i preu disa pendë. Në mbrëmje e mori me vete dhe ua shpuri fëmi-

jëve. Kur ata e pyetën se ç'lloj zogu ishte ky, ai u përgjigj: - Është një sorrë që e mban veten për shqiponjë.

Kush shkon pa mend, për të

arritur më të mëdhenjtë se vetja e vet, bën gjithfarë marrëzish dhe, përveç fat-keqësive që pëson, bëhet edhe qesharak.



# SHQIPONJA DHE BRUMBULLI

Një shqiponjë po ndiqte një lepur, e meqë lepurit nuk gjeti askënd që ta ndihmonte atë çast, pa një brumbull dhe i kërkoi ndihmë. Brumbulli u tregua i gatshëm dhe sapo pa shqiponjën t'i afrohej, iu lut të mos e rrëmbente atë që i

kërkoi ndihmë. Shqiponja e pa brum-bullin e vogël, nuk ia vuri veshin dhe e përblau lepurin para syve të tij. Brumbulli ia mbajti vath në vesh dhe që nga ai çast e vrojtonte, për të parë se ku do ta ndër-tonte follenë. Çdoherë që ajo pillte

vezë, brumbulli fluturonte, zhgërryhej mbi vezë dhe ia bënte copa-copa. Më në fund shqiponja i humbi krejtësisht shpre-sat, prandaj shkoi te Zeusi dhe i kërkoi një vend të sigurt për zogjtë e saj. Zeusi e lejoi të pillte në gjok-sin e tij,

por brumbulli pa gjithçka, bëri një top me bajga, u ngrit lart, dhe kur u gjend mbi gjoksin e Zeusit, e lëshoi. Duke dashur të shkundte bajgat nga trupi, Zeusi u ngrit dhe vezët ranë përtokë. Qysh atëherë, duan të thonë, se kur dalin

brumbujt, shqiponjat nuk pjellin.

Fabula na mëson të mos na shkojë ndër mend të përbu-zim askënd, se nuk ka asnjë aq të pazot, sa të mos hak-merret kur t'i paraqitet rasti.

# BILBILI DHE SKIFTERI

Një bilbil kish qëndruar në një lis të lartë dhe nuk reshte së kënduari. Një skifter i uritur e pa, u lëshua mbi të dhe e kapi. Bilbili,

i bindur për fundin e tij tragjik, iu lut ta linte të shkonte, si ai nuk mjaftonte për ta mbushur barkun e skifterit e meqë ai ishte

i uritur, do të ishte më mirë të gjuante zogj më të mëdhenj se bilbili. Po skifteri iu përgjigj: - Do të isha krejt pa mend në

qoftë se do të lëshoja prenë që kam në dorë dhe të gjuaja të tjerë që nuk m'i zë syri gjëkund.

Fabula tregon, se edhe te

njerëzit, të pamend janë ata që braktisin ç'kanë në dorë, me shpresë se do të gjejnë më shumë.

# HUAMARRËSI

Në Athinë një njeri kish nevojë për një dorë të hollash, prandaj iu lut huadhënësit t'i jepte diçka dhe t'i caktonte një kohë shlyerje. Po meqë nuk mundi t'ia kthente në kohën e

duhur, mori dosën e vetme që kish dhe e shpuri për ta shitur mu përpara syve të huadhë-nësit. Kur iu afrova një blerës dhe e pyeti nëse dosja ishte për të pjellë, ai iu përgjigj, se jo

vetëm që ishte por, sipas mistereve të Elefsinës, lindte femra, ndërsa sipas mistereve të Athinës, meshkuj. Meqë blerësi u çudit fort me fjalët e tij, ndërhyri huadhënësi dhe i

tha: - Mos u çudit aspak, sipas mistereve të Dionisisë, dosja do pjellë keca.

Fabula tregon se shumë njerëz, kur duan të fitojnë, nuk mëdyshejnë të gënjejnë edhe për


gjëra të pamun-dura.

Përktheu nga greqishtja:

Iliaz BOBAJ

Marrë nga numri 22 i revistës

"Akademia"



DAVID LODGE

# NDJESIA E VENDIT

Në LA nuk mundesh me bo kurrigjo nëse nuk vozitë. E unë s'muj me bo kurrigjo nëse s'pi. E kombinimi pije - makinë vërtet është i pamundur. Nëse veç e liron rripin e sigurisë ose e shkund hirin e cigares ose i shtin gishtat në hundë, atëherë vjen autopsia e Alkatrazit me pyetje të shtrueme ma vonë. Çfarëdo mosdisipline, çdo shkelje dhe ja ku e ke altoparlantin, do shënjestra edhe një derr në kopter që këqyr me ta vizatu kokrrën në qilim.

E çka mundet me bo një djalë i shkretë? Del nga hotel *Vraimonti*. Përtej Wattsin që zien, ku horizonti i qendrës bart njolla qurrash jeshile të Zotit. Ec majtas, ec djathtas, si ni grumbull minjsh në lumin e shpejtë që përplasat. Ky restorant nuk shërben pije, tjetri nuk shërben mish, ky tjetri s'u shërben heteroseksualëve. Mundesh me e la shimpanzën, mundesh me e bo tatuazh k...n, njëzet e katër orë, por a mundesh me hongër bukë? Dhe nëse e sheh një tabelë në anën e largët të rrugës që thotë MISH - PIJE - QAQ, harroje. E vetmja mënyrë për me e kalu rrugën

është nëse lind andej. Të gjitha shenjat për kalimin e këmbësorëve thonë MOS EC, krejt, gjithë kohës. Ky mesazh është përmbajtja e Los Anxhelosit: mos ec. Rri mrena. Mos ec. Vozit. Mos ec. Vrapo! Provova taksitë. Kot. Taksistat janë të gjithë Saturnian që as vetë s'janë të sigurt nëse ky është planet i djathtë apo i majtë. Seni i parë që duhet me bo, në çdo udhëtim, është me i mësu me vozit.

MARTIN AMIS Paratë (1984)

SIÇ ËSHTË BËRË TASHMË E QARTË për lexuesin, ndarja e librit tim, arti i fiksionit, në "aspekte" të ndryshme është disi artificiale. Ndikimet në fikcione janë të shumta dhe janë të ndërlidhura, ku secili aspekt shfrytëzon dhe kontribuon te tjetri. Fragmenti i përzgjedhur i veprës *Paratë* të Martin Amisit, si shembull i përshkrimit të vendit, mund të kishte shërbyer po aq mirë për ta ilustruar *Skazin* ose Defamiljarizimin, si edhe ndonjë temë të paprekur ende. Kjo është edhe një formë tjetër të thuhet se përshkrimi në

romanin e mirë kurrë s'është *vetëm* përshkrim.

Ndjësia e vendit është zhvillim mjaft i vonshëm në historinë e prozës. Siç e vërejtë Mikhail Bakhtini, qytetet e romancave klasike, për intrigën, janë perde të këmbëshme: nga ajo që na është thënë, Efesi mund të ketë qenë edhe Korinti ose Sirakuza. Romancierët e hershëm anglezë pothuajse nuk ishin shumë specifikë për vendin. Për shembull, në romanet e Defoesë ose të Fieldingut, Londrës i mungojnë hollësitë e gjalla vizuale të Londrës së Dickensit. Kur Tom Jones mbërrin në kryeqytet në kërkim të Sofisë së tij të dashur, narratori na thotë se ai:

ishite krejt i huaj në Londër; dhe ndërsa mbërriti së pari në një lagje të qytetit, banorët e së cilës kishin shumë pak komunikim me pronarët e shtëpive në sheshin Hanoveri ose sheshin Grosvenor (sepse ai hyri përmes rrugës *Grey's Inn*), brodhi për ca kohë, para se ta gjente rrugën te pallatet fatlume, ku Luksozja ndahet nga e rëndomta... paraardhësit

e të cilëve, të lindur në ditë më të mira, shkak i meritave të ndryshme, sollën pasuri dhe nder te pasardhësit e tyre.

Siç interpretohet nga vizioni ironik i autorit, Londra përshkruhet tërësisht në terma të variacioneve të klasës dhe statusit të banorëve. Nuk bëhet asnjë përpjekje që lexuesi "ta shohë" qytetin, apo ta përshkruajë ndikimin e tij shqisor te një i ri i ardhur nga fshati për herë të parë. Krahasoni përshkrimin e Dickensit për ishullin e Jakobit në librin *Oliver Twist*:

Për të arrirë në këtë vend, vizitori duhet të depërtojë nëpër një labirint rrugësh të fshehta, të ngushta dhe me baltë, të mbushura me njerëz të pagdhundur dhe të varfër të buzëujit... Produktet më të lira dhe më të dobëta grumbullohen përgjyq në dyqane; artikujt më jociësorë dhe më të thjeshtë të veshjeve varen në dyert e shitësve, që derdhen nga muri i ulët dhe dritaret e shtëpive... ai ecën poshtë ballinave të shtëpive që lëkunden e që dalin mbi

trotuar, muret e zhveshura sikur tunden ndërsa kalon, oxhaqet gjysmë të shkatërruara, gjysmë të rropatura të bien, dritaret e mbrojtura nga shufrat e hekurit të ndryshkur që koha dhe pislleku pothuajse i kanë ngrënë, çdo shenjë e imagjinueshme e shkretimit dhe e shpërfilljes.

*Tom Jones* u botua në vitin 1749, ndërsa *Oliver Twist* në vitin 1838. Ndërhyrja e lëvizjes së Romantizmit përsiati mbi efektin e *mjedisit* te njeriu, hapi sytë e njerëzve ndaj bukurisë sublime të peizazhit dhe me kohë, ndaj simbolizmit të zymtë të peizazheve të qytetit në epokën industriale.

Martin Amis është përfaqësues i vonë i traditës dikensiane të gotikës urbane. Vështrimi i tij mahnitës dhe tronditës në qytetin postindustrial pajton vizionin apokaliptik të kulturës dhe të shoqërisë në një gjendje të skajshme shkatërrimi. Ashtu sikurse te Dickensi, ambientet e tij shpesh duken më të animuara se personazhet, sikur jeta të shterëj nga njerëzit e të rishfaqej në formë demonike,





destruktive në gjëra: rrugë, makina, vegla.

Narratori i veprës *Paratë*, John Self (Amis gjithashtu ndjek lojën dikensiane me emrat) nuk është tamam personazh komplekse ose simpatik. Ai është *profesionist i ri urban* i ligë, i dhënë pas ushqimit të shpejtë dhe makinave të shpejta, ushqimit të keq dhe pornografisë. Ai udhëton mes Anglisë dhe Amerikës në përpjekje të lidhë një marrëveshje filmi që do ta pasuronte. Londra dhe Nju-Jorku janë lokacionet kryesore të veprimit të tij. Kjo e fundit është më përpara sa i përket mjerimit fizik dhe moral, por natyra e biznesit, detyrimisht e shpërndarjes së Selfin në Los Anxhelos, kryeqytetin e industrisë së filmit.

Sfida e formës së zgjedhur të këtij romani është që stili të jetë edhe përshkrim elokuent i djerrinës urbane edhe shprehës i karakterit të plogët, vizionngushtë, akulturor të narratorit. Amis e menaxhon këtë truk të vështirë duke maskuar aftësitë e tij letrare pas breshërisë së zhargoneve rrugore, sharjeve, fyerjeve dhe shakave. Narratori flet të folmen e Atlantikut të mesëm që pjesërisht rrjedh nga kultura popullore dhe masmediat dhe pjesërisht nga sajimet e mundshme të Amisit. Për shembull, për ta deshifruar paragrafin e parë të këtij fragmenti duhet të dini se Alkatrazi është burg i famshëm kalifornian, se "derri" është term abuzues për policin, se "me ta vizatu kokrrën" do të thotë të marr në shenjë, "qilimi" është zhargon amerikan për parukë (megjithëse Selfi e përdor për t'iu referuar flokëve të vërteta), dhe supozojmë se "kopter" është pjesë e fjalës që rrjedh nga "helikopter". Metafora për qiellin e ndotur të qytetit, "njolla qurrash jeshile të Zotit", shenjon perëndinë e Dhiatës së Vjetër që ngryset mbi Sodomën e sotme dhe është po aq e papritur sikur të poezia "Kënga e dashurisë së J. Alfred Prufrock" e T. S. Eliotit "kur mbrëmja t'shtrihet për qielli/si pacient gati për operim mbi tavolinë", po ashtu i detyrohet diçka edhe përshkrimi të detit nga Stefan Dedalusi si "jeshil qurrash", në episodin e parë të *Ullisit*. Por, përderisa Prufrocku ka pretendime të larta kulturore dhe Stefani me vetëdije shtrembëron epitetin e pëlqyer të Homerit për detin, "verë -errët", John Selfi duket, thjesht, sikur zemërim i një nxënësi dhe kjo na shpërqendron nga sofistikimi letrar i imazhit.


Tropi kryesor i përshkrimit të Los Anxhelosit është hiperbola ose mbivlerësimi. Në këtë rrafsh ajo i ngjan rrëfimit *skaz*, *Rojë në thekërishte* të përmendur më

parë. Por, fragmenti i Amisit është më shumë një skenë retorike se gjithçka tjetër në romanin e Salingerit. Ai realizon një seri variacionesh të ekzagjeruara në mënyrë komike mbi temën e zakonshme, p.sh., se Los Anxhelosi është qytet i dhënë dhe i dominuar nga makinat ("E vetmja mënyrë për me e kalu rrugën është nëse lind andej"); dhe mbi vëzhgimet e pazakonshme se Amerika favorizon shitore të lira me pakicë dhe se shoferët e taksive amerikanë shpesh janë emigrantë të rinj që nuk i dinë rrugët.

Jo shumë kohë më parë, me të mbërritur në Boston, mora një taksi, shoferi i të cilit bëri tri përpjekje, i ndihmuar nga konsultimi radiotelefonik në rusisht me komandë, para se ta gjejë rrugën e daljes nga aeroporti. Nuk është e lehtë të ekzagjerohet kjo lloj paaftësie, mirëpo Amisi e gjeti mënyrën: "Taksistat janë krejt Saturnianë që as vetë s'janë të sigurt nëse ky është planet i djathtë apo i majtë. Seni i parë që duhet me bo, në çdo udhëtim, është me i mësu me vozit". Jehona e sloganit të zakonshëm për mbajtjen e rripit të sigurisë, "Klank Klink, çdo udhëtim", ndjek menjëherë aludimin për fantashkencë - proza e Amisit argëtohet me pranëvënienë të tilla, të nxjerra nga *plehurat* e ndërdijes urbane bashkëkohore. Kjo jehonë, gjithashtu, përforcon ritmin e hareshëm si kërcitje gishtash të të gjithë fragmentit, që në një çast të veçantë rrëmbyes rrezikon të shpërthejë në vargje të rihuara ("You can get your chimp shampooed, you can get your dick tattooed") (në *shqip nuk rimojnë folja laj dhe emri tatuazh*).

Rreziku i shumicës së përshkrimeve të skenës së vendit (romanet e Sir Walter Scott janë shembuj të tillë) është se vargu i fjalive deklarative të mirëformuara, të kombinuara me suspansën e vonimit narrativ, e vënë lexuesin në gjumë. Këtu nuk ekziston ai rrezik. Koha e tashme përshkruan si vendin ashtu edhe lëvizjen e narratorit nëpër të. Ndryshimet në mënyrat e foljes - nga dëftore ("Del nga hoteli") në pyetëse ("por a mundesh me hongër drekë?") në urdhërore ("Mos ec. Vozit. Mos ec. Vrapo!") dhe përemri i përgjithshëm në vetën e dytë ("Ti ec majtas, ec djathtas") - e përfshijnë lexuesin në proces. Pas leximit të shumë faqeve të këtij lloji shkrimi, mund t'ju zë gjumi nga lodhja, por jo nga mërzia.

Përktheu nga anglishtja:  
Meliza KRASNIQI  
Marrë nga numri 22 i revistës  
"Akademia"



CHARLES BAUDELAIRE

## GRUAJA E EGER DHE GRUAJA HUNDËPËRPIJETË

Ju më lodhni me të vërtetë pa masë dhe pa mëshirë, e dashur. Kur ju dëgjoj që psherëtim, më krijohet përshtypja sikur vuani më tepër se gratë gjashtëdhjetëvjeçare që mbledhin kallinj të grurit në fushë apo plakat lypsare që mbledhin krodhet e bukës të dyert e kabareve.

Psherëtimat tuaja do t'ju nderonin në qoftë se do ta shprehnin brejtjen e ndërgjegjes të paktën, por ato nuk shprehin gjë tjetër veçse makutërinë e mirëqenies dhe topitjen e pushimit. Për më tepër, ju nuk pushoni së dërdëllituri me këmbë e me duar fjalë të kota: - Ju duhet të më dashuron! Kam shumë nevojë për dashurinë tuaj! Më ngushëlloni dhe më përkëdhelini pak.

Mos u mërziqni se do të përpiqem t'ju shëroj. Do të gjej më ndoshta një mënyrë me pak shpenzime, diku në mes të një feste, dhe pa shkuar shumë larg.

Përfytyroni një kafaz të fortë prej hekuri brenda të cilit lëviz pa pushim, duke bërë titur si një i burgosur, duke tundur shufrat si një orangutang i dëshpëruar nga internimi, duke imituar me përsosmëri, herë kërcimet rrethore të tigrit, herë tundjet dhe shkundjet idiothe të ariut të bardhë, një përbindësh, trajtat e të cilit ngajjnë turbullisht me tuajat.

Ky përbindësh bën pjesë tek ato kafshë, që zakonisht i quajmë "engjëlli im", domethënë një femër. Ai përbindëshi tjetër atje, me një shkop në dorë, që ulërin aq fort saqë të shpon veshët, është i shoqi. E ka lidhur gruan e tij të ligshme sikur të ishte një egërsirë dhe e shëtit nëpër qytet gjatë ditëve të panairit, me lejen e gjykatësve kuptohet.

Kini mendjen! E shihni se me çfarë grykësie (që, ndoshta, nuk është e shtirur) i shqyen lepujt e gjallë dhe shpendët kakaritisë që i hedh kornaku<sup>1</sup> i saj.

"Hej, mos i ha të gjitha brenda ditës" - i thotë ai dhe pas kësaj fjale të urtë, ia shkul mizorisht gjahun, zorrët e shpëstjella të të cilit qëndrojnë të varura për një çast te dhëmbët e egërsirës gjakatare, të femrës desha të thosha.

"Duhet t'i jap një dru të mirë që të qetësohet, sepse po i hedh një vështrim të tmerrshëm dhe lakmues ushqimit që ia hoqa nga goja".

O Zot i madh! Shkopi nuk është fals si në teatër. A e dëgjuat se si ushtonte mbi trupin e saj edhe pse është i mbuluar nga qime artificiale? Sytë po i zgurdullohen dhe tani po ulërin më natyrshëm. Në tërbim e sipër, ajo duket sikur lëshon xixa, siç lëshon hekuri kur e rrahim.

Të tilla janë, o Zoti im, zakonet bashkëshortore të krijesave që ke bërë me duart e tua, të këtyre pasardhësve të Evës dhe Adamit! Kjo grua është pa dyshim fatkeqe por, ku i dihet, edhe ajo mund t'i ketë përjetuar orët e veta të lavdisë. Ka vuajtje për të cilat nuk ka shërim dhe as nuk shpërblehesh. Por në botën ku e kanë hedhur, asaj s'i ka shkuar kurrë ndër mend se femra mund meritonte një fat tjetër.

Tani le t'i kthehemi rastit tonë preciozia<sup>2</sup> ime e dashur! Duke e parë se në çskëterrë jeton bota, çfarë kujtoni ju se mendoj unë për skëterrën tuaj të bukur, për ju që shplohdeni mbi stofra të buta si lëkura juaj, për ju që hani vetëm mish të pjekur, të cilin shërbëtori i shkathët jua pret me kujdes në copa të vogla? Çfarë kuptimi kanë këto psherëtime që fryjnë kraharorin tuaj të parfumuar, lozonjarja ime e vërtetë? Po këto sjellje të mësuara nëpër libra, kjo melankoli e pafund, e bërë me qëllim që të ngjallë te njerëzit një ndjenjë krejtësisht të ndryshme nga mëshira? Të them të drejtën, më ka shkuar shpeshherë ndërmend t'ju mësoj se çdo të thotë me të vërtetë fatkeqësi.

Kur ju shoh kështu, o

bukuroshja ime e brishtë, me këmbët e futura në llucë, me sytë të kthyer në mënyrë hyjnore drejt qiellit sikur t'i kërkoni atij t'ju gjente një mbret, më dukeni si një bretkosë e re në kërkim të idealit. Në qoftë se përbuzni traun (rolin e të cilit tani për tani e luaj unë, siç e dini fare mirë), ruajuni nga krilla, e cila do t'ju vrasë, copëtojë e gëlltisë me kënaqësi!<sup>3</sup>


Edhe pse jam poet, nuk jam edhe aq mendjelehtë sa kujtoni ju, dhe në qoftë se do të më lodhni me të qarat tuaja prej precioze, do t'ju trajtoj siç trajtohej një grua e egër, ose do t'ju flak nga dritarja si një shishe bosh.

Përktheu nga frëngjishtja:  
ROLAND ÇIPA  
Marrë nga numri 22 i  
revistës "Akademia"

<sup>1</sup> Nga portugalishtja *cornaca* që është shndërruar nga një gjuhë e Ceilonit kuraua-najaka. Person që merret me zbutjen dhe përdorimin e elefantëve në punët shtëpiake në vendet e Azisë juglindore. Person që merret me zbutjen e kafshëve në përgjithësi.

<sup>2</sup> Nga frëngjishtja *précieuse*. Grua e familjeve të pasura që dallohej për mendjemadhësinë dhe mendjelehtësinë e saj. Personazhi i preciozes është vënë në lojë nga Molieri në veprën e tij *Preciozet qesharake* (*Les précieuses ridicules*).

<sup>3</sup> Në këtë paragraf alegorik autori i referohet fabulës së shkrimtarit francez Zhan de la Fonten (Jean de la Fontaine) (1621-1695) *Bretkosat që kërkojnë një mbret* (*Les grenouilles qui demandent un roi*), e cila është bazuar te fabula me të njëjtin titull e shkrimtarit grek Ezop (Aisopos). Te kjo fabul bretkosat që ishin të mërziqura nga demokracia, i kërkuan Zeusi që t'i sillte një mbret. Zeusi i hodhi një tra, i cili ishte shumë i butë dhe pa autoritet. Bretkosat i hipën menjëherë në qafë këtij mbreti dhe të pakënaqura i kërkuan Zeusi t'i sillte një mbret tjetër. Atëherë Zeusi u sollti atyre një krillë, e cila filloi t'i hante të tëra pa mëshirë. Bretkosat u ankan përsëri, por këtë radhë Zeusi iu përgjigj se ato do të kishin bërë mirë ta ruanin qeverinë e tyre demokratike ose mbretin e parë që ishte i butë dhe i këshilloi të kënaqeshin me krillën, përndryshe do të kishin një mbret tjetër që mund të ishte edhe më i keq.



GEORGE ORWELL

# POEZIA DHE MIKROFONI

Rreth një vit më parë, bashkë me disa të tjerë, u përfshiva në transmetimin e programeve letrare në Indi dhe, ndër të tjera, transmetuam një pjesë të mirë të poezive të shkrimtarëve bashkëkohorë dhe thuajse bashkëkohorë anglezë si: T. S. Eliot, Herbert Rid, W. H. Oden, Stivën Spender, Dilan Tomas, Henri Tris, Aleks Kamfërt, Robert Brixhis, Edmënd Blandën, D. H. Lorens. Sa herë që ishte e mundur poezitë lexoheshin nga ata që i kishin shkruar. Nuk ka nevojë të shpjegohet pse u krijuan këto programe të veçanta (një lëvizje e vogël dhe e largët në luftën e radios), por duhet të theksoj se po transmetonim për një audiencë indiane dhe kjo diktoi në një farë mase teknikën që përdorëm. Çështja thelbësore ishte se transmetimet tona letrare u drejtoheshin studentëve të universitetit indian, një audiencë e vogël dhe armiqësore, e paarrtshme nga çdo gjë që mund të cilësohej si propagandë britanike. Dihej paraprakisht se s'mund të shpresonim të kishim më shumë se disa mijëra dëgjues dhe kjo na krijoi justifikimin për të qenë sa më "përzgjedhës" të ishte e

mundur në transmetim.

Nëse transmetoni poezi për njerëzit që e dinë gjuhën tënde, por nuk kanë të njëjtën prejardhje kulturore, disa komente dhe shpjegime janë të pashmangshme, dhe formula që zakonisht ndiqnim ishte të transmetonim një revistë mujore letrare radiofonike. Redaksia ulej në zyrën e saj dhe diskutonte çfarë të përfshinin në numrin tjetër. Njëri sugjeronte një poezi, tjetri diçka tjetër, bëhej një diskutim i shkurtër dhe më pas lexohej poezia, nga një zë tjetër, mundësisht i autorit. Natyrisht, kjo poezi i linte vendin një tjetre, dhe kështu programi vazhonte, zakonisht me të paktën gjysmë minute diskutim midis dy poezive. Për një program prej gjysmë ore, gjashtë zëra dukej se ishin numri më i mirë.

Një program i këtij lloji në mënyrë të pashmangshme do të ngjante disi i pa formë, por mund t'i krijohet një lloj uniteti duke u përqendruar te një temë e vetme qendrore. Për shembull, një numër i revistës sonë imagjinare iu kushtua temës së luftës. Përfshinte dy poezi të Edmënd Blandënit, *Shtator 1941* të Odenit, fragmente nga

një poezi e gjatë e G. S. Freizërit (*Një letër për Ana Ridlerin*), *Ishujt e Greqisë* të Bajronit dhe një fragment nga *Revoltë në shkretëtirë* e T. E. Lorensit. Kjo lëndë, me argumentet që i paraprinte dhe vijonte, mbuloi mjaft mirë qëndrimet e mundshme ndaj luftës. Poezitë dhe fragmenti i prozës mori rreth njëzet minuta për t'u transmetuar, argumentet rreth tetë minuta.

Kjo formulë mund të duket paksa qesharake, por edhe shumë imponues është fakti që elementi thjesht udhëzues, motivi i teksteve, i cili në mënyrë të pashmangshme nëse do të të transmetojë vargje serioze dhe ndonjëherë "të vështira", bëhet shumë më pak ndalues kur shfaqet si një diskutim joformal. Folësit e ndryshëm mund t'i thonë njëri-tjetrit atë që në të vërtetë po ia thonë audiencës. Gjithashtu, me një qasje të tillë, të paktën i jep poezisë një kontekst, që është pikërisht ajo që i mungon poezisë nga këndvështrimi i një njeriu të zakonshëm. Por sigurisht që ka metoda të tjera. Një nga të cilat e përdornim shpesh ishte ta lexojmë një poezi me muzikë në sfond.

Njoftohet se pas pak minutash do të transmetohet kjo ose ajo lloj poezie, pastaj dëgjohet muzikë, ndoshta për një minutë, muzika bëhet e ulët kur lexohet poezia, e cila vijon pa asnjë titull apo njoftim, më pas muzika bëhet e ulët sërish dhe vazhdon për një ose dy minuta të tjera - e gjithë kjo zgjat ndoshta pesë minuta. Është e nevojshme të zgjidhet muzika e përshtatshme, por është e panevojshme të thuhet, qëllimi i vërtetë i muzikës është ta izolojë poezinë nga pjesa tjetër e programit. Me këtë metodë mund të kesh, të themi, një sonet të Shekspirit brenda tre minutash pas një buletini lajmesh, pa asnjë mospërputhje të madhe për veshin.

Këto programe s'kishin vlerë të madhe në vetvete, por po i përmend për shkak të ideve që ngjallën tek unë dhe disa të tjera për t'i treguar mundësitë e radios si mjet i popullarizimit të poezisë. Më ka habitur që në fillim fakti se transmetimi i një poezie nga personi që e ka shkruar atë nuk krijon vetëm një efekt për audiencën, nëse ka, por edhe për vetë poetin. Duhet kujtuar se në Angli është bërë jashtëzakonisht pak për

mënyrën e transmetimit të poezisë dhe se shumë njerëz që shkruajnë vargje s'e kanë menduar asnjëherë idenë për ta lexuar me zë të lartë. Duke u ulur para një mikrofoni, veçanërisht nëse kjo ndodh rregullisht, poeti vendos një marrëdhënie të re me veprën e tij, e cila përndryshe nuk do të ishte e arritshme në kohën dhe vendin tonë.

Është e zakonshme që në kohët moderne - le të themi gjatë dyqind vjetëve të fundit - poezia ka pasur gjithnjë e më pak lidhje qoftë me muzikën, qoftë me fjalën e folur. Ajo ka nevojë për t'u shtypur që të ekzistojë dhe nuk pritet që një poet, si i tillë, të dijë të këndojë apo edhe të recitojë më shumë se pritet që një arkitekt të dijë të suvatojë një tavan. Poezia lirike dhe retorike pothuajse nuk shkruhen më dhe armiqësia ndaj poezisë nga ana e njeriut të thjeshtë është marrë si e mirëqenë në çdo vend ku të gjithë mund të lexojnë.

Dhe aty ku ekziston një thyerje e tillë, ajo është gjithmonë e prirë të zgjerohet, sepse koncepti i poezisë si diçka më së shumti e shtypur dhe diçka e kuptueshme vetëm për një



pakicë, nxit të errëtën dhe “zgjuarsinë”. Sa njerëz ndiejnë gati në mënyrë instinktive se duhet të ketë diçka që s’shkon me ndonjë poezi, kuptimi i së cilës mund të nxirret me një të lexuar? Duket e pamundur që këto prirje të ndryshojnë nëse nuk bëhet përsëri diçka e natyrshme të lexosh vargjet me zë të lartë dhe është e vështirë të shohësh se si mund të arrihet kjo, përveçse duke përdorur radion si mjet. Por këtu duhet të vihet re përparësia e veçantë e radios, fuqia e saj për ta zgjedhur audiencën e duhur dhe për ta larguar frikën dhe sikletin e skenës.

Në transmetim audiencia jote është e përfytyruar, por e një njeriu. Miliona mund të dëgjojnë, por secili po dëgjon vetëm, ose si anëtar i një grupi të vogël, dhe secili ka (ose duhet të ketë) ndjenjën se po i flisni atij individualisht. Është e arsyeshme të hamendësohet se audiencia është dashamirëse, ose të paktën e interesuar, sepse kushdo që është i mërzhitur mund ta fikë radion me një rrotullim butoni.

Por edhe nëse ju simpatizon, audiencia s’ka fuqi mbi atë që bëni. Pikërisht këtu ndryshon transmetimi nga fjalimi apo leksioni. Në platformë, siç e di kushdo që është mësuar të flasë në publik, është gati e pamundur që toni i komunikimit të mos ndikohet nga audiencia. Është përherë e qartë brenda pak minutash ajo ndaj së cilës reagojnë ose jo, dhe në praktikë jeni thujtë të detyruar të flisni për t’u kuptuar edhe nga personi që për ju mund të jetë më budallai i pranishëm dhe, gjithashtu, të bëheni i pëlqyeshëm me anë të reklamimit të “personalitetit”. Nëse veproni kështu, pasoja është gjithmonë një atmosferë e ftohtë, e sikletshme.

Kjo gjë e frikshme, “lexim poezie”, është e tillë sepse do të ketë gjithmonë në mesin e audiencës disa që mërzhiten ose të gjithë, por janë armiqësorë në mënyrë të sinqertë, ata mund të largohen me veprimin e thjeshtë të rrotullimit të një butoni. Dhe në fund të fundit kemi të njëjtën vështirësi - fakti që një publik teatri nuk është i përzgjedhur - ajo që e bën të pamundur realizimin e një shfaqjeje të mirë të Shekspirit në Angli. Në transmetim radiofonik, këto kushte nuk ekzistojnë. Poeti e ndien se po u drejtohet njerëzve për të cilët poezia do të thotë diçka dhe është fakt që poetët e mësuar të transmetojnë mund të lexojnë në mikrofon me një virtuoizitet që nuk do ta arrinin ta kishin nëse do të kishin një audiencë të dukshme përpara. Elementi i përfytyrimit në këtë rast nuk ka shumë rëndësi.

Çështja është se në të vetmen mënyrë të mundshme tani poeti është në një situatë në të cilën leximi i vargjeve me zë të lartë



duket një gjë e natyrshme dhe e pasikletshme, një shkëmbim normal midis teje dhe tjetrit: gjithashtu ai mendon për veprën e tij më tepër si tingull sesa si diçka e shtypur në letër.

Kësisoj, pajtimi mes poezisë dhe njeriut të zakonshëm është më i afërt. Ai tashmë ekziston në valët në eter të poetit, pavarësisht se çfarë po ndodh me atë që e dëgjon. Megjithatë, ajo që po ndodh në skajin tjetër s’mund të shpërfilllet. Do të shihet se kam folur sikur e gjithë tema e poezisë të ishte e sikletshme, gati e pahijshme, sikur popullarizimi i poezisë të ishte në thelb një manovër strategjike, si t’i japësh të pijë një dozë ilaci një fëmije ose të tregohesh tolerant ndaj një sekti të persekutuar. Por, për fat të keq, kemi të bëjmë me diçka të ngjashme. S’ka dyshim se në qytetërimin tonë poezia është deri më tani arti më i zhvlerësuar, i vetmi art, në të vërtetë, tek i cili njeriu mesatar refuzon të gjejë ndonjë vlerë.

Arnold Benet s’po e ekzagjeronte kur tha se në vendet anglishtfolëse fjala “poezi” do ta shpërndante një turmë më shpejt se një zjarrfikëse. Siç e kam theksuar,

një hendek i këtij lloji prirjet të zgjerohet thjesht për shkak të ekzistencës së saj, njeriu i zakonshëm po bëhet gjithnjë e më shumë anti-poezi, poeti gjithnjë e më shumë arrogant dhe i pakuptueshëm, deri në pranimin e ndarjes midis poezisë dhe kulturës popullore si një lloj ligji i natyrës, megjithëse në fakt i përket vetëm kohës sonë dhe një zone relativisht të vogël të tokës. Ne jetojmë në një epokë në të cilën njeriu mesatar në vendet shumë të qytetëruara është estetikisht inferior ndaj njeriut më të egër.

Kjo gjendje përgjithësisht shihet si e pashërueshme prej ndonjë veprimi të vetëdijshëm dhe, nga ana tjetër, pritet që të vetëkorrigjohet sapo shoqëria të marrë një formë më të përshtatshme. Me ndryshime të vogla marksisti, anarkisti dhe besimtari fetar do t’jua thonë këtë, dhe në terma të përgjithshme kjo është padyshim e vërtetë. Shëmnia në mes të të cilit jetojmë ka shkaqe shpirtërore dhe ekonomike dhe nuk shpjegohet thjesht me shmangien e traditës në një moment apo në një tjetër. Por nuk ka kuptim të thuash se nuk është i mundur asnjë

përmirësim brenda kornizës së tanishme, dhe as që një përmirësim estetik nuk është pjesë e domosdoshme e shëlbimit të përgjithshëm të shoqërisë. Prandaj, ia vlen të ndalemi dhe ta pyesim veten nëse është e mundur edhe tani që të shpëtohet poezia nga kjo rrethanë e veçantë si më e urryera e arteve dhe të fitohet për të të paktën e njëjta shkallë tolerance që ekziston për muzikën. Por duhet nisur duke pyetur, në çfarë mënyre dhe në çfarë mase është e papëlqyeshme poezia?

Në pamje të parë tabloja e mungesës së popullaritetit të poezisë është aq e plotë sa mund të ishte. Por po ta mendosh më mirë, kjo gjendje duhet të cilësohet në mënyrë më të hollësishme. Së pari, ka ende një lloj poezie popullore (vjershat për fëmijë etj.) e cila njihet dhe citohet në të gjithë botën dhe është pjesë e njohurive të secilit. Janë edhe disa këngë dhe balada të lashta të cilat vazhdojnë të jenë të dashura. Përveç kësaj, ekziston popullariteti, ose të paktën tolerimi, i poezisë “së mirë, të keqe”, përgjithësisht e një lloji patriotik ose sentimental.

Mund të duket pa lidhje nëse poezia “e mirë, e keqe” të mos kishte të gjitha karakteristikat që e bëjnë njeriun mesatar të mos e pëlqejë poezinë e vërtetë. Është në vargje, ka rima, trajton ndjenja të larta dhe me gjuhë të pazakontë - e gjithë kjo në një shkallë shumë të theksuar, sepse është pothuajse aksiomatike që poezia e keqe është më shumë “poetike” sesa poezia e mirë. Megjithatë, nëse nuk pëlqehet në mënyrë aktive, të paktën tolerohet. Për shembull, pak para se të shkruaja këtë ese, dëgjova disa humoristë në BBC. që bëjnë shfaqjen e radhës përpara lajmeve të orës 9.00. Në tre minutat e fundit, një nga dy aktorët e humorit papritmas njofton se ai “dëshiron të jetë serioz për një çast” dhe vazhdon të recitojë një pjesë të një paçavureje patriotike të titulluar *Një xhentëlmen i dashur plak anglez*, që lavdëronte Madhërinë e Tij - Mbretin. Tani, cili është reagimi i audiencës ndaj këtij kalimi të papritur në llojin më të keq të heroizmit me rimë? Ky kalim s’mund të jetë negativ në këtë mënyrë kaq të dhunshme, ose do të kishte një vëllim goxha të madh letrash indinjuese për të ndaluar transmetime në BBC. të këtyre lloj gjërash. Kështu arrijmë në përfundimin se megjithëse publiku i gjerë është armiqësor ndaj poezisë, ai nuk është fort armiqësor ndaj vargut. Në fund të fundit, nëse rima dhe metrika nuk do të pëlqeheshin vetëm se janë rima, as këngët dhe as vjershat me fjalë të pista s’do të ishin të njohura.

Poezia është e papëlqyeshme sepse e lidhin me pakuptueshmërinë, prirjen për t’u dukur intelektual dhe ndjesinë e përgjithshme se është vetëm për në fundjavë. Emri i saj krijon paraprakisht të njëjtën përshtypje të keqe si fjala “Zot”, ose kollarja e qenit të një famullitari. Në një farë mase popullarizimi i poezisë është një çështje e çlirimit nga kjo ndjenjë e ngulitur frenimi. Çështja është t’i bësh njerëzit të dëgjojnë në vend se të shqiptojnë në mënyrë mekanike. Nëse poezia e vërtetë mund t’i paraqitet publikut të gjerë në një mënyrë të tillë që ta bënte të dukej normale, pasi gjeputur që sapo kam dëgjuar me gjasë duken normale, atëherë një pjesë e paragjykitimit ndaj saj mund të kapërcehet.

Është e vështirë të besohet se poezia mund të popullarizohet përsëri pa ndonjë përpjekje të qëllimshme për edukimin e shijes së publikut, duke përfshirë strategji dhe, ndoshta, edhe dredhi. T. S. Eliot ka sugjeruar një herë që poezia, veçanërisht ajo dramatike, mund të rikthehej në ndërgjegjen e njerëzve të zakonshëm nëpërmjet sallës së koncerteve; ai mund të shtonte edhe pantomimën, mundësitë e mëdha të së cilës nuk duket se



janë hulumtuar plotësisht. Drama në vargje *Suini Agënostis* ndoshta u shkrua me një ide të tillë në mendje, në fakt do të ishte e imagjinueshme si një sheshpushim në sallën e koncerteve, ose të paktën si një skenë në një shfaqje. Radion e kam sugjeruar si një mjet komunikimi më shpresëdhënës dhe kam vënë në dukje përparesitë e saj teknike, veçanërisht nga këndvështrimi i poetit. Arsyja se pse një sugjerim i tillë tingëllon i pashpresë në dëgjimin e parë është se pak njerëz janë në gjendje ta imagjinojnë radion të përdoret për përhapjen e ndonjë gjëje, përveç gjejurave.

Njerëzit dëgjojnë gjërat që oshijnë në altoparlantët e botës dhe arrijnë në përfundimin se kjo është arsyeja e vetme pse transmetimi radiofonik ekziston. Në të vërtetë, vetë fjala "radiofonik" krijon një foto ose të diktatorëve zëri i të cilëve buçet ose zërash të butë që njoftojnë se tre nga avionët tanë nuk kanë arritur të kthehen. Poezia në radio ngjan me muzat me pantallona me vija. Megjithatë, s'duhet të ngatërrohen aftësitë e një mjeti me përdorimin që i bëhet në të vërtetë.

Transmetimi është ai që është, jo sepse ka diçka në thelb vulgare, budallaqë dhe të pandershme në të gjithë aparatit e mikrofonit dhe transmetuesit, por sepse i gjithë transmetimi që ndodh tani në të gjithë botën është nën kontrollin e qeverive ose kompanive të mëdha të monopoleve që janë të interesuara për ta ruajtur status quo-në dhe, për rrjedhojë, për të

parandaluar që njeriu i zakonshëm të bëhet tepër inteligjent.

Diçka e ngjashme ka ndodhur me kinemanë, e cila, ashtu si radioja, u shfaq në fazën e monopoleve të kapitalizmit dhe është jashtëzakonisht e shtrenjtë për t'u vënë në punë. Në të gjitha artet prirja është e ngjashme. Gjithnjë e më shumë kanalet e prodhimit janë nën kontrollin e burokratëve, qëllimi i të cilëve është ta shkatërrojnë artistin ose të paktën ta tregojnë atë. Kjo do të ishte një perspektivë e zymtë nëse nuk do të ishte se totalitarizimi që po vazhdon tani dhe që padyshim duhet të vazhdojë në çdo vend të botës, zvogëlohet nga një proces tjetër që nuk është i lehtë të parashikohet as edhe në një kohë kaq të shkurtër si ajo para pesë vjetëve.

Kjo do të thotë se makinat e mëdha burokratike, pjesë e të cilave jemi të gjithë, kanë filluar të punojnë duke bërë zhurmë për shkak të madhësisë dhe rritjes së vazhdueshme. Prirja e shtetit modern është ta zhdrukë lirinë e intelektit e, megjithatë, në të njëjtën kohë, çdo shtet, veçanërisht nën trysinë e luftës, ka nevojë gjithnjë e më shumë për një inteligjencë që t'i bëjë reklamën. Shteti modern ka nevojë, për shembull, për shkrimtarë pamfletesh, artistë posterësh, ilustrues, transmetues radiofonik, lektorë, producentë filmash, aktorë, kompozitorë këngësh, madje edhe për piktorë e skulptorë, pa përmendur psikologët, sociologët, biokimistët, matematikanët dhe gjithçka tjetër. Qeveria britanike e

filloi luftën e tanishme me synimin pak a shumë të deklaruar hapur për t'i mbajtur intelektualët e fushës së letrave larg saj; megjithatë, pas tre vjetësh luftime, pothuajse çdo shkrimtar, sado i padëshirueshëm për historinë apo opinionet e tij politike, është punësuar nëpër ministri të ndryshme ose te BBC, madje edhe ata që hyjnë në forcat e armatosura priren që pas një farë kohe ta gjejnë veten të marrëdhëniet me publikun ose të angazhuar me ndonjë punë tjetër, në thelb letrare.

Qeveria i ka përthithur këta njerëz, edhe pa dëshirën e saj, sepse ajo pa qe është e paaftë për të vazhduar pa ta. Ideali, nga pikëpamja zyrtare, do të kishte qenë që të vihej i gjithë publiciteti në duart e njerëzve "të sigurt" si A.P. Herbert ose Ian Hay, por duke qenë se nuk kishte shumë si ata, duhej të përdorej shtresa e intelektualëve që kishin dhe toni dhe, deri-diku, edhe përmbajtja e propagandës zyrtare është ndryshuar në përputhje me rrethanat.

Askush i njohur me broshurat e qeverisë nëpër radio, leksionet, filmat dokumentarë dhe transmetimet radiofonike në vendet e pushtuara, të cilat janë lëshuar gjatë dy vjetëve të fundit, imagjinon se pushtetarët tanë do ta sponsorizonin këtë lloj gjëje nëse mund ta bëjnë vetë. Vetëm se sa më e madhe të bëhet makina e qeverisjes, aq më të shumta bëhen skajet dhe qoshet e harruara në të. Ky është ndoshta një ngushëllim i vogël, por nuk është i përçmuar. Kjo do të thotë se në vendet ku tashmë

ekziston një traditë e fortë liberale, tirania burokratike ndoshta nuk mund të jetë kurrë e plotë. Ata që veshin pantallona me vija do të sundojnë, por për sa kohë që ata janë të detyruar të mbajnë një shtresë intelektuale, kjo shtresë do të ketë njëfarë autonomie. Nëse qeveria ka nevojë, për shembull, për filma dokumentarë, ajo duhet të punësojë njerëz të interesuar veçanërisht për teknikën e filmit dhe duhet t'u lejojë minimumin e nevojshëm të lirisë; për rrjedhojë, filmat që janë të gjithë të gabuar nga pikëpamja burokratike, do të kenë gjithmonë prirjen për t'u shfaqur. Kështu edhe me pikurën, fotografinë, shkrimin e skenarit, reportazhin, leksionin dhe të gjitha artet e gjysmartet e tjera për të cilat ka nevojë një shtet kompleks modern.

Zbatimi i kësaj praktike në radio është i dukshëm. Aktualisht, altoparlanti është armiku i shkrimtarit krijues, por kjo mund të mos mbetet domosdoshmërisht e vërtetë kur vëllimi dhe shtrirja e transmetimit rritet. Kështu siç janë gjërat, megjithëse BBC ka pak interes për letërsinë bashkëkohore, është më e vështirë të kapësh pesë minuta transmetim gjatë të cilave të dëgjosh një poezi sesa dymbëdhjetë orë në të cilat bëhet propagandë e rreme, muzikë e pashije, shaka bajate, "diskutime" të rreme apo çfarë të ketë. Por kjo gjendje mund të ndryshojë në mënyrën që kam treguar, dhe kur të vijë koha, eksperimenti serioz në transmetimin e vargjeve, duke shpërfillur plotësisht ndikimet e

ndryshme që e pengojnë një gjë të tillë, do të bëhej i mundur.


Nuk mëtoj siguritë plot se një eksperiment i tillë do të kishte rezultate të jashtëzakonshme. Radioja u burokratizua aq herët në karrierën e saj sa që raporti ndërmjet transmetimit dhe letërsisë nuk është menduar kurrë. Nuk është e sigurt që mikrofonit është instrumenti me të cilin poezia mund të rikthehet te njerëzit e thjeshtë dhe madje nuk është e sigurt që poezia do të fitonte duke qenë më shumë e recituar dhe më pak e shkruar. Por unë kërkoh që këto mundësi të ekzistojnë dhe ata që kujdesen për letërsinë të mund ta kthejnë mendjen më shpesh te ky mjet komunikimi shumë i përbuzur, fuqitë e të cilit për mirë ndoshta janë errësuar nga zërat e profesor C.E.M Joad<sup>1</sup> dhe doktor Gëbelsi.<sup>2</sup>


Shkruar në vjeshtë 1943, botuar te *New Saxon Pamphlet*, nr. 3, mars 1945.

*Përktheu nga anglishtja:*  
Granit ZELA  
*Marrë nga numri 22 i revistës*  
"AKADEMIA"

<sup>1</sup> Cyril Edwin Mitchinson Joad (1891-1953), filozof anglez dhe personalitet i radios i cili u shfaq në një program diskutimi në BBC gjatë kohës së luftës. Ai popullarizoi filozofinë dhe u bë një njeri i famshëm përpara skandalit për një biletë të papaguar treni në vitin 1948. (Shënim i përkthyesit.)

<sup>2</sup> Paul Joseph Goebbels (1897-1945), politikan nazist gjerman, kryepropagandist i Partisë Naziste dhe më pas ministër i Propagandës së Rajhut nga 1933 deri më 1945. Ishte një nga njerëzit më të afërt të Adolf Hitlerit, i njohur për aftësitë e tij në të folurit publik dhe antisemitizmin e tij. Mbrojtja diskriminimit gjithnjë e më të ashpër dhe shfarosjen e hebrenjve në Holokaust. Gëbelsi mori titullin doktor i Filologjisë në Universitetin e Heidelbergut në vitin 1921. (Shënim i përkthyesit.)





# ZGJIDHJA (IZRAELITE-PALESTINEZE) ME NJË SHTET



EDUARD SAID

Duke pasur parasysh se Qeveria e Netanyahu ra shkaku i Marrëveshjes së Paqes Wye, ka ardhur koha që të vihet në dyshim i gjithë procesi i filluar në Oslo më 1993 si instrumenti i duhur për të sjellë paqen midis palestinezëve dhe izraelitëve. Mendoj se procesi i paqes në fakt ka shtyrë pajtimin e vërtetë që duhet të ndodhë nëse lufta njëqindvjeçare midis sionizmit dhe popullit palestinez do të përfundojë. Osloja përgatiti skenën për ndarje, por paqja e vërtetë mund të vijë vetëm me një shtet dykombëtar izraelito-palestinez.

Kjo nuk është e lehtë as të imagjinohet. Narrativa zyrtare sioniste-izraelite dhe ajo

palestineze janë të papajtueshme. Izraelitëve ua ha mendja se zhvilluan një luftë çlirimtare dhe kështu arritën pavarësinë; Palestinezët thonë se shoqëria e tyre u shkatërrua, shumica e popullsisë u dëbua. Dhe, në fakt, kjo papajtueshmëri ishte tashmë mjaft e dukshme për disa breza të udhëheqësve dhe mendimtarëve të hershëm sionistë, siç ishte sigurisht edhe për të gjithë palestinezët.

"Sionizmi nuk ishte i verbër ndaj pranisë së arabëve në Palestinë", do të shkruante historiani i shquar izraelit, Zeev Sternhell, në librin e tij të fundit, "The Founding Myths of Israel" (Mitet themeluese të Izraelit). "Edhe figurat sioniste që kurrë nuk e kishin vizituar këtë vend, e dinin se nuk ishte pa banorë. Në të njëjtën kohë, as lëvizja sioniste jashtë vendit dhe as pionierët që kishin filluar të vendoseshin në vend nuk mund të hartonin një politikë ndaj lëvizjes kombëtare palestineze. Arsyeja e vërtetë për këtë nuk ishte mosnjohja e problemit, por njohja e qartë e kundërthënies së

pakapërcyeshme midis objektivave bazë të dy palëve. Nëse intelektualët dhe udhëheqësit sionistë e injoruan dilemën arabe, kjo ngjau kryesisht për shkak se e dinin se ky problem nuk kishte zgjidhje brenda mënyrës së të menduarit sionist".

David Ben-Gurion, ta zëmë, ishte gjithmonë i qartë. "Nuk ka asnjë shembull në historinë e një populli", do të deklaronte ai në vitin 1944, "që thotë se ne pranojmë të heqim dorë nga vendi ynë, le të vijë një popull tjetër dhe të vendoset këtu dhe të na e kalojë". Një tjetër udhëheqës sionist, Berl Katznelson, po ashtu, nuk kish iluzione se kundërshtimi midis synimeve sioniste dhe palestineze mund të kapërcehej. Dhe binacionalistët, si Martin Buber, Judah Magnes dhe Hannah Arendt ishin plotësisht të vetëdijshëm se si do të dukej përplasia, nëse do të realizohej, siç sigurisht se ndodhi.

Shumë më tepër se hebrejntë, arabët palestinezë gjatë pas Deklaratës së Balfourit të vitit 1917 dhe Mandatit Britanik

gjithmonë refuzuan çdo gjë që do të rrezikonte dominimin e tyre. Është e padrejtë të qortosh palestinezët retrospektivisht për mospranimin e ndarjes në vitin 1947. Deri në vitin 1948, hebrenjtë zotëronin vetëm rreth 7 për qind të tokës. Pse, thanë arabët kur u propozua rezoluta e ndarjes, duhet t'ua lëshojmë 55 për qind të Palestinës hebrenjve, të cilët ishin pakicë në Palestinë? As Deklarata e Balfourit dhe as Mandati Britanik nuk e pranuan kurrë specifikisht se palestinezët kishin të drejta politike, krahas atyre civile dhe fetare, në Palestinë. Prandaj, ideja e pabarazisë midis hebrenjve dhe arabëve u ndërtua në politikën britanike, dhe më pas të Izraelit dhe të Shteteve të Bashkuara, që në krye të herës.

Konflikti duket i pazgjidhshëm, sepse është një betejë për të njëjtën tokë nga dy popuj që gjithmonë besonin se ishin titulluar legjitimë të saj dhe që shpresonin se pala tjetër do të hiqte dorë me kalimin e kohës ose do të largohej. Njëra palë fitoi luftën, tjetra humbi, por beteja

është e gjallë si kurrë më parë. Ne palestinezët pyesim pse një hebre i lindur në Varshavë ose New York ka të drejtë të vendoset këtu (sipas Ligjit të Kthimit të Izraelit), ndërsa ne, njerëzit që kemi jetuar këtu me shekuj, nuk mundemi. Pas vitit 1967, konflikti mes nesh u acarua. Vitet e pushtimit ushtarak kanë krijuar te pala më e dobët zemërim, poshtërim dhe armiqësi.

Për ta diskredituar edhe më, Oslo bëri pak për të ndryshuar situatën. Arafati dhe numri i tij në pakësim i mbështetësve u shndërruan në përforcues të sigurisë izraelite, ndërsa palestinezët u detyruan të durojnë poshtërimin e "atdheut" të tmerrshëm dhe jo të afërt që përbëjnë rreth 10 për qind të Bregut Perëndimor dhe 60 për qind të Gazës. Oslo na kërkoi të harronim dhe të hiqim dorë nga historia jonë e humbjes, të shpronësuar nga vetë njerëzit që u mësuan të gjithëve rëndësinë e mosharrimit të së kaluarës. Kështu ne jemi viktimat e viktimave, refugjatët e refugjatëve.



Arsyeja e ekzistencës së Izraelit si shtet ka qenë gjithmonë se duhet të ketë një vend të veçantë, një strehë, ekskluzivisht për hebrejtë. Vetë Osloja bazohej në parimin e ndarjes midis hebrejve dhe të tjerëve, siç përsëriste pa u lodhur Yitzhak Rabin. Megjithatë, gjatë 50 viteve të fundit, veçanërisht që kur ngulimet izraelite u vendosën për herë të parë në territoret e pushtuara në vitin 1967, jetët e hebrejve janë ndërthurur gjithnjë e më shumë me ato të johebrejve.

Përprjekja për t'u ndarë ka ndodhur në të njëjtën kohë dhe paradoksalisht me përprjekjen për të marrë gjithnjë e më shumë tokë, gjë që nga ana tjetër ka bërë që Izraeli të fitonte gjithnjë e më shumë palestinezë. Në Izrael, palestinezët numërojnë rreth një milion, pothuajse 20-përqindëshin e popullsisë. Mes Gazës, Jerusalemit Lindor dhe Bregut Perëndimor, ku vendbanimet janë më të dendura, ka pothuajse 2.5 milionë palestinezë. Izraeli ka ndërtuar një sistem të tërë rrugësh "anashkaluese", të projektuara për të shkuar rreth qyteteve dhe fshatrave palestineze, duke lidhur vendbanimet dhe duke shmangur arabët. Por kaq e vogël është zona tokësore e Palestinës historike, aq të ndërthurur janë izraelitët dhe palestinezët, pavarësisht pabarazisë dhe antipatisë së tyre, sa që ndarja e pastër thjesht nuk do të jetësohet, nuk mund të bëhet apo të funksionojë. Vlerësohet se deri në vitin 2010 do të ketë barazi demografike. Çka atëherë?

Është e qartë se një sistem i privilegjuar i hebrejve izraelitë

nuk do të kënaqë as ata që duan një shtet tërësisht homogjen hebraik, as ata që jetojnë atje, por nuk janë hebrej. Për të parët, palestinezët janë një pengesë për t'u asgjësuar disi; për këta të fundit, të qenit palestinez në një shtet hebraik do të thotë të mbytesh përgjithmonë në statusin inferior. Por palestinezët izraelitë nuk duan të lëvizin; ata thonë se janë tashmë në vendin e tyre dhe refuzojnë çdo bisedë për anëtarësimin në një shtet të veçantë palestinez, nëse një gjë e tillë do të krijohet. Ndërkohë, kushtet varfëruese të vendosura ndaj Arafatit po ia bëjnë të vështirë nënshkrimin e banorëve shumë të politizuar të Gazës dhe Bregut Perëndimor. Këta palestinezë kanë aspirata për vetëvendosje që, në kundërshtim me përllogaritjet izraelite, nuk tregojnë asnjë shenjë të zhdukjes. Është gjithashtu evidente se si popull arab -- dhe duke pasur parasysh traktatet e ftohta të paqes mes Izraelit dhe Egjiptit, dhe Izraelit e Jordanisë, ky fakt është i rëndësishëm -- palestinezët duan me çdo kusht të ruajnë identitetin e tyre arab si pjesë e arabëve përreth dhe botës islame.

Për të gjitha këto, problemi është se vetëvendosja palestineze në një shtet të veçantë është e pazbatueshme, po aq e pazbatueshme sa parimi i ndarjes midis një popullsie arabe të përzier demografikisht, të lidhur në mënyrë të pakthyeshme pa sovranitet dhe një popullsie hebraike me të. Çështja, besoj, nuk është se si të krijohen mjete për të këmbëngulur në përprjekjen për t'i ndarë ato, por për të parë nëse është e mundur që ata të jetojnë së bashku në

mënyrë sa më të drejtë dhe paqësore.

Çka ekziston tani është një ngërc dëshpërues, për të mos thënë, i përgjakshëm. Sionistët brenda dhe jashtë Izraelit nuk do të heqin dorë nga dëshira e tyre për një shtet të veçantë hebe; Palestinezët duan të njëjtën gjë për veten e tyre, pavarësisht se kanë pranuar shumë më pak nga Oslo. Megjithatë, në të dyja rastet, ideja e një shteti për "veten" thjesht fluturon përballë fakteve: pa spastrim etnik ose "transferim masiv", si në vitin 1948, nuk ka asnjë mënyrë që Izraeli të shpëtojë prej palestinezëve ose që palestinezët të urojnë largimin e izraelitëve. Asnjëra palë nuk ka një opsion të qëndrueshëm ushtarak kundër tjetrës, gjë që, më vjen keq ta them, është arsyeja pse të dy zgjedhën një paqe që përpiqet kaq qartë të realizojë atë që lufta nuk mundi.

Sa më shumë të vazhdojnë modelet aktuale të ngulimeve izraelite dhe izolimit dhe rezistencës palestineze, aq më pak ka gjasa që të ketë siguri reale për secilën palë. Ishte gjithmonë absurde që obsesioni i Netanyahu me sigurinë të shtrohej vetëm në aspektin e pajtueshmërisë palestineze me kërkesat e tij. Nga njëra anë, ai dhe Ariel Sharon fuqizuan palestinezët gjithnjë e më shumë me nxitjet e tyre të mprehta drejtuar kolonëve për të rrëmbyer atë që mundnin. Nga ana tjetër, Netanyahu priste që metoda të tilla të shtynin palestinezët të pranonin gjithçka që bëri Izraeli, pa masa reciproke izraelite.

Arafati, i mbështetur nga Uashingtoni, është çdo ditë më represiv. Duke përmendur në mënyrë të pamundshme

Rregulloren Britanike për Mbrojtjen Emergjente të vitit 1936 kundër palestinezëve, ai ka dekretuar së fundmi, për shembull, se është krim jo vetëm të nxitësh dhunën, grindjet racore dhe fetare, por edhe të kritikosh procesin e paqes. Nuk ka asnjë kushtetutë apo ligj bazë palestinez: Arafati thjesht refuzon të pranojë kufizime në pushtetin e tij në dritën e mbështetjes amerikane dhe izraelite për të. Kush mendon se e gjithë kjo mund t'i sjellë Izraelit sigurinë dhe nënshkrimin e përhershëm të Palestinës?

Dhuna, urrejtja dhe jotoleranca janë edukuar nga padrejtësia, varfëria dhe një ndjenjë e penguar e përmbushjes politike. Vjeshtën e kaluar, qindra hektarë tokë palestineze u shpronësuan nga ushtria izraelite nga fshati Umm al-Fahm, i cili nuk është në Bregun Perëndimor, por brenda Izraelit. Kjo nxori në pah faktin se, edhe si qytetarë izraelitë, palestinezët trajtohen si inferiorë, në thelb si një lloj shtrese e ulët që ekziston në një gjendje apartheidi.

Në të njëjtën kohë, për shkak se as Izraeli nuk ka një kushtetutë dhe për shkak se partitë ultra-ortodokse po fitojnë gjithnjë e më shumë pushtet politik, ka grupe dhe individë hebrej izraelitë që kanë filluar të organizohen rreth nocionit të një demokracie të plotë laike për të gjithë shtetasit izraelitë. Karizmatiku Azmi Bishara, anëtar arab i Knessetit, ka folur gjithashtu për zgjerimin e konceptit të shtetësisë si një mënyrë për të kapërcyer kriteret etnike dhe fetare që tani e bëjnë Izraelin në fakt një shtet jodemokratik për 20 për qind të popullsisë së tij.


Në Bregun Perëndimor,

Jerusalem dhe Gaza, situata është thellësisht e paqëndrueshme dhe shfrytëzuese. Të mbrojtur nga ushtria, kolonët izraelitë (pothuajse 350.000 prej tyre) jetojnë si njerëz ekstraterritorial, të privilegjuar me të drejta që palestinezët rezidentë nuk i kanë. (Për shembull, palestinezët e Bregut Perëndimor nuk mund të shkojnë në Jerusalem dhe në 70 për qind të territorit janë ende subjekt i ligjit ushtarak izraelit, me tokën e tyre në dispozicion për konfiskim.) Izraeli kontrollon burimet ujore dhe sigurinë palestineze, si dhe hyrje-daljet. Edhe aeroporti i ri i Gazës është nën kontrollin e sigurisë izraelite. Ju nuk keni pse të jeni ekspert për të parë se kjo është recetë për zgjerimin, jo kufizimin e konfliktit. Këtu duhet përballur e vërteta, jo të shmangët apo të mohohet.

Sot ka hebrej izraelitë që flasin sinqerisht për "post-sionizmin", përderisa pas 50 vjetësh historie izraelite, sionizmi klasik nuk i ka dhënë as një zgjidhje pranishë palestineze dhe as një prani ekskluzivisht hebraike. Nuk shoh asnjë mënyrë tjetër veçse të fillojmë tani të flasim për ndarjen e tokës që na ka bashkuar, duke e ndarë atë në një mënyrë vërtet demokratike, me të drejta të barabarta për çdo qytetar. Nuk mund të ketë pajtim nëse të dy popujt, dy komunitetet e vuajtjeve, nuk vendosin se ekzistenca e tyre është një fakt laik dhe se duhet trajtuar si i tillë.

Kjo nuk do të thotë pakësim i jetës hebraike si jetë hebraike ose një dorëzim i aspiratave dhe ekzistencës politike arabe palestineze. Përkundrazi, do të thotë vetëvendosje për të dy popujt. Por kjo do të thotë të jesh





i gatshëm për të zbutur, pakësuar dhe përfundimisht të heqësh dorë nga statusi special për një popull në kurriz të tjetrit. Ligji i kthimit për hebrenjtë dhe e drejta e kthimit për refugjatët palestinezë duhet të merren parasysh dhe të shartohen së bashku. Të dy nocionet e Izraelit të Madh si toka e popullit hebre që iu dha atyre nga Zoti dhe e Palestinës si një tokë arabe që nuk mund të tjetërsohet nga atdheu arab, duhet të reduktohen në shkallë dhe ekskluzivitet.

Është interesante se historia mijërvjeçare e Palestinës ofron të paktën dy precedentë për të menduar në terma kaq laikë dhe modestë. Së pari, Palestina është dhe ka qenë gjithmonë një vend me shumë histori; është njëthjeshtim radikal të mendosh për të si parimisht ose ekskluzivisht si hebraike ose arabe. Ndërsa prania e hebrenjve është e kamotshme, ajo nuk është aspak kryesorja. Qiramarrës të tjerë kanë përfshirë kananitët, moabitët, jebusitët dhe filistinët në kohët e lashta, dhe romakët, osmanët, bizantinët dhe kryqtarët në epokat moderne. Palestina është multikulturore, multietnike, multifetare. Ka aq pak justifikim historik për homogjenitetin sa ka për nocionet e pastërtisë kombëtare ose etnike dhe fetare sot.

Së dyti, gjatë periudhës ndërmjet luftërave, një grup i vogël, por i rëndësishëm mendimtarësh hebrej (Judah Magnes, Buber, Arendt dhe të tjerë) argumentuan dhe agjituan për një shtet binacional. Logjika e sionizmit natyrshëm i mposhti përpjekjet e tyre, por ideja është e gjallë sot aty-këtu mes individëve

hebrenj dhe arabë të frustruar me pamjaftueshmëritë dhe shkatërrimet e dukshme të së tashmes. Thelbi i vizionit të tyre është bashkëjetesa dhe ndarja në mënyra që kërkojnë një gatishmëri novatore, të guximshme dhe teorike për të kapërcyer ngërçin e thatë të pohimit dhe refuzimit. Pasi të bëhet njohja fillestare e tjetrit si i barabartë, besoj se rruga përpara bëhet jo vetëm e mundshme, por edhe tërheqëse.

Megjithatë, hapi fillestar është shumë i vështirë për t'u hedhur. Hebrenjtë izraelitë janë të izoluar nga realiteti palestinez; shumica prej tyre thonë se nuk i shqetëson realisht. Më kujtohet hera e parë që shkova me makinë nga Ramallah në Izrael, duke menduar se ishte si të shkoja direkt nga Bangladeshi në Kaliforninë Jugore. Megjithatë realiteti nuk është se gjithnjë e bën të veten.

Gjenerata ime e palestinezëve, ende të tronditur nga tronditja e humbjes së gjithçkaje në vitin 1948, e kanë pothuajse të pamundur të pranojnë që shtëpitë dhe fermat e tyre janë marrë nga një popull tjetër. Nuk shoh asnjë mënyrë për t'iu shmangur faktit që në vitin 1948 një popull shpërnguli një tjetër, duke bërë kështu një padrejtësi të rëndë. Leximi i historisë palestineze dhe hebrije së bashku jo vetëm që u jep tragjedi të Holokaustit dhe asaj që më pas ndodhi me palestinezët, por gjithashtu zbulon se si gjatë jetës së ndërlidhur izraelite dhe palestineze që nga viti 1948, një popull, palestinezët, ka mbartur një pjesë të shpërpjesëtimshme të dhimbjes dhe humbjes.

Izraelitët fetarë dhe të

djathtistë dhe përkrahësit e tyre nuk e kanë problem një formulim të tillë. Po thonë, fituam, por kështu duhet. Kjo tokë është toka e Izraelit, jo e askujt tjetër. I dëgjova ato fjalë nga një ushtar izraelit që ruante një buldozer që po shkatërronte fushën e një palestinezi të Bregut Perëndimor (pronari i tij duke parë i pafuqishëm) për të zgjeruar një rrugë anashkaluese.

Por ata nuk janë të vetmit izraelit. Për të tjerët, që duan paqen si rezultat i pajtimit, ka pakënaqësi me rritjen e ndikimit të partive fetare mbi jetën izraelite dhe padrejtësinë dhe frustrimet e Oslos. Shumë izraelitë të tillë demonstrojnë kundër shpronësimeve të tokës palestineze të qeverisë së tyre dhe prishjes së shtëpive. Kështu që ju ndjeni një gatishmëri të shëndetshme për të kërkuar paqe diku tjetër sesa në grabitjen e tokës dhe bombat vetëvrasëse.

Për disa palestinezë, për shkak se ata janë pala më e dobët, humbësit, heqja dorë nga një restaurim i plotë i Palestinës arabe, është heqje dorë nga historia e tyre. Megjithatë, shumica e të tjerëve, veçanërisht brezi i fëmijëve të mi, janë skeptikë ndaj të moshuarve dhe shikojnë më në mënyrë jokonvencionale drejt së ardhmes, përtej konfliktit dhe humbjes së pafundme. Natyrisht, institucionet në të dy komunitetet janë shumë të lidhura për të paraqitur rryma "pragmatike" të mendimit dhe formacionet politike për të ndërmarrë diçka më të rrezikshme, por disa të tjerë (palestinez dhe izraelit) kanë filluar të formulojnë alternativa radikale ndaj status quo-së. Ata

refuzojnë të pranojnë kufizimet e Oslos, atë që një studiues izraelit e ka quajtur "paqe pa palestinezë", ndërsa të tjerë më thonë se lufta e vërtetë është për të drejtat e barabarta për arabët dhe hebrenjtë, jo si një entitet palestinez i veçantë, domosdoshmërisht i varur dhe i dobët.

Fillimi është zhvillimi i diçkaje që mungon krejtësisht si në realitetin izraelit, ashtu edhe në atë palestinez sot: idenë dhe praktikën e shtetësisë, jo të komunitetit etnik apo racor, si mjeti kryesor i bashkëjetesës. Në një shtet modern, të gjithë anëtarët e tij janë qytetarë për shkak të pranisë së tyre dhe ndarjes së të drejtave dhe përgjegjësisë. Prandaj, nënshtetësia i jep të drejtën një hebreu izraelit dhe një arabi palestinez për të njëjtat privilegje dhe burime. Kështu, një kushtetutë dhe një ligj i të drejtave bëhen të nevojshme për të kaluar përtej fazës së parë të konfliktit, sepse secili grup do të kish të njëjtën të drejtë për vetëvendosje; pra, e drejta për të praktikuar jetën e përbashkët në mënyrën e vet (hebraike apo palestineze), ndoshta në kantone të federuara, me një kryeqytet të përbashkët në Jerusalem, qasje të barabartë në tokë dhe të drejta të patjetërsueshme laike dhe juridike. Asnjëra palë nuk duhet të mbahet peng i ekstremistëve fetarë.

Megjithatë, ndjenjat e persekutimit, vuajtjes dhe viktimizimit janë aq të rrenjosura saqë është pothuajse e pamundur të ndërmerren nisma politike që i mbajnë hebrenjtë dhe arabët me të njëjtat parime të përgjithshme

të barazisë civile, duke shmangur grackën në kundër atyre. Intelktualët palestinezë duhet t'ua shprehin çështjen e tyre drejtpërdrejt izraelitëve, në forume publike, universitete dhe media. Sfida është si për shoqërinë civile ashtu edhe brenda saj, e cila prej kohësh i është nënshtruar një nacionalizmi që është zhvilluar në një pengesë për pajtimin. Për më tepër, degradimi i diskutit – i simbolizuar nga akuzat tregtare të Arafatit dhe Netanyahu, ndërkohë që të drejtat palestineze rrezikohen nga shqetësimet e ekzagjeruara të "sigurisë" – pengon shfaqjen e çdo perspektive më të gjerë dhe më bujare.

Alternativat janë jashtëzakonisht të thjeshta: ose lufta vazhdon (së bashku me koston e rëndë të procesit aktual të paqes), ose kërkohet në mënyrë aktive një rrugëdalje, e bazuar në paqen dhe barazinë (si në Afrikën e Jugut pas aparteidit), pavarësisht pengesave të shumta. Pasi ta pranojmë që palestinezët dhe izraelitët janë atje dhe s'kanë ku të shkojnë, atëherë përfundimi i denjë duhet të jetë nevoja për bashkëjetesë paqësore dhe pajtim të vërtetë. Vetëvendosje e vërtetë. Fatkeqësisht, padrejtësia dhe lufta nuk zvogëlohen vetvetiu: ato duhet të sulmohen nga të gjithë të shqetësuarit prej tyre.

Shkrim i botuar më 10 janar 1999 në "The New York Times"

Përktheu nga anglishtja:  
Rexhep MALOKU  
Marrë nga numri 22 i revistës "AKADEMIA"

**S**a herë kujtoj momentin kur mësova të vërtetën, u them prindërve që do të doja të më kishit lënë ta jetoja më gjatë atë fantazi...


Tregimet për Babagjyshin, slitën e tij fluturuese dhe elfat që përgatisin dhurata në Polin e Veriut ushqejnë imagjinatën e fëmijëve. Imagjinata është një element kyç për zhvillimin e inteligjencës, sepse ndihmon në zgjidhjen kreative të problemeve dhe nxit të menduarit jashtë kutisë. Në një botë ku teknologjia mbizotëron, besimi te Babagjyshi i ndihmon fëmijët të ruajnë ndjenjën e çudirave. Kjo ndjenjë është thelbësore për fëmijërinë dhe krijon kujtime të paharrueshme që ata do të mbajnë gjatë gjithë jetës.

Historitë për Babagjyshin, i cili ndan dhurata pa pritur asgjë në këmbim, u mësojnë fëmijëve rëndësinë e bujarisë. Gjithashtu, pritja e dhuratave nxit ndjenjën e mirënjohjes tek ata. Edhe pse një ditë fëmijët do të zbulojnë të vërtetën për Babagjyshin, kjo nuk e zbeh magjinë.

Përkundrazi, ata kuptojnë rëndësinë e besimit në diçka më të madhe se vetja dhe mësimin se disa gjëra kanë vlerë sepse na sjellin lumturi, jo sepse janë të vërteta.

Besimi te Babagjyshi i Vitit të Ri nuk është vetëm një histori, është një pjesë e rëndësishme e fëmijërisë që nxit gëzim, kreativitet dhe vlera të rëndësishme për jetën. Prindërit duhet ta ruajnë këtë magji për sa kohë që është e mundur, duke u dhënë fëmijëve një botë plot shpresë, dashuri dhe mirësi.

# Pse nuk duhet të thuash: **Babagjyshi nuk ekziston!**







# 15 mesazhe të veçanta që mund t'u dërgoni familjarëve dhe miqve për Vitin e Ri

Viti i Ri është vetëm disa orë larg dhe të gjithë mezi e presim, më shumë ndoshta se çdo vit tjetër. 2024-a ishte një vit i gjatë, i lodhshëm për shumë prej nesh dhe fatkeq për disa të tjerë që kanë humbur njerëz të zemrës. Por, një dritë e re shpresëdhënëse na bën të shohin përpara e të shpresojmë për mundësi e qëllime, sfida dhe ndryshime të reja.

Familja dhe miqtë bëhen edhe më të dashur në një festë si kjo, ndaj edhe meritojnë mesazhet më të bukura për Vitin e Ri. Kjo është një periudhë e veçantë e vitit që mbart edhe një mesazh special për t'ua uruar ndryshe festën njerëzve të dashur. Janë të shumta mënyrat për të uruar shëndet, dashuri dhe sukses, ndaj bëje urimin më të personalizuar.

Tani që po hyjmë në vitin 2025, është mirë që 2020-a të jetë një kujtim i largët dhe të festojmë Vitin e Ri me shumë gëzim dhe lumturi. Me distancim fizik dhe me orë policie, zilja në Vitin e Ri nuk do të jetë e njëjtë si dikur. Megjithatë, për njerëzit që janë me kilometra larg, ne kemi përpiluar një listë mesazhesh, citatesh dhe urimesh që mund t'ju vijnë në ndihmë shkruan Class.

**1.** Tani që Viti i Ri po afron gjithmonë e më shumë, unë po mendoj për atë që kaluam bashkë gjatë këtij viti. Jam mirënjohëse për shumë njerëz të rëndësishëm duke të përfshirë edhe ty. Askush nuk e di se çfarë ka në dyqanin e tij Viti i Ri për ne, por ti mund ta presësh një kartë tjetër pushimesh nga unë.

**2.** Duke numëruar bekimet e mia, ty të uroj më shumë. Shpresoj që të gëzosh shumë nga të mirat e Vitit të Ri! Të uroj për shumë vjet Gëzuar, miku im!

**3.** Duke pritur Vitin e Ri, unë gjithmonë mendoj për dhuratat më të shtrenjta që prindërit më kanë bërë. Edhe pse jemi milje larg, ti

**7.** Urimet e mia për ty: fillim i mbarë për janarin, dashuri për shkurtin, paqe për marsin, asnjë shqetësim për prillin, qejf për majin, gëzim nga qershori në nëntor, lumturi për dhjetorin. Paç një 2025 me fat dhe të mrekullueshëm!

**8.** Uroj në këtë Vit të Ri shpresa dhe aspirata të

**10.** Viti i Ri shënon një fillim të ri. Njerëz të rinj për të takuar, aventura të reja për të shijuar dhe kujtime të reja për të krijuar. Të uroj një Vit të Ri të lumtur!

**11.** Shpresoj që ky vit të jetë viti më i mirë i jetës suaj dhe i familjes suaj gjithashtu. Gëzuar Vitin e Ri 2025!

**12.** Le t'ju sjellë ky Vit i Ri shumë gëzim dhe paqe, dashuri dhe sukses. Gëzuar Vitin e Ri!

**13.** Ka kaluar një vit i ngarkuar me kujtime të ëmbla dhe kohëra të zymta. Ti e ke bërë vitin tim jashtëzakonisht të pazakontë, uroj që kjo të vazhdojë përgjithmonë. Me ty pranë, çdo minutë është një ngjarje unike për mua. Uroj që të kesh një vit aq të pabesueshëm sa je edhe ti vetë.

**14.** Sado netët të jenë të errëta, ditët do të sjellin sërish dritën. Me

gjithmonë je në mendimet dhe lutjet e mia. Gëzuar për shumë vjet Vitin e Ri!

**4.** Njohja me ty ka qenë Masteri im në miqësinë e vërtetë. Në Vitin e Ri, shpresoj që ta meritoj dashurinë dhe ngrohtësinë tënde. Të uroj një Vit të Ri të gëzuar!

**5.** Çdo fund është një fillim i ri. Mbaje shpirtin dhe vendosmërinë të patundur dhe gjithmonë do të ecësh në një rrugë me lavdi. Me guxim, besim dhe përpjekje, do ta arrish çdo gjë që ke dëshiruar. Të uroj një vit të lumtur!

**6.** Ndërsa mendoj për miqësinë tonë dhe sa të lumtur më ka bërë ajo mua, dua të të uroj shumë lumturi për vitin që po vjen!

reja, së bashku me zellin, guximin dhe angazhimin tënd për t'i arritur. Të uroj gjithë të mirat dhe Gëzuar Vitin e Ri!

**9.** Uroj që Viti i Ri të të japë forcën për të përballuar sfidat e jetës dhe kurajën për të qetësuar ujërat e për të pasur gjithçka nën kontroll në çdo hap që do të ndërmarrësh! Është Vit i Ri, i dashur!

urimin që jeta të jetë gjithmonë plot dritë, ju dëshiroj një vit të bekuar e të suksesshëm 2025. Gëzuar Vitin e Ri!

**15.** Çdo dimër është paralajmërim i ardhjes së pranverës dhe bashkë me të, edhe i një jetë të re plot dritë. Qoftë i tillë viti 2025 për ju! Gëzuar Vitin e Ri!

Happy  
New Year  
2025

# Kam gjithçka, por nuk jam e lumtur!

“Të kesh dhe të Jesh “ dy koncepte sa të ndryshme por që kanë një ndikim thelbësor në mirëqenien psikologjike!

E megjithatë, “Të kesh” nuk është domosdoshmerisht siguria për një Jetë të lumtur.

Ti mund të kesh një familje, një partner që e do dhe të do shumë, miq të vertetë, mund të kesh para, punë që të bën të ndihesh mirë, suksese të realizuara e projekte që presin te realizohen nga ti, por në thelb a je ti e lumtur me gjithcka bën dhe gjithcka që të rrethon?

A ndihesh ti e përmbushur? A ndihesh ti në paqe me veten? A ndihesh ti e sigurt me njerëzit, miqtë, familjarët, kolegët, me të gjithë keta aktorë që përbëjnë rrethin social, shoqëror dhe emocional tëndin?

Apo ata shërbejnë si një burim stresi për ty?

Të mirat materiale influencojnë jetët e gjithsecilit nga ne sepse padyshim ato sigurojnë dhe garantojnë mbijetesën tonë. Na bëjnë të ndihemi më te qetë e më te sigurt me veten, më te fortë në sy të të tjerëve duke na e forcuar vetbesimin.

Por, a mjaftojnë përpjekjet tona për “ Te pasur sa më shumë” përgjatë gjithë rrugëtimit tonë jetësor për të na dhuruar kënaqesine dhe lumturinë?

A e garanton lumturinë, kënaqesia që vjen përtej asaj që ne posedojmë?

Përmbushja materiale sigurisht që na ben të ndihemi mirë, ndihmon në rritjen e cilësisë së jetës.

Por mos harrojmë se është nje proces, një dukuri natyrale dhe njerëzore që e zhvillon momentin e saj në terma të shkurtër, që zgjat shumë pak!

“ Lumturia është një gjendje e brendëshme me të cilën punohet çdo ditë.. që shkon përtej “ Të Pasurit”! Lumturi do të thotë “Të Jesh”, “Të ndjesh”, “ Të Jetosh”!

Eshte psikologjikisht e shëndetëshme “ Të Jesh” e të mësosh “ Të Kesh “ më pak për tu fokusuar mbi ekzistencën, Jetën tonë, mbi gjithcka që ndjejmë, mbi vet Jetën.

Jetojmë në epokën materialiste ku qenia njerëzore priret drejt materiale për të mbërrirë lumturinë! Nëse gjithmonë përqendrohemi mbi tendencën për “ Të Pasur” sa më shumë të mira materiale, kufiri drejt esenciales bëhet tejet i paqartë.

Sa më shumë priremi të kemi, aq më pak rrezikojmë të ndjejmë!

Dhe për rrjedhojë, kur ti ndjen se “ Je me të vërtetë “ , ti nuk ke më nevojë te “Kesh” përtej limiteve sepse të “Jesh” dhe të bëhesh ajo që ti do të jesh, është gjithçka që të duhet për të qenë e Lumtur!





# Misteri i Dhomës Amber: Thesari më i madh i humbur në botë

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazistët e Adolf Hitlerit vodhën rreth 600.000 vepra arti nga e gjithë Evropa. Deri në fund të luftës, vepra arti me vlerë miliardë paund ishin të shpërndara kudo, sepse grabitja e nazistëve kishte qenë në një shkallë industriale.

Ndërsa disa nga veprat iu kthyen pronarëve të tyre të ligjshëm, shumë prej tyre mungojnë ende, përfshirë një koleksion të çmuar të njohur si Dhoma Amber, ku gjendeshin sendet ndoshta më të vlefshme të grabitura ndonjëherë nga regjimi fashist.

Dhoma u quajt "Mrekullia e Tetë e Botës", dhe një nga artefaktet më të çmuara të Rusisë. Pas grabitjes së saj, dhoma u kthye në Gjermani dhe u ekspozua, por u zhduk në muajt e fundit të luftës. Fati i tij është një nga misteret më të mëdha të Luftës së Dytë Botërore.

Dhoma Amber daton që në vitin 1701, kur skulptori gjerman barok Andreas Shlyter filloi punën ndërtimin e saj. Në atë kohë, Shlyter ishte arkitekti kryesor i oborrit mbretëror prusian, dhe përdorimi i qelibrarit për dekorimin e brendshëm ishte një praktikë krejtësisht e re.

I njohur si Ari i Veriut, qelibrari është një rrëshirë peme e fosilizuar, dhe thuhet se rajoni Baltik përmban depozitimin më të madh të njohur të tij. Shlyter planifikoi të zbulonte me panele qelibrari muret e njërës prej dhomave në Pallatin Karlotenburg, në Berlin.

Pallati ishte shtëpia e Frederikut I, mbretit të parë të Prusisë dhe gruas së tij Mbretëreshës Sofi Karlota. Për të përfunduar punën, Shlyter kërkoi ndihmën e mjeshtrit danez të qelibrarit Gotfrid Volfram. Të dy shpikën një mënyrë për të punuar me

qelibrarin. Kjo lëndë ngrohej dhe më pas zhytej në një përzierje me mjaltë dhe farë liri, përpara se të punohej në panele druri të mbuluara me fletë ari apo argjendi dhe të zbkurohej me xhevahire të çmuara.

Në vitin 1707, mjeshtrit e qelibrarit Ernst Shaht dhe Gotfrid Turau nga Danzigu, e vazhduan punën deri në vdekjen e Sofi Karlotës dhe Frederikut. Kur përfundoi, dhoma u instalua në Pallatin e Qytetit të Berlinit. Gjatë një vizite në vitin 1716, Cari i Rusisë, Pjetri i Madh, u magjeps prej saj.

Për të krijuar një aleancë midis dy shteteve, djali i Frederikut, Frederik Vilhelmi I, ia bëri dhuaratë Pjetrit dhomën luksoze. Ajo u çmontua, u vendos në kuti të mëdha dhe u zhvendos në qytetin që Pjetri sapo kishte themeluar, Shën Petersburg.

Në vitin 1755, vajza e Pjetrit, perandoresha Elizabeta, e vendosi dhomën në Pallatin e Katerinës në Pushkinin e sotëm, në periferi të Shën Petersburgut. Disa zejtarë të tjerë rusë, gjermanë dhe italianë punuan në këtë dhomë gjatë viteve të ardhshme, duke zgjeruar atë. Në vitin 1770, dhoma zinte një sipërfaqe prej shumë se 55 metra katrorë, dhe ishte zbuluar me mbi 6 ton qelibrar. Pamja e saj mahniti dhe hipnotizoi të gjithë ata që hynë për ta parë.

Vlerësimet moderne flasin për një kosto prej 120-240 milionë paund. Dhoma Amber mbeti një thesar i Rusisë gjatë shekujve XVIII-XIX, dhe madje i mbijetoi Revolucionit të vitit 1917. Megjithatë, qëndrimi i në territorin rus përfundoi në vitin 1941, kur forcat e Hitlerit rrethuan Shën Petersburgun (në atë kohë quhej Leningrad) si pjesë e



Operacioni Barbarosa.

Krye-kuratori i artit, Anatoli Kuçumov, kishte për detyrë ta çmontonte dhomën e çmuar, dhe

ta përgatiste atë për një zhvendosje të sigurt në lindje të vendit. Por ai zbuloi se panelet e qelibrarit ishin bërë shumë të brishta për shkak të kalimit të kohës, dhe besonte se do të demtoheshin keq nëse do të dëntohej të çmontohej.

Prandaj ai urdhëroi që dhoma të mbulohej me një shtresë të hollë letër-muri, me shpresën se nazistët nuk do ta vinin re. Por mashtrimi dështoi. Hitleri ishte i mirë-informuar mbi historinë e Dhomës Amber. Në sytë e tij, vepra artistike ishte një prodhim gjerman, ndaj duhej rikthyer në vendlindje për t'u shijuar nga bashkatdhetarët e tij.

Nazistët e dinin saktësisht se çfarë kërkonin, dhe brenda 36 orëve ata ia dolën të bënin atë që nuk e kishte arritur Kuçumov: hoqën panelet nga muret dhe i paketuan në arka.

Arkat u dërguan në Königsberg në Gjermani në bregdetin Baltik (Kaliningradi i sotëm, një enklavë ruse) dhe dhoma u rindërtua në kështjellën e Königsbergut.

Ajo mbeti e ekspozuar për popullin gjerman atje për 2 vitet e ardhshme. Kur vala e luftës u kthye në favor të aleatëve, dhoma ishte sërish në lëvizje, pasi Hitleri urdhëroi që pasuritë e grabitura nga Königsbergu të dërgoheshin jashtë vendit. Në vitin 1944, forcat ajrore britanike, RAF bombarduan rëndë Königsbergun, duke përfshirë lagjet e tij historike.

A u evakuua në kohë Dhoma Amber apo u shkatërrua nga bombardimet? Kur Ushtria e Kuqe marshoi në qytetin gjerman, Dhoma Amber nuk u pa askund, dhe vendndodhja e saj mbetet ende sot një mister. Teoria më popullore dhe e mbështetur nga profesori Aleksandër Brusov, njeriu që sovjetikët e dërguan për të rimarrë artefaktet e vjedhura në maj 1945, është se dhoma u shkatërrua nga bombardimet dhe zjarret që pasuan.

Në bodrumin e kështjellës, Brusov supozohet se zbuloi mbetjet e djegura të 3 nga 4 mozaikët florentinë, që kishin qenë në dhomën e qelibrarit. Por Kuçumov, njeriu që nuk kishte arritur ta mbante dhomën të sigurt në vitin 1941, refuzoi të pranonte përfundimin e Brusov. Me mbështetjen e KGB-së, ai e denoncoi Brusovin dhe filloi hetimin e tij, ndoshta në një përpjekje për të larguar vëmendjen nga gabimi personal.

Në vitet që pasuan, u ngritën teori të ndryshme. Dëshmitarët okularë pohuan se e kishin parë Dhomën Amber duke u paketuar dhe vendosur në bordin e

anijes "Vilhelm Gustlof", e cila u fundos në janar 1945 nga një nëndetëse sovjetike. Por rrënojat e saj janë eksploruar shumë herë, dhe nuk është zbuluar asgjë që lidhet me Dhomën Amber.

KGB-ja kreu hetime të plota rreth Königsberg, por nuk gjeti asgjë. Pretendime të tjera e vendosin dhomën në minierat e vjetra të kripës në kufirin çek, të zhytur në një lagunë në Lituani apo edhe madje në SHBA. Pas një investigimi të gjatë, gazetarët britanikë Kethrin Skot-Klark dhe Adrian Levi shkruan në librin e tyre të vitit 2004 "The Amber Room", se Brusov kishte të drejtë: dhoma ishte shkatërruar nga bombardimet në Königsberg.

Sigurisht, Dhoma Amber është dëshmuar të jetë një obsesione rrezikshme për disa. Ish-ushtari gjerman dhe historiani amator Georg Shtein, i kushtoi një pjesë të madhe të jetës së tij gjetjes së dhomës së qelibrarit. Ai u gjet i varë në një pyll bavarez në vitin 1987. Ndërkohë gjenerali Juri Gusev, nën/drejtor i njësisë së inteligjencës së jashtme të Rusisë, vdiq në një aksident misterioz automobilistik në vitin 1992.

Ai ishte burimi kryesor për një gazetar që po hetonte vendndodhjen e Dhomës Amber. Në vitin 1979, qeveria sovjetike urdhëroi realizimin e një kopje të Dhomës Amber. 24 vjet më vonë dhe me një kosto prej 11 milionë dollarësh, pjesërisht e financuar nga gjermanët, ajo u përfundua dhe u montua sërish në Pallatin Katerina në Shën Petersburg. Originali është zëvendësuar, por nuk është harruar. Shumë njerëz besojnë se gjuetia për thesarin më të madh të humbur në botë nuk ka përfunduar.

/History.co.uk/ bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

# Khudoja ia zbardhë fytyrën Kosovës, rrëmben dy medalje në Lojërat Olimpikë



Sporti i khudos, i udhëhequr nga Driton Kuka, mbetet i pakonkurrencë në Republikën e Kosovës për rezultate pozitive në arenën ndërkombëtare. Në vitin që po lëmë pas sportistët e khudos ishin triumfues edhe në Lojërat Olimpikë që u mbajtën në Paris. Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu rrëmbyen një të argjendtë dhe një të bronzhtë, derisa rezultatet nuk munguan në asnjë kampionat e garë ku ishin pjesëmarrës sportistët e Kosovës

**EPOKA ERE****Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, DHJETOR, JANAR - Viti 2024 ishte shumë i suksesshëm për sportin numër një në Kosovë, khudos. Garuesit kampionë arritën rezultate të mëdha përgjatë gjithë vitit, derisa kulmin e arritën në

Lojërat Olimpikë "Paris 2024", duke rrëmbyer dy medalje, duke e çuar në pesë numrin total të medaljeve olimpikë. Në fillim të janarit kampionia olimpikë dhe botërore, tashmë trajnerja Majlinda Kelmendi, në Itali e udhëhoqi kampin e khudos me rreth 1 500 khudistë. Kampi u organizua

nga klubi italian i khudos Akiyama Settimo, kurse në të kanë marrë pjesë edhe kryetrajneri Driton Kuka dhe ekipi U21 nga Kosova. Më 9 janar ekipi i khudos së Kosovës mori pjesë edhe në kampin olimpik në Mittersill të Austrisë. Pjesëmarrës ishin rreth 1 000 garues nga 55

shtete. Më 20 janar është mbajtur kampionati i Kosovës për sendorë në Qendrën Nacionale të Khudos në Pejë. Kampionati është organizuar nga Federata e Khudos e Kosovës në bashkëpunim me Klubin e Khudos "Ippon" nga Peja. Në fund të janarit komuna e Pejës shpalli sportistët e vitit me një ngjarje të veçantë: Driton Kukës i takoi çmimi i trajnerit të vitit, Distria Krasniqi është shpallur sportistja e vitit 2023, kurse Akil Gjakova sportisti i vitit. Fatmir Salihaj e ka rrëmbyer çmimin e gjyqtarit më të mirë, derisa klubi më i suksesshëm "Ippon". Ndërsa epiteti i sportistit më me perspektivë i takoi Blin Kukës. Në muajin shkurt filluan të vijnë medaljet në vendin

tonë. Një e artë dhe një e bronzhtë ishte bilanci i medaljeve të fituara nga ekipi olimpik i khudos në Grand Slamin e mbajtur në Paris të Francës. Distria Krasniqi fitoi medaljen e artë në kategorinë - 52 kilogramë. Akil Gjakova fitoi medaljen e bronzhtë në kategorinë -73 kilogramë, duke shkëlqyer me pesë fitore në një konkurrencë tejet të fortë. Në të njëjtën kategori, Dardan Cena pati njërrën prej paraqitjeve më të mira në karrierë, duke shënauar tri fitore radhazi, por që më pas u ndal në çerekfinale dhe në repesazh. Cena doli i shtati. E suksesshme ishte edhe Nora Gjakova, e cila ishte e pafat në luftën për të bronzhtë, duke përfunduar në vendin e pestë të kategorisë -57 kg. Në



këtë kategori garoi edhe Flaka Loxha, e cila u ndal në raundin e tretë.

Medalje xhudistet arritën edhe në Grand Slam "Baku 2024". Nora Gjakova ishte e pandalshme deri në finale, ku për arsye të lëndimit është detyruar ta ndërpresë garën dhe ta marrë medaljen e argjendtë. Lorianana Kuka dhe Laura Fazliu janë renditur në vendet e shtata. Distria Krasniqi është zgjedhur "Sportistja e vitit" në ngjarjen "Laureatët e Vitit 2023" të organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës, kurse Akil Gjakova "Sportisti i vitit". Driton Kuka mori çmimin "Trajneri i vitit". Në fillim të muajit mars u mbajt Kupa Evropiane për kadetë 2024 në Antali nën udhëheqjen e trajneres Majlinda Kelmendi. Fiona Kuka, Sidorela Dodaj dhe Enise Zijade në këtë garë siguruan vendin e pestë në kategoritë e tyre. Po ashtu, u mbajt Kampionati Stërvitor në Golem, Shqipëri, ku pjesëmarrës ishin 120 xhudistë nga të gjitha klubet e Kosovës si dhe xhudistë nga Shqipëria.



for Gold", nën udhëheqjen e kryemjeshtrit Driton Kuka dhe trajnerit Fatos Tabaku. Në kamp pjesëmarrës ishin 600 garues nga 50 shtete të botës, kurse nuk munguan kampionët e Kosovës, Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Laura Fazliu, Lorianana Kuka, Flaka Loxha, Dardan Cena, Fatjona Kasapi dhe Sidorela Doda. Më 22 mars Distria Krasniqi (-52 kg) e fitoi medaljen e bronzitë në Grand

mbajtur në Zagreb e fitoi medaljen e artë. Krasniqi në finale e mposhti garuesen italiane Odette Giuffrida. Në kuadër të komponentit, "Diplomacia publike", e programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos", përgjatë dy javëve është mbajtur kampionati stërvitor ndërkombëtar në Qendrën Nacionale të Xhudos. Pjesëmarrës ishin ekipet e xhudos nga Anglia, Bullgaria, Polonia, Afrika e Jugut, Suedia dhe Bosnjë-Hercegovina, ku garuesit u përgatitën për Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Kampionati është udhëhequr nga trajneri e selektori Driton Kuka. Më 21 maj u regjistrua edhe një sukses i madh, ku Laura Fazliu (63 kg) ka bërë paraqitje fantastike në Botërorin e Xhudos në Abu Dhabi, pasi ka fituar medaljen e bronzitë. Në finale të repesazhit pati punë me kanadezen Catherine Beauchemin-Pinard, të cilën e mposhti në kohën e rregullt me një "waza-ari", për t'u stolitur me medalje. Pas katër ditësh, Roland Berani është stolitur me medalje të bronzitë në Kupën Evropiane U15 për Shpresa në Bielsko Biala të Polonisë. Berani fitoi katër ndeshje dhe humbi një. Ndërsa Elvira Ukaj

është stolitur me medalje të argjendtë. Ukaj fitoi tri ndeshje dhe humbi një, atë të finales. Më 1 qershor, Blerina Gashi doli e artë, kurse Besjana dhe Bleona Gashi zunë vendet e pesta në Kampionatin Ballkanik për Kadet (U18) në Podgoricë të Malit të Zi. Pjesëmarrës ishin 11 shtete. Më 16 qershor, Flaka Loxha dhe Erza Muminoviq fituan medalje të bronzitë në Kupën Evropiane për Senior në Podçetertek të Sllovenisë. Më 22 qershor, Nora Gjakova kaloi me sukses lëndimin dhe fitoi medaljen e artë në "Pan american Open" në Peru, që ishte gara e fundit kualifikuese para Lojërave Olimpikë. Në Peru garoi edhe Dëbora Gjakova që mori medaljen e argjendtë. Në fillim të muajit korrik, Sidorela Dodaj doli e pesta në Kampionatin Evropian U18 në Sofje të Bullgarisë. Ekipi ynë olimpik mori pjesë në kampionat e fundit olimpik që u mbajt në Benidorm të Spanjës nga data 2 deri më 6 korrik, para Lojërave Olimpikë në Paris. Më 8 korrik Flaka Loxha (-57 kg) e fitoi medaljen e bronzitë në Kupën Botërore në Tallin të Estonisë. Loxha për të bronzitën mposhti

me ngufatje për Ippon holandezen Danique Janssen. Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Francës, nën organizimin e Ambasadës së Francës në Kosovë me ambasadorin Olivier Guerot, u mbajt demonstrimi i xhudos nga Klubi i Xhudos "Polici" nga Prishtina dhe xhudistëve të këtij klubi. Më 16 korrik u mbajt ceremonia e dorëzimit të flamurit të Republikës së Kosovës nga presidentja Vjosa Osmani për ekipin olimpik. Të pranishëm në këtë ceremoni, përveç presidentes Osmani, ishin edhe kryeministri Albin Kurti, ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ambasadori i ShBA-së, Jeffrey Hovenier, kryetari i KOK-ut, Ismet Krasniqi etj. Ceremonia kulmoi me dorëzimin e flamurit nga presidentja Osmani për ekipin olimpik, pranuar nga e arta, Nora Gjakova.

Ekipi i xhudos, nën udhëheqjen e kryemjeshtrit Driton Kuka, ka arritur suksese të mëdha në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Kosova në këtë Olimpiadë arriti të sigurojë dy medalje olimpikë, një të argjendtë dhe një të bronzitë dhe një vend të pestë. Me këto arritje, Kosova tani ka gjithsej pesë medalje olimpikë. Mbi të gjitha, Distria, Laura, Akili, Lorianana dhe Nora na dhanë emocione të jashtëzakonshme.

Nën drejtimin këmbëngulës të kryemjeshtrit Driton Kuka dhe trajnerëve Majlinda Kelmendi e Fatos Tabaku, bashkë me xhudistët e talentuar, Kosova vazhdon traditën dhe përkushtimin në xhudo. Kosova tash është midis vendeve të dëshmuara në sportin e xhudos edhe në arenën ndërkombëtare. Rezultatet: Distria Krasniqi (-52 kg) medalje të argjendtë, Laura Fazliu (-63 kg) medalje të bronzitë, Akil Gjakova (-73 kg) vendin e pestë, Lorianana Kuka (-78 kg) vendin e nëntë, kurse Nora Gjakova (-57 kg) pa plasman. Pas përfundimit të Lojërave Olimpikë, medalistja evropiane e botërore, Lorianana Kuka, përfundoi karrierën e suksesshme si xhudiste. Më 7 gusht është bërë pritje për shtetërore për ekipin olimpik të Kosovës në sheshin "Xhorxh Bush" në Prishtinë. Pritje solemne është bërë edhe nga komuna e Pejës, nga vijnë kampionët e xhudos. Më 11 gusht Laurina Gashi (-52 kg) e fitoi medaljen e bronzitë në Kupën Evropiane për juniorë në Shkup. Gashi për të bronzitën mposhti me Ippon serben Anja Cobanoviq. Të bronzitën e rrëmbeu edhe Sidorela Dodaj (-48 kg). Dodaj për të bronzitën mposhti me "wazaari" në vazhdime serben Iva Miloseviciq. Ndërsa Federata Ndërkombëtare e Xhudos dhe Federata Evropiane e Xhudos



Kampionati është udhëhequr nga kryemjeshtri Driton Kuka dhe asistentet e reprezentacionit "Fatos Tabaku & Majlinda Kelmendi". Bashkia e Kavajës, respektivisht kryetari i Bashkisë, Fisnik Qosaj, nderoi me mirënjohje dhe si simbolikë i dhuroi flamurin kombëtar kryemjeshtrit Kuka për kontributin e dhënë në promovimin e sportistëve cilësorë me rezultate të larta në përfaqësimet ndërkombëtare në sportin e xhudos. Më 10 mars Rrezarta Alimi (-63 kg) fitoi medaljen e bronzitë në Kupën Evropiane për Juniorë në Podgoricë, kurse Lorianana Kuka është eliminuar nga Grand Prix Upper Austria. Ajo u ndal në xhiron e dytë, duke pësuar humbje ndaj kroates Karla Prodan. Gjashtë ditë më vonë në Nymburk të Çekisë u mbajt Kampionati Olimpik "Going

Slamin e Tbilisit të Gjeorgjisë. Xhudistja jonë u njoftua me humbjen në çerekfinale, ku u mposht nga spanjollja Ariane Toro Soler. Ajo vazhdoi në repesazh, ku në raundin e parë e mposhti zviceranen Binta Ndiaye, ndërsa në finale të repesazhit, Krasniqi e mposhti kinezen Yeqing Zhu dhe në këtë mënyrë e rrëmbeu medaljen e bronzitë. Ndërsa Laura Fazliu (-63 kg) u rendit e pesta. Laura për të bronzitën humbi nga holandezja Joanne Van Lieshout. Më 13 prill xhudistët e Kosovës ishin pjesë të Kampionatit Stërvitor Olimpik në Tata të Hungarisë. Një lajm i mirë për Kosovën erdhi më 20 prill nga Sarajeva, ku Jon Kuka (46 kg) e fitoi medaljen e parë në gara zyrtare. Pesë ditë më vonë, Distria dridhi edhe një herë Ballkanin, saktësisht në Kampionatin Evropian të





kanë dërguar urimet e tyre zyrtare për suksesin e Kosovës në Lojërat Olimpike "Paris 2024".

Më 24 gusht KFOR-i amerikan vizitoi Qendrën Nacionale të Xhudos. Në fund të gushtit, Flaka Loxha dhe Dëbora Gjakova fituan medaljet e arta, derisa Erza Muminoviq e Dardan Cena të argjendta, Muhamedin Veseli të bronztën, derisa Anes Veseli doli i pesti në Kampionatin Ballkanik për Senior në "Sarajevë 2024". Në shtator Flaka Loxha e fitoi medaljen e bronztë në Grand Prix që u mbajt në Zagreb. Në fund të këtij muaji, në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë është mbajtur turneu ndërkombëtar i xhudos "Xhudo për Paqe" për Kadetë dhe Senior. Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, e vizitoi ekipin e xhudos ku e përgëzoi trajnerin Kuka dhe ekipin për rezultatet fantastike në Lojërat Olimpike "Paris 2024". Trajneri Kuka i dhuroi ambasadorit Hovenier pllakate nga Federata e Xhudos e Kosovës, në shenjë mirënjohje dhe falënderimi. Më 2 tetor është mbajtur Kupa Evropiane dhe sesioni teknik me Majlinda Kelmendin si udhëheqëse në Brno të Çekisë. Në këtë kupë ishin 320 pjesëmarrës, 97 klube nga 19 kombe. Tri ditë më vonë në Kampionatin Ballkanik të Xhudos U21 në Tiranë, Kosova mori pesë medalje të arta me: Estea Arifaj, Enise Zijade, Andi Reshitaj, Muhamedin Veseli dhe Sidorela Dodaj. Flaka Loxha dhe

Erza Muminoviq janë renditur të pestat në Grand Slam Abu Dhabi. Më 19 tetor Blerina Gashi fitoi medaljen e artë në Kupën Evropiane U18 në Riga të Letonisë. Më 22 tetor është mbajtur Kampionati Ballkanik i Xhudos U23 në Pejë, ku morën pjesë rreth 150 garues nga



shtetet e Ballkanit. Ekipi i Kosovës fitoi 9 medalje, nga të cilat dy të arta, tri të argjendta dhe katër të bronzta. Në Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë në tetor është mbajtur Kampionati Ndërkombëtar Stërvitor i Xhudos me rreth 200 xhudistë e xhudiste nga shtetet si: Anglia, Shqipëria, Moldavia, Bullgaria, Bosnjë-Hercegovina, Kroacia, Çekia, Rumania, Mali i Zi, Turqia dhe ekipi ynë. Ky kamp organizohet në kuadër të programit shtetëror, "Kosova,

shtet i xhudos", nën komponentin "Diplomacia publike", që ka për qëllim zhvillimin e diplomacisë së Kosovës përmes sportit të xhudos. Në fund të tetorit sërish xhudo i solli medalje Kosovës dhe kësaj radhe nga "Sarajeva European Open 2024". Flaka



Loxha dhe Erza Muminoviq rrëmbyen medaljet e argjendta. Dardan Cena fitoi medalje të bronztë, kurse Muhamedin Veseli është renditur i pesti. Në fillim të muajit nëntor, trajneri i xhudos, Mustafë Veseli, në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos", mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar të trajnimit për xhudo në Japoni. Ndërsa në Golem të Shqipërisë për një javë është mbajtur kampionati stërvitor dedikuar grupmoshave kadetë,

juniorë dhe sendorë. Kampionati është udhëhequr nga kryemjeshtri Driton Kuka. Ndërsa Erza Muminoviqe ka fituar të bronztën në Kampionatin Evropian U23 në Pila të Polonisë.

Më 23 nëntor ishte një tjetër moment krenarie për xhudos e Kosovës. Federata e Xhudos e Kosovës u nderua me çmimin organizatori më i mirë për vitin 2023 nga Federata Evropiane e Xhudos. Në kongresin e 76 të mbajtur në Budapest, Hungari, ky vlerësim erdhi si rezultat i organizimit të shkëlqyer të Kampionatit Evropian Open "Prishtina 2023", ndërsa në këtë muaj është shfaqur premiera e dokumentarit "SENSEI Driton Toni Kuka - Made in Kosova". Dokumentari është realizuar nga regjisori Vranin Gecaj, kurse ky event mbledhi figura të shquara nga sporti, politika dhe diplomacia, përfshirë kryeministrin Albin Kurti, ambasadorin e ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ministrin e Sportit, Hajrulla Çeku dhe kryetarin e KOK-ut, Ismet Krasniqi. Më 30 nëntor është mbajtur në Prishtinë turneu ndërkombëtar "Adem Jashari", ku morën pjesë mbi 100 garues. Turneu është zhvilluar për kadetë dhe sendorë. Përveç klubeve të Kosovës, morën pjesë edhe klube nga Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Sllovakia, Maqedonia e Veriut, Bullgaria, Sllovenia, Suedia, Çekia. Garuesi më i mirë për meshkuj u shpall Dardan Cena, kurse garuesja më e mirë për femra u shpall Erlule

Musaj. Në fillim të dhjetorit, ekipi i Kosovës mori pjesë në Kampionatin Evropian U23 në Romë të Italisë. Xhudistët dhe xhudistet e Kosovës janë stërvitur me ekipet nga Italia, Gjermania, Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina. Ekipi ishte nën udhëheqjen e trajnerit e selektorit tonë Driton Kuka. Kryemjeshtri Kuka dhe medalistet olimpike Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Nora Gjakova dhe Laura Fazliu nderohen me rastin e 10-vjetorit të anëtarësimit të KOK-ut në Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Çmimet u dhanë nga presidenti i KON-it, Thomas Bach. Në Pejë u mbajt Kampionati i Kosovës në Xhudo për grupmoshat U18, U21 dhe U23. Kampionati u organizua nga Federata e Xhudos e Kosovës në bashkëpunim me Klubin e Xhudos "Ippon".

Më 16 dhjetor, në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos", në Qendrën Nacionale të Xhudos në qytetin e Pejës, është organizuar trajnimi për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës në fushën e xhudos, me fokus në avancimin e teknikave të xhudos dhe vetëmbrojtjes. Ky program përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të FSK-së, duke u bazuar në njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes sportit të xhudos. Duhet cekur se sporti i xhudos në kuadër të programit shtetëror "Kosova, shtet i xhudos" u demonstrua nëpër shkollat e ndryshme në Kosovë.





©Kosovo Olympic Committee

# Sporti i Kosovës me rezultate të kënaqshme. Spanja fiton 'Euro 2024', Rodri shpërblehet me 'Topin e Artë', Reali mbledh titujt dhe merr Mbappen

EPOKA  
ERE

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, DHJETOR, JANAR** - Sporti i Kosovës ka pasur ngritje në cilësi në vitin 2024, por rezultatet nuk kanë munguar edhe në rrafshin ndërkombëtar. Sporti botëror, si zakonisht, solli ngjarje të jashtëzakonshëm. Vlen të ceket triumfi i Spanjës në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Mesfushori i kësaj kombëtare, Rodri, që u shpallë kampion edhe me Manchester Cityn në Angli, e rrëmbeu "Topin e Artë", derisa transferimi kryesor është ai i Kylian Mbappes nga PSG-ja në Real Madrid. Ndërkohë klubi mbretëror fitoi titullin në La Liga, Ligën e Kampionëve dhe Superkupën.

## Prishtina, fituese e Ligës Unike Femrat

**3 MARS** - Trofeun e Final 4 Liga Unike Femrat e fitoi Prishtina, pasi në finale triumfoi ndaj Bashkimit me rezultat 49:92 (16:20, 6:16, 16:19, 11:27). Çmimi MVP i ka takuar Asiana Johnson që e mbylli ndeshjen me 27 pikë e dhjetë kërcime, çmim që u nda nga sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe Klodeta Krasniqi, shefe e kabinetit të ministrit Hajrulla Çeku. Në fund trofeun e kampionit kapitenes Elektra

Zykaj ia dorëzoi Arben Fetahu, kryetar i FBK-së dhe Daulina Osmani, zëvendësministre në MKRS.

## Hendbollistet U18 të Kosovës për herë të parë marrin pjesë në Kampionatin Botëror

**4 MARS** - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll për herë të parë ka marrë pjesë në Kampionatin Botëror në Chuzhou të Kinës. Në ndeshjen e fundit, "dardanet" e reja e mposhtën Nigerinë (21:18). Botërorin e parë të saj, Kosova U18 e përfundoi me tri fitore e katër disfata. Paraqitja në Botëror është sukses i madh i kësaj kombëtareje dhe hendbollit të Kosovës në përgjithësi. Përvoja në Kampionatin Botëror do të jetë me rëndësi për karrierën e mëtejme të kësaj gjenerate, prej së cilës pritet shumë.

## Miratohet programi 'SuperSportistët', me buxhet 4 milionë euro për katër vjet

**2 PRILL** - Qeveria e Kosovës e ka miratuar programin "Super Sportistët", përmes të cilit synohet të rritet numri i

normave olimpike dhe medaljeve olimpike për Lojërat Olimpike "Los Angeles 2028". Programi parasheh mbështetje në vlerë 4 milionë euro për katër vitet e ardhshme për sportistë të rinj të sporteve olimpike. Ky program, i përpiluar nga profesionistë të fushës, nga KOK-u, MKRS-ja dhe gazetaria sportive, udhëhiqet nga kryemjeshtri i normave dhe medaljeve të arta olimpike, Driton Kuka. Përmes programit synohet edhe rritja e numrit të medaljeve në Kampionate Botërore, Evropiane dhe Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030".

## KB Trepça dhe KBF Bashkimi mbledhin trofetë në basketboll

**10 PRILL** - Pas 12-vjetësh pritjeje, KB Trepça e ka fituar titullin e Kosovës në basketboll. Trepça e mposhti Golden Eagle Yllin në ndeshjen e pestë finale të plejofit të elitës së basketbollit kosovar. Trepça fitoi me rezultat 67:66 në palestrën "Minatori" në Mitrovicë, që ishte e stërbushur me shikues. Në këtë sezon klubi në fjalë e ka fituar edhe Kupën e Kosovës, Superkupën dhe Ligën Unike. KBF Bashkimi shkroi histori duke i fituar për herë të dytë rresht tre trofetë e basketbollit të Kosovës: Superkupën, Kupën

dhe titullin e kampionit. Titullin e kampionit për edicionin 2023/2024, Bashkimi e siguroi në palestrën "Seza Surroi". E mbylli serinë finale të plejfoit me rezultatin e përgjithshëm 3:0. Në finale mposhti Prishtinën.

## Florian Miftari zgjedhet dekan i ri i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit

**24 PRILL** - Ish-basketbollisti i mirënjohur Florian Miftari është zgjedhur dekan i ri i Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit. Miftari ka marrë besimin për të drejtuar këtë pjesë të rëndësishme të Universitetit "Hasan Prishtina". Deri tani këtë pozitë e mbante Musa Selimi i cili ka qenë dekan për dy mandate. Florian Miftari që ligjëron tri lëndë në këtë Universitet, ka qenë basketbollist i spikatur në vendin tonë.

## Taekwondistët e Kosovës fitojnë 15 medalje në Kampionatin Evropian, 4 në Kampionatin Ballkanik

**26 PRILL** - Përfaqësuesja e Kosovës në Taekwondo ka arritur të fitojë 15 medalje në Kampionatin Evropian të Taekwondos për shtetet e vogla në Tallin të Estonisë. Sportistët e Kosovës ngritën flamurin lart

duke u stolisur me pesë medalje të arta, katër të argjenda, gjashtë të bronzta. Suksesi nuk mungoi as në Kampionatin Ballkanik për Seniorë, i cili u mbajt në Oradea të Rumanisë, ku ekipi i Taekwondosë së Kosovës ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm duke fituar katër medalje. Jon Gashi shkëlqeu në kategorinë -80 kg, duke siguruar medaljen e artë, ndërsa Bleron Ademi u stolis me medaljen e argjendit në kategorinë -58 kg. Gjithashtu, Elion Agushi dhe Rona Gashi fituan medalje të bronzta, përkatësisht në kategoritë -74 kg dhe -57 kg.

## Studentët e Kosovës, kampionë të dyfishtë në Belgjikë

**26 PRILL** - Studentët e Kosovës në lojërat PCU të mbajtura në Antwerp të Belgjikës fituan vendin e parë në kategoritë M&F, duke përfaqësuar më së miri flamurin e Kosovës. Ekipet e Universitetit të Prishtinës, të cilat u koordinuan nga FSUNK-ja, fituan vendet e para në mesin e shumë universiteteve pjesëmarrëse. Ekipi i vajzave të UP-së triumfoi edhe përballë ekipit nga Serbia, duke fituar kështu këtë trofe të çmuar. Në këto lojëra morën pjesë 61 ekipe universitare.



### Katër medalje në Rumani nga garuesit e bodybuildingut dhe fitnessit

**28 PRILL** - Në Kampionatin Ballkanik në Timisoara të Rumanisë, garuesit e Reprerentacionit të Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës arritën katër medalje. Arsim Kullashi e fitoi medalje e Artë në kategori Bodybuilding +100 kg, dhe kampion absolut në Bodybuilding, Arbnora Racaj e fitoi të Artën në Senior Women Wellness, Arsim Qiriqi e rrëmbeu të argjendit në Muscular Men's Physique, derisa Edona Gashi e fitoi të argjendit në kategorinë Women Bikini Fitness + 166 cm. Metin Soydari e fitoi të bronzit, kategorija Junior Bodybuilding 16-20 vjeç dhe vendi i 6-të në Man's Classic Physique up to 175 cm dhe Erona Bajrami e mori vendin e katërt, kategorija Women Bikini Fitness -166 cm.

### Rahoveci dhe Kastrioti fitojnë titullin dhe Kupën te meshkujt, Istogu dhe Kastrioti te femrat

**28 PRILL** - KH Rahoveci është kampion i ri i Kosovës në hendboll në konkurrencën e meshkujve, pasi mposhti Besa Famgasin me rezultat 29:24 (21:11), në finalen e dytë të "play-off"-it të Superligës së Kosovës. Rahoveci me meritë mori titullin kampion për herë të parë në histori të ekzistimit të këtij klubi. Ndërsa KH Kastrioti e fitoi Kupën, duke e mposhtur në finale Besa Famgasin (34:32). Në konkurrencën e femrave, Istogu është kampion i Kosovës në hendboll për edicionin 2023/2024, ndërsa Kupën e fitoi Ferizaj që e mposhti në finale Istogun me rezultat 2:0 dhe në këtë mënyrë e ka fituar Kupën për herë të parë.

### Paragllajdisti Fanol Shala thyen rekord botëror në Turqi

**30 PRILL** - Paragllajdisti Fanol Shala, nga Klubi Aerounatik "Shqiponjat e Kastriotit", ka arritur rezultat të

jashtëzakonshëm në Kupën e Botës (seria e dytë) disiplina paragllajding precizion, të mbajtur në Alania të Turqisë. Fanoli u rendit i dyti nga 82 garues, me gjashtë pikë në total, por ajo që e veçoi më shumë ishte rekordi botëror. Fanoli pati gjashtë ulje radhazi me rezultat 1 cm (total 6 cm), duke thyer rekordin botëror, të konfirmuar pas garës edhe nga Federata Ndërkombëtare e Aeronautikës. Kosova më 15 shtator ka shënuar një sukses historik në garat (PGA World Cup) në finalen e Kupës së Botës duke u renditur ekipi i dytë më i mirë në botë pas përfundimit të pesë etapave. Migjen Shala, një nga garuesit më të dalluar, u radhit i 6-ti në botë, duke treguar një performancë të shkëlqyer. Fanol A Shala zuri vendin e 9-të, ndërsa Veton Sylaj u rendit në vendin e 11-të, kurse Gëzim Statovci u rendit në vendin e 61-të. Ky rezultat përforcon pozicionin e Kosovës si një fuqi në sportin e paragllajdingut, dhe është dëshmi e përkushtimit të ekipit dhe garuesve për të arritur suksese në nivele ndërkombëtar.

### KV Peja dhe KVF Drita shpallen kampione në volejboll

**10 MAJ** - KV Peja dhe KVF Drita fituan titullin e kampionit për edicionin 2023/2024, duke dëshmuar dominimin në volejbollin e Kosovës. Peja, në konkurrencën e meshkujve, mundi Skënderbeun, në serinë e finaleve, ndërsa vajzat e Dritës triumfuan ndaj Skenderajt.

### Ukrainasi Volodimir Melençuk, fitues i turneut 'Lah Nimani'

**19 MAJ** - Volodimir Melençuk nga Ukraina e ka fituar trofeun kryesor në edicionin e 16 të Turneut Ndërkombëtar në Boks "Lah Nimani". Melençuk e pranoi trofeun nga djali i trajnerit Lah Nimani, Istrefi. Boksierja me perspektive u shpall Anhelina Filipçuk, kurse gjyqtari më i mirë Pavlo Vazilinçuk. Epitetin e teknikut më të mirë e fitoi Ahmet Koçi nga

Shqipëria, kurse çifti më luftarak u shpall dyshja Angel Dimitrov nga Bullgaria e Norbert Parkosh nga Polonia. Boksieri më i mirë vendor u shpall Lumturim Xhoxhaj, kurse boksieri më i mirë i huaj Lisi Koxhaxhiku nga Maqedonia e Veriut.

### Balkani fiton titullin dhe Kupën te meshkujt, KFF Mitrovica te femrat

**23 MAJ** - FC Balkani dhe KFF Mitrovica fituan titujt e kampionit në elitën e futbollit të Kosovës. Balkani për herë të tretë rresht fitoi titullin, ndërsa u stolis për herë të parë me Kupën e Kosovës, duke vazhduar dominimin në sportin më masiv në vend. Vashat e Mitrovicës fituan Kupën, sukses që erdhi pasi arriti ta rrëmbejë titullin kampion.

### City, Reali, Interi, Leverkuseni dhe PSG-ja shpallen kampione në ligat më të forta

**19 MAJ** - Për të katërtin vit radhazi Manchester City fitoi titullin kampion në Angli. Fitorja me rezultat 3-1 ndaj West Hamit në shtëpi, bëri që skuadra e Guardiola të marrë trofeun e kampionit. Ky është titulli i 10

kampion për "Qytetarët". Real Madridi siguroi titullin në Spanjë pasi mposhti Cadizin (3-0), në anën tjetër Barcelona humbi nga Girona (4-2). Këtë sukses madrilenët e fituan katër javë pa përfunduar kampionati dhe është titulli i 36-të në histori të këtij klubi.

Në Serinë A, Interi e rrëmbeu titullin e kampionit, pas fitores në derbin "Della Madonnina" ndaj Milanit (1-2). Një gjë të tillë, "Nerazzurët" e bënë pesë javë pa përfunduar kampionati. Në Gjermani, Bayer Leverkuseni është skuadra kampione për sezonin 2023-2024 në Bundesligë. Ky është titulli i parë në historinë 120-vjeçare të klubit të Leverkusenis. Triumfoi 5-0 ndaj Werder Bremenit, bëri që të shpërthejë festa e çmendur nga tifozët kuqezinj. Një ecuri e pastër, 25 fitore në 28 ndeshje të Bundesligës të luajtura, katër barazime dhe asnjë humbje. Paris Saint-Germain festoi titullin e tretë radhazi dhe të 12 në histori. Pas humbjes 3-2 të Monacos në transfertën e Lyonit, PSG-ja është matematikisht kampione e Ligës 1 për sezonin 2023-2024.

### Real Madridi, Atalanta dhe Olympiacosi dominojnë Evropën

**1 QERSHOR** - Real Madridi vendosi një rekord të ri në Ligën e Kampioneve, duke fituar trofeun e 15-të të këtij kompeticioni, si askush tjetër deri më tani. Reali në finale e mposhti me rezultat 0-2 Borussia Dortmundin në "Wembley". Golat e fitores për "Los Blancos" i shënuan Carvajal dhe Vinicius, ndërsa Atalanta e fitoi Ligën e Evropës, duke e arritur suksesin më të madh në histori të klubit. Skuadra italiane e mposhti në finale kampionin e ri të Gjermanisë, Bayer Leverkusen (3-0). Golat i shënoi Ademola Lookman. Ndërkohe Olympiacosi e fitoi Ligën e Konferencës për edicionin 2023/24. Gjiganti grek e mposhti në finale Fiorentinën me rezultat minimal 1-0 pas vazhdimëve, kurse shënues ishte El Kaabi.

### Liridon Kalenderi renditet i pari në garën e autosportit në Çeki

**2 QERSHOR** - Liridon Kalenderi është renditur i pari në garën e mbajtur në Shternberk të Çekisë, e vlefshme për Kampionatin Evropian, duke lënë prapa garues me shumë përvojë, që kanë dominuar në këtë sport për vite me radhë. Kalendari ishte bindshëm më i shpejtë se përcjellësi më i afërt, Igor Stefanovski. Kalendari punën më të madhe e kreu në vozitjen e parë, në të cilën në cak arriti në kohën fantastike prej 03:08.372 minuta, ndërsa në të dytën pati kohë prej 03:20.406, derisa Stefanovski pati kohë prej 03:15.037 dhe 03:31.443 minuta. Në garën në Shternberk pjesëmarrës ishin edhe Valdet Kaçandolli e Përparim Dushi.

### Galperin Platon, fitues në Kampionatin e Hapur Ballkanik të Shahut

**14 QERSHOR** - Kryemjeshtri suedez Galperin Platon ka triumfuar në Kampionatin e Hapur Ballkanik të Shahut "Balkan & Prishtina Open 2024". Në këtë garë pjesëmarrës ishin shahistë më eminentë nga 17 shtete të Ballkanit, Evropës dhe Botës me 13 Kryemjeshtrë (GM), 5 Mjeshtër Ndërkombëtarë (IM), 8 Mjeshtër FIDE etj. Garat janë zhvilluar sipas sistemit zviceran me 9 xhiro. Duhet cekur se Endit Uruçi shënoi fitore kundër turkut Ozgun Sahin dhe me këtë fitore Uruçi tuboi 5.5 pikë dhe u rendit në pozitën e 11-të. Ai ishte njëherësh shahisti më i suksesshëm i Kosovës.

### Boston shpallet për herë të 18 kampion në NBA, Milwaukee fiton Kupën

**18 QERSHOR** - Boston Celtics është shpallur kampion i tetëmbëdhjetëfishtë i NBA-së. Keltët u bënë sërish klubi më i trofeshëm në ligën elitare







amerikane pasi mundën Dallas Mavericksat në finale, 4-1. Në ndeshjen e pestë të serisë ata fituan 106:88 në TD Garden, të udhëhequr nga Jason Tatum që pati 31 pikë e 11 asistime. Ndërkaq, Luka Donçiqi bëri aq sa mundi për klubin e tij, duke shënuar 28 pikë 12 asistime. MVP i finaleve u zgjodh Jaylen Brown i cili u spikat më së shumti përgjatë këtyre pesë ndeshjeve. Ndërsa Milwaukee Bucks fitoi Kupën e NBA-së duke mundur në finale Oklahoma City Thunder me rezultat 97:81. Milwaukee e kishte më të lehtë të merrte fitore pas një paraqitje të jashtëzakonshme nga Giannis Antetokounmpo, i cili regjistroi një performancë triple-double dhe u bë MVP i Kupës NBA. Ylli grek shënoi 26 pikë me 19 kërcime dhe 10 asistime në finale derisa Damian Lillard shtoi 23 pikë të tjera. Nga ana tjetër, Shai Gilgeous-Alexander shënoi 21 pikë për OKC, por që nuk mjaftuan për të marrë fitore.

**Gresa Bakraçi dhe Muhamet Ramadani fitojnë tri medalje në Gjibraltar**

**22 QERSHOR** - Federata e Atletikës e Kosovës ka marrë pjesë në Kampionatin e Shteteve të Vogla që është zhvilluar në Gjibraltar, ku fituan dy medalje të argjendta. Atletja Gresa Bakraçi fitoi dy medalje. Të argjendtë e fitoi në 1 500 metra, ndërsa të bronztën në 5 000 metra. Medaljen e argjendtë e fitoi edhe Muhamet Ramadani në hedhjen e gjyles.

**Spanja, kampione e Evropës. Shqipëria regjistron një barazim dhe dy humbje**

**14 KORRIK** - Spanja ka fituar Kampionatin Evropian të Futbollit "Euro 2024", pasi mposhti me rezultat 2-1 në finale Anglinë. Kjo është hera e katërt që Spanja shpallet kampione evropiane në futboll - më shumë se çdo kombëtare tjetër. Në finalen e zhvilluar në Berlin, më 14 korrik, Spanja kaloi e para në epërsi në minutën e 47 me një gol të Nico Williamsit. Por, në minutën e 73-të, Cole Palmer shënoi për Anglinë, duke barazuar rezultatit. Golin e fitores për Spanjën e shënoi Mikel Oyarzabal në minutën e 86-të, duke ia pamundësuar Anglisë që për herë të parë ta fitojë Kampionatin Evropian të Futbollit. Spanja kishte fituar Kampionatin Evropian të Futbollit edhe më 1964, 2008 dhe 2012, ndërsa rrugëtimi i Shqipërisë në Kampionatin Evropian "Gjermani 2024" mbyllet me një barazim ndaj Kroacisë dhe dy humbje ndaj Italisë dhe Spanjës.

**Mbappe, transferimi i vitit 2024**

**16 KORRIK** - Drama shumëvjeçare mori fund në verën e 2024-s, kur Kylian Mbappe edhe zyrtarisht u bë lojtari më i ri i Real Madridit. Francezi ka nënshkruar me gjigantin spanjoll një kontratë pesëvjeçare, sipas së cilës, do të mbetet futbollist i "Los Blancos"

deri në vitin 2029. Mbappe te Real Madridi transferohet si lojtar i lirë pasi kontrata e tij me PSG-në do të skadojë më 30 qershor të këtij viti.

**Rinovimi i tërësishëm i stadiumit 'Fadil Vokrri'**

**17 KORRIK** - Stadiumi "Fadil Vokrri" në Prishtinë ka pësuar ndryshime, pasi është rinovuar tërësisht fusha. Rikthimi i këtij stadiumi në funksion pas rinovimit u testua me sukses gjatë ndeshjes kualifikuese për "Euro 2025" ndërmjet Kosovës dhe Ukrainës.

**Kosova U18 kampione e EuroBasket, Divizioni C**

**28 KORRIK** - Kosova ka arritur triumf historik në FIBA U18 Women's Euro Basket, Divizioni C, duke fituar kampionatin që u zhvillua në Prishtinë nga 23 korriku deri më 28 korrik. Finalja u përmbyll në mënyrën më të mirë të mundshme për ekipin e vajzave të Kosovës, të cilat mposhtën Azerbajxhanin me rezultat 75:65 (27:24, 13:9, 24:17, 11:15). Ndërkaq, Shqipëria e mbylli kampionatin në pozitën e tretë, pasi në ndeshjen për medaljen e bronzit e mundi Qipron, me rezultat 70:55. MVP e Evropianit u shpall Flutra Mehmeti e Kosovës.

**Ndahen nga jeta Izet Gjinovci dhe Shqipe Bajçinca-Brestovci**

**5 GUSHT** - Në moshën 63-vjeçare është ndarë nga jeta Izet

Gjinovci, simboli i hendbollit kosovar. Gjinovci ishte sekretari i përgjithshëm i Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe ia ka kushtuar gjithë jetën sportit të hendbollit. Ai ka kontribuar në pavarësimin e sportit kosovar, ndërsa në vitet nëntëdhjeta, kur sporti kishte misionin e kundërvënies ndaj pushtuesit, është shquar me angazhimin e pandalshëm. Ishte pjesë e organizimeve të rëndësishme të hendbollit dhe pjesë e pandashme e tij. Pas një sëmundje të rëndë e të gjatë më 31 mars, ka ndërruar jetë Shqipe Bajçinca-Brestovci. Shqipja ishte anëtare e Bordit Ekzekutiv të KOK-ut dhe komisioneve të ndryshme në KOK si dhe anëtare e BE te Federata e Hendbollit e Kosovës, pedagoge në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, ndërsa gjatë karrierës 24-vjeçare si sportiste ishte marrë edhe me karate, atletikë dhe hendboll.

**Learta Muharremi fitoi Turneun Ndërkombëtar 'Peja Open' për U14**

**25 GUSHT** - Tenistja Learta Muharremi shkëlqeu në Turneun Ndërkombëtar "Peja Open", të mbajtur në Brestovik të Pejës. Learta u bë kampione në grupmoshën U14, duke dalë e para prej 19 garueseve, shumica të huaja. Ajo shënoi fitore bindëse, të gjitha 2:0 në sete, ndaj kundërshtareve nga ShBA, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe në finale mundi tenisten nga Mali i Zi. "Peja Open" është në kalendarin e Federatës Evropiane të Tenisit.

**Kosova për herë të parë në Lojërat Paralimpike, Grevist Bytyqi përfundoi i 15-ti**

**31 GUSHT** - Kosova ishte pjesëmarrëse në Lojërat Paralimpike në të cilat morën pjesë 4 000 atletë me dëmtime fizike, pamore dhe mendore, në 22 sporte. Atleti nga Kosova, Grevist Bytyqi, ka përfunduar pjesëmarrjen e tij në Lojërat Paralimpike në Paris. Bytyqi garoi në atletikë, në grupin T46, vrapim deri në 1 500 metra. Ai përfundoi i 15-ti në grupin e tij me kohë prej 4:32.88 – që është koha më e mirë personale e tij. Bytyqi, 33 vjeç, është atleti i parë që ka përfaqësuar Kosovën në Lojërat Paralimpike.

**Mbi 1 000 mijë pjesëmarrës në Prishtina Marathon 2024**

**22 SHTATOR** - Mbi 1 mijë pjesëmarrës kanë marrë pjesë në edicionin e 23-të të maratonës dhe gjysmëmaratonës "Prishtina 2024", të organizuar nga Federata Atletike e Kosovës. Maratonën 42-kilometërshe te vajzat e fitoi kampionia e Evropës në 3 000 metra me pengesa, shqiptarja Luiza Gega, ndërsa te djemtë vendi i parë shkoi për kenianin Shedrack Kimaiyo. Paraqitje të mirë patën edhe atletët tanë, të cilët u ngjitën në podium në disiplinat e tjera. Olimpistja Gresa Bakraçi zuri vendin e parë në 10 kilometra. Në 5 km, te meshkujt, vendin e parë e zuri Genc Isufi, ndërsa Valentina Kelmendi dhe





Merve Spahi u renditën në vendet 2 përkatësisht 3 te vajzat. Garat u mbajtën në disiplinën dykilometërshe, 5 km, 10 km, 21 km dhe maratonë 42 kilometra e 195 metra.

### Ekipi i karatesë së Kosovës arrin suksese në Sarajevë dhe Olbia të Italisë

**23 SHTATOR** - Tetë medalje, prej tyre katër të argjendta dhe po aq të bronzta është bilanci i suksesit të kombëtares së Kosovës në karate në Kampionatin Mesdhetar për seniorë, juniorë dhe kadetë, të mbajtur në Olbia të Italisë. Të argjendtën për seniorë e fituan vajzat në ekipore, si dhe Redona Gashi në individuale. Me të bronztën u stolisën Benjamin Shabani, Behije Mustafa dhe Elmedina Istogu. Te juniorët, medalje të argjendtë fituan Ensar Zejnullahu dhe Qëndresa Ibrahim, ndërsa të bronztën për kadete e fitoi Engjëllusha Isufi. Ndërsa Kosova ka fituar dy medalje të argjendta në Kampionatin Ballkanit të Karatesë që është mbajtur në Sarajevë. Fitues të medaljeve janë Artioli Shaqiri dhe Ermira Maqedonci. Afër medaljes ishin edhe shumë garues të tjerë që zunë vendet e pesta.

### Vajzat e Kosovës U17 kualifikohen në Ligën A për 'Euro 2025'

**5 NENTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës e vajzave U17 në futboll është kualifikuar në Ligën A për kualifikimet e Evropianit, pasi e ka mbyllur turneun kualifikues të Grupit B4 në pozitën e parë, me 4 pikë. "Dardanet" U17 për të tretin vit radhazi arritën të kualifikohen në Ligën A.

### Kosova me 'play-off' kërkon promovim në Ligën B, Shqipëria bie në Ligën C

**18 NENTOR** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll përfundoi e dyta në Grupin C me 12 pikë, kurse do të luajë "play-off" për t'u promovuar në Ligën B. Kundërshtarë e "dardanëve" në mars do të jetë Islanda. Ndërsa Shqipëria përfundoi në vendin e fundit Grupin B me vetëm shtatë pikë të grumbulluara dhe tash ka zbritur në Ligën C për edicionin e ri.

### Agron Kuka edhe një mandat në Komitetin Ekzekutiv të Federatës Evropiane të Xhudos

**23 NENTOR** - Kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, ka marrë besimin edhe për një mandat katërvjeçar si anëtar i Komitetit Ekzekutiv të European Judo Union (EJU). EJU mbajti Kongresin e 76, ku i pari i sportit më të suksesshëm në vend është zgjedhur të jetë pjesë e Komitetit Ekzekutiv në cilësinë e drejtorit sportiv. Presidenti i EJU-së u rizgjodh hungarezi Laszlo Toth.

### Verstappeni fiton titullin e katërt në Formula 1

**25 NENTOR** - Piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, ka siguruar titullin e botës në Formula 1 për vitin 2024 në Grand Prix të Las Vegasit, duke shënuar kampionatin e tij të katërt radhazi. Me dy raunde të mbetura, 27-vjeçari Verstappen vulosi titullin e pilotëve pasi përfundoi përpara sfiduesit më të afërt, Lando Norris të McLarenit. Verstappeni doli i pesti në rrugët e Las Vegasit, ndërsa Norrisi përfundoi

raundin e 22-të në vendin e gjashtë. Piloti i Mercedesit, George Russell, fitoi Çmimin e Madh të Las Vegasit në 50 xhiro.

### Josip Ziziq, boksieri më i mirë në turneun 'Adem Jashari'

**25 NENTOR** - Boksieri nga Kroacia, Josip Ziziq, u shpall boksieri më i mirë në Turneun e 26 Ndërkombëtar "Adem Jashari", në të cilin morën pjesë garues nga tetë shtete të ndryshme. Tekniku më i mirë u shpall Bashkim Bajoku, derisa çifti më luftarak Shpëtim Bajoku - Rumen Rumenov. Boksieri më ferplej u shpall Kristian Koço nga Shqipëria. Boksieri më i mirë në mirë u huaj Erik Katona nga Sllovakia dhe boksieri më i mirë vendor Taulant Jakupi.

### Sportistët e Kosovës në Muaythai i fituan shtatë medalje

**29 NENTOR** - Ekipi i muaythait i Kosovës fitoi shtatë medalje, prej tyre dy të arta, tri të argjendta dhe dy të bronzta. Të artat i fituan: Lindon Demiri (U-23) dhe u shpall ylli i së ardhmes, Lorik Mehmeti (U-16), të argjendtat: Dior Guda, Erdonit Alija (juniorë), Agnesa Veseli (U-23). Me të bronztën u stolisën Altina Topalli (U-23) dhe Orges Maliqi (junior), në Kampionatin Evropian të Muaythait të organizuar në Prishtinë, ku pjesëmarrës ishin 32 shtete.

### KH Rahoveci shkon deri në rrethin e tretë në Kupën Evropiane

**30 NENTOR** - Kampioni i Kosovës në hendboll, Rahoveci, ka pasur paraqitje dhe rezultate të mira në Kupa Evropiane, por është



## Viti i Granit Xhakës. Shqiptari, i 16-ti në renditjen e 'Topit të Artë'

**29 NENTOR** - Viti 2024 mund të vlerësohet lirisht si viti i futbollistit Granit Xhaka, i cili me Bayer Leverkusenin arriti të bëjë histori. Xhaka me Leverkusenin e fitoi Bundesligën dhe Kupën e Gjermanisë, derisa arriti edhe në finale të Ligës së Evropës, ku është mposhtur nga

Atalanta. Granit Xhaka është i nominuar për "Sportistin e Vitit" në Zvicër, si i vetmi futbollist, pasi në listë vijjnë nga sportet e tjera. Xhaka ka fituar tri herë çmimin e futbollistit më të mirë në Zvicër: 2017, 2022 dhe 2023. Xhaka ishte gjithashtu i 16-ti në renditjen e "Topit të Artë".

eliminuar në rrethin e tretë. Në raundin e dytë e eliminoi Bocholtin e Belgjikës, kurse në raundin e tretë u përballë me skuadrën e madhe rumune Minaur Baia Mare. Ndeshjen e parë Rahoveci e humbi 38:31, kurse të dytën e fitoi 40:35 dhe në këtë mënyrë u eliminua, duke mbetur i pakalueshëm raundi i tretë për klubet nga Kosova.

e financimit dhe përcaktimin e rolit të palëve të përfshira. Lojërat Mesdhetare 2030 janë ngjarja më e madhe multisportive ndërkombëtare në shtetin tonë.

### Federata e Motoçiklizmit e Kosovës pranohet në FIM

**6 DHJETOR** - Federata e Motoçiklizmit e Kosovës (FMKS) është bërë anëtare me të drejta të plota e Federatës Ndërkombëtare të Motoçiklizmit (FIM). Vendimi u mor në Asamblenë e Përgjithshme të FIM, të mbajtur në Palma de Majorca të Spanjës. "Ky është një moment historik për sportin e motoçiklizmit në Kosovë dhe një hap i madh përpara në afirmimin ndërkombëtar të federatës sonë dhe sportistëve tanë", ka njoftuar FMKS-ja.

### Thomas Bach vizitoi Kosovën

**9 DHJETOR** - Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, për herë të dytë e ka vizituar Kosovën. Vizita e të parit të sportit në botë është bërë me rastin e 10-vjetorit të



## Rodri fiton 'Topin e Artë'

**28 tetor** - Mesfushori spanjoll i Manchester Cityt, Rodrigo Hernandez Cascante, i njohur si Rodri, ka fituar "Topin e Artë" për vitin 2024. Në këtë garë Rodri mposhti tre yjet e Real Madridit, Vinicius Jr,

Jude Bellingham e Dani Carvajal, që zunë pozitën dy, tre, respektivisht katër. Ndryshe, Rodri në vitin 2024 fitoi Premierë Ligën me Manchester Cityn dhe Kampionatin Evropian me Spanjën.



# Gjmnastika po rritet, paraqitjet ndërkombëtare për çdo lëvdatë

27 NËNTOR - Aktiviteti i parë i Federatës së Gjmnastikës së Kosovës ishte në Turqi më 14 janar. Dymbëdhjetë gjmnaste nga ekipi i Kosovës janë trajnuar për shtatë ditë. Në këtë kamp gjmnastet kanë ndërtuar më shumë njohuri dhe përvojë në këtë fushë. Gjmnastet pjesëmarrëse: Hira Haziri, Fernaze Cakaj, Diellona Azemi, Jora Gërvalla, Sara Pllana, Rea Berisha, Bora Hoti, Vlera Gërguri, Elena Sefa, Vilëza Zeqiri, Kaltrina Thaqi dhe Valëza Rama. Më pas, për nder të Ditës së Pavarësisë së Kosovës, FGJK-ja ka organizuar aktivitetet për fëmijë "Gjmnastrada 2024". Në mars tri gjmnastet me perspektivë të madhe, Vilëza Zeqiri, Valëza Rama dhe Kaltrina Thaqi, kanë përfituar bursa nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) bashkë me 41 bursistë të rinj "Shpresa Olimpikë 2024". Më 12 prill kryetari i Federatës Ndërkombëtare të Gjmnastikës, Morinari Watanabe, e ka vizituar Kosovën, ku është takuar me kryetarin e Federatës së Gjmnastikës së Kosovës, Besim Halilaj, sekretarin e përgjithshëm Amir Tahiraga dhe nënkryetaren Sherife Qerimi, si dhe me ministrin e Sportit, Hajrulla Çeku dhe zëvendësministren Daulina Osmani. Në muajin maj Kosova për herë të parë mori pjesë në Kampionatin Evropian të Gjmnastikës, duke shënuar si një moment historik për vendin. Atmosfera ishte e ngrohtë dhe emocionuese, veçanërisht për shkak të statusit tonë si një shtet i ri. Garat u mbajtën me datë 2

maj për kategorinë seniore, ku Kaltrina Thaqi, Valëza Rama, dhe Vilëza Zeqiri treguan performancën e tyre të shkëlqyer. Ndërsa me datën 3 maj juniorët, gjithashtu, shkëlqyen Bora Hoti, Vlera Gërguri dhe Elena Sefa. Trajnerët dhe stafi i shoqëruar, duke filluar nga Abeliana Bregu dhe Arlind Shaqiri, deri te doktoresha Blerina Mema dhe shefja e delegacionit, Shera Aliçkaj Qerimi, treguan përkushtimin e tyre në prezantimin e ekipit për këtë ngjarje të rëndësishme. Nga 19 deri më 25 gusht ekipi i Kosovës mori pjesë në një kamp stërvitor intensiv në Sofja, Bullgari. Federata e Gjmnastikës e Kosovës nga data 26 deri më 29 shtator u përfaqësua nga gjmnastja Fiona Konxheli në Kupën Ballkanike "FIG Ballkan Cup in Rythmic Gymnastics", e cila është mbajtur në Budva të Malit të Zi. Më 24 tetor presidenti i FGJK-së, Besim Halilaj, së bashku me sekretarin gjeneral Amir Tahiraga, përfaqësuan Kosovën në Kongresin e 85 të International Gymnastics Federation - FIG në Doha të Katari. Më 30 tetor u mbajt Kampionati i Kosovës në Gjmnastikë Artistike, ku morën pjesë shumë gjmnastë e gjmnaste me performancat e tyre fantastike. Me sukses ekipi i gjmnastikës së Kosovës përfundoi garën ndërkombëtare Horizon Cup në Selanik të Greqisë në muajin nëntor. Sara Pllana arriti vendin e dytë në tra, kurse Fernaze Cakaj, të tretin në parter.



Gjithashtu Fernaze Cakaj është shpërblyer me kupën e 4-garëshit me një total prej 41.250 pikësh, vendi i tretë. Në 8-shen e më të mirëve u rënditën edhe Bora Hoti dhe Rea Berisha. FGJK-ja kthehet nga gara me gjithsej 7 medalje, një rezultat i shkëlqyer për ekipin tonë, përkundër konkurrencës shumë të lartë. Gjmnastet e Kosovës vazhdojnë të na bëjnë krenarë në arenën ndërkombëtare, pasi gjmnastja

Fernaze Cakaj nga KGj Vushtrria shkëlqeu në garën ndërkombëtare GAIA International Tournament në Portugali, duke fituar medaljen e argjendtë në katër-garësh. Klubet e gjmnastikës nga Kosova: Klubi Vushtrria, Klubi Elita, Klubi Fushë-Kosova dhe Klubi Omnisport shkëlqyen në turneun ndërkombëtar të 20 për Klube në Gjmnastikë, "Liubcho Solachky", që u mbajt në Bullgari.



anëtarësimit të KOK-ut në IOC. Bach gjatë kësaj vizite është takuar edhe me kryeministrin e Kosovës, Albin Kutli, ku kanë biseduar për progresin që Kosova ka bërë në fushën e sportit, arrijtjet e sportit tonë në 10 vjet të anëtarësimit në familjen e madhe olimpikë, me theks të veçantë pesë medaljet e olimpikë.

## 2 Korriku ië gjurmë në Ligën e Kampionëve për të Rinj

11 DHJETOR - 2 Korriku U19 ka lënë gjurmë në "UEFA YouthLeague". Djelmoshat e klubit nga kryeqyteti kishin kaluar dy raundet e para të "UEFA Youth League", duke

eliminuar Bylisin e Shqipërisë në raundin e parë dhe Dublinin e Irlandës në të dytin. Megjithatë, ata u eliminuan nga Dynamo Kyiv në raundin e tretë. 2 Korriku është eliminuar duke pësuar një tjetër humbje nga Dinamo Kiev U19 në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë, me rezultat 4-1, pasi në ndeshjen e parë kishte humbur 5-0 në Poloni.

## Usyk sërish mposhti Furyn, mbron titujt kampion bote në peshën e rëndë

22 DHJETOR - Oleksandr Usyk ka mposhtur për herë të dytë Tyson Furyn, për të mbajtur peshat e rënda WBC, WBO dhe WBA. Pas 12 raundeve pa një fitues të

qartë, me vendim unanëm 116-112, 116-112 dhe 116-123, gjyqtarët i dhanë fitoren boksierit ukrainas. Për Usyk, kjo është fitorja e dytë brenda vitit ndaj Furyt, ndërsa nuk do të ketë më përballje mes tyre, të paktën sipas kontratës së nënshkruar. Ukrainasi konfirmohet "mbret" i boksit dhe për momentin nuk njih rivalë.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Živo tne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

## NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore e kategorisë së Tretë me Aplikues: TDI Balkans SHPK – Z.K. Komoran- Gllgovc Kosovë, i autorizuar nga Vigan Iberdemaj me nr. të protokollit 3797/24 të dt. 10.06.2024 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar fotovoltaik dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Komoran, me numër të parcelave:

P-70314035-01264-1 ZK; P-70314035-01268-0 dhe P-70314035-01317-1 me sipërfaqe totale prej 565.016 m<sup>2</sup> që ndodhen në Komunën e Gllgovcit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e "Impianti fotovoltaik 45MW në Komoran" për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt. 13.01.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

### Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara: TDI Balkans SHPK "Impianti fotovoltaik 45MW në Komoran", Gllgovc

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual ( format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Tokë bujqësore - Kullosë i klasës 6 Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	1 - m'
c. Vija e ndërtimit.	6.00 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	5 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	5 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.44 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	93.5 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	1-1.5- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	24
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese

l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po  Jo   
Nuk aplikohet

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?

Po  Jo  Nuk aplikohet  Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po  Jo  Nuk aplikohet  Sqaro:

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Bio Krap" shpk, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Hurdhën e Peshkut Krap, në Herticë, Komuna e Podujevës. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.02.2025 në ora 11:00 në objektin e SHFMU "Rilindja" në fshatin Herticë, Komunës e Podujevës do të organizohet debat publik nga Kompania "Bio Krap" shpk, Podujevë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Bio Krap" shpk, Podujevë, për Hurdhën e Peshkut Krap, në Herticë, Komuna e Podujevës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnv.komente@rks-gov.net](mailto:vnv.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Dakaj-M" shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për për Zgjerimin e Zonës së Shfrytëzimit të Rërës dhe Zhavorrit, në Gllaviçicë, të Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.02.2025 në ora 10:00 në objektin e Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "Zef Serembe", fshati Gllaviçicë, komuna Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Dakaj-M" shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Dakaj-M" shpk, Pejë, për për Zgjerimin e Zonës së Shfrytëzimit të Rërës dhe Zhavorrit, në Gllaviçicë, të Pejës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnv.komente@rks-gov.net](mailto:vnv.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Flori Floring" shpk, Lipjan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin për prodhimin e Lajsneve dhe Folieve të Laminatit, në Konjuh, të Lipjanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.02.2025 në ora 09:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, rruga "Shqipëria" Lipjan, do të organizohet debat publik nga Kompania "Flori Floring" shpk, Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbkCoccsSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë Impiantin për prodhimin e Lajsneve dhe Folieve të Laminatit, në Konjuh, të Lipjanit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Ultra Cosmetics" shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabriken e Prodhimit të Pecetave të Lagura, në Vitomiricë, të Pejës

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.02.2025 në ora 11:30 në objektin e Shkollën Fillore e Mesme e Ulët "7 Shtatori", fshati Vitomericë, komuna Pejë, do të organizohet debat publik nga "Ultra Cosmetics" shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPr68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Ultra Cosmetics" shpk, Pejë, për Fabriken e Prodhimit të Pecetave të Lagura, në Vitomiricë, të Pejës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Investik Oil" shpk, Podujevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fermën e Rritjes së Shpezëve, në Balloc, Komuna e Podujevës. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 20.02.2025 në ora 10:00 në objektin e SHFMU "Ali Ajeti" në fshatin Balloc, Komunës e Podujevës do të organizohet debat publik nga Kompania "Investik Oil" shpk, Podujevë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPr68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Investik Oil" shpk, Podujevë, për Fermën e Rritjes së Shpezëve, në Balloc, Komuna e Podujevës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Solar Tec 4" shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun Solar Fotovoltaik me kapacitet 71.8 MW, në Zallç, të Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 19.02.2025 në ora 14:00 në objektin e Shtëpisë së Kulturës "Adem Jashari" kati i dytë - Istog, do të organizohet debat publik nga Kompania "Solar Tec 4" shpk, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/79707425669?pwd=nyA3L9s2OHdSGnuvgLPG0U48xqaePb.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Solar Tec 4" shpk, Prishtinë, për Parkun Solar Fotovoltaik me kapacitet 71.8 MW, në Zallç, të Istogut.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 30.12.2023 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qira.

### Shpallje Publike T-24-15

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça SH.A.  
Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000

Personi Kontaktes: Zyra e Shitjes dhe dhenies me qira  
E-mail: contact@trepcasha.com  
Telefoni: +381 28 538 050  
Faks: +381 28 539 202

#### Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qera e hapësirave, dhe objekteve ne Trepça SH.A.  
Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet Çmimi më i lartë  
Data e shpalljes: 31.12.2024  
Sqarimi: deri me 20.01.2025  
Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 20.01.2025  
Behet ne e-Mail: poshtë shënuar ose në zyrën e shitjes dhe qirasë.  
Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 20.01.2025 në 11:00  
Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë

#### Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës te pa paguara.

#### Shënime shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madhe apo i barabarte me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça SH.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks 1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

### Aneksi 1 OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T?)	

Përmbledhje		Çmimi
a	m <sup>2</sup>	
b	Çmimi për metër	
c = a * b	Çmimi me TVSH	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbytësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

### Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund te behet deri me datën 20.01.2025 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

### Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i asetëve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asetë jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e asetëve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e asetëve. Objekti është i ndarë në lote,

**Trepça Sh.A.** përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

### DHËNIE ME QIRA E HAPËSIRËS

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe varësisht nga llozet në të cilën do të vendosen do të bëhet llogaritja përfundimtare në faturim.

#### LOT 1

Njësia Biznesore: Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Depo e elektros-punëtorisë	550	1.20 €	660.00 €	118.80 €	778.80 €

#### LOT 2

Njësia Biznesore: Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e pa mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Parcela 3A	1000	0.59 €	590.00 €	106.20 €	696.20 €
2	Parcela 5A	1300	0.59 €	767.00 €	138.06 €	905.06 €
3	Parcela 8A	2400	0.59 €	1,416.00 €	254.88 €	1,670.88 €
4	Parcela 9A	1000	0.59 €	590.00 €	106.20 €	696.20 €

#### LOT 3

Njësia Biznesore: Industria Kimike						
Nr	Objekti	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Parcela 01090-2	5021.21	0.59 €	2,962.51 €	533.25 €	3,495.77 €
2	Parcela 01099-1	2818.5	0.59 €	1,662.92 €	299.32 €	1,962.24 €

#### LOT 4

Njësia Biznesore: Fabrika e Paisjeve të Procesit						
Nr	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar (m <sup>2</sup> )	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH (€)	TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
1	Depoja nr 4	140	1.20 €	168.00 €	30.24 €	198.24 €
2	Depoja e rimorkiove	180	0.88 €	158.40 €	28.51 €	186.91 €

Lejohet nën ndarja e një lloti në mes dy operatorëve ekonomik sipas çmimit më të lartë të ofruar nga njëri nga ofertuesit për lotin e njëjtë.



## Gëzuar Vitin e Ri nga Vida!

100%  
Fresh &  
Natural



Le të nisë viti i ri me freskinë dhe cilësinë e qumështit tonë, për një fillim të mbarë dhe plot energji!



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zubol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Gëzuar Vitin e Ri 2025!





# TRADITË QË NGA 1992



Gëzuar Vitin e Ri nga Meka!  
Për një vit plot shije dhe gëzime!